

**E DREJTA E JETËS. MBROJTJA E KËSAJ TË DREJTE
REFERUAR NENIT 2 KEDNJ. ÇËSHTJET E FETUSIT,
ABORTIT DHE EUTANAZISË.**

Afërdita Tepshi

Dorëzuar
Universitetit Europian të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoraturës në
Shkenca Juridike, me profil e Drejtë Publike, për marrjen e gradës shkencore
“Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof. Asoc. Dr. DARIEL SINA

Numri i fjalëve: 68,811

Tiranë, Maj 2016

DEKLARATA E AUTORËSISË

Nën përgjegjësinë time deklaroj se ky punim është shkruar prej meje, nuk është prezantuar asnjëherë para një institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar asnjëherë i tëri.

Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër, përveç rasteve të cituara dhe referuara.

ABSTRAKTI

E drejta për jetën është padyshim një nga të drejtat më të rëndësishme njerëzore, gëzimi i së cilës përbën dhe burimin e të gjitha të drejtave të tjera të derivuara prej saj. E drejta për jetën është një e drejtë e paderogueshme, e pandashme dhe e patjetërsueshme, e cila lidhet ngushtësisht me qenien njerëzore. E drejta për jetën për nga rëndësia renditet e para duke qenë një nga të drejtat themelore që lidhet me ekzistencën e njeriut, privimi arbitrarisht i së cilës do të kthente në inekzistente të gjitha të drejtat e tjera me karakter social dhe ekonomik. E drejta për të jetuar është një e drejtë themelore me fokus të gjerë, në të cilin përfshihen aspekte që kanë të bëjnë me çështje dhe aspekte të ndryshme. Punimi synon të sjellë një analizë të rëndësishme për të kuptuar se sa efektiv është legjislacioni i fushës për të realizuar të drejtën kushtetuese të jetës, si një nga të drejtat me të cilat individit lind, dhe si e drejtë e patjetërsueshme. Ai fokusohet në mënyrë të veçantë në disa elemente, si: trajtimi i mbrojtjes së të drejtës së jetës sipas nenit 2 KEDNJ-së, studimi i detajuar i jurisprudencës së Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, dhe në veçanti vendimet e fundit të saj, evidentimi i kufizimeve të së drejtës së jetës, konstatimi i zbatimit të legjislacionit kombëtar nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut dhe në mënyrë të veçantë në vendin tonë, evidentimi i akteve të tjera ndërkombëtare që mbrojnë të drejtën e jetës dhe shtrirja e fuqisë ligjore zbatuese të tyre, si dhe përcaktimi i termave dhe statusit të abortit dhe eutanazisë si kufizim i të drejtës së jetës. Një vlerë të veçantë në këtë studim kanë çështjet e sipërpërmendura në legjislacionin shqiptar, duke sjellë në mënyrë të detajuar analizën juridike të akteve ndërkombëtare dhe rajonale me rëndësi në këtë fushë, aktet ligjore të posaçme për garantimin e të drejtës së jetës. Fokus i këtij studimi ka qenë edhe jurisprudenca e paktë vendase lidhur me këtë të drejtë.

Fjalët kyçe: e drejta e jetës, Neni 2 KEDNJ, mbrojtje substanciale, mbrojtja procedurale, dënimi me vdekje, fetusit, aborti, eutanazia.

ABSTRACT

The right to life is undoubtedly one of the most important human rights, the exercise of which constitutes the source of all other rights derived from it. The right to life is a non-derogable right, indivisible and inalienable, which is closely related to human beings. The right to life ranks as the most important human right, as being fundamental to human existence, the arbitrary deprivation of which would repel all other rights of social and economic character. The right to life is a fundamental right with a wide focus, which includes different aspects and issues. The paper aims to bring important insight in order to understand how effective the legislation is regarding the exercise of constitutional right to life, as one of the rights to which an individual is born, and as an inalienable right. It focuses particularly on some elements, such as the protection of the right to life under Article 2-ECHR, the detailed study of the jurisprudence of the European Court of Human Rights, and in particular the recent evidences of decisions that limit the right to life, the analysis of the implementation of national legislation by the European Court of Human Rights, specifically in our country, the identification of other international acts that protect the right to life and the extent of labor law enforcement them, as well as to determine the terms and status of abortion and euthanasia as a limitation of the right to life. A significant value of this study is bringing the above issues in context of the Albanian legislation, by compiling a detailed legal analysis of international acts and their regional importance, in the regard of special laws guaranteeing the right to life. The focus of this study is also on the minimal national jurisprudence on this right.

Key words: right to life, Article 2-ECHR, substantial protection, procedural protection, death penalty, fetus, abortion, euthanasia.

DEDIKIMI

*Këtë punim ia dedikoj prindërve të dashur dhe familjes time, të cilët kanë qënë motivim i
përhershëm për t'ia arritur këtij qëllimi!*

FALENDERIME

Shpreh një falenderim të sinqertë për udhëheqësin tim shkencor, Dariel Sina, i cili ka qënë i pakursyer në kohë dhe përkushtim me këshillat e tij të vlefshme shkencore! Nuk mund të lë pa përmendur dhe ndihmën e paçmuar të Prof. Asoc. Dr Migena Leskoviku, Prof. Asoc. Dr Erjona Bana (Canaj) dhe Prof. Dr Romeo Gurakuqi.

PËRMBAJTJA E LËNDËS

KAPITULLI I. Hyrje dhe bazimi teorik.....	1
1. Hyrje.....	1
2. Objektivat e punimit.....	3
3. Pyetje dhe Hipoteza.....	4
4. Metodologjia e punimit.....	5
5. Rëndësia e studimit.....	7
6. Kufizimet e punimit.....	8
7. Përmbajtja e punimit	9

KAPITULLI II: E DREJTA E JETËS NË KUADRIN E TË DREJTËS NDËRKOMBËTARE. AKTET JURIDIKE TË MBROJTJES SË SAJ NË NIVEL UNIVERSAL, RAJONAL DHE KOMBËTAR

2.1 E drejta e jetës në aktet juridike ndërkombëtare në nivel universal.....	13
2.1.1 Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut.....	15
2.1.2 Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike.....	17
2.1.3 Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Ekonomike Sociale dhe Kulturore.....	19
2.2 Aktet juridike në nivel rajonal që mbrojnë të drejtën e jetës.....	21
2.2.1 Sistemi Evropian i mbrojtjes së të drejtës së jetës.....	21
2.2.1.1 E drejta jetës në legjislacionin e Bashkimit European.....	23
i) Karta e të drejtave themelore të njeriut e Bashkimit European...	25
ii) Jurisprudenca (e paktë) e GJED-së lidhur me të drejtën e jetës..	28
2.2.1.2 E drejta e jetës në aktet juridike të Këshillit të Evropës.....	30
i) Roli i KEDNJ-së për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të individëve në kuadër të respektimit të të drejtës së jetës.....	31
ii) Risitë e Draft-Protokollit 15 dhe 16 KEDNJ. Cështja e (mos)ratifikimit nga Shtetet dhe situata e Shqipërisë.....	33

iii) Roli i GJEDNJ-së në respektimin e të drejtës së jetës	35
2.3 E drejta e jetës, e drejtë kushtetuese në Shqipëri.....	37
2.3.1 Raporti i KEDNJ-së me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë	40

KAPITULLI III: MBROJTJA E JETËS NË STANDARTET E NENIT 2 KEDNJ DHE PROTOKOLLEVE SHITESË

3.1 E drejta e jetës, kuptimi dhe natyra e saj.....	43
3.1.1 Mbrojtja e të drejtës së jetës në planin substancial sipas KEDNJ-së.....	47
3.1.2 Aspektet e mbrojtjes procedurale që ofron Konventa për të drejtën e jetës...51	
3.2 Kufizimet e të drejtës së jetës sipas KEDNJ-së.....	57
3.3 Detyrimet pozitive të shtetit për të mbrojtur jetën sipas KEDNJ-së.....	63
3.3.1 Mbrojtja ndaj trajtimeve të dëmshme mjekësore.....	64
3.3.2 Mbrojtja nga Policia.....	66
3.3.3 Mbrojtja e të burgosurve dhe e personave në paraburgim.....	68
3.3.4 Zhdukjet.....	70
3.3.5 Mbrojtja kundër rreziqeve mjedisore që janë kërcënuese për jetën e individit.....	75
3.3.6 Dëbimi ku si pasojë mund të rezultojë vdekja e individit.....	77
3.4 Çështja e dënimit me vdekje.....	79
3.4.1 Dënimi me vdekje dhe ekstradimi.....	82
3.4.2 Çështja Rrapo kundër Shqipërisë.....	83
3.4.3 Çështja e dënimit me vdekje në Shqipëri.....	85

KAPITULLI IV: E DREJTA E JETËS: ÇËSHTJA E FETUSIT DHE ABORTIT

4.1 Vështrim i përgjithshëm mbi konceptet e jetës dhe të abortit.....	89
4.2 Debati bashkëkohor mbi momentin e fillimit të jetës.....	90
4.2.1 E drejta për të mos lindur (veçse i shëndetshëm).....	93
4.3 E drejta e jetës dhe aborti.....	95
4.3.1 Momenti i debatueshëm i fillimit të jetës.....	97
4.3.2 Çështja e ligjshmërisë së abortit	100
4.3.3 Ndërprerja e shtatzënisë pa pëlqimin e gruas.....	103
4.4 Vështrim i shkurtër mbi rregullimin ligjor të abortit në vende të ndryshme	106
4.5 Rregullimi i abortit në Shqipëri. Analize e Ligjit Nr. 8045, datë 7.12.1995 “Për ndërprerjen e shtatëzënisë”	109
4.5.1 Diskutime mbi problematikat aktuale në vendin tonë: aborti selektiv.....	114

KAPITULLI V: E DREJTA E JETËS versus EUTANAZIA

5.1 Vështrim i përgjithshëm historik mbi konceptin e eutanazisë.....	117
5.2 Parimet e eutanazisë: universaliteti dhe utilitarizmi.....	119
5.3 Llojet e eutanazisë dhe cilësimi ligjor i tyre.....	120
5.3.1 Eutanazia aktive.....	121
5.3.2 Eutanazia pasive.....	123
5.3.3 Eutanazia vullnetare dhe jo vullnetare.....	124
5.3.4 Eutanazia indirekte dhe doktrina e efektit të dyfishtë.....	126
5.3.5 Vetëvrasja e asistuar.....	128
5.3.6 Urdhërat DNR si një formë eutanazie pasive.....	129
5.4 Kuptimi i Eutanazisë në bazë të nenit 2 KEDNJ.....	131
5.5 Jurisprudenca e paktë e GJEDNJ-së lidhur me eutanazinë.....	133
5.5.1 Çështja Dianne Pretty kundër Mbretërisë së Bashkuar	134
5.5.2 Çështja Lambert.....	136

5.6 Rregullimi ligjor i eutanazisë në vende të ndryshme europiane.....	137
5.7 Debati mbi eutanazinë në Shqipëri.....	144
5.8 Argumentet kundër aplikimit të eutanazisë në vendin tonë.....	147
5.8.1 Argumentet fetare.....	148
5.8.2 Argumentet etike.....	150
5.8.3 Argumente filozofike.....	151
5.8.4 Argumentet praktike dhe teoria e shpërndarjes së drejtë të burimeve mjekësore.....	152
5.8.5 Argumentet bazuar në të drejtat.....	153

KAPITULLI	VI
Konkluzione.....	155
Rekomandime.....	166
Bibliografia.....	169

KAPITULLI I: HYRJE

1. Hyrja dhe bazimi teorik

E drejta për jetën është padyshim një nga të drejtat më të rëndësishme njerëzore, gëzimi i së cilës përbën dhe burimin e të gjitha të drejtave të tjera të derivuara prej saj. E drejta për jetën është një e drejtë e paderogueshme, e pandashme dhe e patjetërsueshme e cila lidhet ngushtësisht me qenien njerëzore. E drejta për jetën për nga rëndësia renditet e para duke qenë një nga të drejtat themelore që lidhet me ekzistencën e njeriut, privimi arbitrarisht i së cilës do të kthente në inekzistente të gjitha të drejtat e tjera me karakter social dhe ekonomik.

E drejta për të jetuar është një e drejtë themelore me fokus të gjerë, në të cilën përfshihen aspekte që kanë të bëjnë me çështje të ndryshme. Këto aspekte lidhen direkt ose indirekt, jo vetëm me dinjitetin dhe cilësinë e jetës, por edhe me të drejtën për të jetuar. Subjektet që detyrohen nga ligji për të garantuar të drejtën për të jetuar janë të shumtë dhe realizojnë mbrojtje të posaçme, të veçantë, konkrete, apo të përgjithshme. Në krye të tyre subjekteve qëndron Shteti. Për këtë qëllim ai ndërton, institucionalizon, modernizon dhe monitoron mekanizmat, strukturat kapilare në çdo sektor të jetës, mjetet dhe metodat, kushtet dhe mundësitë për funksionimin efektiv të tyre. Në kuadrin e realizimit të këtij misioni merr përparësi parandalimi i kriminalitetit kundër jetës. Suksesi i shtetit nuk mund dhe nuk duhet të matet me nivelin e masave për përballimin e situatave, apo ngjarjeve kriminale që shoqërohen me vdekje, por me reagimin për parandalimin e tyre në kohë.

Për shkak të rëndësisë së padiskutueshme të saj, e drejta për jetën gëzon një mbrojtje të posaçme nga instrumentet kombëtare dhe ndërkombëtare. Duket sikur instrumentet ndërkombëtarë në lidhje me të drejtën e jetës i kushtojnë më shumë rëndësi cilësisë së të jetuarit si proces se sa ekzistencës së jetës si gjendje. Ato ndalojnë heqjen në mënyrë arbitrare të jetës por në disa raste dhe në disa shtete e legjitimojnë atë, duke e kufizuar me anë të lejitimit të dënimit me vdekje, në raste specifike të përcaktuara nga vetë ligji i brendshëm. Po ashtu, dhe aborti dhe eutanazia si procese të rëndësishme të jetës dhe

ekzistencës së njeriut, janë një konflikt i hapur dhe i vazhdueshëm në raport me rëndësinë e jetës si proces. Aborti është shkatërrimi i qëllimtë i fetusit në mitër apo çfarëdo lindje para kohe me qëllim që të shkaktohet vdekja e fetusit. Qëllimi është që të përfundohet jeta e krijesës, që e bën abortin temë të diskutueshme edhe në ditët e sotme.

Aborti në vetvete mbetet një çështje delikate. Ai prek nga ana tjetër edhe të drejtat e grave. Në të gjithë botën, aborti është një temë që ka provokuar shumë diskutime dhe debate.

E drejta e mbrojtjes së jetës së embrionit nuk garantohet nga shumica e legjislacioneve ndërkombëtare, sepse abortin nuk e konsiderojnë akt penal, por si e drejtë e gruas që të vendosë për fatin e frytit të saj. Edhe në Shqipëri aborti rregullohet nga Ligji për Abortin. Ky ligj respekton të drejtën e gruas që të marrë vendim të pavarur. Ligji në fjalë ka si qëllim të respektojë në mënyrën e duhur jetën njerëzore si dhe të rregullojë mënyrën e duhur dhe institucionet me të cilat shoqëria riprodhohet; të garantojë barazinë e plotë për gratë dhe t'iu përgjigjet kërkesave të arsyes publike duke mënjanuar në të njëjtën kohë efektet dhe doktrinat e tjera ideologjike apo teologjike që mund të ndikojnë mbi të me argumente të tjera.

Në këtë punim do të trajtojmë edhe një sërë çështjesh: si e drejta e personit për të zgjedhur vdekjen për shkaqe objektive duke kaluar në plan të dytë të drejtën e jetës (eutanzia). Eutanazia si një mënyrë e ndërprerjes së jetës ende është një nga debatet më të nxehta, nëse do të konsiderohet një veprim arbitrar apo jo, pasojat juridike të këtij veprimi, e drejta ligjore dhe morale për të kërkuar mbështetje nga persona të tjerë për kryerjen e një veprimi të tillë, dhe përgjegjësia e tyre sipas legjislacionit penal. Legjislacioni shqiptar ka mangësi në këtë drejtim, pasi duke mos dalë me një dispozitë konkrete për eutanazinë, lë shteg për abuzime lidhur me cilësimin ligjor të veprës duke u shkelur të pandehurve të drejtat e tyre proceduriale dhe materiale.

2. Objektivat e punimit

Me anë të këtij punimi synohet të analizohen zgjidhjet me të mira të parashikuara nga legjislacioni kombëtar dhe ndërkombëtar. Një shoqëri e lirë përmban në vetvete si interes parësor të drejtat e individit. Duke iu referuar zhvillimeve historike të shoqërive, preokupacioni kryesor i të drejtës ka qenë afirmimi i lirive kundrejt krijimit të legjislacionit dhe strukturave juridike që nënkuptojnë në vetvete realizimin dhe garantimin e tyre. Objektivat e punimit përmes të cilit synohet të përmbushet qëllimi i këtij studimi synon të shohë nëse dinamikat e qëndrimit dhe trajtimit ndaj të drejtës së jetës në rastet e fetusit dhe të eutanazisë karakterizohen nga tendenca drejt respektimit ose jo të kësaj të drejte. Studimi tenton të qartësojë gjithashtu faktorët që përcaktojnë prirjet dhe tendencat në qëndrimin dhe trajtimin e kësaj të drejte. Objektivat e këtij punimi janë:

- Trajtimi i mbrojtjes së të drejtës së jetës sipas nenit 2 KEDNJ-së
- Studimi i detajuar i jurisprudencës së Gjykatës Europiane e të Drejtave të Njeriut dhe në veçanti vendimet e fundit të saj.
- Evidentimi i problematikave kryesore të të drejtës së jetës.
- Analiza e detajuar e jurisprudencës së Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut kundër Shqipërisë si dhe zbatimi i standarteve të vendosura nga Këshilli i Europës nga vendi ynë.
- Evidentimi i akteve të tjera ndërkombëtare që mbrojnë të drejtën e jetës dhe shtrirja e fuqisë ligjore zbatuese të tyre.
- Përcaktimi i termave dhe statusit të abortit dhe eutanazisë si kufizim i të drejtës së jetës.

Realizimi i objektivave të punimit ndihmon në transmetimin e informacionit mbi çështjet e mbrojtjes së të drejtës së jetës, abortit dhe eutanazisë.

3. Pyetjet kërkimore dhe Hipotezat e studimit

Tema në tërësi do të fokusohet në shpjegimin e rrugëtimit që ka ndjekur evoluimi i të drejtës së jetës, duke u ndalur në fillesat e saj, trajtimin e instrumentave juridike ndërkombëtarë dhe europianë. Analiza jonë konsiston në përmirësimet dhe evoluimin ligjor të të drejtës së jetës në vendin tonë. Megjithatë, pavarësisht objektivit të përgjithshëm ishte e nevojshme të rendisnim dhe disa objektiva të tjera që na kanë udhëhequr që në fillimet e kësaj inisiative shkencore.

Studimi që do të ndërmarrim në këtë fushë ka karakter studimor dhe synon të evidentojë risitë, konceptet shkencore, por dhe përmirësimet të cilat duhet ta pasojnë atë.

Punimi është një analizë e rëndësishme për të kuptuar se sa efektiv është legjislacioni i fushës në realizimin e të drejtës kushtetuese të jetës, si një nga të drejtat me të cilat individit lind dhe si një e drejtë e patjetërsueshme. Gjatë punimit kemi trajtuar dhe sfidat me të cilat përballet legjislacioni ndërkombëtar dhe ai kombëtar në lidhje me respektimin e të drejtës së jetës.

Për të analizuar këtë tematikë kemi ngritur fillimisht disa pyetje kërkimore të cilat janë:

1. Cili është kuptimi i jetës, kur fillon dhe mbaron ajo?
2. Cilat janë instrumentat juridikë ndërkombëtarë dhe europianë në lidhje me njohjen dhe zbatueshmërinë e të drejtës së jetës në nivel global dhe cili është roli i tyre?
3. A është përqasur legjislacioni shqiptar me atë evropian në lidhje me të drejtën e jetës? Po në lidhje me abortin? A mund të thuhet e njëjta gjë edhe për eutanazinë?
4. Cilat janë problematikat që shfaq shoqëria shqiptare lidhur me abortin?
5. Cilat janë disa çështje që lidhen me dënimin me vdekje?
6. Çfarë është Eutanazia? Cila është eksperiencia e vendeve të ndryshme lidhur me eutanazinë?
7. A duhet të lejohet dhe të ketë një përjasje të të gjitha legjislacioneve për pranimin e eutanazisë?
8. A lejohet eutanazia në Shqipëri? A rregullohet ajo në legjislacionin tonë?
9. Cili është orientimi i GJEDNJ-së lidhur me respektimin dhe garantimin e të drejtës së jetës në Shqipëri?

10. Çfarë ka konstatuar GJEDNj-ja për respektimin e të drejtës së jetës në Shqipëri?

Punimi është realizuar gjithashtu edhe për qëllime kontributive modeste akademike, si një studim i mirëfilltë që trajton të drejtën e jetës.

Hipoteza

Hipoteza 1. E drejta e jetës është një nga të drejtat më të rëndësishme dhe të pacënueshme në vendin tonë, me gjithë problematikat që ajo has në mënyrë të veçantë në Shqipëri.

Hipoteza 2. Për respektimin e të drejtës së jetës nevojiten si reforma ligjore, ashtu edhe mekanizma zbatues efektivë. Sa i takon kësaj pjese, vendi ynë duhet t'u sigurojë të drejtën e jetës shtetasve të vet, me të gjitha mënyrat përfshirë këtu edhe nga gjykatat, të cilat janë tepër të rëndësishme për zbatimin e kësaj të drejte themelore.

Hipoteza 3. Aborti në moshë të vogël dhe aborti selektiv është një nga çështjet që prek në mënyrë të drejtpërdrejtë vendin tonë.

Hipoteza 4. Sa i takon fenomenit të eutanazisë, mendoj se nuk është ende koha për përfshirjen e saj në legjislacionin tonë.

4. Metodologjia e punimit

Për të arritur objektivat e këtij punimi ishte e rëndësishme hartimi i një metodologjie të bazuar në disa metoda të kërkimit shkencor. Hartimi i saj na adresoi disa objektiva të ndërmarra nga një pikëpamje subjektive dhe duke i bazuar ato mbi disa norma dhe institute themelore kombëtare dhe ndërkombëtare, të tilla si: respektimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, mbi të drejtën për të jetuar, të drejtën për të vdekur dhe të drejtën e abortit.

Një ndër metodat e përdorura është *metoda e analizës së legjislacionit* më anë të së cilës kemi arritur të evidentojmë problemet ligjore. Normat juridike në sistemin tonë ligjor janë të sanksionuara në kode, ligje dhe vendime, analizimi i të cilave na ka ardhur në ndihmë të parashtrojmë dhe rekomandimet tona në lidhje me problematikat e evidentuara. Kjo metodë na vjen në ndihmë për të sqaruar dhe paqartësitë e normave, vendosjen e tyre në një rend koherent dhe të analizojmë ndërveprimin e normave të brendshme me ato ndërkombëtare. Pjesë e rëndësishme e studimit ka qenë dhe analiza e legjislacionit ndërkombëtar duke mundësuar një krahasim me sistemin e brendshëm në lidhje me të drejtën e jetës dhe çështjet e abortit. Gjatë hartimit të punimit kam përdorur metodat shkencore bashkëkohore. Si të tilla, ashtu kam përfshirë analizën dhe sintezën, që janë dy metodat universale të njohjes. Analiza përfaqëson në punim ndarjen e objektit që studiohet në pjesën e tij përbërëse. Ndërkohë, sinteza përfaqëson një bashkim përmbledhës të elementëve të objektit të studimit. Analiza dhe sinteza në punim janë në unitet me njëra tjetrën.

Kemi përdorur *metodën e kërkimit doktrinar* e cila konsiston në gjetjen e literaturës së përshtatshme për realizimin e punimit në përputhje me objektin e tij. Përdorimi i kësaj metode konsiston në gjetjen e librave, punimeve të ndryshme, artikujve shkencorë të autorëve vendas apo të huaj që kanë hulumtur në këtë fushë. Gjithashtu, ndër metodat e përdorura janë edhe metoda *empirike* dhe ajo *krahasimore*. Përmes metodave kërkimore dhe shkencore është tentuar nxjerrja në pah e karakteristikave dhe parimeve kryesore të së drejtës së jetës, abortit dhe së drejtës për të vdekur.

Metoda e analizës së praktikës gjyqësore është përdorur në punim me synimin për të parë mënyrën e interpretimit dhe zbatimit në praktikë të normave ligjore në lidhje me mbrojtjen e të drejtës së jetës dhe abortit.

Një metodë tjetër po aq e rëndësishme është *metoda cilësore e intervistës* e realizuar kjo muajt e fundit. Intervista është zhvilluar në funksion të hipotezës së tretë e cila kërkon jo vetëm analizë të legjislacionit por edhe evidentimin në praktikë të problematikave që lidhen me abortin në vendin tonë. Intervista është shtrirë në dy spitale shtetërore në rrethin e Tiranës dhe në disa klinika private në rrethin e Tiranës dhe të Durrësit. Të intervistuarit janë mjekë obstetër gjinekologë.

5. Rëndësia e studimit

Rëndësia e këtij punimi është e shumëfishtë. Së pari, nëpërmjet rishikimit të kujdesshëm të literaturës hidhet dritë mbi faktorët të cilët kanë çuar në mungesën e zbatimit të normave ligjore për respektimin e të drejtës së jetës në të drejtën kombëtare por dhe të asaj ndërkombëtare. E drejta e jetës është një nga të drejtat më sublimë, pa ekzistencën e të cilës asnjë nga të drejtat e tjera nuk do të merrnin jetë. Në kontekstin e këtij hulumtimi e pashë me rëndësi studimin e kësaj të drejte për këto arsye:

Së pari, sepse kjo e drejtë lidhet ngushtësisht me ekzistencën e njeriut dhe është pjesë tejet e rëndësishme e të drejtave të njeriut;

Së dyti, e drejta e jetës shfaq karakter sensitiv.

Së treti, sepse e drejta e jetës përfshin shumë elementë të cilët mbartin problematika të ndryshme. Në kuadrin e tyre përfshihet edhe vendi ynë.

Edhe pse një nga të drejtat më të rëndësishme me karakter ekzistencial, vlen të theksohet se trajtimi i kësaj të drejte është i kufizuar dhe kjo vërtetohet me anë të mungesës së punimeve të ngjashme vendase në këtë fushë, gjë që ka bërë që shpesh në shtjellimin e këtij punimi, të hidhet dritë mbi koncepte të patrajuara më parë. Në lidhje me abortin dhe eutanazinë, ka qenë e vështirë për të krahasuar rastet analoge me rastin shqiptar në kontekst, kjo si rezultat i vakumit legjislativ dhe mungesës së praktikës gjyqësore, e cila do të bënte të mundur një artikulum të një niveli tjetër të konceptit të eutanazisë dhe fetusit. Si rezultat i një studimi disa vjeçar në fushën e të drejtës publike dhe si studiuese në fushën e të drejtave të njeriut, e konsiderova të rëndësishëm trajtimin e të drejtës së jetës, jo vetëm duke e parë si një nga të drejtat më të rëndësishme të njeriut, por dhe duke konstatuar boshllëkun informativ në këtë fushë me synimin e sjelljes së një kontributi dhe pasurimit të literaturës së munguar. Me anë të këtij punimi synohet të kontribuohet në zgjerimin e njohurive mbi politikat dhe problematikat në lidhje të drejtën e jetës si një nga elementët e të Drejtave të Njeriut. Një numër institucionesh dhe organizatash ndërkombëtare vazhdimisht e kanë klasifikuar Shqipërinë si një vend problematik përse i takon politikave për respektimin e të drejtave të njeriut, duke i tërhequr asaj vëmendjen për një angazhim

më të madh dhe realizim të politikave që stimulojnë rritjen e shkallës së respektimit të të drejtave të njeriut.

Në Shqipëri është konstatuar se të drejtat e njeriut shkelen në mënyrë të herëpërhershme jo vetëm nga persona individualë, por edhe nga grupe sociale, institucione, apo strukturat qeveritare. Në mënyrë konstante dhe të përhershme, media dhe përfaqësues nga komuniteti mjekësor në Shqipëri kanë vënë në dukje nivelet e larta dhe tendencat në rritje të aborteve në Shqipëri. Nga ana tjetër shtrohet pyetja se pse shoqëria shqiptare qëndron larg praktikimit të eutanazisë? Në Shqipëri është e vështirë gjetja e ndonjë gjurme të praktikimit të eutanazisë qoftë edhe për arsye dokumentacioni, por përjashtohet mundësia që eutanazia të jetë praktikuar edhe në Shqipëri në rrugë informale, duke qenë se fenomeni i munguar i eutanazisë në Shqipëri shpjegohet me mosqenien pjesë e traditave dhe kulturës shqiptare. Ashtu siç dhe kemi theksuar më sipër, kontributi shkencor për sa i përket konceptimit dhe trajtimit ligjor të së drejtës së jetës lë për të dëshiruar, duke krijuar kështu mungesë informimi dhe boshllëk ligjor në trajtimin e mbrojtjes së kësaj të drejte.

Në legjislacionin shqiptar vërehet një hendek midis praktikave të abortit dhe eutanazisë, edhe pse ligjet dhe institucionet shqiptare kanë lëvizur drejt përqafimit të standarteve ndërkombëtare, të vendosura nga aktet dhe institucionet ndërkombëtare, dhe të pranura nga shtetet kombëtare, kontribuese të akteve ndërkombëtare dhe anëtare të institucioneve ndërkombëtare. Miratimi i këtyre akteve reflekton në mënyrë direkte një paqartësi përsa i takon preçizimit të praktikave që ato inkurajojnë apo dekurajojnë. Kjo situatë shpjegon shkallën e ulët të praktikimit të eutanazisë.

6. Kufizimet e punimit

Realizimi i këtij hulumtimi shoqërohet me një varg kufizimesh të rëndësishme, duke qenë se ky punim ka një fokus të gjerë, siç është e drejta e jetës dhe nuk mund ta konsiderojmë dot një punim shterues për asnjë nga çështjet e analizuara. Në këtë kontekst, ky hulumtim konsiderohet si një punim i cili hedh dritë mbi disa koncepte të pathelluara nga legjislacioni Shqiptar, mbi të cilin mund të mbështeten punime të tjera të ngjashme në të ardhmen, ku këto koncepte mund të parashikohen nga legjislacioni Shqiptar.

Fusha në të cilën shtrihet studimi ynë është e gjerë, por karakterizohet nga kufizime në kohë dhe hapësirë. Kufizimet kohore i referohen periudhës në të cilën kemi aktet e para të dokumentuara që mbrojnë të drejtën e jetës, që ndalojnë/lejojnë abortin dhe lejojnë aplikimin e eutanazisë.

Kufizimet në hapësirë (shtrirje gjeografike) i përkasin faktit që nuk kemi një legjislacion të unifikuar dhe të detyrueshëm për të gjitha vendet. E drejta e jetës, ligji mbi abortin nuk është i njëjtë për çdo vend duke qenë se shtete të ndryshme nuk kanë aderuar ende dhe nuk janë ende pjesë e akteve me karakter ndërkombëtar në lidhje me sigurimin e të drejtës së jetës. Kjo sjell dhe mosrespektimin në mënyrë të njëtrajtshëm të çështjeve të sipër përmendura. Por sa i përket eutanazisë, duhet thënë se kufizimet janë më të larta duke qenë një temë e ndjeshme, pavarësisht se duhet të konsiderohet si një realitet i pranueshëm tashmë, ende shumica e vendeve e konsideron tabu dhe nuk ka një rregullim ligjor për të.

Një tjetër kufizim që vlen të përmendet është edhe fakti se intervistat lidhur me problematikat e abortit në vendin tonë janë kryer në klinika shtetërore dhe private në rrethet Tiranë dhe Durrës, në pamundësi kohore për t'u shtrirë më tej.

Çështjet e abortit, fetusit dhe eutanazisë kanë qenë të vështira për të krahasuar rastet analoge me rastin shqiptar në kontekst, për shkak të mungesës së praktikës gjyqësore, e cila do të bënte të mundur një artikulum të një niveli tjetër të konceptit të eutanazisë dhe fetusit.

7. Përmbajtja e punimit

Punimi do të ketë si synim kryesor të analizojë të drejtën e jetës në kuadrin e KEDNJ-së, duke dhënë kuptimin e të drejtës për jetën, duke analizuar standartin e provës si dhe kufizimet të cilat lidhen me kuptimin e të drejtës së jetës. Gjithashtu, do të trajtojë mbrojtjen e posaçme që ligji i jep jetës duke dënuar veprimet që çenojnë atë, si dhe duke u përpjekur të japë një analizë për problemin dhe detyrimin për të hetuar vdekjen dhe shkaqet e saj. Në lidhje me të drejtën e jetës, do të trajtohet edhe koncepti apo fenomeni i “zhdukjes” si vepër penale, që në vetvete ka të bëjë me privimin e individit nga liria, të kryer nga organet shtetërore, qoftë me dijeninë apo indiferentizmin e tyre. Në vijim të punimit do të shqyrtoj masat mbrojtëse procedurale, të nevojshme për një hetim të plotë të

ngjarjes që ka cënuar jetën apo të shkakut të vetë humbjes së jetës, në kuadër të mbrojtjes së saj. Një trajtim i hollësishëm do t'i kushtohet detyrimeve pozitive për mbrojtjen e jetës, siç janë: a) mbrojtja nga policia; b) trajtimi mjekësor; c) mbrojtja e të burgosurve; d) rreziqet mjedisore; e) dëbimi. Për sa i përket përjashtimeve të lejuara për cënimin e të drejtës së jetës, punimi do të përmbajë analizën e elementeve që Konventa sanksionon si parakusht përpara se të përdoret forca vdekjeprurëse. Trajtesa me interes do të jenë gjithashtu edhe disa çështje të debatueshme në shoqërinë tonë, siç janë : “dënimi me vdekje”, “aborti”, “eutanazia”. Sigurisht, përfundimet do të synojnë të bëjnë një përmbledhje të punimit, duke ndarë në pika aspektet kryesore të analizës shkencore të së drejtës së jetës. Hulumtimi është konceptuar i ndarë në pesë kapituj, përmbledhjen e të cilëve do ta trajtoj si më poshtë:

Kapitulli i parë është kreu prezantues që përshkruan sfondin e studimit. Ky kapitull përfshin hyrjen, e cila përbën pjesën paraqitëse të punimit, të punës së bërë për realizimin e tij, të bazës teorike, të literaturës së shfrytëzuar, qëllimin dhe objektivat e studimit, hipotezën si dhe pyetjet kërkimore, si dhe metodologjinë e përdorur gjatë gjithë punimit. Më poshtë kam parashtruar arsyet e zgjedhjes së këtij punimi, si dhe kufizimet që kam hasur gjatë punimit të tij. Ky kapitull e njeh lexuesin me përkufizimet e termave kryesore të përdorura në studim.

Kapitulli i dytë: kemi të bëjmë me një analizë të zgjeruar me të gjitha komponentët kryesorë që përfshin e drejta e jetës. Si fillim kemi paraqitur anën kuptimore të së drejtës së jetës, për të sqaruar shumëllojshmërinë e të drejtave të tjera që lindin në kuadër të saj, si: mbrojtja e jetës nga ligji, detyrimi i shtetit për të hetuar vdekjen dhe zhdukjet. Kemi trajtuar të drejtën e jetës në mënyrë të thelluar. Secilën çështje të trajtuar në këtë kapitull e kemi shoqëruar me praktikën gjyqësore të ndjekur nga Gjykata Europiane e Drejtësisë. Kemi trajtuar standardin e provës dhe mbrojtjen e jetës nga ligji, detyrimet e shtetit për të hetuar vdekjet, dhe zhdukjet, si dhe masat e nevojshme proceduriale që ndërmerr shteti për të hetuar vdekjen. Në këtë kuadër, fokus të veçantë i kemi dhënë detyrimeve pozitive që ka shteti për mbrojtjen e jetës, si: mbrojtja nga policia, trajtimi mjekësor, rreziqet mjedisore. Gjithashtu, duke marrë parasysh se legjisllacioni ynë e ka ndaluar dënimin me vdekje si një dëmtim i të drejtës së jetës, do të sjellim vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Në këtë

kapitull do trajtohen edhe çështjet që lindin nga e drejta për jetën si: dënimi me vdekje, trajtimi që i bëhet atij nga praktika gjyqësore shqiptare, si dhe trajtimi i tij në vende të tjera.

Kapitulli i tretë: kemi trajtuar marrëdhëniet mes të drejtës së jetës, ligjit dhe institucioneve shqiptare dhe ndërkombëtare në rastin e fetusit. Analizën tonë e kemi filluar me një vështrim të përgjithshëm mbi të drejtën e abortit dhe kuptimit ligjor të së drejtës së fetusit për të jetuar, nga ku janë ngritur diskutime dhe polemika të ndryshme, siç është pyetja: “kur fillon jeta”. Këto pyetje kanë marrë përgjigje duke u mbështetur në doktrinën dhe praktikën gjyqësore të huaj dhe të Gjykatës së Strasburgut, si dhe në legjislacionin shqiptar. Pasi kemi analizuar këto çështje, trajtesa ka kaluar në një tjetër këndvështrim, ku fokus të veçantë i kemi dhënë të drejtës së gruas për të ndërprerë shtatëzaninë dhe e drejta e fetusit për të jetuar, të drejtën për të mos lindur në rastin e shtatëzanive të padëshiruara, ndërkohë të njëjtën trajtesë kemi bërë edhe në rastin e kundërt, ku kemi trajtuar aspektet penale të ndërprerjes së shtatëzanisë pa pëlqimin e gruas. Në këtë kapitull, përveç eksperiencës dhe praktikës që i bën legjislacioni shqiptar abortit, kemi trajtuar shkurtime dhe legjislacionin e disa vendeve të ndryshme të Europës. Duke analizuar këtë të drejtë në vendin tonë, kemi konstatuar se një nga problemet në vendin tonë lidhet me abortin selektiv, i cili trajtohet gjerësisht në fund të këtij kapitulli.

Kapitulli i katërt: Në këtë kapitull kemi trajtuar konceptin e eutanazisë, si e drejta për të vdekur me dinjitet. Janë pasqyruar debate rreth një konflikti sa etiko-juridik aq edhe social e human, mbi të drejtën për të vdekur me dinjitet dhe argumentat pro e kundër dekriminalizimit të eutanazisë. Gjithashtu, janë parashtruar mundësitë në lidhje me cilësimin ligjor të llojeve të eutanazisë, duke qenë se Kodi Penal nuk e parashikon eutanazinë si figurë e posaçme e veprës penale.

Kapitulli i pestë: Në këtë kapitull kemi trajtuar gjerësisht konceptin e eutanazisë. Si fillim kemi analizuar kuptimin e së drejtës së jetës dhe eutanazisë, më pas kemi vijuar me vështrimin historik të eutanazisë, ku kemi analizuar rregullimin ligjor të saj në shtete të ndryshme, duke pasqyruar ato shtete të cilat e kanë legjitimuar eutanazinë. Duke qenë se në Shqipëri koncepti eutanazi është i panjohur, kemi analizuar atë bazë të varfër ligjore që parashikon ndalimin e aplikimit të saj. Duke qenë se eutanazia na shfaqet në forma dhe lloje të ndryshme, kemi analizuar format më të shpeshta, ku në mënyrë të veçantë kemi

trajtuar ndihmën për realizimin e vetëvrasjes, si dhe ekzistencën e paramendimit për kryerjen e eutanazisë. Dhe së fundmi, duke qenë se shtetet e tjera kanë avancuar në praktikimin dhe legalizimin e eutanazisë, kemi sjellë në fokus disa shtete europiane, specifikisht praktikat e tyre gjyqësore, në mënyrë që të mund të diskutojmë rreth aplikimit të tyre edhe në shtetin tonë.

Kapitulli i gjashtë jep përfundimet e nxjerra në funksion të pyetjeve kërkimore në lidhje me tre çështjet kryesore të punimit: të së drejtës së jetës, abortit dhe eutanazisë. Në studim kemi dhënë edhe rekomandimet përkatëse, të cilat mund të shfrytëzohen nga palët e interesuara rreth termave kyç të këtij punimi.

Ky studim jep rekomandime për studime të mëtejshme në të ardhmen.

KAPITULLI II: E DREJTA E JETËS NË KUADRIN E TË DREJTËS NDËRKOMBËTARE. AKTET JURIDIKE TË MBROJTJES SE SAJ NË NIVEL UNIVERSAL, RAJONAL DHE KOMBËTAR

2.1. E drejta e jetës në aktet juridike ndërkombëtare në nivel universal.

E drejta për jetën është padyshim e drejta më e rëndësishme njerëzore nga gëzimi i së cilës burojnë dhe një sërë të drejtash të tjera themelore të ndërvuarura. Ajo përbën një të drejtë të paderogueshme, të pandashme të patjetërsueshme e lidhur ngushtë me qenien njerëzore. Të drejtat e njeriut, demokracia dhe shteti i së drejtës janë vlera të përbashkëta në një shoqëri demokratike, ku e drejta për jetën përbën të drejtën themelore. Këto të drejta mbrohen nga një sërë konventash dhe aktesh të tjera ndërkombëtare, nga Kushtetuta dhe nga ligjet e brendshme të shtetit (Gjoni, 2001:19). Për shkak të rëndësisë së saj të padiskutueshme e drejta për jetën gëzon një mbrojtje të posaçme nga mekanizmat dhe instrumentat kombëtare dhe ndërkombëtare.

Të drejtat e njeriut nuk mund të kuptohen jashtë konceptit të shoqërisë njerëzore dhe padyshim nuk mund të zhvishen nga karakteri i tyre universal. Në një vështrim retrospektiv në historinë e lindjes dhe respektimit të të drejtave të njeriut dhe më konkretisht të të drejtës së jetës, do të vërejmë që është bërë një rrugë e gjatë dhe një luftë diku e heshtur e diku e hapur për realizimin e një katalogu për të drejtat e njeriut.

Jeta, koncepti dhe vlera e së cilës sot gëzon një mbrojtje të lartë, dikur varej nga gjykimi individual i vetë njerëzve. Rëndësia jetësore por dhe e pazëvendësueshme që kishte kjo e drejtë e shndërroi atë në domosdoshmëri të funksionimit të shoqërisë moderne, pa të cilën nuk do të sigurohej vazhdimësia e njerëzimit. Njerëzimi u tregua i vendosur për t'iu larguar koncepteve të skllavërisë por dhe të luftërave të cilat nuk ishin gjë tjetër veçse motori shkatërrues i vlerës më të rëndësishme pa të cilën ekzistenca do të bëhej nul. Por shihej gjithmonë e më e vështirë realizimi i sigurimit të të drejtës së jetës në rrugë individuale, ndaj u ndje nevoja e krijimit të një organizmi i cili do të sundonte mbi iniciativat individuale dhe do të frenonte dhe të rregullonte sistemin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, ndër to dhe të të drejtës së jetës. Kjo nënkuptonte krijimin e një krijese

artificiale e cila do të quhej “shtet” dhe daljen nga shteti natyror i cili qeverisej nga interesat individuale të më të fortëve. Me krijimin e shtetit, njerëzimi doli zyrtarisht nga epoka primitive dhe një epokë e re pozitive nisi që nga ai moment. Krijimi i shteteve u shoqërua me krijimin e instrumenteve të ndryshëm ligjorë me anë të të cilave do të realizohet mbrojtja e jetës së individit.

Një ndër aktet e para nëpërmjet të cilave u mundësua realizimi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe të drejtës së jetës ishte: Magna Karta (The Magna Carta) e hartuar në vitin 1215. Mbi këtë dokument u realizua hartimi i një sërë dokumentesh të tjera të rëndësishme si: Deklarata e të Drejtave të Njeriut dhe Qytetarit të Revolucionit Francez në vitin 1789 dhe më vonë Karta Amerikane e të Drejtave të Njeriut e vitit 1791. Me anë të këtyre dokumenteve u iniciua respektimi i jetës si ekzistencë dhe si proces duke mundësuar përmirësimin e jetesës dhe duke realizuar mbrojtjen e saj edhe pse e kufizuar. Ky shënoi një hap të rëndësishëm drejt sigurimit të ekzistencës dhe vazhdimësisë.

Me modernizimin e shoqërisë dhe me fillimin e lëvizjeve me natyrë demografike, krijimi i akteve kombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në përgjithësi dhe të të drejtës së jetës në veçanti ishte e pamjaftueshme për ta mbrojtur atë. Shoqëria filloi të pretendonte tashmë një standard mbrojtje i cili i kapërcente kufijtë kombëtarë duke kaluar në planin ndërkombëtar. Këto dokumente do të ishin pasaporta e njerëzve në lidhje me zbatimin dhe respektimin e të drejtave të tyre. Pas Luftës së Dytë Botërore u krijua Lidhja e Kombeve dhe prej saj u krijua OKB-ja, krijimi i së cilës u shoqërua me miratimin e Kartës së OKB-së me anë të së cilës do të realizohej respektimi i disa të drejtave të njeriut, ndër to dhe e drejta e jetës (Alston, Philip dhe James Crawford, 2000: 125). Koncepti i të drejtave universale të njeriut, u bë i pranueshëm për të gjithë njerëzit vetëm pas Luftës së Dytë Botërore, kur nga 48 shtete u arrit marrëveshja për Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut. Që atëherë, ky koncept është bërë komponent i pandashëm i sistemit të Kombeve të Bashkuara. Për të qenë pjesë e Lidhjes së Kombeve duhet të pranojë të garantojë respektimin e të drejtave të pakicave që jetonin në shtetet e vendeve aderuese. Më vonë në 10 dhjetor të vitit 1948, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara miratoi dhe shpalli Deklaratën Universale mbi të Drejtat e Njeriut si dokumentin ndërkombëtar bazë që shpalli të drejta të pandashme dhe të patjetërsueshme të të gjithë anëtarëve të familjes

njerëzore. E drejta e jetës sanksionohet në nenin 3 të DUDNJ-së. Kjo deklaratë do të jetë pjesë e analizës së punimit e trajtuar më gjerësisht më poshtë duke qenë se është dokumenti i parë i cili ndalet dhe e trajton të drejtën e jetës në veçanti duke i dhënë asaj vendin dhe rëndësinë e duhur. E drejta e jetës është sanksionuar gjithashtu edhe në akte të tjera në nivel ndërkombëtar të tilla si: Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike; Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Ekonomike Sociale dhe Kulturore; Konventa Amerikane për të Drejtat e Njeriut; Konventa Afrikane; Konventa e New York-ut për mbrojtjen e fëmijëve e vitit 1989 etj.

Më poshtë do të trajtojmë të drejtën e jetës të sanksionuar nga këto akte me karakter ndërkombëtar.

2.1.1. Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut

Duke marrë parasysh se mosrespektimi i të drejtës së jetës ka çuar drejt akteve barbare, të cilat kanë ofenduar ndërgjegjen e njerëzimit, si dhe duke konsideruar se dinjiteti i lindur i të drejtave të barabarta dhe të patjetërsueshme të të gjithë anëtarëve të familjes njerëzore është themeli i lirisë, drejtësisë dhe paqes në botë, u ndje e nevojshme që të drejtat e njeriut duke përfshirë dhe të drejtën e jetës, të mbrohen me dispozita juridike. Për këtë arsye, më 10 dhjetor të vitit 1948, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara miratoi dhe shpalli Deklaratën Universale mbi të Drejtat e Njeriut si dokumentin ndërkombëtar bazë që shpalli të drejta të pandashme dhe të patjetërsueshme të të gjithë anëtarëve të familjes njerëzore (Alfredson, 1999:36). DUDNJ –ja përbëhet nga 30 nene dhe aktualisht është pjesë e legjislacioneve të shumë vendeve sepse vendos një standard arritjeje për të gjitha kombet që të luftojnë për këto të drejta pasi kjo Deklaratë u shpall si “standard i përbashkët arritjeje për të gjithë njerëzit dhe kombet” për respektimin e të drejtave të njeriut. Në nenin 3 të Deklaratës theksohet se “*Gjithkush ka të drejtë të jetojë, të jetë i lirë dhe të ketë sigurimin vetjak.*” duke i dhënë kështu një rëndësi dhe dimension universal konceptit të së drejtës së jetës (Baefsky, 2002:45).

Neni 3 DUDNJ-së përcakton se “*Gjithkush ka të drejtë të jetojë, të jetë i lirë dhe të ketë sigurimin vetjak.*” është në koherencë dhe në vijim të nenit 1 ku thuhet se: “*Të gjithë njerëzit lindin të lirë dhe të barabartë në dinjitet dhe në të drejta. Ata kanë arsye dhe ndërgjegje dhe duhet të sillen ndaj njëri tjetrit me frymë vëllazërimi..*” ndaj kanë të drejtën e jetës. Ky nen është vazhdimësi e përmbushjes së kuptimit dhe përmasat të nenit 1, duke veçuar në një nen të posaçëm, tri të drejta themelore: të drejtën e jetës, të lirisë, të sigurisë së personit. Ky nen parashton tri kolonat themelore të të drejtave, të cilat shërbejnë si pikë nisje, pa të cilat nuk garantohet ekzistenca dhe vazhdimësia e gjinisë “njerëzore”.

Të treja të drejtat e përfshira në nenin 3 të DUDNJ-së janë të rëndësishme, por e drejta e jetës, është *e patjetërsueshme* dhe e parë si e tillë e drejta për t’a jetuar jetën është individuale dhe e pazëvendësueshme dhe i përket vetëm personit, duke mos e deleguar këtë të drejtë tek askush tjetër (Alfredson, 1999:37). Në nenin 3 DUDNJ e drejta e jetës është trajtuar në 2 këndvështrime:

E para: Është trajtuar jeta si vlerë dhe si domosdoshmëri dhe këtë e gjejmë të sanksionuar në pjesën e parë të nenit ku thuhet se “*Gjithkush ka të drejtë të jetojë,*” duke përcaktuar këtu karakterin individual dhe të pa tjetërsueshëm të saj.

E dyta: Jeta është trajtuar si vlerë universale e parë në bashkëjetesë me konceptin e lirisë dhe të sigurisë “*Gjithkush ka të drejtë të jetë i lirë dhe të ketë sigurimin vetjak.*” nga ku përcaktohet se liria e personit varet por nuk kushtëzohet nga liria e tjetrit, dhe siguria e personit, është kuptuar si sigurimi i lirisë së nevojshme për të realizuar të drejtën e jetës në kushte të cilat nuk tjetërsojnë dhe shfytyrojnë bashkësinë njerëzore. (Hysi & Kamani & Methasani & Harasani, 2008:23)

Një nga çështjet më të diskutueshme në lidhje me të drejtën e jetës është se nga cili moment Deklarata fillon të mbrojtë të drejtën e jetës, që nga momenti i “konceptimit” të fetusit, apo nga momenti i lindjes? Ka pasur këndvështrime të ndryshme lidhur me momentin e mbrojtjes së jetës. Disa ekspertë sillnin argumente se, mbrojtja fillon në momentin e ngjizjes së fetusit, duke dënuar abortin e provokuar. Të tjerë, sillnin argumente se mbrojtja e jetës fillon në momentin e lindjes së individit. E ndodhur në kushtet e pamundësisë së gjetjes së një konsensusi në lidhje me këtë temë, mes ekspertëve u vendos që DUDNJ-ja të marrë në mbrojtje individin që nga momenti i lindjes.

Një çështje tjetër me interes dhe objekt diskutimesh ka qenë dhe koha deri kur mbrohet jeta e individit sipas DUDNJ-së. Ekspertët të cilët kanë hartuar deklaratën janë përpjekur të mbrojnë të drejtën e jetës duke përjashtuar dënimin me vdekje. Në shumë shtete është përjashtuar me ligj dënimi me vdekje i individëve. Deklarata favorizon në mënyrë indirekte individët deri 18 në vjeç dhe gratë shtatëzëna.

2.1.2. Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike

Njohja e të drejtave të barabarta e të patjetërsueshme të të gjithë pjesëtarëve të familjes njerëzore janë themeli i lirisë, drejtësisë dhe paqes në botë dhe burojnë nga dinjiteti i lindur i njeriut. Individët mund të gëzojnë liritë civile e politike vetëm nëse shtetet që janë përgjegjëse për të nxitun respektimin universal dhe efektiv të të drejtave dhe të lirive të njeriut, i krijojnë kushtet që t'i lejojnë ata të gëzojnë këto të drejta. Për këtë arsye më 16 dhjetor 1966, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara miratoi Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike. Në bazë të këtij Pakti, individi ka detyrë ndaj të tjerëve dhe ndaj kolektivitetit të cilit i përket të respektojë të drejtat e njohura në këtë Pakt. Pakti trajton të drejtat themelore me karakter civil dhe politik që shtetet palë duhet të garantojnë për të gjithë individët që hyjnë brenda juridiksionit të tyre. Shtetet palë të Paktit në përputhje me procedurat e tij, duhet të marrin masat legislative të nevojshme për të zbatuar të drejtat e njohura në të (Alston, Philip dhe James Crawford, 2000: 130).

Parimi themelor i Paktit është parimi i mosdiskriminimit mbi bazën e të cilit, shtetet palë, duhet të respektojnë dhe t'u sigurojnë të gjithë njerëzve që ndodhen në territorin e tyre dhe që varen nga juridiksioni i tyre, të drejtat e njohura në këtë Pakt, pavarësisht racës, ngjyrës, seksit, gjuhës etj¹. Pakti gjithashtu proklamon parimin e barazisë gjinore midis burrit dhe gruas² dhe nuk lejon kufizim ose shmangie në respektimin e të drejtave themelore të njeriut që janë të njohura nga ligjet, konventat, aktet ose zakonet e tjera. Pakti përcakton të drejtat civile dhe politike që shtetet palë janë angazhuar të sigurojnë për të gjithë individët, pa asnjë lloj diskriminimi ku përfshihen: e drejta e jetës, e

¹ Shih nenin 2 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike.

² Shih nenin 3 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike.

drejta për të mos iu nënshtruar torturës, apo dënimeve ose trajtimeve mizore, çnjerëzore a poshtëruese, e drejta për liri dhe siguri, e drejta e personave të privuar nga liria për t'u trajtuar me humanizëm dhe respekt për dinjitetin e tyre, e drejta për të lëvizur lirisht brenda territorit ku personi ndodhet ligjërisht, e drejta për një proces të rregullt gjyqësor etj. Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike është akt ligjërish i detyrueshëm që krijon obligime me anë të të cilave shtetet do të zotohen të respektojnë të drejtat e njeriut të përcaktuara në DUDNJ. (Hysi & Kamani & Methasani & Harasani, 2008:7)

Pakti në nenin 6 paragrafi 1 trajton të drejtën e jetës: *“E drejta e jetës është e drejtë e lindur e njeriut. Kjo e drejtë duhet të mbrohet me ligj. Askush nuk mund të privohet arbitrarisht nga jeta”*. Sipas këtij neni e drejta e jetës nuk mund të provohet në mënyrë arbitrare duke i cënuar individit këtë të drejtë të cilën e gëzon që me lindjen e tij. E drejta e jetës kufizohet vetëm nga dhënia e dënimit me vdekje në shtetet në të cilat legjislacioni i brendshëm e lejon këtë dënim. Në lidhje me dënimin me vdekje, Pakti në paragrafin 2 të nenit 6, përcakton se *“Në vendet ku nuk është hequr dënimi me vdekje, ai mund të jepet vetëm për krimet më të rënda, në përputhje me ligjin në fuqi në kohën e kryerjes së krimit dhe nuk duhet të jetë në kundërshtim me dispozitat e këtij Pakti dhe me Konventën për Parandalimin dhe Ndjekjen e Krimit të Gjenocidit. Ky dënim mund të jepet vetëm në bazë të një gjykimi përfundimtar nga një gjykatë kompetente”*. Pra, paragrafi 2 i këtij neni përcakton se individi mund të privohet nga e drejta e jetës vetëm nëse ndaj tij është marrë një vendim përfundimtar nga ana e një gjykate kompetente.

Në rastet kur privimi nga e drejta e jetës përbën një krim gjenocidi, shtetet palë të këtij Pakti duhet të respektojnë detyrimet e marra përsipër në bazë të dispozitave të Konventës për Parandalimin dhe Ndjekjen e Krimit të Gjenocidit.³ Më tej në trajtimin që i bëhet të drejtës së jetës në dispozitat e këtij pakti është përcaktuar se të dënuarit me vdekje kanë të drejtën të kërkojnë falje si dhe zëvendësimin e dënimit me vdekje. Sipas nenit 6 paragrafi 4 *“Amnistia, falja ose zëvendësimi i dënimit me vdekje mund të jepen në të gjitha rastet”*. Në lidhje me kategoritë të cilat përjashtohen nga dënimi me vdekje, Pakti e ngushton rrethin e personave ndaj të cilëve nuk mund të aplikohet dënimi me vdekje (Alston, Philip dhe James Crawford, 2000: 132). Sipas paragrafit 6 të këtij neni *“Dënimi*

³ Shih nenin 6/3 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike

me vdekje nuk mund të jepet për krimet e kryera nga personat nën 18 vjeç dhe nuk mund të zbatohet ndaj grave shtatëzëna”.

Pakti parashikon krijimin e komitetit të quajtur Komiteti i të Drejtave të Njeriut, si dhe përcakton përbërjen, mënyrën e zgjedhjes së anëtarëve, funksionet dhe veprimtarinë e Komitetit. Shqipëria është anëtare me të drejta të plota në Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike që prej datës 04.09.1991(Daci, 2011: 44).

2.1.3. Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Ekonomike Sociale dhe Kulturore

Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore është një traktat, i miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në Dhjetor 1966 dhe hyri në fuqi në vitin 1976. Pakti ka për qëllim të njohë, të proklamojë dhe të rregullojë të drejtat ekonomike, sociale, kulturore të njeriut. Të drejtat e njeriut janë të ndarë në dy kategori kryesore: në të drejtat Civile dhe Politike, dhe Ekonomike Sociale dhe Kulturore. Kategoria e parë (të drejtat Civile dhe Politike) ka të bëjë me të drejtat personale themelore si: e drejta për jetën, integritetin fizik, liria fetare, etj, të cilat përfshihen në Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike të cilin e trajtuam më sipër. (Hysi & Kamani & Methasani & Harasani, 2008:8)

Kategoria e dytë (të drejtat Ekonomike Sociale dhe Kulturore) konsiston në njohjen e të drejtave të barabarta për të gjithë individët, për të marrë pjesë në jetën shoqërore, kulturore dhe ekonomike të vendit. Për të siguruar të drejtat e grupit të parë duhet që shtetet vetëm të mos ndërhyjnë në jetën personale dhe të organizojnë mekanizmat e nevojshëm për të ndëshkuar personat që nuk lejojnë gëzimin e këtyre të drejtave. Ndërsa, përsa i përket të drejtave të grupit të dytë, këto të drejta janë më të vështira për t'u siguruar sepse duhet që shteti të ndërhyjë në mënyrë aktive përmes hartimit dhe miratimit të marrëveshjeve midis tyre për sigurimin e tyre. Nisur nga fakti që e drejta e jetës është një nga të drejtat që nis me lindjen e individit dhe që gëzimi i saj varet edhe nga gëzimi i një sërë të drejtash të tjera duhet të theksojmë se ky Pakt është i rëndësishëm në realizimin e së drejtës së jetës (Daci, 2011:219). Mbrojtja që ky Pakt i bën të drejtës së jetës në mënyrë të

drejtpërdrejtë realizohet në nenin 12 paragrafi 2 ku thuhet se: ”Masat që shtetet palë të këtij Pakti do t’ë marrin për të arritur realizimin e plotë të kësaj të drejte, duhet t’i përfshijnë ato masa që janë të nevojshme për të siguruar: *“Uljen e vdekshmërisë gjatë lindjes dhe vdekshmërisë së foshnjave, si dhe zhvillimin e shëndetshëm të fëmijës”*. Pra, Pakti i detyron shtetet anëtare që të ndërmarrin hapa me qëllim instalimin e një skeme sigurie për të arritur qëllimin e sipërcituar. Të drejtat e tjera ekonomike, sociale dhe kulturore ndikojnë në mënyrë të tërthortë në gëzimin e së drejtës së jetës. E drejta e cila ka një impakt më të lartë, është e drejta e kujdesit shëndetësor. Nëse një individ do t’i nënshtrohej një kujdesi shëndetësor jo të përshtatshëm ose ky kujdes do t’i refuzohet në kohën e duhur dhe kjo do të shkaktoje vdekjen e individit atëherë ai do të privohej nga e drejta e jetës.

Pakti është i hapur për aderime të reja dhe procedura e aderimit përcaktohet në nenin 26 të tij. Paragrafi 1 i këtij Pakti shprehet se ky Pakt është i hapur për nënshkrimin e çdo shteti anëtar të Organizatës së Kombeve të Bashkuara ose anëtar i çfarëdo organizate të specializuar të tij, të çdo shteti palë në Statutin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë si dhe të çdo shteti tjetër të ftuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara. Si një dokument me vlerë ligjore ndërkombëtare, në pikën 2 përcaktohet se ky Pakt i nënshtrohet ratifikimit. Instrumentet e ratifikimit depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Në paragrafin 3 të këtij neni sanksionohet se është i hapur për aderim ndaj çdo shteti të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni. Në pikën 4 të këtij neni përcaktohet qartë mënyra e aderimit në këtë pakt, e cila do të realizohet nëpërmjet depozitimit të një instrumenti të aderimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe ky i fundit, do të informojë të gjitha shtetet të cilat kanë nënshkruar këtë Pakt ose kanë aderuar në të për depozitimin e çdo instrumenti të ratifikimit ose të aderimit.” Aktualisht janë 160 shtete të cilat e kanë ratifikuar këtë instrument të rëndësishëm ndërkombëtar në fushën e të drejtave të njeriut. Shqipëria është anëtare me të drejta të plota në Paktin Ndërkombëtar mbi të Drejtat Ekonomike Sociale dhe Kulturore që prej datës 09.04.1991. (Daci,2011:222)

2.2. Aktet juridike në nivel rajonal që mbrojnë të drejtën e jetës.

Përveç instrumenteve universale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, gjithashtu janë zhvilluar edhe disa sisteme rajonale të të drejtave të njeriut, të cilat zakonisht ofrojnë standarde më të larta për të drejtat dhe implementimin e tyre. Përparësia e sistemeve rajonale qëndron në mundësinë e tyre për adresim më efektiv të ankesave. Në rastin e gjykatave mund të nxirren vendime të karakterit të detyrueshëm për kompensim dhe, në përgjithësi, rekomandimet e Komisioneve për të Drejtat e Njeriut merren seriozisht nga ana e shteteve. Mund të ndodhë që shtetet jo vetëm të interpretojnë dhe sqarojnë dispozitat e instrumenteve për të drejtat e njeriut në “*rastet kryesore*”, por edhe të ndryshojnë legjislacionin e tyre të brendshëm, me qëllim të harmonizimit të tyre me detyrimet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Për më tepër, sistemi rajonal ka tendencë të jetë më sensitiv ndaj problemeve kulturore dhe fetare, nëse ekzistojnë arsye të tilla. (Hysi & Kamani & Methasani & Harasani, 2008:6)

Rajonet më të rëndësishme të botës që kanë miratuar akte ligjore për respektimin e të drejtave dhe lirive themelore e njeriut janë: Amerika, Evropa, Afrika dhe Vendet Arabe. Për arsye të këtij studimi do të sjellim këtu në mënyrë të veçantë studimin dhe analizën e detajuar të së drejtës së jetës në Europë, pra, në rendin juridik të Bashkimit European dhe në atë të Këshillit të Europës.

2.2.1. Sistemi Evropian i mbrojtjes së të drejtës së jetës

Sistemi evropian i të drejtave të njeriut ka tri nivele, sistemin e Këshillit të Evropës, Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë dhe Bashkimin Evropian. Duke përjashtuar OSBE-në, për shkak të natyrës së të drejtave që ajo mbron (në mënyrë të veçantë për minoritetet)⁴, ne do të fokusohemi tek Sistemi Evropian i të drejtave të njeriut i

⁴OSBE-ja është një organizatë e posaçme, e cila në vitin 1994 ka zëvendësuar Konferencën për Siguri dhe Bashkëpunim të Evropës. Ajo nuk ka ndonjë kartë ligjore ose akt ligjor ndërkombëtar të detyrueshëm, ndërsa deklaratat dhe rekomandimet e saj janë vetëm të natyrës politike dhe nuk janë të detyrueshme për shtetet.

cili është sistemi më i përpunuar rajonal. Ai është zhvilluar si reagim ndaj shkeljeve masive të të drejtave të njeriut gjatë Luftës së Dytë Botërore. Thelbin e rendit ligjor evropian e përbëjnë të drejtat e njeriut, sundimi i ligjit dhe demokracia pluraliste. Si Këshilli i Evropës ashtu dhe Bashkimi Evropian kanë arritur të krijojnë një legjislacion i cili siguron njohjen dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut brenda sistemit ligjor evropian. Këshilli i Evropës u themelua në vitin 1949, pas Luftës së Dytë Botërore dhe synimi i tij është të krijojë një hapësirë demokratike e juridike të përbashkët për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, dhe për këtë arsye, në vitin 1950, në Romë, shtetet Palë të Larta Kontraktuese miratuan Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ)⁵. KEDNJ – ja përfaqëson aktin e parë të Këshillit të Evropës që merret me mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Që nga krijimi i saj Konventa i është nënshtruar disa ndryshimeve dhe amendimeve të cilat kanë shërbyer si baza e krijimit të shumë konventave të tjera nga ana e Këshillit të Evropës. Konventa është plotësuar nga protokollat shtesë që kanë shërbyer për forcimin e mekanizmave për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. (Daci, 2011:130).

Ndërsa themelet e Bashkimit Evropian ngrihen mbi një marrëveshje ndërkombëtare shumëpalëshe ndërmjet shteteve anëtare duke krijuar kështu një organ mbikombëtar unik që fillimisht kishte karakter kryesisht ekonomik ku nuk kishte vend për të drejtat civile dhe sociale. Me ndryshimet sociale dhe ekonomike të drejtat themelore të njeriut u shndërruan në një prej çështjeve më kryesore në të drejtën komunitare për këtë arsye në 7 dhjetor 2000 në Nicë, Shtetet Anëtare miratuan Kartën e të drejtave themelore të njeriut. Karta mund të konsiderohet dokumenti i parë formal i BE-së, i cili përmbledh në një tekst të vetëm të

Mirëpo, katalogët mjaft të detajuar, që janë miratuar nëpër konferenca dhe takime të ekspertëve ose në konferenca të rregullta, të cilat janë monitoruar nga Këshilli i shteteve përfaqësuese, paraqesin një mekanizëm monitorues mjaft të suksesshëm. I ashtuquajtur *“Procesi i Helsinikut”*, gjatë luftës së ftohtë ka luajtur rolin kryesor në ndërtimin e bashkëpunimit mes Jugut dhe Perëndimit, duke ofruar një bazë për bashkëpunim të gjerë në Evropën e përbërë nga 55 shtete. OSBE-ja në emër të *“dimensionit njerëzor”*, ka ndërmarrë një sërë aktivitete në fushën e të drejtave të njeriut dhe në veçanti në atë të të drejtave të minoriteteve. Këto aktivitete kanë qenë shumë të rëndësishme në terrene të misioneve të ndryshme të OSBE-së si në, Bosnjë-Hercegovinë, Serbi, Mal të Zi dhe në Kosovë. Për këtë arsye, misionet e OSBE-së përmbajnë departamente dhe zyrtarë për të drejtat e njeriut, të cilët shpërndahen në gjithë vendin, për të monitoruar dhe raportuar mbi gjendjen e të drejtave të njeriut, por edhe për të promovuar të drejtat e njeriut, kurse në raste të veçanta edhe për të asistuar në mbrojtje. Po ashtu, në vendet ku OSBE-ja ka misionet e veta përkrah edhe institucionet kombëtare, siç është përkrahja e ombudsmanit në Bosnjë-Hercegovinë dhe në Kosovë.

⁵ Konventë e miratuar më 1950, hyri në fuqi në vitin 1953.

gjithë kategorinë e të drejtave civile, politike, ekonomike, sociale.(Canaj:2013:3) Për shkak të rëndësisë që kanë këta dy organizma të rëndësishëm evropian do t'i trajtojmë të ndarë më poshtë bashkë me aktet përkatëse ligjore për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe jurisprudencën përkatëse.

2.2.1.1. E drejta jetës në legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Bashkimi Evropian ka në themel vlerat e respektimit të dinjitetit të njeriut, lirisë, demokracisë, barazisë, shtetit të së drejtës dhe respektimit të të drejtave të njeriut (neni 2 TBE) (Craig, P. Burca, D. 2013:427). Megjithatë, siç u theksua edhe në paragrafin pararendës, traktatet kanë pasur mungesa në njohjen e të drejtave themelore të njeriut. Një rol shumë të rëndësishëm në njohjen dhe zhvillimin e këtyre të drejtave ka luajtur Gjykata Evropiane e Drejtësisë (GJED). Prurjet e jurisprudencës u konfirmuan më pas edhe nga traktatet. Gjykatës së Drejtësisë i është dashur të mbushë këtë mangësi të traktateve. Ajo ka elaboruar në mënyrë të vazhdueshme mbrojtjen e të drejtave të njeriut, derisa ato gradualisht u njohën në mënyrë të shprehur edhe nga traktatet. Çështja e të drejtave themelore të njeriut në Bashkimin Evropian për një kohë relativisht të gjatë ka qenë objekt i një vëmendje të kufizuar për Komunitetin evropian. Traktatet themeluese të Komunitetit Evropian, të vitit 1957, nuk përmbanin asnjë dispozitë me objekt mbrojtjen e të drejtave të njeriut, pasi këto të fundit duhet të ishin rregullimi juridik i një bashkimi ekonomik, në mënyrë që individi të mos mbrohej si person “qenie njerëzore “ por vetëm si individ-punëtor, individ-operator ekonomik etj, pra si objekt i botës komplekse ekonomike, në të cilën bashkëveprojnë shtetet. (Canaj:2013:2) Traktatet Themeluese të Komunitetit Evropian të vitit 1957 teknikisht nuk përmbanin asnjë dispozitë në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe nuk i detyronin institucionet e Komunitetit t'i respektonin ato gjatë veprimtarisë së tyre (Canaj & Bana 2014:143). Rendi juridik i BE-se i është referuar në mënyrë të veçantë edhe Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut. Disa nga të drejta themelore që u përmendën për herë të parë në Traktatet Themeluese të Bashkimit Evropian ishin: liria e qarkullimit të mallrave, personave, shërbimeve dhe kapitaleve dhe ndalimi i diskriminimit në bazë të kombësisë dhe gjinisë. Veç të tjerash, këto liri themelore kanë

ndihmuar në realizimin e tregut të përbashkët, në qëllimin e shteteve që kishin miratuar Traktatin. Fillimisht tek disa shtete të BE-së ekzistonte një druajtje për miratimin e traktatit për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, sepse, me përfshirjen e një dokumenti të të Drejtave Themelore, veprimtaria e organeve të Komunitetit nuk do të kishte më kufij dhe, në këtë mënyrë, ato organe do të mbronin jo vetëm interesat ekonomike, por edhe ato politike. Pikërisht mungesa e përfshirjes së këtij dokumenti në traktat u balancua në njëfarë mënyre nga garancia që shtetet anëtare dhanë për mbrojtjen e këtyre të drejtave me anë të legjislacionit të brendshëm të të secilit vend (Jacque, 2011: 56).

Vetëm me Traktatin e Maastricht-it u aprovua neni “f” (aktualisht neni 6) që, në paragrafin 2, konfirmon se *“Bashkimi Evropian respekton të drejtat themelore të cilat janë garantuar nga Traktati i Romës në vitin 1950 mbi të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, si dhe të traditave kushtetuese të përbashkëta të shteteve anëtare, si parime të përgjithshme të së drejtës komunitare”*. Por, norma shitesë në Traktatin e Maastricht-it nuk ishte e mjaftueshme.” Kjo fushë u rishikua më vonë edhe me Traktatin e Amsterdemit. Rëndësia e të drejtave themelore në ndërtesën evropiane është forcuar dhe respektimi i tyre garantohet në disa drejtime. Neni i ri “f” i Traktatit të BE-së përmban në paragrafin e parë referimin te “parimet e lirisë, të demokracisë, të respektit të të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore, si dhe të shtetit të së drejtës, parime të përbashkëta për shtetet anëtare”, mbi të cilat është themeluar Bashkimi Evropian. Nga ana tjetër, neni “O” sanksionoi respektimin e parimit të sipërpërmendur si kusht për të aderuar në Bashkimin Evropian. Me kalimin e viteve dhe statusi i të drejtave të njeriut në sistemin ligjor të BE-së ka ndryshuar në mënyrë rrënjësore. Një përforcim i të drejtave themelore haset edhe me ndryshimet që i sjell së fundi Traktati i Lisbonës nenit 6 TBE. Sipas këtij neni: *“1. Bashkimi njeh të drejtat, liritë dhe parimet e sanksionuara në Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian, të 7 dhjetorit të vitit 2000, të miratuar më 12 dhjetor të vitit 2007, në Strasburg, e cila ka të njëjtën vlerë juridike si dhe traktatet. Dispozitat e Kartës nuk i zgjerojnë në asnjë mënyrë kompetencat e Bashkimit Evropian, të përcaktuara në traktate. Të drejtat, liritë dhe parimet e Kartës interpretohen konform dispozitave të përgjithshme të titullit VII të Kartës, të cilat rregullojnë interpretimin dhe aplikimin e saj, si dhe duke pasur parasysh shpjegimet, të cilave i referohet Karta, që tregojnë burimet e këtyre dispozitave.*

2. Bashkimi Evropian anëtarësohet në Konventën Evropiane për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Ky anëtarësim nuk ndryshon kompetencat e Bashkimit Evropian të përcaktuara në Traktate.

3. Të drejtat themelore të sanksionuara nga Konventa Evropiane për liritë dhe të drejtat themelore të njeriut dhe ato që rezultojnë nga praktikat kushtetuese të përbashkëta të shteteve anëtare janë pjesë e së drejtës së Bashkimit Evropian si parime të përgjithshme.”.
(Version i konsoliduar i Traktatit të Bashkimit Evropian dhe i Traktatit të Funksionimit të Bashkimit Evropian, (2011).

Në përgjithësi, të drejtat themelore të garantuara në BE janë ato të sanksionuara shprehimisht në Traktatet themeluese, në Konventën Evropiane të të drejtave të njeriut, si dhe në parimet e përgjithshme të së drejtës komunitare. Për sa u përket të drejtave që u rezervohen në mënyrë specifike emigrantëve jo komunitarë, që na intereson në mënyrë të veçantë, ato u janë lënë, kryesisht, shteteve anëtare. Ndërkohë që, edhe pse të gjitha aktet dhe zhvillimi i politikave kohët e fundit në BE projektohen sa më afër nevojave të qytetarëve, të drejtat që gëzojnë emigrantët janë të përcaktuara nga dy rende juridike të ndërthurura: legjislacioni evropian dhe ai kombëtar, ky i fundit i influencuar edhe nga e drejta ndërkombëtare. (Canaj.2013:3) Për këto arsye, u konsiderua i nevojshëm krijimi i një katalogu të të drejtave themelore me karakter ekonomik, politik dhe social, që garantohen dhe respektohen në BE. E drejta e jetës është e sanksionuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në Kartën e Drejtave Themelore e Bashkimit Evropian të cilën do e analizojmë në paragrafin vijues.

i) Karta e të drejtave themelore të njeriut e Bashkimit Evropian

E drejta e jetës është e sanksionuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në Kartën e të Drejtave dhe Lirive Themelore të BE-së në nenin 2 të saj. Karta e të drejtave themelore të njeriut zyrtarisht u shpall në Nisë, në 7 dhjetor 2000, nga presidentët e Parlamentit Evropian, Këshillit dhe Komisionit Evropian dhe nga shtetet anëtare të Bashkimit Evropian. (Bianku, 2005:15) Karta fillimisht u miratua si një deklaratë me karakter politik. Hartimi i një katalogu evropian i të drejtave themelore, me qëllim që të sigurohej një

mbrojtje më efikase, është vendosur shprehimisht si një nga objektivat parësorë të Bashkimit European në fillimet e punimeve në Këshillin European të mbajtura në Këln, më 3-4-qershor1999. Me atë rast, krerët e shteteve dhe të qeverive të vendeve anëtare të BE-së theksuan nevojën e hartimit të një karte të të drejtave themelore “me qëllim që të sanksiononin në mënyrë të shfaqur rëndësinë thelbësore të të drejtave dhe lirive themelore të individëve”. (Canaj, 2013:4)

Duke mbajtur parasysh kompetencat dhe detyrat e Bashkimit si edhe parimin e subsidiaritetit, kjo Kartë ripohon të drejtat që rrjedhin sidomos prej traditave kushtetuese dhe detyrimeve ndërkombëtare që janë të përbashkëta për Shtetet Anëtare prej Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, Kartës Sociale të miratuar dhe nga Këshilli i Europës si edhe nga jurisprudenca e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit European dhe Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Karta interpretohet, në këtë kontekst, prej gjykatave të Bashkimit dhe të Shteteve Anëtare duke pasur parasysh shpjegimet e përgatitura nën autoritetin e Presidiumit të Konventës që e hartoi këtë Kartë dhe të përditësuara nën përgjegjësinë e Presidiumit të Konventës Europiane (*Version i konsoliduar i Traktatit të Bashkimit European dhe i Traktatit të Funksionimit të Bashkimit European*, (2011).

Karta mund të konsiderohet dokumenti i parë formal i BE-së, i cili përmbledh në një tekst të vetëm të gjithë kategorinë e të drejtave civile, politike, ekonomike, sociale, si dhe disa të drejta të tjera të kategorisë së “brezit të tretë”, siç është e drejta për një mjedis të pastër ose e drejta për miradministrimin. (Daci, 2011:167) Vlera juridike e Kartës ishte e pasaktësuar, pavarësisht se ajo u shpall në mënyrë solemne një dokument i rëndësishëm, kjo për faktin se ajo nuk pati formën e një dokumenti detyrues për shtetet anëtare, pasi nuk ishte pjesë e legjislacionit të BE-së dhe, në këtë mënyrë, vështirësia qëndronte tek zbatimi i saj. Karta mori vlerën juridike të së drejtës primare vetëm në vitin 2007 nga ana e Konferencës Ndërqeveritare e cila hartoi Traktatin e Lisbonës dhe pikërisht modifikimi i nenit 6 të Traktatit të Bashkimit European nga Traktati i Lisbonës i cili i jep shprehimisht rëndësinë e të drejtës primare Kartës së të Drejtave Themelore (*Version i konsoliduar i Traktatit të Bashkimit European dhe i Traktatit të Funksionimit të Bashkimit European*, (2011).

Nëpërmjet modifikimit të nenit 6 ,Traktati i Lisbonës e bën Kartën të detyrueshme por nuk e ka bërë pjesë të Traktatit, për shkak të kundërshtimeve të disa shteteve që ishin kundër kontrollit nga ana e Gjykatës së Drejtësisë për këto fusha të veçanta (Canaj, 2009). Karta afirmon të drejtat dhe liritë themelore të njohura nga praktikat kushtetuese të shteteve anëtare, nga Konventa Europiane e të drejtave dhe lirive themelore, si dhe të drejtat të cilat janë njohur dhe zhvilluar më tepër nga jurisprudenca e Gjykatës së Luksemburgut dhe e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut⁶.

E drejta e jetës trajtohet në nenin 2 të kësaj Karte.

1. *Kushdo ka të drejtën për jetën.*

2. *Askush nuk mund të dënohet me vdekje apo të ekzekutohet.*

Në këtë akt, nëpërmjet paragrafit të parë të nenit “*Kushdo ka të drejtën për jetën*” rikonfirmohet që e drejta e jetës është një e drejtë që e gëzon çdo individ dhe që fitohet që me lindjen e tij. Paragrafi i dytë i nenit 2 i Kartës përcakton se “*Askush nuk mund të dënohet me vdekje, apo të ekzekutohet*”, çka do të thotë që kjo Kartë nuk e lejon dënimin me vdekje ashtu siç kemi konstatuar në aktet e tjera të të drejtave të njeriut si: KEDNJ-ja, Konventa Amerikane e të Drejtave të Njeriut etj. Moslejimi i dënimit me vdekje i jep Kartës së të drejtave themelore të njeriut karakter human ashtu si KEDNJ. (Daci, 2011:166)

Në mënyrë më të hollësishme duhet thënë se paragrafi 1 i këtij neni është i bazuar në fjalinë e parë të nenit 2, paragrafi 1, të KEDNJ-së, i cili thotë:

“E drejta e çdo njeriu për jetën mbrohet me ligj.”

2. Fjalja e dytë e dispozitës, e cila i referohet dënimit me vdekje, u zëvendësua nga hyrja në fuqi e Protokollit nr. 6 i KEDNJ-së, neni 1, i cili parashikon si më poshtë:

Dënimi me vdekje hiqet. Askush nuk mund të dënohet me një dënim të tillë, as të ekzekutohet.

Kjo dispozitë është frymëzuar nga neni 2, paragrafi 2, i Kartës dhe Protokollit Shtesë ku jepet kuptimi dhe qëllimi i këtij paragrafi. Prandaj përkufizimet dhe detyrimet “negative” që janë në KEDNJ duhet të konsiderohen njësoj edhe për Kartën:

a) Neni 2, paragrafi 2 i KEDNJ-së;

⁶ Shih parag. 5 të Preambulës së Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Europian.

2. Privimi nga jeta nuk konsiderohet të shkaktohet në kundërshtim me këtë nen në rastet kur ky privim vjen nga përdorimi i forcës, që është jo më shumë se absolutisht i domosdoshëm: a) në mbrojtje të çdo personi nga dhuna e paligjshme; b) për të kryer një arrestim të ligjshëm ose për të parandaluar arratisjen e një personi të ndaluar ligjërisht; c) për të kundërshtuar, në përputhje me ligjin, një trazirë ose kryengritje.

b) Neni 2 i Protokollit 6 i KEDNJ-së: Një shtet mund të parashikojë në legjislacionin e tij dënimin me vdekje për akte të kryera në kohë lufte ose rreziku shumë të afërt të luftës; një dënim i tillë do të zbatohet vetëm në rastet e parashikuara nga ky legjislacion dhe në përputhje me dispozitat e tij. Ky shtet do t'i komunikojë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës dispozitat përkatëse të legjislacionit në fjalë. (*Explanatory Memorandum of the EU Charter*, [ëëë.curia.eu](http://eur-lex.europa.eu/curia/eu)). Në këto vite po zhvillohet dhe një jurisprudencë e GJED-së lidhur me Kartën si dhe në mënyrë specifike lidhur me nenin 2, jurisprudencë e cila gjen pasqyrim në paragrafin vijues.

ii) Jurisprudenca (e paktë) e GJED-së lidhur me të drejtën e jetës.

Në Bashkimin European, pra nga GJED-ja kemi shumë pak vendime që lidhen me të drejtën e jetës dhe posaçërisht me nenin 2 të Kartës. Kjo për shkak se, siç u theksua edhe në paragrafët e mëparshëm, Karta vetëm në fund të vitit 2009 ka hyrë në fuqi, pra si akt juridikisht i detyrueshëm për t'u aplikuar nga gjykatat e BE-së, si dhe për arsye të vendit që ka zënë KEDNJ-ja lidhur me të drejtën e jetës si dhe të raportit që ekziston ndërmjet të dy akteve në fjalë ([ëëë.europa.eu](http://eur-lex.europa.eu)).

Vendimi i vetëm i drejtpërdrejtë që lidhet me nenin 2 të Kartës është vendimi C-467/10. Një shtetas gjerman është konsideruar, nga autoriteti kompetent gjerman, si një person jo i aftë fizikisht dhe mendërisht për ngarje të sigurt të një automjeti. Si pasojë, kërkesa e tij për një patentë shoferi iu refuzua. Aplikanti të cilit iu refuzua kjo kërkesë e ka siguruar patentën më pas nga autoritetet çeke dhe e përdori atë në Gjermani. Përdoruesi i patentës u dënua nga një gjykatë penale e shkallës së parë pasi autoritetet vendase nuk pranuan vlefshmërinë e dokumentit në fjalë në Gjermani, pasi sipas tyre edhe makina ishte

pa leje. Personi i drejtohet gjykatës së apelit e cila e parashtron çështjen në GJED për një vendim paragjykimor (ëëë.curia.eu).

GJED-ja, pas shqyrtimit të rekursit arrin në përfundimin se dispozitat e kombinuara të neneve 1 (2) dhe 8 (2) dhe (4) të Direktivës së Këshillit 91/439/KEE e 29 korrik 1991 në lidhje me patentat dhe ato të Nenit 2 (1) dhe 11 (4) të Direktivës 2006/126/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 20 dhjetorit 2006 në lidhje me patentat, duhet të interpretohet që nuk e pengojnë legjislacionin e një Shteti Anëtar të refuzojnë ose të njohë, brenda territorit të tij, një patentë të lëshuar nga një shtet tjetër anëtar në rastin kur mbajtësi apo përdoruesi i licencës nuk ka qenë subjekt i licencuar nga ai Shtet Anëtar. Kjo vlen në kuptim të nenit 8 (4) të Direktivës 91/439 ose nënparagrafin e dytë të nenit 11 (4) të Direktivës 2006/126, edhe kur çështja e lejes së drejtimit të automjetit në shtetin e parë është refuzuar për atë person me arsyetimin se ai nuk e kënaq, sipas legjislacionit të atij shteti, kërkesat fizike dhe mendore për ngarje të sigurt të një automjeti.

Sipas Gjykatës këto dispozita duhet të interpretohen në kuptimin që të mos ndalojnë legjislacionin e një Shteti Anëtar të vendosë kufizime apo të refuzojë të njohë, brenda territorit të tij, patentë për drejtim automjeti të lëshuar në një shtet tjetër anëtar në rastin kur ajo është marrë, në bazë të informacioneve të padiskutueshme që burojnë nga Shteti Anëtar që e lëshon, apo kur mbajtësi i patentës nuk përmbush kushtet normale të qëndrimit të përcaktuar në nenin 7 (1) (b) të Direktivës 91/439 dhe në nenin 7 (1) (e) të Direktivës 2006/126 në kohën kur është lëshuar kjo leje.

Faktikisht, informacioni që është përcjellë, nga Shteti Anëtar që lëshon lejen tek autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar pritës, jo në mënyrë të drejtpërdrejtë, por indirekte, në formën e një njoftimi nga palët e treta, nuk është, në vetvete, i tillë që të parandalojë individët apo autoritetet vendase për lëshimin e një leje drejtimi. Kjo ndodh edhe në rastet kur individi nuk ka një rezidencë të përhershme. Kjo është një çështje që i takon gjykatës referuese (kombëtare) për ta përcaktuar nëse informacioni i marrë në rrethana të tilla mund të klasifikohen si informata që burojnë nga Shteti Anëtar që lëshon leje drejtimi automjeti dhe, nëse është e nevojshme, për të vlerësuar atë informacion nëse ajo përbën informacion të padiskutueshëm pra, tregon që mbajtësi i licencës nuk ka qenë normalisht banues në territorin e atij shteti të fundit në kohën kur është lëshuar patentja (ëëë.curia.eu).

2.2.1.2. E drejta e jetës në aktet juridike të Këshillit të Evropës.

Këshilli i Evropës u themelua në vitin 1949. Synimi kryesor që në gjenezën e tij ka qenë krijimi i një hapësire demokratike ku të mbizotëronte parimi i respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Por, Këshilli i Evropës zhvillon një bashkëpunim të gjithanshëm për një numër të madh çështjesh si: edukimi, kohezioni shoqëror, mbrojtja shëndetësore, lufta kundër të gjitha formave të diskriminimit dhe intolerancës. (Gomien, 2005:9) Për të arritur në një qeverisje në mënyrë demokratike ishte e nevojshme krijimi i një Katalogu të të Drejtave të Njeriut. Disa muaj pas krijimit të Këshillit të Europës u hartua pikërisht Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Pra, instrumenti kryesor i Këshillit të Evropës është *Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut* e vitit 1950 dhe 14 protokollat shtesë të saj⁷ të miratuara në vite (ëëë.echr.org).

Përpara se të analizojmë në detaje KEDNJ-në duhet të theksojmë gjithashtu se në kuadër të Këshillit të Europës me rëndësi paraqitet edhe Karta sociale Evropiane e vitit 1961 dhe Karta e rishikuar e vitit 1996, së bashku me Protokollat shtesë të vitit 1985 dhe 1995. (Korff,2006:5)

Karta Sociale Evropiane e vitit 1961 është nxjerrë me qëllim shtimin e të drejtave ekonomike dhe sociale. (Daci, 2011:175) Që nga fillimi ajo ka vuajtur nga sistemi i dobët dhe joefektiv për implementim, pasi mungojnë mekanizma zbatues si: GJEDNJ-ja. Sidoqoftë, nga fundi i viteve 1980, krahas rritjes së vëmendjes për të drejtat ekonomike dhe sociale në nivel universal, një vëmendje e re, gjithashtu, i është përkushtuar Kartës Sociale Evropiane, e cila është amenduar dy herë, më 1988 dhe 1995, e cila duke u bazuar në protokollin shtesë tani ofron mundësi edhe për ankesa kolektive. Kjo Kartë ndër të tjera garanton në thelb të drejtën për të përfitur nga të gjitha masat që ndërmerren dhe që të gëzojnë standardin më të lartë të arritshëm të shëndetit: eliminimin e shkaqeve të

⁷ Aktualisht janë miratuar edhe dy Protokolle të tjera shtesë, Protokollin 15 dhe 16 të cilat janë në fazën e ratifikimit nga Shtetet Anëtare të Këshillit të Europës.

sëmundjeve; parashikon ofrimin e shërbimeve këshilluese dhe edukimin shëndetësor, garanton të drejtën për mbrojtje sociale dhe mjekësore etj.

Karta Sociale Evropiane e vitit 1961 nuk ka fituar kurrë rëndësi sa Konventa Evropiane e të drejtave dhe lirive themelore. Për funksionimin efikas të Konventës Këshilli i Europës hartoi një sërë mekanizmesh nëpërmjet të cilëve çdo shtet detyrohej të përdorte detyrimin pozitiv të respektimit të saj. Një rol të rëndësishëm këtu paraqet pikërisht Gjykata Evropiane e të drejtave të Njeriut. Në frymën e mbrojtjes së jetës Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut konsiderohet si një ndër aktet më të rëndësishme ose e konsideruar ndryshe si pasaporta e të drejtave të njeriut. (Daci, 2011:176)

i) Roli i KEDNJ-së për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të individëve në kuadër të respektimit të të drejtës së jetës.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut u hartua bazuar në frymën e Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, e cila ka zënë vendin e nderit në preambulën e KEDNJ-së. Konventa u nënshkrua në Romë në 04.11.1950 dhe hyri në fuqi në 03.09.1953. Ajo ka qenë subjekt i shumë ndryshimeve pasuese të cilat synonin përmirësimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe të të drejtës së jetës në veçanti. (Gomien,2005:11)

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut është një ndër konventat më të rëndësishme të ratifikuara nga vendi ynë që zë vend të veçantë në hierarkinë e akteve normative⁸ e cila është ratifikuar me Ligjin nr. 8137, datë 31/07/1996 “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore. Konventa parashikon në çdo nen të saj, të drejtat civile, politike, ekonomike, shoqërore, kulturore etj. Konventa ka karakter detyrues dhe jo deklarativ, sepse u imponon shteteve anëtare detyrime negative dhe pozitive në favor të mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Falë mbrojtjes që ky akt i jep jetës dhe të drejtave të njeriut shkelja e të cilave përbën një çështje jo thjesht në nivele rajonale por ndërkombëtare. (Daci,2011:132)

⁸ Neni 116 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, 1998.

E drejta e jetës është parashikuar në nenin 2 të KEDNJ-së nga ku thuhet se: “1. E drejta e çdo njeriu për jetën mbrohet me ligj. Askujt nuk mund t’i merret jeta qëllimisht, me përjashtim të rastit kur zbatohet një vendim gjyqësor me vdekje, pas dënimit për një krim për të cilin ky dënim është parashikuar me ligj.

2. Marrja e jetës nuk konsiderohet të jetë shkaktuar në kundërshtim me këtë nen në rastet kur ajo vjen si pasojë e përdorimit të forcës, që është jo më shumë se absolutisht e nevojshme:

a. në mbrojtje të çdo personi nga dhuna e paligjshme;

b. për të kryer një arrestim të ligjshëm ose për të parandaluar arratisjen e një personi të cilit i është hequr liria ligjërisht;

c. për të kundërshtuar, në përputhje me ligjin, një trazirë ose kryengritje.” duke përcaktuar në këtë mënyrë dhe kufizimet të cilat konsiderohen “të ligjshme” në marrjen e saj. (Gomien, 2005, 12).

Që nga hyrja në fuqi e Konventës janë miratuar katërmëdhjetë Protokolle, të cilat kanë hyrë në fuqi dhe i kanë sjellë ndryshime të rëndësishme Konventës. Protokollet Nr.1, 4, 6, 7, 12 dhe 13 i kanë shtuar të drejta e liri të tjera atyre që garantohen nga Konventa, ndërsa Protokoli Nr.2 i ka dhënë Gjykatës kompetencën për të dhënë mendime këshillimore. (Daci,2011: 131) Protokoli Nr.9 ka mundësuar që kërkuarit individualë të paraqesin çështjet e tyre përpara Gjykatës duke iu nënshtruar ratifikimit nga Shteti i paditur dhe duke u pranuar nga një panel kontrolli⁹⁹. Protokoli nr.11, ndryshoi sistemin e kontrollit duke i unifikuar procedurat para Komitetit dhe Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe duke kaluar të gjitha funksionet Gjykatës. Kjo e fundit është i vetmi organ përgjegjës që ka mandat të shqyrtojë ankesat në lidhje me të drejtën e jetës por dhe të gjitha të drejtave të tjera. Pjesë e KEDNJ-së janë tashmë dhe protokoli nr:3 dhe ai nr:13 me anë të të cilëve garantohet e drejta e jetës duke hequr dënimin me vdekje.(Korff, 2006:4)

Në vazhdim ky punim do të fokusohet në analizën e disa vendimeve të rëndësishme, studimin e mekanizmave dhe garancive që disponon Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut në mbrojtjen e të drejtave të garantuara në nenin 2 të Konventës, si një nga parimet bazë të platformës demokratike dhe shtetit të së drejtës. Në vazhdim do të

⁹⁹<http://www.coealb.org/index.php?faqe=content/detail&id=38&mnu=65>

trajtojmë të gjithë elementët e të drejtës së jetës duke e analizuar në mënyrë të detajuar çdo çështje që lidhet me këtë të drejtë ekzistenciale.

ii) Risitë e Draft-Protokollit 15 dhe 16 KEDNJ. Çështja e (Mos)ratifikimit nga Shtetet dhe situata e Shqipërisë.

Së fundmi, KEDNJ-së i është shtuar dhe Protokollin Nr.15 dhe Protokollin Nr.16. Protokollin Nr.15 i Konventës Europiane “Për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”, shërben për lehtësimin e mundësisë së qytetarëve në ushtrimin e të drejtave dhe interesave të tyre në mënyrë sa më efikase. Shtetet të cilat ratifikojnë Protokollin Nr. 15, i cili amendon Konventën europiane për të drejtat e njeriut konfirmojnë se GJEDNJ-ja, mund të vazhdojë të luaj rolin e saj në mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Europë. Protokollin Nr. 16 i lejon gjykatat më të larta një Pale të Lartë Kontraktuese, siç është përcaktuar nga ky i fundit, të kërkojnë nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhënien e mendime (opinioneve) këshillimore për çështje parimore në lidhje me interpretimin ose zbatimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara nga Konventa ose protokollet e saj. (Bana,2015:2) Hartimi i këtij Protokollin (fillim 2006) ka ardhur si rezultat i mbingarkesës së GJEDNJ, e cila i paralajmëroi institucionet e Këshillit të Evropës për rritjen e numrit të rasteve për shqyrtim në GJEDNJ, pasi kështu kërcënohej seriozisht funksionimi i sistemit të Konventës dhe aftësia e Strasburgut për të përballuar ngarkesën e punës. Për këtë arsye, Gjykata propozoi dhe gjeti të përshtatshëm si mekanizmat e reja të filtrimit për të lehtësuar punën futjen e "opinioneve këshillimore", që mund të kërkonin gjykatat e brendshme nga GJEDNJ-ja. Kjo do të çonte në zhvendosjen e ngarkesës më të madhe të punës në mbrojtjen e të drejtave të njeriut tek gjykatat kombëtare. Tre Shtete e kanë ratifikuar Protokollin nr.16. Shqipëria e ka ratifikuar Protokollin nr. 16 nëpërmjet Ligjit Nr. 48/2015 “Për ratifikimin e protokollit të 16-të të Konventës “Për mbrojtjen e të

drejtave të njeriut dhe lirive themelore”, miratuar në datën 7.5.2015 dhe botuar në Fletoren Zyrtare datë 26.05.2015 nr.85¹⁰.

Protokolli Nr.16 do të ketë një vlerë të veçantë sepse do të rrisë efikasitetin e gjykatave të vendit tonë. Në këtë drejtim ngarkesa më e madhe e punës në mbrojtjen e të drejtave të njeriut mund të zhvendoset te gjykatat tona. Përgjegjësia kryesore për të komunikuar me gjykatën e Strasburgut është te gjykatat më të larta të vendit (gjykatat e apelit, GJK dhe Gjykata e Lartë). Sistemi i Konventës, nga ana tjetër, bazohet te mungesa e detyrimit dhe vetë vullneti i gjykatave kombëtare për t’i parashtruar Strasburgut pyetje të mundshme, pra nuk është e detyrueshme. Ky është një tregues shumë domethënës i cili nuk do i vërë “në pozitë” gjykatat tona. Opinioni këshillimor paraqet hapin e parë drejt institucionalizimit të mëtejshëm të lidhjeve dhe kontakteve mes gjykatave kombëtare dhe Gjykatës së Strasburgut. Strasburgu mundet me anë të kësaj procedure që të zhvillojë doktrinën e tij *acte clair* dhe *acte eclairé* se kur duhet të pranojë ose të refuzojë pyetje në lidhje me opinionet këshillimore dhe t’iu japë gjykatave kombëtare me udhëzime ilustruese se cilat pyetje kërkojnë sqarime të mëtejshme ligjore dhe cilat pyetje janë shpjeguar.(Bana,2015 :15)

Siç edhe u theksua në paragrafët e mëparshëm nëse një çështje është parashtruar formalisht para Gjykatës së Strasburgut sipas nenit 34 të KEDNJ-së, ndërsa çështje të tjera të ngjashme janë ende në pritje në gjykatat «më të larta» kombëtare, dhe gjykatat kombëtare vendosin të kërkojnë opinione këshillimore për të njëjtën çështje apo çështje të ngjashme, aplikimi individual patjetër që do të gëzojë përparësi. Gjykatat shqiptare janë, deri diku të kufizuara në të drejtën e tyre për të kërkuar opinion këshillimor, pasi munden vetëm të kërkojnë opinion këshillimor në kontekstin e një çështje në pritje të gjykimit të tyre. Kjo do të thotë se pyetja përkatëse ligjore duhet të ketë lindur mbi bazën e një çështjeje të diskutueshme në lidhje me të drejtat individuale dhe se procedura nuk do të lejojë shqyrtime abstrakte të legjislacionit.(Bana,2015 :16).

¹⁰ www.qbz.gov.al

iii) Roli i GJEDNJ-së në respektimin e të drejtës së jetës

Të drejtat dhe liritë e sanksionuara në Konventën Europiane të të drejtave të Njeriut u bënë objekt i shqyrtimit të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut në raport me çdo të drejtë të cënuar në të. Gjykata Evropiane e të drejtave themelore të Njeriut është kompetente që të kontrollojë dhe sigurojë respektimin e së drejtës në interpretimin dhe zbatimin e normave të përcaktuara në KEDNJ nga ana e institucioneve legislative dhe ekzekutive të Palëve të Larta Kontraktuese. Kjo Gjykatë, nëpërmjet numrit dhe gamës shumë të madhe të çështjeve, që ka trajtuar dhe që ka zgjidhur, i ka dhënë vetë Konventës një hapësirë dhe shtrirje, me të vërtetë të madhe për nga pikëpamja e zbatimit të neneve të saj. (Daci,2011: 133) Mjaft vendime të Gjykatës së Strasburgut kanë dhënë sanksione ndaj shteteve, që janë gjetur në shkelje të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore dhe veçanërisht të së drejtës së jetës. Gjykata, nëpërmjet vendimeve, ka arritur të shprehet se shtetet palë janë të detyruara që të ndërmarrin veprime efektive kur paraqitet nevoja për të kryer hetime, kur zhduken persona të ndryshëm. Madje, kur shteti nuk ndërmerr një hetim përkatës, për të gjetur njeriun e zhdukur, kjo përbën një trajtim çnjerëzor dhe degradues për të afërmit e tyre.

Nga ana tjetër, mbi bazën e nenit 47 KEDNJ, edhe Komiteti i Ministrave mund t'i kërkojë Gjykatës të japë një opinion këshillues mbi çdo çështje ligjore që ka lidhje me interpretimin e Konventës dhe të protokolleve të saj, për sa kohë ky vendim nuk ka të bëjë me përmbajtjen dhe fushën e zbatimit të të drejtave të garantuara, ose me çdo çështje që Gjykata ose Komiteti mund t'i duhet të marrin në konsideratë në lidhje me procedimet që rrjedhin nga autoriteti i kësaj Konvente. Juridiksioni më i rëndësishëm i ushtruar nga Gjykata është juridiksioni i saj i diskutueshëm në çështje gjyqësore të karakterit individual dhe ndërshtetëror. (Daci,2011:134) Me ratifikimin e Konventës Europiane për të drejtat e Njeriut, çdo shtet pranon në mënyrë automatike juridiksionin e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut për rishikimin e ankesave ndërshtetërore mbi bazën e nenit 33, si dhe të ankesave individuale mbi bazën e nenit 34. Ndërkohë që një nga pikat më të rëndësishme të KEDNJ është edhe neni 6 i Konventës në të cilin zë vend e drejta për një proces të rregullt ligjor.(Heyns& Strasser & Padilla,2003:78) Në kuadër të njohjes së kësaj të drejte

duhet përcaktuar fillimisht se të drejtat civile kanë të bëjnë me të drejtat e individëve në raport me njëri-tjetrin dhe në raport me shtetin. “ Të drejtat e personave privatë në marrëdhëniet e tyre midis njëri-tjetrit”, për shembull: të drejtën e kontraktimit, të drejtën tregtare, të drejtën e dëmshpërblimit, të drejtën e familjes, të drejtën e punësimit dhe të drejtën e pronës.

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut mund të vihet në lëvizje vetëm pasi të jenë shteruar mjetet e brendshme ligjore sipas kuptimit nga parimet përgjithësisht të pranuar të së drejtës ndërkombëtare dhe brenda një afati prej gjashtë muajsh nga data e vendimit përfundimtar të brendshëm. Vendimet e Gjykatës janë detyruese: kur konstaton një shkelje, vendi në fjalë është i detyruar të ekzekutojë vendimin, duke marrë masa për të siguruar që një shkelje e tillë e ngjashme të mos ndodhë më dhe mbi të gjitha të rregullojë pasojat për viktimën. Gjykata gjithashtu mund të urdhërojë shtetin t’i paguajë kërkuarit një shumë parash si “shpërblim të drejtë”, si kompensim. Të tjera masa specifike mund të nevojiten gjithashtu, si për shembull, lirimi i kërkuarit nëse mbahet nën arrest, rivendosja e kontakteve me fëmijën e kërkuarit, dhënien e lejes së qëndrimit për të, etj. Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës është përgjegjës për monitorimin e zbatimit të vendimeve të Gjykatës: ai i ndihmon shtetet që të identifikojnë masat e nevojshme dhe të gjendet zgjidhje kur adoptimi i masave të caktuara ndeshet me probleme. Gjithashtu, ai vlerëson efektivitetin e masave të marra për kërkuarin dhe për këdo tjetër që mund të gjendet në të njëjtën situatë.”¹¹ Nga ana tjetër duhet të theksojmë se Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut e ka zgjeruar dukshëm fushëveprimin e mbrojtjes së këtyre të drejtave në kuadër të nenit 2 të Konventës, sigurisht bazuar në çështjet që rast pas rasti i janë paraqitur asaj për zgjidhje. Gjykata kërkon nga pala që të dëshmojë se masa që sfidohet është e nevojshme në shoqërinë demokratike, për aq sa plotëson nevojën urgjente shoqërore dhe përputhet me vlerat e përbashkëta. Gjykata në të gjitha rrethanat duhet të tregohet e vëmendshme duke përcaktuar qartë se gjendja apo rrethana specifike e parashikuar që çështja e paraqitur pranë saj përbën apo jo, shkelje e të drejtës së jetës pra të drejtave që garanton neni 2 i Konventës (Daci, 2011:135).

¹¹ www.echr.coe.int/Document/

2.3. E drejta e jetës, e drejtë kushtetuese në Shqipëri

E drejta e jetës është e garantuar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. Në kuadrin e lirive dhe të drejtave të shtetasve, në bazë të nenit 21 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, kujtdo i sigurohet mbrojtja e jetës me ligj (Dobjani, 2001:9). Pa dyshim që shoqëria demokratike të drejtën e jetës e koncepton dhe duhet ta konceptojë jo vetëm në drejtim të sigurimit të saj në kuptimin e ngushtë, por e sheh më gjerë, në drejtim të sigurisë dhe të lirisë, në drejtim të mirëqenies, si dhe të një tërësie kushtesh sociale, institucionale, ligjore, kulturore, arsimore, politike etj. (Çeço 2011:14). Në fakt, e drejta për të jetuar, konsiderohet si një nga të drejtat më themelore, në të cilin përfshihen aspekte që kanë të bëjnë me shumë çështje si: sigurinë, ato me karakter shëndetësor, ushqimor, mjedisor, pasuror, seksual, ato që kanë të bëjnë me punën etj. Këto aspekte lidhen direkt ose indirekt, jo vetëm me dinjitetin dhe cilësinë e jetës, por edhe me të drejtën për të jetuar. Në një shoqëri demokratike vihet në plan të parë mbrojtja e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut e posaçërisht e të drejtës për të jetuar, sepse jeta është e pakrahasueshme dhe e pazëvendësueshme me asgjë tjetër. Për këtë arsye Kodi Penal siguron mbrojtje juridiko-penale të të drejtës së njeriut për të jetuar, me anën e parashikimit të një varg dispozitash të llojeve të ndryshme të krimit të vrasjes dhe të dënimeve penale për secilën prej tyre. Subjektet që detyrohen nga ligji për të garantuar të drejtën për të jetuar, në fakt, janë të shumtë dhe realizojnë mbrojtje të posaçme, të veçantë, konkrete, apo të përgjithshme. Në krye të këtyre subjekteve qëndron Shteti. Për këtë qëllim ai ndërton, institucionalizon, modernizon dhe monitoron mekanizmat, strukturat kapilare në çdo sektor të jetës, mjetet dhe metodat, kushtet dhe mundësitë për funksionimin efektiv të tyre. Në kuadrin e realizimit të këtij misioni merr përparësi parandalimi i kriminalitetit kundër jetës. Suksesi i shtetit nuk mund të matet me nivelin e masave për përballimin e situatave, apo ngjarjeve kriminale që shoqërohen me vdekje, por me reagimin për parandalimin e tyre në kohë.¹²

¹² Referuar nenit 21 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 2 KEDNJ.

Mbrojtja dhe respektimi i të drejtës së jetës së individit, e konceptuar dhe e sanksionuar si një nga të drejtat më themelore të njeriut, qëndron në themel të legjislacionit tonë kushtetues dhe të atij penal e procedural penal (Naço, 2002:102). Jeta e personit mbrohet me ligj. Në këtë mënyrë është sanksionuar koncepti juridik i mbrojtjes së jetës njerëzore në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Ky formulim shpreh qartë dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë mbrojtjen e jetës së njeriut, e cila përbën një vlerë kushtetuese. E drejta për jetën paraqitet në Kushtetutë si një vlerë, nga e cila burojnë të gjitha të drejtat e tjera. Kreu i të drejtave dhe i lirive themelore të njeriut përshkohet nga koncepti i mosdhunimit të tyre. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, sipas nenit 15 të Kushtetutës, janë të pandashme, të patjetërsueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik, prandaj ekziston edhe detyrimi parësor dhe kushtetues i shtetit, nëpërmjet organeve të tij, që t'i respektojë dhe t'i mbrojë këto të drejta. Parimet themelore të mbrojtjes së jetës gjejnë mbështetje të plotë në dispozitat kushtetuese. Kreu kushtetues mbi të drejtat e njeriut përbën një katalog të përpunuar të të drejtave civile, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore, të cilat bazohen në standartet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut (Nuni, 2001:60).

Jeta është një e drejtë, atribut themelor i qenies njerëzore dhe duke pasur një vlerë të padiskutueshme bëhet objekt i mbrojtjes kushtetuese. Mbrojtja e jetës së njeriut në çdo çast dhe në të gjitha rrethanat nuk është e njëjtë, pasi ajo është e ndikuar nga një sërë faktorësh të ndryshëm, për të cilët edhe ligjvënësi mund të jetë ai që nëpërmjet ligjit që harton e miraton të parashikojë hollësitë që mund të garantojnë këtë jetë njerëzore. Vetëm nëpërmjet ligjit mund të bëhen përjashtimet, kur, si rrjedhojë e mbrojtjes së një të drejte më të rëndësishme kushtetuese, kërkohet të hiqet jeta e dikujt. Ligji është ai, të cilit i jepet e drejta, që, në raste të veçanta dhe që kanë lidhje me vdekjen, në kuptim të nenit 2 pika 2 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, të lejojë edhe heqjen e jetës për njeriun. Konkretisht, këto raste kanë gjetur rregullimin e tyre ligjor në dispozitat e përgjithshme të Kodit Penal që parashikojnë institutin juridik të mbrojtjes së nevojshme, ose në ligjin “Për përdorimin e armëve të zjarrit”, i cili u jep të drejtë Forcave të Armatosura, forcave të policisë, rojave civile të armatosura që të përdorin armët e zjarrit në rastet e sipërpërmendura. Sipas kësaj dispozite të Konventës, jeta e njeriut, mund të hiqet dhe kjo

lloj vdekjeje, që i shkaktohet atij, qoftë dhe nga shteti nëpërmjet organeve të tij, nuk ka të bëjë dhe nuk mund të jetë e njëjtë me dënimin me vdekje, si lloj dënimi që jepej më parë nga gjykata, por është e lidhur me ato raste përjashtimore, shprehimisht të sipërcituara. Në këtë mënyrë është ndërtuar legjislacioni ynë dhe në të vërtetë ky është kuptimi kushtetues e ligjor mbi të cilin realizohet mbrojtja e jetës së njeriut. Ky është legjislacioni ynë që më shumë u përgjigjet kushteve të një shoqërie moderne, të emancipuar dhe me një demokraci solide. Në këtë aspekt, legjislacioni shqiptar paraqitet shumë më pararendës se mendësia shoqërore dhe tradicionale, gjë që sipas autorit Sadushi përbën një pengesë tepër të vështirë në përsosjen dhe konsolidimin e kësaj shoqërie (2001:111).

Nga ana tjetër në Kushtetutë është i parashikuar kufizimi i të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve për shkak të ligjit, por ky trajtim është një kufizim i ligjshëm dhe kushtetues. Është e kuptueshme se këto të drejta dhe liri nuk mund të konceptohen si të paprekshme dhe të pakufizuara. Njihet kufizimi i të drejtave dhe lirive themelore, por kur një gjë e tillë është e parashikuar me ligj, kur kërkohet të mbrohen të drejtat e të tjerëve. Dhe ky kufizim kushtetues parashikohet në rastet e diskriminimit (18/3), të punës së detyruar (26), të heqjes së lirisë (27), të bërjes publike të të dhënave vetjake (35), të kontrollit të banesës (37), të drejtës së pronës (41), etj. Por nga ana tjetër, në disa dispozita të kreut të të drejtave dhe lirive themelore, legjislatori ka parashikuar vetëm rregullin e përgjithshëm dhe nuk ka lejuar absolutisht përjashtimin. Kjo do të thotë se ka disa të drejta dhe liri që nuk mund të kufizohen as nga ligji dhe as nga Kushtetuta. Mungesa në mënyrë të qartë e këtij përjashtimi shfaqet në shumë dispozita kushtetuese dhe konkretisht në nenet që nuk lejojnë tejkalimin e kufizimeve të parashikuara nga Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut (17, pika 2), të drejtat e pakicave (20), lirinë e ndërgjegjes e të fesë (24), ndalimin e torturës (25), të drejtën e mbrojtjes (28, 31), prezumimin e pafajësisë (30) etj. Në këtë grup dispozitash bën pjesë edhe e drejta për jetën (neni 21), në të cilën nuk është parashikuar asnjë lloj kufizimi. Kjo do të thotë se shteti nuk mund të pajtohet me raste ose dukuri që çenojnë të drejtën e jetës. Janë këto koncepte të sanksionuara në Kushtetutë, mbi të cilat u mbështet dhe Gjykata Kushtetuese për të konsideruar dënimin me vdekje në Shqipëri të papajtueshëm me Kushtetutën (Sadushi 2001:117).

2.3.1 Raporti i KEDNJ-së me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut ashtu siç e theksuam edhe më sipër është miratuar në 1950 i cili hyri në fuqi në vitin 1953. Përfaqëson konventën e parë të Këshillit të Evropës që merret me mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Shtetet duhet të ratifikojnë Konventën për tu bërë pjesë e Organizatës. Që nga viti 1950 Konventa i është nënshtruar disa ndryshimeve – amendimeve dhe i ka dhënë shtysë krijimit të shumë konventave të tjera të Këshillit të Evropës. Jurisprudenca e Gjykatës e shndërron Konventën në një “instrument të gjallë”, në gjendje për t’iu përshtatur ndryshimeve që ndodhin në shoqëritë tona. Ky traktat është unik në llojin e tij.

Vendi që zë KEDNJ në legjislacionin e brendshëm shqiptar, përcaktohet qartë dhe si asnjëherë tjetër nga Kushtetuta e Shqipërisë. Për këtë mjafton t’u referohemi disa neneve të Kushtetutës. Në nenin 5, Kushtetuta përcakton se: “Republika e Shqipërisë zbaton të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të”. Ndërsa, në nenin 116, paragrafi 1, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara renditen pas Kushtetutës, në gërmën “b”, si akte normative, që kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Ndërsa në nenin 17, ku flitet për kufizimin e të drejtave dhe lirive të parashikuara në Kushtetutë, përcaktohet qartë se “këto kufizime nuk mund të çenojnë thelbin e lirive dhe të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në KEDNJ”. (Panda 2001:118).

Konventa përfshin midis të tjerave të drejtën e jetës; mbrojtjen kundër torturës dhe trajtimit çnjerëzor; lirinë dhe sigurinë; të drejtën për një proces të rregullt gjyqësor; të drejtën për të respektuar jetën private të çdonjërit dhe jetën familjare etj. Protokollet që kanë pasuar në vite kanë shtuar të drejta të tjera përveç atyre të parashtruara në Konventë, si: heqja e dënimit më vdekje. Shqipëria është pjesë e kësaj Konvente që nga 29 korrik 1996. Me anë të këtij traktati, Shqipëria dhe 46 vende të tjera Evropiane, janë angazhuar të garantojnë respektimin e disa të drejtave themelore të njeriut për të gjithë qytetarët që ndodhen nën juridiksionin e tyre. Këto të drejta duhet të jenë, dhe sigurisht janë, të

siguruara më mirë në nivel kombëtar. Kjo edhe për faktin se meqenëse qeveritë vendase janë më pranë individit dhe janë në dijeni për atë çka ndodh rreth tij, mjetet dhe mënyrat e përdorura nga to, priten të jenë më efektive se ato ndërkombëtare. Kështu Kushtetuta shqiptare, përmban kryesisht të njëjtat të drejta me ato të Konventës. Rëndësia e kësaj Konvente nuk qëndron vetëm në numrin e madh të të drejtave të përfshira në të, por në mekanizmat mbrojtës të vendosura në Strasburg për të hetuar shkeljet e kallëzuara dhe për të respektuar detyrimet që rrjedhin nga Konventa. Dispozitat e Konventës kanë ushtruar një influencë gjithnjë e më të thellë mbi ligjet dhe realitetet shoqërore të shteteve anëtare. Gjykatat kombëtare të shteteve anëtare të Konventës, kur vendosin mbi një çështje për të drejtat e njeriut, i referohen gjithnjë e më tepër vendimeve të Strasburgut dhe zbatojnë standartet dhe parimet e vendosura atje. Gjithashtu mund të përmenden shumë raste të modifikimit të legjislacionit të shteteve dhe të praktikave administrative përpara ratifikimit të Konventës nga ana e tyre, veçanërisht në rastin e atyre shteteve që i janë bashkuar së fundmi Këshillit të Europës. Krahas GJEDNJ-së, në vitin 1999, u krijua Komisioneri i të Drejtave të Njeriut. Ai ka për mision promovimin e edukimit dhe sensibilizimin me të Drejtat e Njeriut në shtetet anëtare. Ai kujdeset për respektimin e plotë dhe efektive të Këshillit të Europës si: Konventat, rekomandimet dhe rezolutat e miratuara nga Komiteti i Ministrave. Ai nuk ka fuqi juridike, por një rol informues dhe këshillimor për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe parandalimin e dhunimit të tyre. (Daci,2011:399)

Roli dhe vendi i KEDNJ-së në Kushtetutën tonë është i një rëndësie të veçantë. KEDNJ është inkorporuar në Kushtetutën Shqiptare dhe madje në disa prej dispozitave të saj, ne mund të konstatojmë pozitën e rëndësishme që i është dhënë duke pasur edhe një pamje më të qartë pozicionit të saj krahasuar me Kushtetutën dhe legjislacionin vendas. Parë në këtë këndvështrim të drejtat e pabashkuara në të kanë një ndikim të madh tek ligjvënësi, gjykatat dhe ekzekutivi. GJEDNJ si autoritet interpretues i Konventës luan një rol vital në krijimin e jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese në përputhje me standartet e KEDNJ-së. Në njëfarë mënyre, në nivel kombëtar vendimet e GJEDNJ-së kanë një lloj efekti *erga omnes*, sepse vërtet vendimi i GJEDNJ-së është *inter partes*, por për raste të njëjta, jo domosdoshmërisht shteti shqiptar duhet të kalojë të njëjtin kalvar dhe çështja të përfundojë me gjobitjen e tij, prandaj edhe ky i fundit duhet të ketë parasysh efektet e

vendimit për raste të njëjta. Pas ratifikimit të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, në Shqipëri ndodhën ndryshime pozitive në rendin kushtetues dhe ato, hapën rrugën drejt forcimit të shtetit ligjor. Më parë dispozitat kryesore kushtetuese dhe më pas Kushtetuta e vitit 1998, sanksionuan të drejtat dhe liritë themelore të individit dhe krijuan mjetet e nevojshme për të garantuar ushtrimin efektiv të tyre. Në këto procese, duke zënë një vend të rëndësishëm, u përfshi dhe Gjykata Kushtetuese. Kontrolli i pajtueshmërisë së legjislacionit me standardet e KEDNJ-së përbën detyrën parësore të Gjykatës Kushtetuese (Kristo, 2007: 1). Sipas nenit 131 të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese vendos, ndër të tjera, “për pajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare” (siç parashikohet në nenin 122). Në larminë e çështjeve të kontrollit kushtetues të legjislacionit, një vend të posaçëm zënë vendimet për çështje të respektimit të standardeve të të drejtave të njeriut siç parashikon KEDNJ. Nëpërmjet veprimtarisë vendimmarrëse, Gjykata Kushtetuese ka dhënë kontribut të qenësishëm për rritjen e përgjegjësisë së institucioneve drejt përmbushjes, gjithnjë e më shumë, të standardeve evropiane për respektimin e të drejtave dhe lirive të individit.

Njohja dhe reflektimi me standardet e KEDNJ-së dhe me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut përbën një domosdoshmëri. Veçanërisht jurisprudenca e GJEDNJ përbën një eksperiencë të çmuar për reflektimin dhe pasqyrimin deri në perfeksion të standardeve të Konventës. Çështjet e kontrollit të pajtueshmërisë së ligjit me KEDNJ dhe me idetë udhërrëfyese të jurisprudencës së GJEDNJ kanë qenë dhe janë një proces sa delikat aq dhe i rëndësishëm i veprimtarisë vendimmarrëse të GJK. (Kristo, 2007: 2). Duhet të konsiderohet fakti, se Gjykatës i është dashur, përgjatë pak vitesh ekzistencë, të krijojë eksperiencën e saj dhe ta pasurojë atë gradualisht, gjë që nuk është bërë pa vështirësi e pengesa. Në shumë raste, asaj i është dashur të çelë shtigje të reja, të krijojë e të përsosë jurisprudencën si garante e respektimit të Kushtetutës, duke reaguar kundër çdo akti ligjor antikushtetues. (Daci,2011:398).

KAPITULLI III: MBROJTJA E JETËS NË STANDARTET E NENIT 2 KEDNJ DHE PROTOKOLLEVE SHITESH

3.1. E drejta e jetës, kuptimi dhe natyra e saj

E drejta e jetës është parashikuar në nenin 2 të KEDNJ-së sipas të cilit:

“1. E drejta e çdo njeriu për jetën mbrohet me ligj. Askujt nuk mund t’i merret jeta qëllimisht, me përjashtim të rastit kur zbatohet një vendim gjyqësor me vdekje, pas dënimit për një krim për të cilin ky dënim është parashikuar me ligj.

2. Marrja e jetës nuk konsiderohet të jetë shkaktuar në kundërshtim me këtë nen në rastet kur ajo vjen si pasojë e përdorimit të forcës, që është jo më shumë se absolutisht e nevojshme:

a. në mbrojtje të çdo personi nga dhuna e paligjshme;

b. për të kryer një arrestim të ligjshëm ose për të parandaluar arratisjen e një personi të cilit i është hequr liria ligjërisht;

c. për të kundërshtuar, në përputhje me ligjin, një trazirë ose kryengritje.”

Neni 2 përmban dy elementë thelbësorë që pasqyrohen në dy paragrafët e tij: një detyrim të përgjithshëm për të mbrojtur të drejtën për jetën “me ligj” (paragrafi 1) dhe ndalimin e privimit të jetës që rrethohet nga një listë përjashtimesh (paragrafi 2) (Gomien, 2005:16).

Ajo që përbën një nga elementet më të rëndësishëm dhe më interesante të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, është se të gjitha të drejtat e përmendura më lart në strukturimin e saj janë të përfshira nën rolin themelor të dy dispozitave që luajnë rolin e garantëve të të gjitha të tjerave, të parashikuara nga neni 1 dhe neni 13 i Konventës (Toska Dobjani, 2011: 25). Konkretisht, me anë të Nenit 1 të gjitha shtetet anëtare marrin përsipër që t’u sigurojnë të gjithë individëve, pra jo vetëm shtetasve të tyre, që gjenden nën juridiksionin e tyre të drejtat e parashikuara nga Titulli I i Konventës, dhe me anë të Nenit 13 ato angazhohen t’u japin këtyre individëve mundësitë për ankim efektiv për vënien në vend të shkeljes eventuale të këtyre të drejtave (Zaganjori Xh., 2007:2).

Nga ana tjetër duhet përmendur gjithashtu se të gjitha këto të drejta të lartpërmendura vishen me një kriter barazie, në kuptimin që gëzohen nga të gjithë pavarësisht nga pozitat e ndryshme që mund të kenë individët e caktuar, siç parashikohet nga neni 14 i Konventës. Madje mund të shtohet këtu se për Gjykatën Evropiane të Drejtave të Njeriut nuk ka rëndësi nëse shkelja e Konventës është herë nga organe me karakter legjislativ, administrativ apo gjyqësor. Për të përgjegjësia për shkeljen e Konventës ka karakterin e një përgjegjësie ndërkombëtare te shtetit, përderisa ai si subjekt i së drejtës ndërkombëtare është Palë e Lartë Kontraktuese në Konventën Evropiane të Drejtave të Njeriut dhe në bazë të Nenit 1 të Konventës ka marrë përsipër që të garantojë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Pra përgjegjësia është e paspecifikuar në lidhje me organin e brendshëm, veprimi ose mosveprimi i të cilit ka çuar në shkelje të Konventës. Përgjegjësia e specifikuar institucionale ka të bëjë me përgjegjësinë shtetërore. Në këtë drejtim shprehet qartë edhe Gjykata Evropiane e Drejtave të Njeriut sipas së cilës nuk ka vend: “për të saktësuar se cili autoritet shtetëror është përgjegjës për një shkelje të Konventës: kemi të bëjmë këtu vetëm me përgjegjësi të shtetit¹³”

Neni 1 i Konventës, i titulluar “Detyrimi për të respektuar të drejtat e njeriut” sipas të cilit: *“Palët e Larta Kontraktuese i sigurojnë çdo njeriu që ndodhet në juridiksionin e tyre të drejtat dhe liritë e përcaktuara në titullin e I të kësaj Konvente.”* tregon që nuk është e mjaftueshme që shtetet vetëm të mbajnë qëndrime mosvepruese, por ato duhet të marrin masat e duhura, që përfshijnë veprime të caktuara për të arritur të sigurojnë respektimin e të drejtave dhe lirive të përfshira në Titullin I të Konventës. Të drejta të tilla si :për shembull ajo e jetës e garantuar nga neni 2 nuk mund të siguroheshin në qoftë se shteti nuk ngre struktura adekuate për ndjekjen e krimit. Për më tepër ka nene të veçanta, që duke u nisur nga karakteri i të drejtave që mbrojnë e theksojnë akoma më tej domosdoshmërinë për angazhim pozitiv të shteteve.

Në kontekstin e nenit 2 të KEDNJ-së koncepti i “Jetës” nënkupton jetën njerëzore. Në këtë kontekst nuk përfshihet e drejta e jetës së kafshëve dhe as e drejta për ekzistencën e “personave juridike”. Personat juridikë, si kompanitë e ndryshme të cilët nuk gëzojnë të

¹³ Shih vendimin e Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut në lidhje me çështjen *Lingens kundër Austrisë*.

drejtën e jetës në konceptin njerëzor, do të mbështeten p.sh. tek KEDNJ-ja për respektimin e së drejtës për pronën dhe të së drejtës për një proces të rregullt gjyqësor etj.¹⁴.

Konventa nuk flet për një hierarki të të drejtave të njeriut por është e kuptueshme që e drejta e jetës kryeson majën e piramidës për vetë faktin se pa këtë të drejtë nuk do të kishte dhe nuk do të pretendohet për të drejta sociale, politike ekonomike etj. por pavarësisht kësaj të drejtat e njeriut nuk mund të shikohen të veçuara nga njëra tjetra. Pasi është e vërtetë se kur kjo jetë hiqet, apo merret me çfarëdolloj mënyre, njeriu në të njëjtën kohë nuk mund të jetë subjekt i të drejtave të tjera dhe ato bëhen joreale, por po aq e vërtetë është edhe se jeta nuk do të kishte kuptim nëse nuk do të shoqërohej me të drejtat e tjera. E drejta për jetën është e paderogueshme dhe tani kjo është e tillë edhe në kohë lufte, me përjashtim të rasteve të vdekjes që rrjedhin nga akte të lejueshme të luftës¹⁵.

Konventa nuk jep një përcaktim të qartë për jetën, gjithashtu ajo nuk përcakton kufijtë e fillimit dhe të përfundimit të mbrojtjes që kjo Konventë i bën të drejtës së jetës. Për këtë arsye por dhe për shkak të mungesës së një kompromisi ligjor në nivel evropian dhe shkencor në lidhje me çështjen, tashmë i përket hapësirës së vlerësimit të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Sipas Gjykatës shtetet duhet të shohin Konventën si një *“instrument jetik që duhet të interpretohet në dritën e kushteve të ditëve të sotme”*. (Korff, 2006:10)

Gjykata arriti në këtë përfundim sepse sipas saj çështja për mbrojtjen e jetës është ende një çështje e pazgjidhur brenda shumicës së Shteteve Kontraktuese. Evropa ende nuk ka një kompromis në lidhje me përkufizimin shkencor dhe ligjor të fillimit të jetës për këtë arsye Gjykata e lidh me legjislacionet e brendshme të shteteve të ndryshme vlerësimin për fillimin e mbrojtjes së jetës. Kjo tematikë gjithsesi do të jetë objekt analize e detajuar në Kreun pasardhës.

Por çfarë është e drejta e jetës sipas Konventës? A mbron ajo vetëm individët nga vrasjet e qëllimshme nga ana e shtetit? A mund që shtetet të kenë për detyrë të mbrojnë individët edhe nga kërcënimet që vijnë nga individë të tjerë privatë, rreziqe mjedisore, si

¹⁴Për shembull, *Stran Greek Refineries dhe Stratis Andreadis kundër Greqisë, Tre Traktor Aktiebolag kunder Suedisë*, vendimi i 7 korrikut 1989.

¹⁵ Shih *McCann dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, dt. 5 shtator 1995, paragrafi 147.

dhe nga privimet e paqëllimshme të jetës? A shtrihen këto detyra edhe në lidhje me individë veçanërisht të rrezikuar, të tillë si të burgosurit apo ato me probleme të shëndetit mendor? A mundet neni 2 të mbrojtë cilësi të caktuara të jetës? Apo do të ishte shumë e madhe një ndërhyrje nga ana e gjykatës me vendime politike dhe shpërndarja e burimeve do të ishte më e përshtatshme t'i lihej shtetit për të vendosur? Në fakt, neni 2 i KEDNJ-së ngre gjithashtu disa dilema të vështira morale të cilat do të trajtohen, siç e theksuam në kapitujt në vijim.

Interpretimi i Gjykatës për të drejtën e jetës ka evoluar shumë që nga viti 1995, kur është përcaktuar qëllimi i nenit 2 në çështjen *McCann kundër Mbretërisë së Bashkuar*.

Sipas interpretimit të nenit 2 të KEDNJ-së e drejta e jetës është një e drejtë negative çka do të thotë se çdo person e gëzon atë individualisht pa ndërhyrjen e shtetit por ky i fundit është garant i respektimit të kësaj të drejte që ka detyrimin për krijimin e sistemit ligjor që do të jetë në funksion të mbrojtjes së kësaj të drejte. Pra paragrafi i parë i nenit 2 të KEDNJ-së ku thuhet se *”E drejta e çdo njeriu për jetën mbrohet me ligj. Askujt nuk mund t’i privohet qëllimisht jeta, me përjashtim të rastit, kur zbatohet një vendim me vdekje i dhënë nga një gjykatë, kur krimi ndëshkohet me këtë dënim nga ligji”*, e detyron shtetin jo vetëm të mos provokojë me dashje dhe qëllimisht vdekjen e dikujt por edhe të marrë masat e duhura për mbrojtjen e jetës së individëve që ndodhen nën juridiksionin e tij.

Sipas këtij juridiksioni, fjalia e parë e nenit 2 § 1 e detyron Shtetin jo vetëm të mos provokojë me dashje dhe në mënyrë të parregullt vdekjen e individëve, por edhe të marrë masat e duhura për mbrojtjen e jetës së individëve që ndodhen nën juridiksionin e saj¹⁶. Në këto kushte, autoritetet vendase kanë për “detyrë kryesore të garantojnë të drejtën e jetës duke formuluar një legjislacion penal konkret me qëllim ndalimin e cenimit të individit” por dhe “të marrë paraprakisht masa praktike për të mbrojtur individin, jeta e të cilit rrezikohet nga veprimet kriminale të individëve të tjerë”. Megjithatë, kjo detyrë nuk është absolute. Gjykata vlerëson se duhen marrë njëkohësisht parasysh vështirësitë që lidhen me ushtrimin e funksioneve të forcave policore, zgjedhjet operationale të autoriteteve vendase dhe sjelljen e paparashikuar të individit. Gjithashtu, ashtu siç e ka përcaktuar Gjykata në vendimin *Osman*, “çdo kërcënim i hamendësuar i jetës nuk i detyron autoritetet, në bazë të

¹⁶ Shih vendimin *LCB v. Angli* i 9 qershorit 1998, §36.

Konventës, që të marrin masa për parandalimin e realizimit të tij ” (Akandji-Kombe 2005: 20).

Pra, në kuadër të mbrojtjes së të drejtës së jetës shohim që Konventa ofron dy lloj mbrojtjesh të kësaj të drejte, mbrojtjen në planin substancial dhe mbrojtjen në planin procedural të saj.

3.1.1. Mbrojtja e të drejtës së jetës në planin substancial sipas KEDNJ-së.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka analizuar nenin 2 të Konventës si në planin substancial dhe në atë procedural. Plani substancial përkon me detyrimin e shtetit, veç rastit kur është absolutisht e domosdoshme, për të mos përdorur forcën që mund të çojë në privimin e jetës. GJEDNJ-ja ka marrë në shqyrtim një numër rastesh në të cilat pretendohet se organizimi jo i duhur dhe kontrolli nga ana e policisë ka çuar në vrasje të shumë personave, gjë kjo që bie në kundërshtim me kërkesat e nenit 2 të Konventës.

Në çështjen e shumëpërmendur *McCann kundër Britanisë së Madhe* ku u vranë tre anëtarë të ushtrisë irlandeze nga ana e forcave britanike të sigurimit në Gjilbraltar, Gjykata konstatoi haptazi shkelje të nenit 2 edhe pse ushtarët britanikë kishin vepruar në mirëbesim, duke menduar se vrasjet ishin të nevojshme me qëllimin për të mbrojtur jetën e personave të tjerë. Por, organizimi dhe kontrolli i operacionit në tërësi dhe në veçanti vlerësimi dhe transmetimi i informacionit nga ana e Qeverisë Britanike ishte i papërshtatshëm. Në analizën e vendimit të saj Gjykata shprehet se shteti ka detyrimin të marrë masat e duhura për të mbrojtur jetën e çdo individi brenda juridiksionit të tij duke vendosur norma efektive penale për të penguar kryerjen e veprave kundër personave, të mbështetur nga mekanizmat e zbatimit të ligjit për parandalimin, ndalimin dhe dënimin e shkeljeve të dispozitave të tilla¹⁷. Gjykata shprehet më tej se ky detyrim i shtetit nuk realizohet vetëm duke parashikuar formalisht një kuadër ligjor dhe institucional, por duhet që praktikisht agjentët e tij (pra, të gjitha institucionet) të zbatojnë rast pas rasti këto ligje, duke realizuar efektivisht mbrojtjen e të drejtës së jetës (Gomien, 2005:16). Shteti duhet të rregullojë rendin e tij të brendshëm juridik në mënyrë që të përcaktojë me saktësi veprimin

¹⁷ Shih edhe *Osman v Britania e Madhe*, 28 tetor 1998.

e forcave të rendit dhe të mundësojë kontrollin e tyre të efektshëm (Akandji-Kombe 2005: 21).

Në rrethana të mirë-përcaktuara, autoritetet shtetërore duhet të kenë gjithashtu detyrimin pozitiv për të marrë masa konkrete parandaluese për të mbrojtur një individ, jeta e të cilit rrezikohet nga aktet kriminale të individëve të tjerë privatë, rreziqet mjedisore apo edhe nga ai vetë. Në këto kushte jemi përpara parimit të efektit horizontal në zbatimin e të drejtave të parashikuara nga Konventa.(Zaganjori, 2011:12) Duke u bazuar në këtë parim, nuk janë vetëm shtetet ato që kanë detyrimin për të mos shkelur të drejtën e jetës por edhe shtetasit duhet të mos cenojnë jetën e personave të tjerë. Shteti në këtë rast të fundit, do të jetë përgjegjës indirekt për shkeljen e kësaj të drejte vetëm në rastin kur e dinte apo duhej të dinte ekzistencën e një rreziku që i kanosej personit, dhe ndërkohë nuk ndërmori të gjitha masat që kishte në dispozicion për ta parandaluar apo minimizuar rrezikun¹⁸. Duke patur parasysh vështirësitë për të mbikëqyrur shoqëritë moderne, paparashikueshmërinë e sjelljes njerëzore, dhe zgjedhjet operative që duhet të bëhen në terma të prioriteteve dhe të burimeve, gjykata është e kujdesshme, kur vlerëson një detyrim pozitiv, që të mos e interpretojë nenin 2 në një mënyrë që i imponon shteteve një barrë të pamundur ose joproporcionale. Kështu, jo çdo denoncim për një rrezikim të mundshëm të jetës. Kjo mund të sjellë për autoritetet detyrimin që rrjedh nga Konventa për të ndërmarrë masa operative për të parandaluar që ky rrezik të materializohet.¹⁹ Detyrimi pozitiv i shteteve mbulon edhe rastet që një individ kërkon të “vetëvritet”. Edhe në një situatë të tillë shtetet kanë detyrimin të ndërmarrin të gjitha masat për të shmangur vetëvrasjen e personave të caktuar.

Në çështjen *Abdullah Yilmaz kundër Turqisë* gjykata shprehet: *në pjesën e parë të paragrafit të parë, neni 2 i Konventës vendos në ngarkim të shteteve detyrimin pozitiv për të marrë paraprakisht të gjitha masat e nevojshme për të mbrojtur personat që hyjnë në juridiksionin e saj, ndaj çdo sulmi të të tjerëve, ose sidoqoftë edhe kundër vetes së tyre. Mbi bazën e këtij arsyetimi, në paragrafin 60 të vendimit, duke aplikuar parimin në rastin konkret, GJEDNJ-ja, shprehet që: duhet gjithashtu të verifikohet nëse autoritetet ushtarake dinin apo duhet të dinin se kishte një rrezik real, që Masallah do të vetëvritej, dhe në një*

¹⁸Shih *Tarariyeva v. Russia*, par.88 - 89.

¹⁹ Shih *Maiorano kundër Italisë*, datë 15.12.2009.

rast të tillë, a kanë bërë çdo gjë që mund të bëhej në mënyrë të arsyeshme nga ato, për të parandaluar një rrezik të tillë, duke patur parasysh detyrimin e tyre për të mbrojtur kundër “vetvetes” një person i cili ndodhej nën kontrollin e tyre.²⁰

Po ashtu, në çështjen *Dülek kundër Turqisë*, datë 03/11/2011 pala ankuese pretendoi duke u bazuar në nenin 2 të KEDNJ-së se autoritetet ushtarake nuk kishin marrë masat e nevojshme për të mbrojtur jetën e Bayramit. Përpara fillimit të shërbimit ushtarak Bayram i ishte nënshtruar një ekzaminimi mjekësor duke u diagnostikuar se vuante nga një çrregullim mendor dhe iu përshkrua një trajtim mjekësor. Mjekët pavarësisht diagnozës e deklaruan atë të aftë për të kryer shërbimin ushtarak të cilin e filloi atë më 26 maj 2006. Por, pas fillimit të shërbimit ushtarak më konkretisht nga 30 maj deri në 16 qershor 2006, Bayram u ekzaminua dhe katër herë nga mjekë të ndryshëm të cilët vunë në dukje se ai kishte tendenca vetëvrasëse dhe për këtë arsye u vendos transferimi i tij për në spitalin e Izmirit në 19 qershor 2006, datë në të cilën Bajrami u gjend i vdekur sepse kishte varur veten në tualetin e kazermave.

Në çështjen *Acet dhe të tjerët kundër Turqisë*, datë 18/10/2011 Gjykata theksoi se shteti turk nuk arriti të parandalonte që një ushtar i ri të kryente vetëvrasje gjatë shërbimit ushtarak. Në 7 tetor 2003 Ismail Acet e filloi shërbimin ushtarak dhe pas kryerjes së testeve të zakonshme psikologjike, ai u diagnostikua si anti-social sepse vuante nga një çrregullim ankthi. Autoritetet ushtarake vlerësuan gjatë diagnostikimit se ky "*problem i vogël psikologjik*" nuk përbënte pengesë për kryerjen e shërbimit të detyrueshëm ushtarak. Gjatë vitit 2004 Ismaili filloi të tregonte sjelljet e tij anti-sociale duke u përfshirë në një grindje gjatë një dasme, gjithashtu ai nuk respektonte oraret e ushtrisë, nuk kryente shërbimin e rojës, kishte prerë veten me një brisk dhe kishte thyer derën e zyrës së komandantit. Autoritetet ushtarake vendosën që Ismail duhej të ekzaminohej nga një specialist dhe gjatë vitit 2004 ai u kontrollua në disa raste nga një psikiatër, i cili kishte konfirmuar se ai kishte një personalitet anti-social dhe se ishte përdorues i rregullt i drogës. Më 26 maj 2004, gjatë kohës që po kryente shërbimin e rojës, qëlloi veten në kokë me armën e shërbimit. Familja e Ismailit ka pretenduar, duke u bazuar në nenin 2 të KEDNJ-së, se autoritetet ushtarake kishin dështuar për të mbrojtur jetën e Ismailit. Gjykata në vendimin e saj ritheksoi se të

²⁰ Shih Abdullah YILMAZ *kundër Turqisë* par. 55.

gjitha shtetet të cilat kanë ratifikuar Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut kanë detyrimin për të marrë të gjitha masat e nevojshme parandaluese për të mbrojtur njerëzit brenda juridiksionit të tyre, të cilët ndodhen në rrezik nga veprimet e individëve të tjerë ose nga vetë aktet e tyre. Në fushën e shërbimit ushtarak të detyrueshëm ishte e nevojshme një kuadër ligjor dhe administrativ i unifikuar duke përfshirë rregulla që pasqyrojnë rrezikun potencial për jetën si nga natyra e aktiviteteve dhe misionëve ushtarake ashtu dhe nga elementi njerëzor që hyn në lojë kur një shtet vendos të thërrasë qytetarët e tij për shërbimin ushtarak. Në këto raste, Shteti i ka vendosur këta individë në një situatë të tillë që mund t'i dobësojë ose mund ta përforcojë këtë dobësi të tyre. Në këto rrethana mund të konsiderojmë se neni 2 duket se përcakton vigjilencën si detyrë të veçantë (Akandji-Kombe 2005: 23).

Gjykata vuri në dukje se Turqia ka bërë hapa përpara duke krijuar një sistem masash të vendosura për të mbrojtur integritetin fizik dhe psikik të ushtarëve por në përputhje me standartet e kohëve të sotme ky sistem duhet të ishte konkretizuar duke u pasuar nga masa praktike të mëtijshme dhe se autoritetet nuk duhet të kishin lejuar që Ismaili të vendosej në një detyrë që lejonte mbajtjen e armëve. Gjykata gjeti në këtë çështje shkelje të nenit 2 të Konventës dhe theksoi se të gjitha vdekjet duhet të hetohen në mënyrën e duhur. Ligji duhet të ndalojë dhe të dënojë vrasjet dhe ai duhet të zbatohet në mënyrë efikase.²¹ Gjykata vlerësoi se çdo vdekje e shkaktuar nga një agjent i shtetit duke përdorur forcë tej asaj që është absolutisht e domosdoshme ose për një arsye tjetër nga ato të parashikuara në paragrafin 2 do të përbëjë shkelje të Nenit 2 të KEDNJ-së²². (Korff, 2006:15)

Duke patur parasysh natyrën serioze të çdo pretendimi se është pikërisht shteti ai që duhet të mbajë përgjegjësinë për vdekjen e një individi i cili vuan një dënim, GJEDNJ-ja ka vendosur standardin e provës si një standard “përtej një dyshimi të arsyeshëm”. Në trajtimin e këtij standardi gjykata ka vendosur çdo provë mund të jetë rrjedhojë e implikimeve të njëpasnjëshme, të qarta në faktet e padiskutueshme, dhe nga ku ngjarjet janë të dukshme në masën më të madhe duke marrë në konsideratë edhe njohuritë e

²¹ Shih *Tarariyeva v. Russia*, 14 dhjetor 2006, par. 102 - 103.

²² Shih *McCann v Mbretërisë së Bashkuar*, par. 148 – 149.

autoriteteve, si në rastin e personave të dënuar që kontrollohen nga këto autoritete. Barra e provës mund të konsiderohet se i takon autoriteteve që të provojnë dhe japin një shpjegim të kënaqshëm dhe, mbi të gjitha, bindës. Në kushtet e standartit të provës, ku është dyshuar që humbja e jetës është shkaktuar nga agjentët e Shtetit, Gjykata e Strasburgut ka mbajtur qëndrimin se kjo duhet të provohet përtej çdo dyshimi të arsyeshëm .²³ Në çështjen *Mojsieje kundër Polonisë*, datë. 24.03.2009, Gjykata është shprehur se kur një individ vdes në paraburgim dhe shteti nuk arrin të japë një shpjegim të kënaqshëm atëherë Gjykata mund të arrijë në përfundimin se vdekja ka ndodhur si rezultat i veprimeve ose mosveprimeve të autoriteteve shtetërore. Barra e provës për të identifikuar shkakun e vdekjes në raste të tilla bie mbi shtetin, pasi informacioni i nevojshëm lidhur me rrethanat e vdekjes mund të jetë në dispozicion vetëm të autoriteteve shtetërore, qëndrim ky i mbajtur dhe në një numër çështjesh të tjera.²⁴

3.1.2. Aspektet e mbrojtjes procedurale që ofron Konventa për të drejtën e jetës

Aspektet procedurale të nenit 2 të KEDNJ-së kërkojnë që shtetet të kryejnë një hetim efektiv të vdekjeve që kanë ndodhur në kundërshtim me ligjin vendas. Edhe pse një detyrim i tillë nuk shfaqet në pamje të parë të nenit 2 të Konventës, pa atë, ndalimi për marrjen e paligjshme të jetës do të bëhej pothuajse i pakuptimtë. Për këtë arsye kjo detyrë procedurale është ndërtuar nga ana e Gjykatës së Strasburgut për të siguruar që të drejtat substanciale të parashikuara në nenin 2 të mbrohen në mënyrë efektive në praktikë (Gomien, 2005:18).

Hetimi duhet të kryhet nga një organ i pavarur publik; duhet të jetë i plotë dhe rigoroz; duhet të jetë në gjendje të përcaktojë përgjegjësinë për vdekjen. Në qoftë se agjentët e Shtetit janë përgjegjës, hetimi duhet të jetë në gjendje të përcaktojë nëse vrasja ishte ose jo justifikuar sipas nenit 2 paragrafi 2 të KEDNJ-së. Nëse hetimi ka filluar në bazë të një ankese penale, parashtruesi i ankesës duhet t'i krijohet mundësia për të marrë

²³ Shih *Yasa kundër Turqi* (2 shtator 1998), par.34, 89-97, shih gjithashtu rastin e fundit *Kaya kundër Turqisë* (24 tetor 2006), par.29 – 34.

²⁴ Shih *Salman kundër Turqisë*, 27 qershor 2000, par.99; *Imakayeva kundër Rusisë*, 9 nëntor 2006, par.114 - 115, 139-143, 146-151; *Tais kundër Francës*, 1 qershor 2006, par.85, 87, 96-104, *Choban*.

pjesë në procedurë, dhe duhet të mundësojë përfshirjen efektive të një të afërmi tjetër. Çdo hetim, gjithashtu, duhet të jetë në gjendje të marrë parasysh çdo dështim që mund të ketë shkaktuar vdekjen. Detyrimi për të siguruar që jeta e çdokujt të mbrohet me ligj përfshin një aspekt procedural përmes të cilit rrethanat e privimit të jetës i nënshtrohen një shqyrtimi publik dhe të pavarur.²⁵

Detyrimi për të hetuar vdekjet lind pavarësisht se si autoritetet marrin dijeni për vdekjen, nëse janë të përfshirë agjentët e shtetit, ose rrethanat e lidhura me vdekjen. Gjithashtu ky detyrim procedural nuk është i kufizuar vetëm në ato rrethana kur një individ ku ka humbur jetën si pasojë e një akti dhune. Në çështjen *McShane kundër Mbretërisë së Bashkuar* datë 28 gusht 2002, neni 2 i KEDNJ-së u zbatua edhe në lidhje me ngjarjen e pakujdesshme të një automjeti të blinduar në një turmë protestuesish. Ai gjithashtu mund të shtrihet në hetimin e shkakut të vdekjes së një individi nën kujdesin dhe përgjegjësinë e mjekëve.

Që të zhvillohet hetimi nuk është vendimtare që të jetë depozituar një ankesë formale. Thjesht dijenia nga ana e autoriteteve mbi një vrasje lind detyrimin për të kryer një hetim efektiv.²⁶ Dështimi për të hetuar siç duhet një vdekje çon në shkelje të nenit 2 të KEDNJ-së dhe një shkeljeje të tillë do t'i shtohet çdo shkelje e konstatuar në lidhje me vetë vrasjen. Thjesht pagimi i një kompensimi për mungesë të një hetimi nuk është i mjaftueshëm për të plotësuar nenin 2.²⁷ Karakteristikat e një hetimi që të plotësojë standartet për t'u konsideruar si provë në procesin gjyqësor dhe të besueshëm janë disa. Ne do t'i trajtojmë ato në vijim.

1. Hetimi duhet të kryhet nga një organ i pavarur publik.
2. Kriteri i dytë ka të bëjë me detyrimin e shtetit nga pikëpamja procedurale. Në fakt, këtu bëhet dallimi ndërmjet detyrimit të rezultatit dhe detyrimit të procedurës. Në qoftë se agjentët e Shtetit janë përgjegjës, hetimi duhet të jetë në gjendje të përcaktojë nëse vrasja ishte ose jo justifikuar sipas nenit 2 paragrafi 2.

²⁵ McCann kundër Mbretërisë së Bashkuar; Yasa kundër Turqi; Gulec kundër Turqi; Ergi kundër Turqisë, Salih Mehmet Ajhan dhe Ajhan Cennet kundër Turqisë, 27 qershor 2006, Kaya kundër Turqisë, 24 tetor 2006.

²⁶ Ergi kundër Turqisë, Luluyev kundër Rusisë Luluyev, 9 nëntor 2006, par.90 -101.

²⁷ Jordan kundër Mbretërisë së Bashkuar.

3. Kriteri i tretë ka të bëjë me shpejtësinë e autoriteteve në hetimin e përdorimit të forcës vdekjeprurëse. Ai duhet të jetë i plotë dhe rigoroz; duhet të jetë në gjendje të përcaktojë përgjegjësinë për vdekjen.
4. Nëse hetimi ka filluar në bazë të një ankesë penale, parashtruesi i ankesës duhet t'i krijohet mundësia për të marrë pjesë në procedurë, dhe duhet të mundësojë përfshirjen efektive të një të afërmi tjetër.

Hetimi duhet të kryhet nga një organ i pavarur publik.

Në lidhje me objektin e hetimit, neni 2 i Konventës kërkon që agjentët e Shtetit duhet të jenë përgjegjës për përdorimin e forcës vdekjeprurëse që ushtrojnë. Prandaj veprimet e tyre, duhet t'i nënshtrohen një forme shqyrtimi të pavarur dhe publik, të aftë për të përcaktuar nëse forca e përdorur ishte apo nuk ishte e justifikuar në një grup të veçantë të rrethanave. Në çështjen *Jordani kundër Mbretërisë së Bashkuar* Gjykata u shpreh se, që hetimi të jetë në përputhje me nenin 2 të KEDNJ-së, duhet të plotësojë masat mbrojtëse proceduriale që vijnë:

“Ai duhet të kryhet nga një organ publik i pavarur. Veçanërisht e rëndësishme është pavarësia e personave përgjegjës për hetimin. Në përgjithësi, kjo nënkupton se këto duhet të jenë të pavarur nga ata që janë të implikuar në ngjarje. Kjo kërkon jo vetëm mungesën e lidhjes hierarkike apo institucionale, por edhe një pavarësi praktike.”

Në çështjen *Ergi kundër Turqisë*, për shembull, prokurori i çështjes nuk u tregua i pavaruar në procesin e hetimit dhe të grumbullimit të provave sepse ai e mbështeti hetimin e tij kryesisht në informacionin e dhënë nga xhandarët të cilët ishin të implikuar në incidentin në fjalë. Nevoja për pavarësi është shumë e rëndësishme në rastet ku janë të përfshirë agjentët e shtetit. (Korff, 2006:20) Në një numër rastesh që përfshinin Turqinë, Gjykata vuri në dukje se sistemi hetimor i aplikuar në lidhje me vrasjet e dyshuara nga agjentët e

shtetit, ndryshonte nga hetimi lidhur me vdekjet e tjera,²⁸ dhe në veçanti vendimet për procedim nuk janë marrë nga prokurori, por nga këshillat administrative.²⁹ Në mënyrë të ngjashme në çështjen *Jordani kundër Mbretërisë së Bashkuar* hetimi në lidhje me sjelljen e punonjësve të policisë në Irlandën e Veriut, u realizua nga policë të cilët ishin pjesë e të njëjtës forcë dhe pikërisht për këtë arsye u konsiderua si një hetim jo i pavarur. Sa i takon shkallës së shqyrtimit publik të hetimit, kjo do të ndryshojë nga rasti në rast, por në të gjitha rastet duhet të jetë i mjaftueshëm për të siguruar përgjegjësinë si në praktikë ashtu edhe në teori, dhe gjithashtu e rëndësishme në ruajtjen e besimit të publikut (Gomien: 2005:19).

Hetimi duhet të jetë i plotë dhe rigoroz. Neni 2 i KEDNJ-së është shkelur kur autoritetet kanë dështuar në konstatimin e dëshmitarëve të mundshëm okularë, pyetjen e të dyshuarve në një fazë mjaftueshmërisht të shpejtë të hetimit, kërkimin e provave konfirmuese, marrjen në konsideratë të provave të dukshme, kryerjen në mënyrën e duhur të autopsisë, testet për gjurmë baruti³⁰. Në çështjen *Beksultanova kundër Rusisë*, datë 27.9.2011, hetimet në lidhje me ankesën për zhdukje filluan pas më shumë se tre muaj pasi hetuesit kishin marrë në dorëzim ankesën e aplikantit. Proçesi i marrjes në pyetje të ankuesit u realizua por pas tre muajsh. Për këto vonesa qeveria Ruse nuk mundi ti jepte dot asnjë shpjegim Gjykatës. Ajo u shpreh se vonesat e pashpjegueshme nuk janë në përputhje me detyrimin e autoriteteve për të ushtruar kujdesin shembullor dhe shpejtësinë që kanë të bëjnë me një krim të tillë të rëndë³¹. Nga hetimi rezultonte se disa hapa të rëndësishëm hetimor nuk janë marrë fare. Hetuesit nuk kanë bërë ndonjë përpjekje për të intervistuar një oficer, megjithëse kërkuesi e ka përmendur shprehimisht këtë person, ndërsa është marrë në pyetje nga hetuesit. Autoritetet hetuese nuk ndërmorën asnjë hap për të identifikuar dhe intervistuar njeriun që kishte thënë kërkuesi për arrestimin e dyshuar të djalit të saj, madje as nuk u përpoqën të identifikonin apo të intervistonin dëshmitarët e mundur okularë për rrëmbimin. Ajo që impresionoi më shumë Gjykatën, është fakti se hetuesit nuk morën hapa për të verifikuar informatat të cilat u gjendën në certifikatën e lëshuar nga kreu i Zyrës së

²⁸ *Kiliç kundër Turqisë*, 28 mars 2000

²⁹ *Gulec kundër Turqisë*, 27 korrik 1998

³⁰ *Shih Bazorkina v Russia*, 27 korrik 2006, par.120 - 125,

³¹ *Shih Paul dhe Audrey Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 2002.

Qarkut të Punëve të Brendëshme (ROVD). Është e qartë se që këto masa të prodhonin ndonjë rezultat të rëndësishëm, duhet të ishin marrë menjëherë pas raportimit të krimit tek autoritetet.

Hetimi duhet të jetë në gjendje të përcaktojë përgjegjësinë për vdekjen.

Në çështjen *Oneryildiz kundër Turqisë*³² trajtohet një aksident tragjik në një qendër riciklimi, i cili ishte vënë në funksion nga autoritetet lokale në rrethinat e Stambollit. Autoritetet vendase nuk kishin zbatuar ligjet rregulluese për operimin e një qendre të tillë dhe në të mungonte sistemi i ventilimit. Pikërisht mungesa e ventilimit shkaktoi grumbullimin e metanit dhe gazrave të tjera nga të cilat u shkaktua një shpërthim ku pësoi shkarje toka afër saj dhe si rezultat mbuloi disa shtëpi të ndërtuara aty afër. Gjykata vendosi se autoritetet turke duhet mbanin përgjegjësi për humbjet e personave (Akandji-Kombe 2005: 23). Ky vlerësim i Gjykatës erdhi dhe si pasojë e një raporti të realizuar nga një grup ekspertësh disa vite para aksidentit nga ku ishte identifikuar një rrezik i tillë por asnjë masë nuk ishte marrë. Edhe pse shtëpitë e shkatërruara ishin ndërtuar në mënyrë të jashtëligjshme, autoritetet qeveritare ishin tolerante ndaj ndërtimeve të tilla dhe banorët ishin pajisur me elektricitet dhe me ujë të pijshëm dhe gjithashtu paguanin taksa ndaj qeverisë lokale. Për më tepër do të ishte shumë më e thjeshtë shmangia e tragjedisë nëpërmjet instalimit të një sistemi ventilimi (Gomien, 2005:19).

Sa i përket faktit, në qoftë se agjentët e Shtetit janë apo jo përgjegjës, hetimi duhet të jetë në gjendje të përcaktojë nëse vrasja ishte ose jo e justifikuar sipas nenit 2 paragrafi 2 dhe duhet të jetë në gjendje të identifikojë dhe të ndëshkojë ata që janë përgjegjës. (Korff, 2006:23).

Nëse hetimi ka filluar në bazë të një ankimi penal, parashtruesit të ankesës duhet t'i jepet mundësi për të marrë pjesë në procedim dhe duhet të mundësojë përfshirjen efektive të një të afërmi tjetër. Kjo është me të vërtetë një kërkesë vendimtare, moszbatimi i së cilës do të përbëjë shkelje të së drejtës për jetë. (Akandji-Kombe 2005: 32).

³² Shih *Oneryildiz kundër Turqisë*, date 30 nëntor 2005.

Për shembull ,në çështjen *Bazorkina kundër Russisë*, datë 27 korrik 2006, u konstatua shkelje e nenit 2 të KEDNJ-së, sepse familja nuk u lejua të marrë pjesë në tërë hetimin. Në çështjen *Paul dhe Audrey Edëards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, datë 14 mars 2002, u konstatua shkelje e nenit 2 të KEDNJ-së, për shkak të dështimit për të thirrur zyrtarët e burgut që ishin në detyrë natën që Christopher Edëards u vra nga shoku i qelisë, dhe sepse familja nuk u lejua të marrë pjesë në tërë hetimin.

Çdo hetim duhet të jetë në gjendje të marrë parasysh edhe që mund të ketë dështime që kanë shkaktuar vdekjen, për shembull, planifikimi dhe organizimi i një operacioni shpëtimi, (Constantinou & Andronicou kundër Qipro, datë 9 tetor 1997) dhe planifikimi i operacioneve anti-terroriste të policisë, (*McCann kundër Mbretërinë e Bashkuar*).

Së fundi, që një hetim të jetë efektiv ai duhet të fillohet menjëherë. Në çështjen *Finucane kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Gjykata arriti në konkluzionin se hetimet që zhvillohen pas një kohe të konsiderueshme nuk janë efektive nëse nuk mund të sigurojnë fakte lidhur me incidentin, duke përfshirë dëshmi okulare dhe prova mjeko-ligjore. Një përgjigje e shpejtë do të jetë vendimtare edhe në ruajtjen e besimit të publikut dhe parandalimin e çdo shfaqjeje të marrëveshjeve të fshehta ose tolerancës së akteve të paligjshme.

Në të gjitha kërkesat ku pretendohet shkelja e të drejtës së jetës nga ankuesit gjykata e vë theksin te efikasiteti i hetimeve të kryera. Në disa raste gjykata ka theksuar se në rrethana të caktuara dëmshpërblimet civile mund të japin mbrojtjen e duhur, kur nëpërmjet dëmshpërblimit arrihet një marrëveshje mes palëve. Këtë kriter (efikasitetin në procedurë) ka shqyrtuar Gjykata edhe në vendimet e fundit të saj si: *Elena Apostol and Others kundër Rumanisë* e dt. 23 shkurt 2016 dhe *Oztunc kundër Turqisë* e dt. 9 shkurt 2016 ku ka konstatuar shkelje të nenit 2 KEDNJ pasi sipas saj shteti ka dështuar në mbrojtjen e jetës nga pikëpamja e efikasitetit në hetime.

3.2. Kufizimet e të drejtës së jetës sipas KEDNJ-së.

E drejta e jetës është një vlerë universale, gëzimi i së cilës është individual dhe i pacënueshëm, por kjo e drejtë nuk është absolute. Neni 2 paragrafi 1 i të drejtës së jetës thekson se *”e drejta e çdo njeriu për jetën mbrohet me ligj”* çka do të thotë se shtetet duhet të vënë në zbatim një legjislacion i cili e konsideron krim vdekjen e shkaktuar qëllimisht nga individë privatë apo agentë të shtetit të cilët tejkalojnë kompetencat që vetë ligji iu jep. Në vazhdim të këtij neni thuhet se *“Askujt nuk mund t’i privohet qëllimisht jeta, me përjashtim të rastit, kur zbatohet një vendim me vdekje i dhënë nga një gjykatë, kur krimi ndëshkohet me këtë dënim nga ligji.”* çka do të thotë që ligji e legjitimon heqjen e jetës së një individi vetëm kur ndaj tij ka një vendim të formës së prerë të dhënë nga gjykata për dënimin e tij me vdekje. Objekt i studimit në mënyrë të detajuar do të jetë pika 2 e nenit 2 të KEDNJ-së nga ku përcaktohen përjashtimet e lejuara për të drejtën e jetës (Korff, 2006:16).

Paragrafi i dytë i Nenit 2 i referohet “privimit të jetës”. Për disa akte të caktuara të cilat rezultojnë në vdekjen e personave ai thotë se *“nuk do të konsiderohet se bie në kundërshtim me këtë nen”* - pra, nuk do të konsiderohen si shkelje të së drejtës për jetën duke pasur parasysh se ato përmbushin disa kritere.

Së pari: heqja e së drejtës së jetës të bëhet në kushtet e ekzistencës së njëres prej tre situatave të parashikuara në mënyrë shteruese në nenin 2;

”a. në mbrojtje të çdo personi nga dhuna e paligjshme;

b. për të kryer një arrestim të ligjshëm ose për të penguar arratisjen e një personi të cilit i është hequr liria ligjërisht;

c. për të kundërshtuar, në përputhje me ligjin, një trazirë ose kryengritje”

Së dyti: përdorimi i forcës në një situatë të tillë të jetë absolutisht i domosdoshëm, që nënkupton se nuk mund të shmanget në ndonjë mënyrë tjetër më pak kufizuese dhe të jetë në proporcion me gjendjen që e ka diktuar.

Së treti: shkaktimi i vdekjes në kushtet e ekzistencës të situatave të tilla, të mos jetë i qëllimshëm.

Këto tre kushte janë komplementare dhe mungesa qoftë edhe e njërit prej tyre, e bën të paaplikueshëm nenin 2 paragrafi 2 duke i konsideruar të paligjshme ndërhyrjet që bëjnë autoritetet në të drejtën e jetës. Përdorimi i forcës me pasojë heqjen e jetës duhet të ketë qenë “*absolutisht e domosdoshme*” si kriter shumë i rëndësishëm dhe kjo e fundit i nënshtrohet një testi objektiv dhe jo perceptimit që mund të kenë pasur personat që e kanë përdorur atë (Korff, 2006:16).

Vlerësimi në bazë të një testi objektiv ka një rëndësi të madhe duke qenë se, jo në pak raste autoritetet shtetërore bëjnë ndërhyrje të pa diktuar nga një nevojë absolutisht e domosdoshme dhe njëkohësisht justifikohen me nenin 2 paragrafi 2 të KEDNJ. Nëpërmjet parashikimit në nenin 2 paragrafi 2, Konventa synon të përcaktojë dhe të kontrollojë veprimin ose masat që autoritet publike janë të lejuara të marrin në shkelje të të drejtave të njeriut, për të mirën e shoqërisë në përgjithësi, në funksion të kufizimit të ushtrimit arbitrar të pushtetit shtetëror nga shteti, i cili të paktën teorikisht ka monopolin e ushtrimit të ligjshëm të dhunës.

Përgjashtimet për të drejtën e jetës janë të përcaktuara në Nenin 2, paragrafi 2. Natyra themelore e të drejtës për jetën do të thotë se këto përgjashtime janë shteruese dhe duhet të interpretohen ngushtë. Për më tepër, neni 2 paragrafi 2 nuk synon të jetë një listë e situatave në të cilat vrasjet me dashje janë të justifikuara, por Konventa vendos kufizime për përdorimin e forcës e cila mund të rezultojë në vdekje. Përsëri duke reflektuar rëndësinë absolute të së drejtës për jetën, përdorimi i forcës duhet të jetë jo më shumë se “absolutisht i domosdoshëm” për të arritur një nga qëllimet e përcaktuara në nën-paragrafët a), b) ose c) të nenit 2/2 të KEDNJ-së. Nga një analizë e detajuar që do t’i bëjmë nenit 2/2 të KEDNJ-së, do të evidentojmë rastet dhe situatat e “përgjashtimeve të ligjshme” për të drejtën e jetës të pasqyruar edhe me praktikën e pasur gjyqësore (Gomien: 2005:19).

Duke interpretuar paragrafin e dytë të nenit 2 të Konventës do të arrijmë në konkluzionin se, pavarësisht përgjashtimeve që ky nen ofron, vdekja e ardhur si pasojë e dhunës duhet të justifikojë se kjo dhunë ka ardhur si pasojë e padëshiruar dhe nuk ishte e qëllimshme. Kriteri i vendosur për testin e situatave të tilla është “absolutisht e

domosdoshme”, çka tregon që përdorimi i dhunës që ka shkaktuar heqjen e jetës ishte i pashmangshëm Ky paragraf nuk duhet në asnjë mënyrë të interpretohet sikur justifikon vrasjen e një personi edhe nëse kjo vrasje paraqitet si domosdoshmëri e situatave të paraqitura në pikën 2 të nenit 2 të KEDNJ-së si më poshtë vijon.

a) Kur privimi i jetës është bërë absolutisht i domosdoshëm “*në mbrojtje të çdo personi nga dhuna e paligjshme*”

Përdorimi i fjalës “*absolutisht*” siguron një test më të rreptë sesa ai që aplikohet për të vendosur nëse ndërhyrja e shtetit është “*e nevojshme në një shoqëri demokratike*.” Përdorimi i forcës duhet të jetë rreptësisht në proporcion me arritjen e qëllimeve të përcaktuara në nenin 2/2a. Shtetit do t’i kërkohej të paraqesë prova të mjaftueshme për sulmin e armatosur të agjentëve të tij në skenën e një incidenti, por vetë-mbrojtja është e mjaftueshme për të plotësuar nenin 2 paragrafi 2 të KEDNJ-së (Korff, 2006:16).

Në rastin e përmendur *McCann kundër Mbretërisë së Bashkuar*, ku 3 terroristë kishin planifikuar të sulmonin me bombë në Gjibraltari, u qëlluan dhe u vranë nga forcat policore britanike, mbrojtja u bazua në nenin 2/2 të KEDNJ-së. Gjykata nuk e mori në konsideratë sepse nuk e gjeti brenda kuptimit të nevojës absolute pohimin e bërë nga Mbretëria e Bashkuar se forcat policore britanike ishin duke mbrojtur publikun në përgjithësi, sepse sipas arsyetimit të gjykatës terroristët e dyshuar mund të ishin parandaluar që në fillim të hynin në Gjibraltari, edhe nëse autoritetet mund të kishin prova të mjaftueshme për ndekjen e tyre në atë fazë se ata do të shkaktonin vdekjen e disa personave të pafajshëm, ndaj policia duhet të mbronte jetën e njëjërëve nga ky sulm i paligjshëm.

Gjykata konstatoi se planifikimi i operacionit kundër terrorizmit nuk kishte marrë parasysh në mënyrë të mjaftueshme rëndësinë themelore të së drejtës për jetën. Një rast tjetër shkeljeje është dhe shkaktimi i vdekjes gjatë kohës kur personi është nën hetim nga funksionarët shtetërorë ose më keq akoma kur vdekja e tij ka ardhur si rezultat i dhunës së pajustificuar të organeve shtetërore³³. (Akandji-Kombe 2005: 31). Situata e fundit krijon një gjendje destabiliteti dhe pasigurie sociale e cila sjell në vëmendje përgjegjësinë direkte të shtetit pavarësisht se akti është kryer nga një funksionar i tij. Në rastin *Kaya kundër*

³³ Shih vendimin *Angelova kundër Bullgarisë* (13.06.2002)

Turqisë, GJEDNJ-ja u shpreh se shteti ka barrën e provës dhe duhet të realizojë një hetim real, efektiv dhe të pavarur në rastet kur shkaktimi i vdekjes ka ardhur nga funksionarët shtetërorë. (Korff, 2006:20).

Në lidhje me pavarësinë e organeve të cilat do të merren me hetimin e këtyre ngjarjeve GJEDNJ-ja e përcakton nocionin e pavarësisë në dy dimensione, sipas saj organet hetimore duhet të jenë të pavarur hierarkisht, çka do të thotë të mos influencohet nga eprorët e tyre gjatë procesit të hetimit, dhe hetimi të jetë real, çka nënkupton që duhet të jetë i vërtetë dhe i plotë. Nëse hetimi plotëson këto standarde kjo siguron dhe informimin e të afërmeve të viktimës dhe të shoqërisë, për zhvillimin e hetimeve si dhe gjetjen e fajtorëve. Efikasiteti i hetimit varet nga pavarësia e vetë shtetit dhe nga iniciativa e tij për të kryer vetë hetimet, pa ia ngarkuar këtë përgjegjësi të afërmeve të viktimës, madje në rastet kur lejohet duhet dhe të përfshihen këta të fundit në procesin e hetimit.

- b) Kufizimi i jetës si rezultat i përdorimit të forcës absolutisht të domosdoshme *“për të kryer një arrestim të ligjshëm ose për të penguar arratisjen e një personi të cilit i është hequr liria ligjërisht”*

Në Nenin 2/2 pika b, termi *“i ligjshëm”* nuk është përcaktuar nga Gjykata. Gjykata ka theksuar nevojën për kryerjen e paralajmërimeve të duhura para përdorimit të forcës potencialisht vdekjeprurëse³⁴. Të jepen të gjitha mundësitë për t’u dorëzuar dhe përdorimi i forcës duhet të jetë opsioni i fundit.

Më poshtë do të bëjmë një klasifikim të rasteve të bërë ky nga GJEDNJ-ja, në bazë të precedentëve dhe rasteve të gjykuara prej saj.

- Kur një individ merret nën arrest nga ana e policisë në gjendje të mirë shëndetësore dhe gjë të kësaj periudhe konstatohet se është dëmtuar shëndeti i tij dëmtim i cili ka sjellë dhe humbjen e jetës atëherë përgjegjësia për të dhënë shpjegime bindëse dhe të bazuara në prova reale i takon shtetit.
- Nuk është e nevojshme përdorimi i armëve të zjarrit për të kryer një arrestim të një personi të dyshuar për vepra me karakter jo të dhunshëm dhe të cilat dihet që nuk përbejnë rrezik, edhe nëse mospërdorimi i këtyre armëve do të sillte mungesën e arrestimit të personit në fjalë.

³⁴ Shih vendimin *Ogura kundër Turqisë*.

Gjykata vlerësoi në rastin *Nachova kundër Bullgari*, datë 6 korrik 2005 se përdorimi i armëve të zjarrit për të arrestuar një shkelës jo të dhunshëm i cili nuk përbënte kërcënim për askënd, nuk ishte absolutisht i domosdoshëm siç pretendonte mbrojtja. Sipas Gjykatës, përdorimi i armëve të zjarrit është i paligjshëm edhe nëse kjo do të çonte në humbjen e mundësisë për të kryer një arrestim. Në rastin *Kelly kundër Mbretërisë së Bashkuar*, datë 4 gusht 2001, u konstatua se të shtënat vdekjeprurëse nga ushtarët ndaj terroristëve të dyshuar të cilët kaluan në një pikë kontrolli pa ndaluar, ishin absolutisht të domosdoshme në mënyrë që ti jepnin efekt arrestimit të ligjshëm.

- Shteti konsiderohet përgjegjës për dhënien e dokumentacionit të nevojshëm në lidhje me hetimin, në rastet kur kemi një kërkesë e cila përmban një ankim se nuk është zhvilluar një hetim efektiv.

Përdorimi i forcës duhet të jetë rreptësisht në proporcion me arritjen e qëllimeve të përcaktuara në nenin 2/2 të KEDNJ-së.

Gjykata u shpreh në rastin *McCann kundër Mbretërisë së Bashkuar* se kur përdoret forcë e qëllimshme vdekjeprurëse, atëherë çështja duhet t'i nënshtrohet një shqyrtimi të kujdesshëm jo vetëm për veprimet e agjentëve të shtetit, por edhe rrethanat e çështjes të tilla si: planifikimi dhe kontrolli i veprimeve në shqyrtim. Kur planifikohet një operacion sigurie që mund të rezultojë në përdorimin e forcës vdekjeprurëse, duhet të merren në konsideratë sa më poshtë:

- a) E drejta për jetën e popullsisë së përgjithshme si edhe të të dyshuarve,
- b) Masat paraprake për të shmangur ose minimizuar vdekjen aksidentale të civilëve dhe përdorimi i armëve të përshtatshme
- c) Trajnimi i personave të përfshirë
- d) Llogaritjet e rrezikut të bëra duke pasur parasysh p.sh. nëse të dyshuarit janë të armatosur apo jo.

Megjithatë një besim i sigurtë, por i gabuar, mund të jetë i mjaftueshëm për të qenë në përputhje me nenin 2 të KEDNJ-së. Në *McCann*, Gjykata u shpreh se autoritetet nuk kishin treguar kujdesin e duhur në organizimin dhe kontrollin e operacioneve të arrestimit. Gjykata theksoi se autoritetet kishin alternativa të tjera që do të thotë se humbja e jetës mund të ishte shmangur. Në mënyrë të ngjashme në çështjen *Ergi kundër Turqisë*, Gjykata

u shpreh se popullsia civile në një fshat ishte ekspozuar në një shkëmbim zjarri mes forcave të sigurisë dhe PKK, dhe se nuk ishin marrë masa të mjaftueshme për të mbrojtur jetën e tyre.

- a) Kufizimi i jetës si rezultat i përdorimit të forcës absolutisht të domosdoshme “*për të kundërshtuar, në përputhje me ligjin, një trazirë ose kryengritje*”

Konventa nuk na jep një përkufizim të qartë në lidhje me konceptin e kryengritjes apo të trazirave dhe ia lë në gjykim praktikës dhe precedentit duke u kushtëzuar dhe nga rrethana dytësore. Pavarësisht se asnjë nga termat e mësipërm nuk është përcaktuar ende kur jemi para situatës që qindra ose mijëra njerëz kanë hedhur predha ndaj forcave të sigurisë Neni 2/2 c të KEDNJ-së ka gjetur zbatim (Gomien: 2005:19).

Gjykata konstatoi se qëllimi i nenit 2 të KEDNJ-së mbulon jo vetëm rastet e heqjes të qëllimshme të jetës, por edhe situata ku përdorimi i forcës është i lejuar dhe sjell si rezultat humbjen e jetës në mënyrë të paqëllimshme. Me këtë arsytim Gjykata në rastin *Steëart kundër Britanisë*, ku ushtria britanike vrau aksidentalisht një djalë 13 vjeçar, kur një breshëri plumbash gome u zbraz në turmë gjatë trazirave në Irlandën Veriore dhe një gur, hedhur nga turma, kishte goditur një prej oficerëve dhe kishte shkaktuar shkrepjen, gjeti shkelje të nenit 2 të Konventës. Në vendimin e tij, Komisioni pati parasysh faktin se ushtarët ishin përballë një sulmi nga një turmë armiqësore dhe e dhunshme dhe u ndjenë të kërcënuar, dhe se përdorimi i plumbave të gomës mund të konsiderohet i përshtatshëm në këto rrethana, dhe se ushtarët të trajnuar dhe me përvojë në përdorimin e tyre (Korff, 2006:35).

Gjykata theksoi në rastin *Güleç kundër Turqisë* se megjithëse një situatë mund të jetë brenda fushës së nenit 2/ 2 c të KEDNJ-së, duhet të vendoset një balancë e përshtatshme midis qëllimit dhe mjeteve të përdorura për të arritur atë ndaj, duke u nisur nga fakti se në rastin në fjalë u përdorën mitralozë nga forcat e sigurisë turke për të shtypur një demonstratë të dhunshme. Mungesa e pajisjeve të përshtatshme për të kontrolluar trazirat, duke i detyruar forcat e sigurisë të përdornin armë kaq të fuqishme ishte e papranueshme, për më tepër që incidenti u zhvillua në një zonë ku ishte shpallur gjendja e jashtëzakonshme. Përdorimi i forcës që shkaktoi vdekjen e djalit 15 vjeçar nuk ishte absolutisht e domosdoshme, duke përbërë kështu shkelje të nenit 2 të KEDNJ-së.

3.3. Detyrimet pozitive të shtetit për të mbrojtur jetën sipas KEDNJ-së.

Për të mbrojtur jetën e individëve brenda juridiksionit, duhet të ndërmerren masa të përshtatshme. Kjo mund të përfshijë ofrimin e informacionit lidhur me një rrezik të mundshëm për jetën të shkaktuar nga veprimet e shtetit, dhe ky detyrim mund të shtrihet për të dekurajuar individët në shkaktimin e rreziqeve serioze në shëndetin e tyre (Akandji-Kombe 2005: 22). Studiuesit e kanë shtrirë kufirin e mbrojtjes edhe më tej duke përfshirë dhe i ngarkuar shtetit edhe më shumë përgjegjësi dhe në fusha si: mbrojtja nga rreziqet mjedisore, ose mbrojtja nga mjekimi i pakujdesshëm. Një masë tjetër e rëndësishme është ruajtja e të dhënave të paraburgimit³⁵, duke vënë në dukje çështje të tilla si: datën, kohën dhe vendin e ndalimit, emri i të paraburgosurit, si dhe arsyet për paraburgim dhe emrin e personit që e ka në përgjegjësinë e tij³⁶.

Në mënyrë të thjeshtuar mund të thuhet se jurisprudenca e Gjykatës për mbrojtjen e jetës dhe të integritetit fizik të njerëzve ka koherencë dhe ekuilibër. Detyrimet e Shtetit mund të formulohen si vijon: të parandalojë shkeljet (për aq sa është e mundur); të kërkojë fajtorët (në rastin kur parandalimi ka dështuar); të ndëshkojë (në mënyrën e duhur) fajtorët; të zbatojë dënimin me humanizem (duke respektuar dinjitetin e personave në fjalë) (Akandji-Kombe 2005: 25). Edhe në vendimet e saj më të fundit GJEDNJ-ja mban të njëjtin qëndrim ndaj detyrimeve pozitive të Shtetit për të mbrojtur jetën e individëve që ndodhen nën juridiksionin e tyre. Përmendim këtu çështjet: *Isenc kundër Francës* e dt.4 shkurt 2016, *Cavit Tinarlioglu kundër Turqisë*, e datës 2 shkurt 2016³⁷, *Lopes de Sousa Fernandes kundër Portugalisë* e datës 15 dhjetor 2015³⁸, *Mihu kundër Rumanisë*, e dt. 1 mars 2016³⁹ etj. Le të shohim në vijim mbrojtjen që i bëhet të drejtës së jetës në kuadër të këtyre detyrimeve pozitive.

³⁵ Shih edhe vendimin *Tais kundër Francës*, 1 qershor 2006, par.85, 87, 96-104, lidhur me detyrimin e shtetit për të siguruar kujdesin mjekësor dhe monitorimin e personave të paraburgosur.

³⁶ Shih *Bazorkina v Rusia*, 27 korrik 2006, par.147.

³⁷ Aplikimi nr. 3648/04.

³⁸ Aplikimi nr. 56080/13.

³⁹ Aplikimi nr. 55354/11.

3.3.1. Mbrojtja ndaj trajtimeve të dëmshme mjekësore.

Konventa nuk e përfshin shprehimisht të drejtën për trajtim mjekësor por në shumë raste kërkuesit kanë argumentuar se vdekjet që kanë rezultuar nga ndërhyrja dhe neglizhenca e dënueshme mjekësore duhet të përfshijnë përgjegjësinë e Shtetit në shumë mënyra. Ata pretendojnë se Shteti ka një detyrim për të siguruar një hetim të plotë të fakteve në lidhje me çështjen dhe problemet që ngrihen dhe në këto çështje të rënda Shteti ka një detyrim për të ndëshkuar personat që janë përgjegjës. Pra, neni 2 të KEDNJ-së mund të angazhojë përgjegjësinë e shtetit kur administrimi i pakujdesshëm i kujdesit shëndetësor ka rezultuar në vdekjen e një pacienti dhe do të kërkojë gjithashtu që të ketë një sistem efektiv të hetimit gjyqësor në rastet e aksidenteve mjekësore. Detyrimi i veçantë për të siguruar një trajtim mjekësor ose kujdes mund të lindë në lidhje me individët që janë në paraburgim ose në burg, qendrat rinore të paraburgimit apo institucionet psikiatrike.⁴⁰

Gjykata në çështjen *N.G kundër Italisë* e cila ka të bëjë me rastin e përgjegjësisë për një “mjekim të pakujdesshëm”, arsyeton se kur shkelja e të drejtës së jetës apo e integritetit fizik nuk bëhet me dashje, detyrimi pozitiv, sipas nenit 2 të KEDNJ-së, nuk kërkon detyrimisht, në çdo rast, ndjekjen e një rruge penale. Në veçanti, në kuptimin specifik të neglizhencës në fushën mjekësore, ky detyrim përmbushet duke i siguruar të interesuarve mundësinë që t'i drejtohen një rruge civile, vetëm apo së bashku me një rrugë penale duke ngritur një padi civile në procesin penal, me synimin për të verifikuar përgjegjësinë e mjekut, dhe për të siguruar aplikimin e një sanksioni civil të përshtatshëm, si: kompensimi i dëmit dhe publikimi i vendimit.

Në një tjetër çështje, atë *Luigi di Bella dhe Caterina Dragotta kundër Italisë*, GJEDNJ-ja, nuk e pranoi ankimin e tyre me arsyetimin, bazuar në jurisprudencën e saj, se kur cënimi i të drejtës së jetës nuk është me dashje, detyrimi pozitiv që rrjedh nga neni 2 i KEDNJ-së përmbushet atëherë kur sistemi gjyqësor i shtetit i ofron të interesuarve një akses përpara një juridiksioni civil, në përfundim të të cilit vendoset përgjegjësia e personelit mjekësor i cili paditet, me synimin që të mbajë përgjegjësi civile për veprimet e kryera. Ky arsyetim vlen edhe në rastin e ndërprerjes së detyruar të shtatëzanisë, si pasojë

⁴⁰*McGlinchey v Mbretërisë së Bashkuar*, 29 korrik 2003, *Keenan v Mbretërisë së Bashkuar*, 3 prill 2001.

e një mjekimi të pakujdesshëm, nga personeli mjekësor. Në çështjen *Poëll kundër Mbretërisë së Bashkuar*,⁴¹ një djalë 20 vjeçar, Robert Poëll, i biri i kërkuesit, vdiq nga sëmundja Addison, një gjendje e rrallë që lind nga insuficiencë adrenale, që është me shumë mundësi fatale nëse nuk trajtohet, por që përbën rrezik edhe nëse diagnostikohet në kohë. Megjithëse më përpara ishte rekomanduar kryerja e një testimi për sëmundjen nga pediatri i spitalit, asgjë nuk ishte urdhëruar që të kryhej nga doktorët e ndryshëm të spitalit që ishin të përfshirë në trajtimin e djalit. Ankuesi ngriti pretendimin e falsifikimit të regjistrave mjekësore duke qenë se ndikimi që këto dokumenta të ndryshojnë totalisht rrjedhën e vendimit, por nuk u provua dot vepra e falsifikimit të kartelave mjekësore dhe për rrjedhojë nuk qe e mundur të provohej fajësia e doktorëve por mbetet i pandryshueshëm fakti që kemi humbjen e jetës së një individi në këto rrethana. (Korff, 2006:85).

Gjykata ka shkuar edhe me tej duke i dhënë statusin e viktimës në kuptim të ankimit për shkelje të nenit 2 të Konventës, edhe personave të infektuar me sëmundje të rënda, si pasojë e veprimeve dhe mosveprimeve të paligjshme të shërbimeve shëndetësore publike. Konkretisht, në çështjen *E.G kundër Italisë*, GJEDNJ-ja arsyeton shprehimisht: “Gjykata, thekson, se në fakt hepatiti C, me të cilin është infektuar zonja D.C, në strukturat sanitare të transfuzionit të gjakut dhe produkteve të tjera derivate, është një sëmundje potencialisht vdekjeprurëse. Megjithëse kërkuesja, jeton që nga viti 1979 e deri më sot, në një gjëndje në të cilën jeta e saj është me të vërtetë e rrezikuar nga sëmundja në fjalë, duhet të konsiderohet si “viktimë”, në shkelje të nenit 2 të Konventës.

Po ashtu, Gjykata rithekson në vendimin e fundit *Mihu kundër Rumanisë* e dt. 1 mars 2016 se fjalja e parë e nenit 2 kërkon nga shtetet marrjen e të gjitha masave si detyrime pozitive për mbrojtjen e shëndetit ndaj trajtimeve mjekësore ose neglizhencës mjekësore. Në vendimin në fjalë në fakt Gjykata nuk konstatoi shkelje të nenit 2 KEDNJ lidhur me mbrojtjen substanciale por konstatoi shkelje të nenit në fjalë nga pikëpamja proceduriale.

⁴¹*Erikson kundër Italisë*, 26 tetorit 1999 fq.7-8.

3.3.2. Mbrojtja nga Policia

Në disa rrethana të mirë-përcaktuara, Gjykata ka konstatuar se autoritetet shtetërore mund të kenë një detyrim pozitiv për të marrë masa parandaluese konkrete për të mbrojtur një individ jeta e të cilit është në rrezik, për shembull nga veprat penale të një individi. Gjykata është e ndërgjegjshme për të siguruar që një detyrim i tillë të mos u imponojë autoriteteve një barrë të pamundur apo joproporcionale dhe do të marrë në konsideratë "vështirësitë e lidhura me policinë në shoqëritë moderne, paparashikueshmërinë e sjelljes njerëzore dhe zgjedhjet operative duhet të bëhen në kushtet e prioriteteve dhe burimeve".

Deklarata e qartë e këtij detyrimi u bë nga Gjykata në çështjen *Osman kundër Mbretërisë së Bashkuar*. Në këtë çështje babai ishte vrarë dhe djali i tij ishte plagosur nga djali i një mësueseje të shkollës së mesme i cili kishte rënë në dashuri me të. Nëna e djalit bëri një ankesë kundër policisë, ku pretendoi se policia kishte dështuar që të vepronte në një seri të paralajmërimeve të qarta se mësuesja e shkollës përbente një kërcënim serioz për sigurinë fizike të djalit të saj dhe pjesës tjetër të familjes (Korff, 2006:75). Mbi këto fakte, Gjykata nuk gjeti asnjë shkelje të nenit 2 të KEDNJ-së duke qenë se nuk ishte vendosur më parë standarti se autoritetet kanë dështuar nëse nuk kishin arritur të ndërmarrin hapa të arsyeshëm për të shmangur një rrezik real dhe të menjëhershëm për jetën, rrezik për të cilin kishin apo duhet të kishin marrë dijeni⁴²(Akandji-Kombe 2005: 26).

Megjithatë, edhe ku një rrezik real dhe i menjëhershëm për jetën, për të cilin autoritetet janë ose duhet të jenë në dijeni, është i pranishëm, detyrimi pozitiv për të mbrojtur jetën nuk do zgjasë për të siguruar një mbrojtje të vazhdueshme ose për një periudhë të pacaktuar, pasi në këtë mënyrë do të vendoste një barrë të pamundur apo joproporcionale mbi autoritetet dhe mund të përfshijë çështje të shpërndarjes më të përshtatshme të burimeve të vendosura nga secili shtet.

Në rastin *Maiorano kundër Italisë*, u pretendua për cenimin e të drejtës së jetës nga ana e shtetit Italian, i cili kishte zbatuar një alternativë të dënimit me burgim ndaj një

⁴² Shih edhe vendimin *Branko TOMAŠIĆ etj.kundër Kroacisë*, 15 janar 2009.

personi të dënuar me burgim të përjetshëm, ky i fundit, edhe pse gjatë këtij regjimi kishte kryer vepra të tjera, përsëri arrinte të siguronte qëndrimin nën këtë regjim.

Gjykata arsyeton se ka patur shkelje të së drejtës së jetës, të një kolektivi të caktuar njërezish. Konkretisht, duke vlerësuar se sistemi i sanksionuar nga autoritetet gjyqësore Italiane, për lënien e personave në gjysëmliri, është i papërshtatshëm për të garantuar të drejtën e jetës së personave. Ajo evidentoi se, pavarësisht se psikologët në raportet e tyre, kishin shprehur një opinion pozitiv për të zbatuar alternativat e dënimit, gjykata përkatëse do të duhej detyrimisht të kishte mbajtur në konsideratë jo vetëm relacionet në favor të tij, por edhe rrethanat në të cilat personi përsëritës, në kushtet e burgut, kishte kryer një seri krimesh, duke u treguar mospërfillës për ligjin dhe për autoritetet gjyqësore (Gomien, 2005:19).

Gjykatat kombëtare, duke patur parasysh shumëllojshmërinë e krimeve të kryera nga i akuzuari, i deklaruar përsëritës, edhe pse i dënuar me burgim të përjetshëm për një krim që kishte tronditur gjithë shoqërinë për shkak të brutalitetit të sjelljes së tij, duhet të kishin qënë shumë të kufizuara për ta vënë në regjimin e gjysmëlirisë. Për këto arsye, gjykata ishte e mendimit që, shkelja e detyrimit për mbrojtjen e jetës, të kërkuar nga neni 2 i Konventës, është shkaktuar nga një seri elementësh, që konsistojnë si në dhënien e gjysmëlirisë për Izzon, megjithë sjelljen dhe preçedentëve penalë të tij, por mbi të gjitha për mungesën e informacioneve, nga ana e Prokurorisë së Kampobasos për Gjykatën, si pasojë e aktivitetit kriminal të kryer nga vetë ai. (Akandji-Kombe 2005: 27).

Ky rast i sipërcituar, na konfirmon atë çka analizuar më sipër gjatë këtij punimi, që një shtet i caktuar shkel detyrimin e tij për të mbrojtur jetën e personave, jo vetëm kur nuk ka një kuadër ligjor penal apo civil, për të siguruar të drejtën e jetës, por edhe në rastin kur nuk i zbaton ato në mënyrën e duhur. I njëjti konkluzion është rikonfirmuar nga Gjykata edhe në vendimin e para pak kohëve, *Civek kundër Turqisë*, e 23 shkurtit 2016 ku autoritetet vendase nuk mundën të mbronin jetën e Selma Civek nga dhuna e përsëritur nga bashkëshorti i saj, derisa gjeti vdekjen. Sipas Gjykatës autoritetet kanë dështuar në mbrojtjen e jetës së Selma Civek edhe pse kjo e fundit disa herë kishte kërkuar ndihmën e autoriteteve. Në këtë rast Gjykata konstatoi shkelje të së drejtës së jetës referuar nenit 2 KEDNJ si nga pikëpamja substanciale ashtu edhe nga pikëpamja procedurale.

3.3.3. Mbrojtja e të burgosurve dhe e personave në paraburgim

Detyrimi për të marrë masa për të mbrojtur jetën e të burgosurve sipas nenit 2 të KEDNJ-së është veçanërisht i rreptë për shkak të pozitës së tyre të pambrojtur. Kjo përgjegjësi është reflektuar nga fakti se barra e provës në lidhje me çdo dëmtim të pësuar në burg, dhe veçanërisht vdekjen e individit, i takon shtetit.

Në veçanti, Shtetet duhet të marrin masa të arsyeshme për të mbrojtur të burgosurit nga kryerja e vetëvrasjes dhe nga vrasja nga një person tjetër në burg. I njëjti test i vendosur në çështjen *Osman* vlen edhe për këto raste, i cili përcakton se që të kemi shkelje të nenit 2, duhet të tregohet që autoritetet nuk arritën të ndërmarrin hapa të arsyeshëm për të shmangur një rrezik real dhe të menjëhershëm për jetën, për të cilin ato ishin ose duhet të ishin në dijeni (Korff, 2006:75).

Në çështjen *Keenan kundër Mbretërisë së Bashkuar*, i biri i aplikantit kishte kryer vetëvrasje, ndërsa ishte në burg. I ndjeri vuante dhe njihej si individ i dhunshëm, paranojak dhe kishte tendenca të dëmtonte veten. Ai kishte sulmuar dy oficerë gjatë kohës që ndodhej në burgim, dhe për këtë vepër penale ishte dënuar me 7 ditë izolim, ku u gjet i varur në qelinë e tij. Gjykata nuk gjeti shkelje të nenit 2, sepse pavarësisht sëmundjes mendore të të burgosurit, i ndjeri nuk ishte diagnostikuar zyrtarisht se vuante nga skizofrenia, për rrjedhojë autoritetet e burgut nuk mund të parashikonin se ai mund të ndodhej përballë një rreziku të menjëhershëm.

Por në rastin *Edwards*, gjykata konstatoi shkelje të nenit 2 të KEDNJ-së, kur një i burgosur u vra barbarisht nga një i burgosur tjetër, Richard Linford, i cili kishte një histori të sëmundjes mendore. Bordi mjekësor, policia, prokuroria dhe gjykata kishin dështuar për të komunikuar informacionin rreth shëndetit mendor të z. Linford dhe histori së mëparshme të dhunës, duke mos bërë kështu një vlerësim të duhur të rrezikut. Gjykata u shpreh se kjo përbën një shkelje të detyrimit të shtetit për të mbrojtur jetën e zotit Edwards (Korff, 2006:77).

Në çështjen *Matushevsky and Matushevskaya kundër Ukrainës*, datë 23.06.2011 një i paraburgosur vdiq në burg dhe autoritetet dështuan në dhënien e një shkaku të justifikuar sepse çështja i referohet vdekjes së një të paraburgosuri në një qendër paraburgimi dhe dështimin e organeve shtetërore në kryerjen e një hetimi efektiv për të hedhur dritë mbi atë çfarë ndodhi. Aplikantët janë të afërmit e Igor Matushevsky i cili vdiq në burg duke pritur gjyqin. Në lidhje me vdekjen e Igorit dhe hetimet në lidhje me të Gjykata nuk u bind nga shpjegimet e dhëna nga autoritetet në lidhje me dëmtimet e Igorit dhe gjithashtu e gjeti jo bindëse mënyrën se si u nxorën këto përfundime. Në veçanti, Gjykata nuk mund të pranojë se asnjë përpjekje, pavarësisht sa e pakualifikuar, apo e minutës së fundit dhe ndihma për ta përmendur të mund të rezultojë në goditje mbrapa të dy veshëve dhe hematoma e tufa flokësh të shkulura nga të dy lobet temporale. Po ashtu e pabesueshme iu duk gjykatës edhe sugjerimi i autoriteteve se Igor mund të kishte dëmtuar veten e vet në të dy anët e brëndshme të lobeve temporale si rezultat i rënies nga krevati. Në lidhje me këtë, pretendimet ishin se Igor kish vdekur në qendrën mjeksore në prezencë të personelit mjeksor të cilët u përpoqën që ta sillnin në jetë dhe asnjë traumë tjetër e mëtejshme nuk i është shkaktuar trupit të vdekur të këtij personi. Rrjedhimisht, Gjykata i gjeti të pashpjegueshme përfundimet e Qeverisë se hemoragjia ka qenë shkaktuar si rezultat i traumës mbi trupin tashmë të vdekur të Igorit. Injektimet me substanca të ndryshme i janë praktikuar atij pak para se ai të vdiste, ende disa nga substancat të cilat iu injektuan nuk janë gjetur në trupin e tij si rezultat i një ekspertimi mjeko-ligjor të mëvonshëm. Kjo mospërputhje nuk është sqaruar kurrë nga autoritetet. Si përfundim, autoritetet nuk kanë bërë asnjë përpjekje reale për të identifikuar kush i bëri telefonatën dhe letrën anonime, në adresë të familjarëve të Igorit, duke aluduar se vdekja e tij kishte qenë e dhunshme. Rreth tre vjet kishin kaluar nga vdekja e Igorit dhe asnjë hetim efektiv nuk kishte përfunduar për këtë çështje. Gjykata konstatoi se ka pasur shkelje të neni 2 të Konventës, për të dyja, si për vdekjen ashtu edhe për mungesën e një hetimi efektiv rreth vdekjes. (Gomien, 2005:19).

Në çështjen *Velkhiyev kundër Rusisë*, datë 5.07.2011 dy vëllezërit Bashir Velkhiyev dhe Bekhan Velkhiyev u torturuan, dhe njëri nga ata gjeti vdekjen, në duart e organeve të policisë në Rusi. Çështja ka të bëjë me burgosjen dhe torturimin e dy

vëllezërve në Ingusheti nga organet e policisë, me pasojë vdekjen e njërit prej tyre, dhe me dështimin për të realizuar një hetim efektiv mbi ngjarjen. Bazuar në nenet 2, 3, 5, 8 dhe 13, aplikantët ankohen për burgosjen dhe torturimin e Bekhan dhe Bashirit dhe në lidhje me vdekjen e Bashirit.

Në lidhje me vdekjen e Beshirit, Gjykata e pranoi lëshimin që bëri qeveria duke pranuar se ka një shkelje të nenit 2 të Konventës. Hetimi filloi menjëherë të nesërmen e vdekjes së Bashirit. Edhe pse disa hapa u hodhën në hetimin e vdekjes së Bashirit gjatë vitit të parë të hetimeve, nga ana e organeve të hetimit nuk u hodhën kurrë hapa të tjerë. Si për shembull, nuk ka pasur kurrë një inspektim apo kqyrje e vendit të ngjarjes dhe po ashtu nuk ka pasur kurrë një kërkesë për informacion nga ana e agjentëve të policisë të cilët ishin caktuar për t'u marrë me çështjen e vëllezërve Velkhiyev. Si përfundim, hetimi u pezullua dhe u rihap disa herë me periudha të gjata pasiviteti për të cilat nuk është dhënë asnjëherë një shpjegim nga ana e organit të prokurorisë. Gjykata vendosi se: *“në ato raste kur nga një hetim i brendshëm organet e hetimit kanë përcaktuar përgjegjësinë e organeve shtetërore, një dështim në identifikimin e individëve përgjegjës mund vijë vetëm nga një qëndrim refraktar i organeve të ndjekjes penale për të bërë një hetim efektiv. Si rrjedhojë, ka pasur shkelje të nenit 2 të Konventës”*.

3.3.4. Zhdukjet

Fenomeni i zhdukjes është një formë komplekse e shkeljes së të drejtave të njeriut, duke përfshirë shkelje të së drejtës së jetës dhe të së drejtës për të mos ju nënshtruar trajtimeve çnjerëzore ose degraduese. Në rastet kur një individ është zhdukur pasi është vendosur në paraburgim, Gjykata nuk ka qenë e gatshme për të gjetur shkelje të Nenit 2 të KEDNJ-së pa prova konkrete që individi ishte vrarë nga agjentët e Shtetit⁴³.

Në vitet e fundit GJEDNJ-ja ka investiguar për të marre në konsideratë shkeljet e nenit 2 KEDNJ kur individët janë marrë nën kujdestari apo mbrojtje nga ana e qeverisë së

⁴³Kurt kundër Turqisë, 25 maj 1998, Luluyev dhe të tjerët kundër Rusisë, par.76 -85

një vendi, Palë e Lartë Kontraktuese (Gomien, 2005:20). Në rast të një zhdukjeje, të afërmit e të zhdukurit bazuar në nenin 2 të KEDNJ-së do të kërkojnë hetimin.

Krimi i “zhdukjes” ka këto elementë përbërës:

- a) privimin e individit nga liria
- b) i bërë nga organet shtetërore ose me dijeni dhe indiferentizmin e tyre ndjekur nga
- c) refuzimi për të pranuar privimin e lirisë së individit ose
- d) refuzimi i kërkesës për të dhënë informacion se ku mund të ndodhet personi duke i vendosur këta persona jashtë hapësirës mbrojtëse të ligjit..

Çështjet lidhur me zhdukjen janë të shumta dhe vazhdojnë ende të paraqiten para Gjykatës (Gomien, 2005:20). Në çështjen *Kurt v Turqi* të dy organet, Komisioni dhe Gjykata e pranuan se ishte provuar qartë se djali i aplikuesit, në këtë rast katër vjet e gjysëm më parë, ishte parë për herë të fundit i rrethuar nga ushtarët gjatë një operacioni sigurie në fshatin e tij në Jug-Lindje të Turqisë. Bazuar në këto fakte babai i të humburit ankohej se mundësia që djali i tij të kishte vdekur në duart e arrestuesve gjatë hetimeve, ishte shumë e madhe dhe jo pa baza. Sidoqoftë të dy organet konkluduan se në mungesë të fakteve konkrete nuk mund të konkludohej se djali ishte vrarë nga autoritetet turke dhe rrjedhimisht nuk kishim shkelje të nenit 2 të KEDNJ-së. Por, konkluduan se kishim të bënim me një shkelje të rëndë të së drejtës për lirinë dhe sigurinë e personit nën nenin 5 të KEDNJ-së duke e lënë kështu të hapur dilemën rreth humbjes së personit. (Korff, 2006:56)

Babai i të zhdukurit në çështjen *Timurtas kundër Turqisë*, u ankua se djali i tij ishte marrë për hetim në vitin 1993 dhe që atëherë rezultonte i zhdukur, sepse nuk ishte kthyer më në banesë. I ati u ankua tek autoritetet turke por nuk ishin ndërrmarre kërkime, sepse dyshohej që djali i tij të ishte anëtar i organizatës terroriste Kurde. Ndërsa qeveria turke mohonte që djali ishte marrë nga policia lokale dhe qendra e interrogimit, në asnjërën prej të cilave nuk përmendej arrestimi i ndonjë djali të ri. Për të provuar pretendimet e të atit një delegacion i Komisionit Europian u detyrua të shkonte në zonën ku ishte bërë arrestimi për të mbledhur prova. Aplikanti e kishte të pamundur gjetjen e ndonjë dëshmitari i cili mund të vërtetonte arrestimin dhe hetimin e djalit të vet. Por, në mbështetje të ankesës ai paraqiti një fotokopje të dokumentit të dhënë nga policia ku vërtetohej arrestimi i të birit. Qeveria turke vuri në dyshim vërtetësinë e dokumentit pasi dyshohej me argumentin se numri i

protokollit në këtë dokument korespondonte me një dokument tjetër të cilin ajo nuk mundej ta paraqiste për asye të sigurisë kombëtare. Duke marrë parasysh rrezikun e mbështetjes në një fotokopje, gjykata vendosi sidoqoftë që mosparaqitja edhe nga ana e shtetit të një prove të pranueshme dhe pa dhënë shpjegimet e duhura, e bëri atë të nënkuptonte se fotokopja e paraqitur nga aplikanti ishte e pranueshme dhe se djali i aplikuesit ishte arrestuar nga policia. Pyetja e dytë që mbetej për t'u trajtuar nga gjykata ishte, nëse mund të kishim një shkelje të nenit 2 të KEDNJ-së, në mungesë të gjetjes së trupit të të humburit. Duke konkluduar se përgjigjja e kësaj pyetje mund të jepej saktësisht vetëm duke marrë në shqyrtim të gjitha faktet e çështjes dhe veçanërisht egzistencën e ndonjë prove që drejtonte drejt një vdekje gjatë hetimeve. Gjukata vendosi se koha e kaluar që nga momenti që personi ishte arrestuar edhe pse jo vendimtare ishte domethënëse, qëkurse sa më shumë kohë të kalonte pa pasur ndonjë informacion aq më bindës bëhej dyshimi se personi kishte vdekur. (Korff, 2006:57).

Çështja *Tashukhadzhiyev kundër Rusisë*, datë 25/10/2011, ka të bëjë me zhdukjen e një të riu në Çeçeni mbasi ai ishte arrestuar nga një grup ushtarakësh në vitin 1996. Aplikuesi është një shtetas rus i cili ka lindur në vitin 1936 dhe aktualisht jeton në Shali (Republikës Çeçene, Rusi). Djali i tij që në atë kohë ishte 26 vjeç Elbek Tashukhadzhiyev ishte duke punuar si shofer i një kamioni çisternë kur u arrestua në shkurt 1996 nga një grup ushtarësh pranë fshatit Berkat-Yurt në Çeçeni. Që nga ai moment ai nuk është parë më. Ditën pas zhdukjes së djalit të tij, Abdulbek Tashukhadzhiyev, filloi kërkimin për të. Ai u informua nga komandanti i një skuadre të forcave ajrore të vendosur në atë zonë që një grup oficerësh të inteligjencës ushtarake kishin arrestuar djalin e tij dhe ishin larguar me një automjet. Sipas parashtimeve të Z.Tashukhadzhiyev kamioni i djalit të tij u gjet disa kohë më vonë duke u përdorur nga ushtarakët. Qeveria ruse nuk i ka kundërshtuar shumicën e fakteve të paraqitura por parashtroi se Elbek Tashukhadzhiyev ishte arrestuar sepse në makinën e tij ishte gjetur një granatë hedhëse.

Në mars të vitit 1996 zyra e prokurorit ushtarak nisi një procedim penal lidhur me zhdukjen. Gjatë procedimit komandanti i njësisë së inteligjencës parashtroi se i arrestuari nga njësia e tij, Elbek Tashukhadzhiyev ishte hedhur nga makina, kishte filluar të vraponte dhe në këtë kohë ishte qëlluar dhe ishte lënë në pyll. Megjithatë komandanti e ndryshoi

deklaratën e tij duke parashtruar se Elbek Tashukhadzhiyev ishte larguar dhe që nga ai moment nuk ishte parë më. Në shtator të vitit 1996 proçedimi penal ishte pushuar për shkak të mungesës së provave. Ai u rihap në prill të vitit 1998 pa informuar Abdulbek Tashukhadzhiyev. Autoritetet më pas kanë përfunduar dhe rihapur proçedimin disa herë pa e informuar z. Tashukhadzhiyev në kohën e duhur. Ata kanë dështuar në zbulimin vendndodhjes së Elbek Tashukhadzhiyev. Sipas qeverisë ruse hetimi është ende në zhvillim e sipër. Pavarësisht kërkesave specifike nga Gjykata, qeveria nuk ka bërë të ditur asnjë dokument nga dosja penale, duke deklaruar se hetimi ishte pezulluar dhe dosja përmbante informacione konfidenciale.

Abdulbek Tashukhadzhiyev pretendoi se djali i tij ishte vrarë nga ushtarët rusë, se hetimi ishte i pamjaftueshëm, se ai ishte arrestuar në kundërshtim me garancitë proçeduriale të përfshira në Konventë dhe se ai ishte privuar nga një mjet efektiv në lidhje me këto shkelje të pretenduara. Ai u mbështet vecanërisht në nenet 2 (e drejta për jetë), 5 (e drejta për liri dhe siguri) dhe 13 (e drejta për mjet juridik efikas) të KEDNJ-së. Duke qenë se qeveria nuk ka zbuluar asnjë nga dokumentat e lidhura me hetimin, Gjykatës ju desh që për të vlerësuar efektivitetin e hetimit të bazohej në ato pak dokumenta të paraqitura nga z. Tashukhadzhiyev dhe informacioneve të përgjithshme lidhur me zhvillimin e hetimit të paraqitur nga Qeveria.

Qeveria nuk arriti të sigurojë më tej informacion të hollësishëm mbi hapat aktuale hetimore të marra nga autoritetet. Megjithatë, nga të dhënat e pakta që zotëronte, Gjykata vërejti se hetimi në lidhje me zhdukjen e Elbek Tashukhadzhiyev kishte filluar më tepër se një muaj mbas ngjarjes dhe më pas ishte pushuar dhe rihapur disa herë. Duke marrë parasysh hezitimin e qeverisë për të ofruar informacion në lidhje me arsyet e vendimeve të ndryshme për rihapjen e proçedimit, gjykata arrin në përfundimin që vendimet për pushimin e proçedimit ishin prishur si të pa bazuara. Ky faktor në vetvete dhe periudha katërmëdhjetë vjeçare e këtij proçedimi penal, i cili është aktualisht në vazhdim, tregon mungesën e efektshmërisë së hetimit për zhdukjen e Elbek Tashukhadzhiyev. Autoritetet kishin dështuar kështu në sigurimin që hetimi të merte nivelin e kërkuar të shqyrtimit publik, ose që të mbronte interesat e të afërme në proçedim. Në këtë aspekt gjykata refuzoi kundërshtimin e qeverisë se mjetet e brendshme nuk kishin ezauruar duke qenë se

investigimi ishte në vazhdim. Në përputhje me këto rrethana ka pasur shkelje të Nenit 2 të KEDNJ-së në aspektin procedural të tij. (Gomien, 2005:20)

Çështja *Beksultanova kundër Rusi*, datë 27/9/2001, tregon se në bazë të parashtrimeve të aplikueses anëtarët e familjes së saj, duke përfshirë edhe Timur Beksultanov, kanë qenë viktimat të persekutimit të vazhdueshëm nga ana e autoriteteve vendase. Në korrik të vitit 2003 Timur Beksultanov iu desh të linte punën e tij si trajner në qendrën sportive Achkhoy - Martan. Për më tepër, në disa raste ushtarakët e forcave federale kanë hyrë në shtëpinë e saj, e kanë kontrolluar dhe kanë kërcënuar kërkuesen dhe anëtarët e familjes së saj.

Sipas kërkueses, Timur Beksultanov dhe I.M. kishin dalë nga automjeti dhe ushtarakët u kishin kërkuar dokumentet e tyre të identitetit. Mbasi i kontrolluan ato, ushtarakët kishin kapur nga krahët Timur Beksultanov dhe kishin filluar ta rrihnin. Kur ai kishte rënë në tokë, dëshmitari kishte dëgjuar disa të shtëna dhe kishte parë se Timur Beksultanov ishte plagosur në kofshë. Menjëherë pas kësaj një oficer i ishte afruar Timur Beksultanov dhe i kishte shtënë në shpatull. Pas kësaj ushtarakët e hipën Timur Beksultanov në një APC dhe ishin larguar në një destinacion të panjohur. Ushtarakët nuk i bënë asgjë I.M, i cili kishte hyrë përsëri brenda automjetit të tij dhe ishte larguar. Sipas kërkuesit, dëshmitari nuk kishte qenë në gjendje të dëgjonte çdo gjë që kishte ndodhur në udhëkryq, por kishte parë qartë se çfarë ndodhi atje. Nuk ka pasur asnjë lajm të Timur Beksultanov që më 2 tetor 2004. Qeveria parashtroi se nga procedimet e brendshme nuk kishte marrë asnjë provë që Timur Beksultanov ishin rrëmbyer nga agjentët e Shtetit.

Sipas parashtrimeve të Qeverisë, ankuesi kishte dështuar edhe për të kërkuar dëmshpërblim në procedurën civile. Përsa i përket *një padie civile për të marrë dëmshpërblim për dëmin e pësuar nëpërmjet akteve të paligjshme apo veprimeve të paligjshme nga agjentët e Shtetit*, Gjykata ka theksuar në një numër rastesh të ngjashme që vetëm kjo procedurë nuk mund të konsiderohet si një mjet efektiv në kontekstin e kërkesave në bazë të nenit 2 të Konventës, për këtë arsye kërkuesi nuk ishte i detyruar të përdorte mjetet civile. Në të njëjtin konkluzion arriti Gjykata edhe në vendimin *Mihu kundër Rumanisë* e datës 4 mars 2016 ku Gjykata rithekson se në rast të disa mjeteve efektive për dëmshpërblimin paditësi mund të zgjedhë atë mjet që ai e mendon më afër problematikës

së tij. Kështu që kur është nisur një procedurë ankimimi për dëmshpërblim, të tjerat nuk duhet medoemos të kërkohen.⁴⁴

Personat e arrestuar janë në një pozitë të pafuqishme dhe detyrimi i autoriteteve për të dhënë llogari për trajtimin e një individi të paraburgosur është veçanërisht i rreptë, kur ai individ vdes ose zhduket më vonë⁴⁵. Me rëndësi paraqitet edhe jurisprudenca e viteve të fundit të GJEDN-së lidhur me zhdukjet.

Në çështjen *Khachukayeva kunder Rusisë*⁴⁶, e datës 9 shkurt 2016, Gjykata konstatoi shkelje të nenit 2 KEDNJ pikërisht sa i takon zhdukjes së Z. Islam Deniyev, pretendim i ngritur nga bashkëshortja dhe vajzat e tij. Gjykata gjeti një lidhje ndërmjet ndalimit të bërë nga agjentët në vitin 2000 të Deniyev dhe gjetjes së kufomës në vitin 2002, pra dy vjet më vonë. Gjykata, në këtë rast konstaton se çështja në fjalë ka të bëjë me ekzekutimin e tij nga agjentët e qeverisë, pra ka patur shkelje të nenit 2 KEDNJ pasi Shteti ka dështuar në mbrojtjen e Z. Islam Deniyev dhe në mënyrë të veçantë në hetimin e zhdukjes dhe vdekjes së tij.

3.3.5. Mbrojtja kundër rreziqeve mjedisore që janë kërcënuese për jetën e individit

GJEDNJ-ja ka pasur një numër çështjesh në lidhje me problemet mjedisore që pretendoheshin se ndikonin në mënyrë të drejtpërdrejtë në të drejtat individuale që mbrohen nga Konventa, duke përfshirë të drejtën për jetën. Kërkuesit në çështjet e mbrojtjes së të drejtës së jetës kanë përfshirë edhe të drejta të tjera në këtë kuadër, për rrjedhojë Komisioni e Gjykata ndonjëherë kanë trajtuar çështje që hynin në mbrojtjen e Nenit 2 dhe ndonjëherë edhe të neneve të tjera. Detyrimet pozitive mund të lindin edhe kur autoritetet shtetërore nuk marrin masat e arsyeshme për të mbrojtur jetën nga rreziqet e mjedisit. (Korff, 2006:71). Në çështjen *OnerYildiz kundër Turqisë*⁴⁷, autoritetet u vlerësuan të ishin neglizhente në zbatimin e masave parandaluese në lidhje me ruajtjen e mbeturinave

⁴⁴ Shih vendimin *Mihu kunder Rumanisë*, dt. 1 mars 2016 paragrafi nr.58.

⁴⁵ Shih vendimin *Mahkraibyeva kundër Rusisë*, vendimi *Giriyeva kundër Rusisë*, 21 qershor 2011.

⁴⁶ Kerkesa nr. 3457/08.

⁴⁷ *OnerYildiz kundër Turqisë*, vendimi i Dhomës së Madhe të 30 nëntorit 2004 (vendimi i Dhomës i rishikuar nga Dhoma e Madhe doli më 18 qershor 2002).

të cilat më pas shpërthyen duke shkaktuar vdekjen e 39 njerëzve. Turqia u konsiderua përgjegjëse edhe për dështimin për t'ju siguruar njerëzve që jetonin në këto toka informacionin e mjaftueshëm për të mbrojtur veten e tyre. Në çështjen *Oneryildiz kundër Turqisë*, Gjykata shqyrtoi në mënyrë të ndarë të dy aspektet e Nenit 2, thelbin dhe procedurën, në lidhje me çështjet mjedisore kërcënuese për jetën dhe qartësisht parashtruan parimet e përgjithshme që duhen zbatuar për secilën nga to. Në aspektin e parë, Gjykata e përqendroi vëmendjen tek rëndësia që informacioni i duhej dhënë publikut i cili ndikon drejtpërdrejtë tek individët në lidhje me rreziqet e mjedisit. Gjykata i vuri dukshëm theksin konventave dhe rekomandimeve të ndryshme të Këshillit të Evropës në këtë fushë. Kërkuesi i cili u paraqit në Gjykatë ishte kryefamiljari i një familjeje që kishte jetuar në banesa në zona të varfra pranë një pike grumbullimi të vendosur nga Bashkia në Umraniye në Stamboll.⁴⁸ Në vitin 1991, një grup ekspertësh gjatë kontrollit konstatuan se vendi ku ndodhej kjo pikë grumbullimi binte në kundërshtim me rregulloret përkatëse dhe përbënte një rrezik të madh për shëndetin e banoreve të luginës, veçanërisht të atyre që jetonin në zonat e varfra. Rreziqe përfshinin riskun për të marrë sëmundje ngjitëse dhe gjithashtu në veçanti, një rrezik për shpërthim të gazit të metanit që formohej në atë pikë grumbullimi.⁴⁹ Këshilli Bashkiak kundërshtoi kërkesat nga kryetari i bashkisë lokale duke kërkuar një urdhër për mbylljen e kësaj pike grumbullimit të plehrave dhe për të dëmshpërblyer banorët e dëmtuar dhe kërkoi krijimin e vendeve të tjera të grumbullimit të plehrave në përputhje me standardet moderne të cilat duhet të hapeshin nga viti 1993.⁵⁰ Gjithsesi e gjithë kjo përpjekje nuk rezultoi e suksesshme sepse ndodhi pikërisht ajo që ekspertët kishin parashikuar. Në 28 prill 1993, ndodhi një shpërthim metani në vend duke shkaktuar rrëshqitje dhe duke shkaktuar vdekjen e 39 personave. Pjesa e shkrirë e mbetjeve nga mali dëmtoi rreth dhjetë banesa të varfra që ndodheshin poshtë tij, duke përfshirë atë që i

⁴⁸Fillimisht, çështja u parashtrua nga Z. Cinar, por çështja e këtij të fundit u trajtua veçmas nga çështja e Z. Oneryildiz (vendimi, para. 3). Z. Oneryildiz, teknikisht edhe i vetmi kërkues i mbetur, nuk veproi vetëm në emër të tij, por edhe në emër të të tre djemve të tij që kishin mbijetuar, Husamettin, Ayfin dhe Halef Oneryildiz, që ishin minore në atë kohë, dhe gjithashtu në emër të të afërmeve të tij të vrarë në aksident të cilët ishin qendra e çështja: gruaja e tij, Gulnaz Oneryildiz, konkubina e tij, Sidika Zorlu, dhe fëmijët e tij, Selahattin, İdris, Mesut, Fatma, Zeynep, Remziye dhe Abdulkemim Oneryildiz (*idem*).

⁴⁹Vendimi i Dhomës së Madhe tek *Oneryildiz*, par. 13.

⁵⁰Vendimi i Dhomës së Madhe tek *Oneryildiz*, par. 16.

përkiste kërkuesit. Tridhjetë e nëntë vetë vdiqën në aksident duke përfshirë edhe gruan e kërkuesit, konkubinën e tij dhe shtatë nga dhjetë fëmijët e tij. Hetimi identifikoi zyrtarët përgjegjës, dhe i çoi ata për ndjekjen penale të dy kryetarëve të bashkive, por vetëm për neglizhencë në kryerjen e detyrave të tyre, dhe jo për vdekje të dënueshme. Si përfundim ata vetëm u gjobitën ligjërisht me një shumë minimale për atë akuzë me më pak se 10 Euro, dhe madje edhe ajo gjobë u pezullua. Kërkuesi dhe fëmijët e tij që mbijetuan morën një kompensim prej rreth 2,285 Euro.⁵¹ (Korff, 2006:72).

Gjykata përsëriti se Neni 2 të KEDNJ-së parashtron një detyrim pozitiv për Shtetet për të ndërmarrë hapat e duhura në mbrojtje të jetës së personave që ndodhen brenda juridiksionit të tyre. Detyrimi pozitiv për të ndërmarrë të gjitha masat e duhura për të mbrojtur jetën për qëllimet e Nenit 2 të KEDNJ-së kërkon mbi të gjitha një detyrim kryesor për Shtetin për të krijuar një kuadër legjislativ dhe administrativ me qëllim sigurimin e parandalimit efektiv kundrejt kërcënimeve ndaj të drejtës për jetën. Ky detyrim pa dyshim zbatohet në kuadrin e veçantë të veprimtarive të rrezikshme, ku duhet vënë një theks i veçantë në rregulloret e hartuara për tiparet specifike të veprimtarisë në fjalë, e veçanërisht në lidhje me nivelin e risqeve të mundshme ndaj jetës së njeriut. Ato duhet të drejtojnë liçensimin, krijimin, kryerjen, sigurimin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë dhe duhet ta bëjnë atë të detyrueshme për të gjithë të interesuarit që kërkojnë të ndërmarrin masa praktike në sigurimin e mbrojtjes efektive të qytetarëve, jeta e të cilëve mund të rrezikohet nga rreziqet e mundshme.

3.3.6. Dëbimi ku si pasojë mund të rezultojë vdekja e individit

E drejta për jetën do të zbatohet edhe në rastet e dëbimit apo ekstradimit të një individ, ku si pasojë mund të rezultojë vdekja e tij, megjithëse kjo ka angazhuar edhe nenin 3 për mbrojtje nga trajtimi çnjerëzor dhe degradues (*D v Mbretërisë së Bashkuar dhe Soering*).

Çështjet kryesore në lidhje me “ekstradimin, përjashtimin dhe dëbimin”, filimisht u vunë re në çështjen e *Soering*, të vitit 1989, ku Gjykata u shpreh se, për shkak të kuptimit të qartë

⁵¹Vendimi i Dhomës së Madhe tek *Oneryildiz*, par. 18.

të fjalisë së dytë të paragrafit të parë të nenit 2, ajo nuk mund të vendoste se ekstradimi në një vend ku kërkuesi mund të përballët me dënimin me vdekje, ishte një shkelje e atij neni (megjithatë u shpreh në atë çështje se “*fenomeni i pritjes së vdekjes në radhë*” në lidhje me atë dënim në Shtetin e Virxhinias të Shteteve të Bashkuara përbënte trajtim çnjerëzor dhe poshtërues, duke e ndaluar kështu ekstradimin në baza të tjera), (Gomien, 2005:25).

Kjo do të thotë se parimi i zbatueshëm për ekstradimet që mund t’i ekspozojë individët ndaj një trajtimi që bie në kundërshtim me nenet 2 dhe 3 të KEDNJ-së në një Shtet që nuk është Palë e Konventës, zbatohet tashmë edhe për ekstradimet që mund ta ekspozojnë një individ ndaj dënimit me vdekje në kohë paqeje. Nëse ekzistojnë “*motive substantive*” për të besuar se ka një “rrezik real” se një person që do të ekstradohet në një Shtet që nuk është Palë, do të akuzohet në atë vend me ndëshkimin kapital dhe, nëse dënohet, do të ndëshkohet me vdekje dhe do të ekzekutohet, Shtetit ekstradues do t’i kërkohet të marrë siguri të qartë e detyruese nga Shteti pritës që personi nuk do të dënohet, apo të paktën, nëse merr një dënim të tillë, dënimi nuk do të ekzekutohet.

Dhënia e një sigurimi të paqartë me efektin që autoritetet gjyqësore do t’i bëjnë të ditur gjykatës se do ta gjykojnë personin, për të cilin Shteti ekstradues do të preferonte që të mos imponohej apo të mos ekzekutohej vendimi me vdekje (sigurim i tillë që u ofrua nga autoritetet gjyqësore të Virxhinias në çështjen *Soering*), është qartësisht i pamjaftueshëm. Ekstradimi i personit pa marrë një siguri të tillë do të përbëjë shkelje të Konventës. (Gomien, 2005:25).

Ndërsa çështja *Ahmed kundër Austrisë* kishte të bënte me një somalez, Z. Ahmed,⁵² të cilit i ishte dhënë statusi i refugjatit në Austri pasi, si pjesëtar i një grupi luftues në konfliktin somalez, ai ishte në rrezik persekutimi dhe vrasjeje nëse kthehej në vendin e lindjes. Pasi u dënua për një vepër penale, autoritetet donin ta kthenin në Somali, duke qenë se ligji austriak e parashikon një dënim të tillë në raste të veprave të rënda penale. Autoritetet përfshinë nenin 33 të Konventës së Gjenevës të 28 korrikut 1951 në lidhje me Statusin e Refugjatëve, që parashikon se, asnjë Shtet Kontraktues nuk duhet të dëbojë apo kthejë një refugjat në asnjë lloj mënyre, në kufijtë e territoreve, ku jeta apo liria e tij mund

⁵² Shih *Ahmed kundër Austrisë*, vendimi i 27 nëntorit 1996.

të kërcënohet për arsye të racës, fesë, kombësisë, anëtarësisë në një grup të caktuar shoqëror, apo të mendimit politik. Kërkuesi kishte argumentuar specifikisht se dëbimi i tij do t'i rrezikonte jetën, dhe megjithëse ai e ripërsëriti këtë pretendim përpara Gjykatës, ai nuk përfshiu Nenin 2 të KEDNJ-së, duke mbështetur pretendimin e vet vetëm në nenin Nenin 3 të KEDNJ-së, dhe Gjykata gjithashtu e trajtoi çështjen në bazë të po këtij neni. Gjykata përsëriti se Shtetet kanë të drejtën për të kontrolluar hyrjen, banimin dhe dëbimin e të huajve, ndërsa neni 3 i ndalon ata të dëbojnë një person në një vend tjetër, nëse ka “motive substantivë” për të besuar se ky person do të përballlet me një “rrezik real” të trajtimit çnjerëzor apo poshtërues në vendin pritës. Ajo theksoi se neni 3 i KEDNJ-së ndalon torturën apo trajtimin çnjerëzor e poshtërues ose ndëshkimin në terma absolute, pavarësisht nga sjellja e viktimës. Gjykata pranoi konstatimin e Komisionit se nuk ka tregues që të provojë se rreziqet ndaj të cilave ishte ekspozuar kërkuesi në vitin 1992, kohë në të cilën iu dha azili, nuk ekzistonin më, apo se një autoritet publik do të ishte në gjendje ta mbronte atë në vendin e vet.⁵³ Kështu dëbimi i kërkuesit përbën shkelje të Nenit 3 KEDNJ.

3.4. Çështja e dënimit me vdekje

Dënimi me vdekje mbetet ende një ndër çështjet më të diskutuara në lidhje me të drejtat e njeriut dhe më konkretisht me të drejtën e jetës. Dënimi me vdekje si masa më ekstreme është e parashikuar të zbatohet vetëm për vepra penale me rrezikshmëri të lartë shoqërore. Sot ky dënim vazhdon të jetë në fuqi në një pjesë të vendeve në botë. Me anë të dhënies së këtij dënimi kapital synohet që të eliminohet përfundimisht jeta e një personi i cili mendohet që është i pareabilitueshëm dhe që ka cënuar në mënyrë të pakthyeshme interesat e shoqërisë. Ky dënim është një dëmtim i dukshëm i të drejtës së jetës dhe në lidhje me mbrojtjen e kësaj të fundit është miratuar Protokollin nr.6 i KEDNJ-së i cili heq dënimin me vdekje në kohë paqe. Ky Protokoll e lejon këtë dënim në kohë lufte për vepra

⁵³Vendimi tek Ahmed, para. 44.

penale me karakter kryesisht ushtarak dhe vepra me rrezikshmëri të lartë shoqërore. Protokolli nr.13 e heq përfundimisht dënimin me vdekje edhe në kohë lufte.

Në një analizë që do t'i bëjmë nenit 2 të KEDNJ-së i cili trajton të drejtën e jetës do ta kanalizojmë atë në dy dimensione. Në paragrafin e parë të nenit 2 thuhet se *“Askujt nuk mund t'i privohet qëllimisht jeta, me përjashtim të rastit, kur zbatohet një vendim me vdekje i dhënë nga një gjykatë, kur krimi ndëshkohet me këtë dënim nga ligji”*. Në këtë paragraf dënimi me vdekje ka si kufizim të vetëm dhënien e një vendimi gjyqësor. Ky paragraf i referohet atyre vendeve të cilat e kanë të pranishëm në kodet e tyre penale dënimin me vdekje dhe ai jepet vetëm nga gjykata në rastet e përcaktuara nga legjislacioni i tyre i brendshëm. Për Shtetet që janë Palë të Konventës,⁵⁴ kjo dispozitë është zëvendësuar nga klauzolat në Protokollin 6 të Konventës që shfuqizon dënimin me vdekje në kohë paqeje dhe në të gjitha rrethanat përkatësisht. Ky paragraf tashmë është zëvendësuar nga klauzolat në Protokollin nr.6 dhe nr.13 të Konventës që e shfuqizojnë dënimin me vdekje si në kohë paqeje dhe në kohë lufte.

Protokolli nr.6 për shfuqizimin e dënimit me vdekje hyri në fuqi në 01.03.1985 dhe në nenin 1 të këtij protokolli parashikohet shprehimisht se *“Dënimi me vdekje do të shfuqizohet. Askush nuk do të dënohet apo ekzekutohet me këtë dënim”* Ky nen përforcohet më tej edhe nga neni 3⁵⁵ dhe 4⁵⁶ të Protokollit nr.6 ku parashikohet se nuk do mund të bëhet asnjë derogim nga ky nen në bazë të nenit 15 të Konventës.

Më vonë Konventa e evoluoi qëndrimin e saj në lidhje me dënimin me vdekje dhe duke parashikuar në Protokolli nr.13 i cili hyri në fuqi në 01.08.2003, heqjen përfundimtare të dënimit me vdekje në të gjitha rrethanat. Hyrja në fuqi e këtij Protokolli u kushtëzua nga 2 kushte dhe më konkretisht: kushti i parë parashikonte se neni 6 i këtij Protokolli kërkonte nënshkrimin dhe ratifikimin e tij me kusht që të jetë ratifikuar medoemos Konventa, ndërsa

⁵⁴Protokolli Nr. 6 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore në lidhje me shfuqizimin e dënimit me vdekje, e 28 prillit 1983, hyri në fuqi që në 1 mars 1985; Protokolli Nr. 13 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore në lidhje me shfuqizimin e dënimit me vdekje në të gjitha Rrethanat, e 3 majit 2002, në fuqi që në 1 korrik 2003.

⁵⁵ Shih Nenin 3 të Protokollit nr:6 “Asnjë derogim nuk lejohet në lidhje me dispozitat e këtij Protokolli në bazë të nenit 15 të Konventës.

⁵⁶ Shih Nenin 4 të Protokollit nr:6” Asnjë rezervë nuk pranohet në lidhje me dispozitat e këtij Protokolli në bazë të nenit 57 të Konventës”

kushti i dytë, parashikonte në nenin 7 të Konventës datën e hyrjes në fuqi pas ratifikimit të tij nga 10 shtete anëtare të Këshillit të Evropës ndaj dhe ky protokoll hyri në fuqi pikërisht pas nënshkrimit nga shteti i dhjetë. Pas ratifikimit të Protokollit nr.6 dhe nr.13 Europa filloi të konsiderohej si një vend ku dënimi me vdekje jepej vetën në kohë lufte, pasi ai nuk do të ekzistonte më në praktikën e gjykatave evropiane. Vlen për t'u theksuar se përgjegjësia e një shteti nuk qëndron vetëm në mosaplikimin e dënimit me vdekje, por shtetet që kanë ratifikuar këto protokolle nuk duhet të lejojnë ekstradimin e shtetasve të cilët në vendet kërkuese mund të dënohen me vdekje.

Në fakt pozicioni ligjor në lidhje me dënimin me vdekje i është nënshtruar një evolucioni që nga koha kur u mor vendimi në çështjen *Soering*. Shfuqizimi *de facto* që vërehet në atë çështje në lidhje me njëzet e dy Shtete Kontraktuese në vitin 1989 është zhvilluar në një shfuqizim *de jure* në dyzet e tre, nga të dyzet e katër Shtetet Kontraktuese dhe në një moratorium në Shtetin që ende nuk e ka shfuqizuar dënimin, përkatësisht Rusia. Ky gati abandonim i plotë i dënimit me vdekje në kohë paqeje në Evropë pasqyrohet në faktin se të gjitha Shtetet Kontraktuese e kanë nënshkruar Protokollin Nr.6 dhe dyzet e një Shtete e kanë ratifikuar atë, që do të thotë të gjitha, përveç Turqisë, Armenisë dhe Rusisë. Kjo pasqyrohet më tej në politikën e Këshillit të Evropës që u kërkon Shteteve të reja anëtare të Këshillit të Evropës të shfuqizojnë dënimin kapital, si kusht për t'u pranuar në organizatë. Si rezultat i këtyre zhvillimeve, territoret që mbulohen nga Shtetet anëtare të Këshillit të Evropës janë bërë një zonë e tërë ku nuk jepet dënimi kapital. (Korff, 2006:97).

Një çështje e cila diskutohet kohët e fundit lidhur me dënimin me vdekje është lidhja me kriminalitetin. Statistika dhe të dhëna prej vendeve që e kanë hequr dënimin me vdekje vazhdimisht provojnë se nuk ekziston asnjë lidhje ndërmjet dënimit me vdekje dhe shkallës së kriminalitetit. Megjithatë është një fakt i mirënjohur se nuk ekziston asnjë provë statistikore për t'a provuar këtë. Kjo pikëpamje e ndeshur shpesh është një mit. Studime pas studimesh në vende të ndryshme nuk kanë arritur të tregojnë një lidhje shkakësore ndërmjet ruajtjes apo heqjes së dënimit me vdekje dhe shkallës ose vëllimit të krimeve të dhunshme. Një studim i zgjeruar i kryer për Komitetin mbi Parandalimin e Krimeve të Kombeve të Bashkuara më 1988 dhe i azhornuar më 1996, i cili shqyrtoi sasinë e madhe të studimeve lidhur me marrëdhënien ndërmjet ndryshimeve në përdorimin e

dënimit me vdekje dhe shkallës së kriminalitetit, arriti në përfundimin se “*ky studim nuk ka arritur të sigurojë provë shkencore se ekzekutimet me vdekje kanë një efekt parandalues më të madh sesa burgimi. Dhe nuk ka të ngjarë që një provë e tillë të gjendet së afërmi. Provat në përgjithësi ende nuk japin ndonjë mbështetje pozitive për hipotezën e parandalimit*”⁵⁷.

3.4.1. Dënimi me vdekje dhe ekstradimi

Gjykata në lidhje me “*ekstradimin, përjashtimin dhe dëbimin*”, u shpreh për herë të parë në çështjen e *Soering*, të vitit 1989, ku për shkak të kuptimit të qartë të fjalisë së dytë të paragrafit të parë të Nenit 2, ajo nuk mund të vendoste se ekstradimi në një vend ku kërkuesi mund të përballët me dënimin me vdekje, ishte një shkelje e atij neni (megjithëse u shpreh në atë çështje se “fenomeni i pritjes së vdekjes në radhë” në lidhje me atë dënim në Shtetin e Virxhinias të Shteteve të Bashkuara përbënte trajtim çnjerëzor dhe poshtërues, duke e ndaluar kështu ekstradimin në baza të tjera.

⁵⁷ Në Kanada, për shembull, numri i vrasjeve në një popullsi prej 100 000 personash ra prej kulmit prej 3.09 më 1975, viti përpara heqjes së dënimit me vdekje për krimin e vrasjes, në 2.41 më 1980 dhe që atëherë është ulur edhe më tej. Më 1999, 23 vjet pas heqjes, numri i vrasjeve ishte 1.76 në një popullsi prej 100 000 personash, 44.7% më i ulët se më 1975. Numri i përgjithshëm i vrasjeve të njoftuara në vend u ul më 1999 për të tretin vit rresht. Vendet në tranzicion nuk bëjnë përjashtim. Në Lituani, asnjë kriminel nuk është ekzekutuar që më 1996 dhe numri i vrasjeve është pakësuar në mënyrë graduale. Në Gjeorgji dënimi me vdekje u hoq në nëntor 1997 dhe që atëherë ka patur një rënie të jashtëzakonshme në numrin e vrasjeve me paramendim. Rezultatet nga Shtetet e Bashkuara, ku përdorimi i dënimit me vdekje ndryshon nga shteti në shtet, tregojnë brenda kontekstit të një vendi të vetëm mungesën e rëndësisë së dënimit me vdekje në parandalimin e krimit. “Shtetet që kanë liogje të dënimit me vdekje nuk kanë shkallë më të ulta krimesh apo vrasjesh sesa shtetet pa ligje të tilla. Dhe shtetet që e kanë hequr dënimin apo e kanë rivendosur atë, nuk tregojnë ndryshime të dukshme në shkallën e krimeve apo të vrasjeve. Pretendimi se dënimi me vdekje parandalon krimin presupozon se ata që kryejnë vrasje dhe krime të tjera të rënda llogaritin paraprakisht me logjikë kostot dhe përfitimet e veprimeve të tyre, duke përfshirë në llogaritje edhe mundësinë e vrasjes së tyre. Ky presupozim mbështetet në një përshkrim krejtësisht të rremë të autorëve të krimit dhe të kushteve në të cilat ata kryejnë krimet që ndëshkohen me vdekje. Shumica e krimeve të rënda kryhen në zjarrin e momentit, në çaste të stresit të madh emocional ose nën ndikimin e drogës apo alkoolit në një kohë kur mendimi logjik gjithashtu kryhen prej individëve shumë të paekuilibruar apo të paafte mendërisht. Në asnjë prej këtyre situatave autorët e krimeve nuk e llogaritin ndëshkimin me të cilin mund të përballen nëse kapen.

Kjo do të thotë se parimi i zbatueshëm për ekstradimet që mund t'i ekspozojë individët ndaj një trajtimi që bie në kundërshtim me Nenet 2 dhe 3 në një Shtet që nuk është Palë e Konventës, zbatohet tashmë edhe për ekstradimet që mund ta ekspozojnë një individ ndaj dënimit me vdekje në kohe paqeje. Nëse ekzistojnë “motive substantive” për të besuar se ka një “rrezik real” se një person që do të ekstradohet në një Shtet që nuk është Palë, do të akuzohet në atë vend me ndëshkimin kapital dhe, nëse dënohet, do të ndëshkohet me vdekje dhe do të ekzekutohet, Shtetit ekstradues do t'i kërkohet të marrë siguri të qartë e detyruese nga Shteti pritës që personi nuk do të dënohet, apo të paktën, nëse merr një dënim të tillë, dënimi nuk do të ekzekutohet. Dhënia e një sigurimi të paqartë me efektin që autoritetet gjyqësore do t'i bejnë të ditur gjykatës se do ta gjykojnë personin, për të cilin Shteti ekstradues do të preferonte që të mos imponohej apo të mos ekzekutohej vendimi me vdekje (sigurim i tillë që u ofrua nga autoritetet gjyqësore të Virxhinias në çështjen *Soering*), është qartësisht i pamjaftueshëm. Ekstradimi i personit pa marrë një siguri të tillë do të përbëjë shkelje të Konventës.

3.4.2. Çështja Rrapo kundër Shqipërisë

Në këtë pikë ka rëndësi të analizojmë nga afër të vetmen çështje që ka të bëjë me te drejtën e jetës, pra nenin 2 KEDNJ, kundër Shqipërisë e cila lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me rastet e dëbimit apo ekstradimit të një individi, shtetas shqiptar, ku si pasojë mund të rezultonte vdekja e tij, edhe pse kjo është trajtuar së bashku me nenin 3 për mbrojtje nga trajtimi çnjerëzor dhe degradues⁵⁸. Bëhet fjalë për çështjen “*Rrapo kundër Shqipërisë*” e datës 25 shtator 2012. Çështja nisi me një aplikim kundër Republikës së Shqipërisë nga një shtetas shqiptar dhe amerikan, Z. Almir Rrapo më 11 Tetor 2010. Ankuesi pretendonte se kishte ndodhur një shkelje e Neneve 2 dhe 3 të Konventës si rezultat i ekstradimit të tij në Shtetet e Bashkuara të Amerikës pasi atje do të dënohej me dënimin kapital për tetë vepra penale të kryera në këtë vend. Më 2 Korrik 2010, ankuesi bëri kërkesë pranë Ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Tiranë për rinovim të pasaportës së tij amerikane. Në pasditen e po të njëjtës ditë ai u arrestua nga policia shqiptare me kërkesë të Ambasadës

⁵⁸Aplikimi nr. 58555/10.

së Shteteve të Bashkuara. Në po të njëjtën ditë, Ambasada e Shteteve të Bashkuara dërgoi shënimin diplomatik nr. 55, me anë të të cilit kërkonte arrestimin paraprak të ankuesit, me qëllim ekstradimin e tij në përputhje me Nenin XI të Traktatit të Ekstradimit. Sipas shënimit diplomatik, më 28 Maj 2010, nga një Gjykatë e Shteteve të Bashkuara ishte lëshuar një urdhër arresti për ankuesin. Prokurori kërkoi konfirmimin e ndalimit paraprak të ankuesit me synim ekstradimin e tij drejt Shteteve të Bashkuara. Në rastin konkret, ankuesi u arrestua me synimin për t'u ekstraduar në Shtetet e Bashkuara. Më 30 Gusht 2010, autoritetet e Shteteve të Bashkuara kërkuan në mënyrë zyrtare ekstradimin e tij, intera lia, mbi një akuzë kapitale. Më 30 Shtator 2010 dhe 1 Nëntor 2010, Gjykata e Rrethit dhe Gjykata e Apelit respektivisht, morën vendimin në favor të ekstradimit të ankuesit. *Është për të ardhur keq që gjykatat e ulta ranë dakort që të lejonin ekstradimin e ankuesit pa ekzaminuar mundësinë e rrezikut të pretenduar nga ai. Është shokues fakti se gjykatat e ulta nuk kërkuan kurrë siguri nga Qeveria që bënte kërkesën, se dënimi me vdekje nuk do të jepej nëse ankuesi dënohej* (shiko paragrafët 13 dhe 16 të vendimit). Kjo problematikë u ngrit si çështje gjatë procedurave përpara Gjykatës së Lartë, fazë në të cilën, me keqardhje, ankuesi ishte ekstraduar. Në lidhje me këtë situatë, Gjykata kujton se Protokolli Nr. 13, i cili në Shqipëri hyri në fuqi më 1 Qershor 2007, së bashku me detyrimet e Shtetit përgjegjës bazuar në Nenet 1, 2 dhe 3 të Konventës, pohonte se, për çfarëdo arsye, ai nuk do t'i ndalonte individët me synimin për t'i ekstraduar ata dhe më pas të gjykoreshin me dënim kapital. Gjithshtu, Shteti përgjegjës brenda juridiksionit të tij, nuk duhet t'i bënte në asnjë mënyrë individët subjekt të një rreziku real për t'u dënuar me dënim me vdekje dhe më pas të ekzekutoheshin nëse nuk kërkoheshin dhe ofrohej siguri e mjaftueshme dhe e detyrueshme nga autoritetet përgjegjëse të Shtetit që bënte kërkesën. Gjykata nuk gjeti asnjë fakt në materialet e paraqitura përpara saj që mund të ngjallë dyshime mbi sigurinë që dënimi kapital nuk do të kërkohet apo të ushtrohet mbi ankuesin nga Shteti i cili ka paraqitur kërkesën. Siguria e dhënë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës ishte specifike, e qartë dhe aspak ekuivoke. Siç u konfirmua më vonë në një tjetër shënim diplomatik të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara, më 24 Shkurt 2001, "kjo siguri është e detyrueshme për Departamentin e Drejtësisë së Shteteve të Bashkuara". Më tej, Gjykata duhet t'i japë rëndësi faktit se nën kontekstin e një kërkesë për ekstradim, asnjëherë nuk janë raportuar

shkelje të sigurisë së dhënë nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara kundrejt një Shteti Kontraktues. Vetëm interesi afatgjatë i Shteteve të Bashkuara për të respektuar angazhimet e veta mbi ekstradimet do të ishte i mjaftueshëm për të dhënë mirëbesimin dhe heqjen e çdo dyshimi për mundësinë e rrezikut që kjo siguri të shkelej. Së fundmi, siç evidentohet edhe nga procesverbali i datës 19 Korrik 2011, në të cilin ankuesi pranon fajësinë ndaj akuzave, Shtetet e Bashkuara nuk kanë përmendur asnjë rrezik që mund të përballë ankuesin me dënimin me vdekje. Nën rrethanat e paraqitura më sipër, Gjykata mendon se ekstradimi i ankuesit në Shtetet e Bashkuara nuk përbënte shkelje të Neneve 2 dhe 3 të Konventës dhe të Nenit 1 të Protokollit Nr. 13 për sa ka të bëjë me rrezikun për ushtrimin e dënimit me vdekje.

3.4.3. Çështja e dënimit me vdekje në Shqipëri

Dënimi me vdekje është një shkelje e hapur e së drejtës për jetën të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe e së drejtës për të mos iu nënshtruar trajtimit mizor, çnjerëzor dhe poshtërues. Një politikë penale humane dhe morale bën dallim ndërmjet kriminelit dhe kriminit dhe kjo është e vetmja politikë me vlerë për një shoqëri demokratike. Dënimi me vdekje shkel të drejtat themelore të njeriut. Si traktatet europiane ashtu edhe ndërkombëtare parashikojnë heqjen e dënimit me vdekje në kohë paqeje dhe madje në kohë lufte. Në nivel ndërkombëtar, Protokollin i Dytë Fakultativ të Konventës për të Drejtat Civile dhe Politike parashikon heqjen e plotë të dënimit me vdekje. Protokollin Nr. 6 të KEDNJ i trupëzon qartë standardet europiane, duke parashikuar heqjen e dënimit me vdekje në kohë paqeje.

Dënimi, përveç shpagimit ka patur si qëllim edhe frikësimin e popullit, kështu që dënimi me vdekje ishte mjaft i shpeshtë dhe në të gjithë kodet penale të shteteve, ashtu sikurse edhe në Shqipëri, dënimi me vdekje aplikohet. Në Shqipëri në vitin 1951 u miratua Kodi Penal ku dënimi me vdekje parashikohej në 31 nene, sidomos për krime kundër shtetit, kundër pasurisë, kundër jetës, etj. Kjo tregonte për ashpërsinë e sanksioneve penale në legjislacionin penal të shtetit totalitar. Ky kod veprroi për rreth 25 vjet dhe në bazë të tij u dënuan me vdekje shumë njerëz, ndërmjet të cilëve edhe te pafajshëm. Për të plotësuar

më mirë kërkesat e shtetit totalitar më 1 tetor 1977, hyri në fuqi kodi i ri. Dënimi me vdekje nuk jepej kundër personave që në kohën e kryerjes së krimit nuk kishin mbushur moshën 18 vjeç, si dhe kundër grave që në kohën e kryerjes së krimit ose të gjyqimit, ishin shtatëzëna.

Në bazë të këtij kodi u dënuan me vdekje në proçeset gjyqësore të viteve 80-të, mjaft persona të akuzuar për krime kundër shtetit. Me gjithë ashpërsimin e sanksioneve penale, vrasjet për hakmarrje e gjakmarrje në vitet 1945-1990 zinin 17%, kurse pas viteve 50-të e sidomos 60-të, shkonin drejt uljes aq sa në vitet 1951-1955-13.5%, nga viti 1965-1989-asnjë. Shndërrimet e thella politike, sociale-ekonomike që u bënë pas përmbykses së shtetit totalitar, nga lëvizja studentore e viteve 90-të dhe reformat në drejtësi, diktuan nevojën e një kodi penal të ri që t'i përgjigjej kërkesave të demokracisë pluraliste. Në vitet 90-të, me ardhjen e demokracisë reformat në drejtësi diktuan nevojën e një kodi penal të ri që t'i përgjigjej kërkesave të demokracisë pluraliste.

Me ndryshimet që iu bënë kodit penal me ligjin Nr.7769, datë 16.11.1993, u hoq dënimi me vdekje për krimet e parashikuara nga nenet 51, 52, 58, 60- a, 62 dhe 101 paragrafi i dytë, duke e reduktuar dënimin me vdekje. Me ligjin Nr.7895 datë 27.1.1995 u miratua kodi penal i ri, i cili hyri në fuqi më 1 qershor 1995, bazuar në parime demokratike. Pjesa e përgjithshme, parashikon dënimin me vdekje, bashkë me burgimin e përjetshëm, si dënim alternativ. Pjesa e posaçme e parashikon në 13 raste dënimin me vdekje krahas burgimit të përjetshëm. Pakësimi i dënimit me vdekje në krahasim me kodet penale të shtetit totalitar, është shprehje e demokratizimit të tij. Me Ligjin Nr.7959, datë 11.07.1995, Kuvendi vendosi aderimin e R.Sh., në Statutin e Këshillit të Europës dhe anëtarësimin e saj me të drejta të plota përfaqësimi. Mbi bazën e këtyre angazhimeve ndërkombëtare dhe brenda afateve të përcaktuara, R.Sh., nënshkroi e ratifikoi Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe disa prej protokolleve të saj, si dhe përmbushi mjaft detyrime të tjera të vendosura nga Asambleja Parlamentare dhe Komiteti i Ministrave pranë Këshillit të Evropës.

Shqipëria gjithashtu zbatoi me korrektësi për tre vjet, moratoriumin mbi ekzekutimet e dënimeve me vdekje, pasi nga viti 1995 nuk u ekzekutua asnjë person, ndaj të cilit ishte aplikuar ky lloj dënimi. Në vitet 1996-1999 (6 muji i parë), nga gjykatat

shqiptare u dënuan me vdekje 17 persona, për krime të rënda, por nga këta të dënuar nuk është ekzekutuar asnjë. Periudha e moratoriumit, natyrisht ishte e domosdoshme në Shqipëri, në mënyrë që të përgatitej opinionin publik, shoqëria shqiptare dhe klasa politike në shqyrtimin dhe marrjen e një vendimi të pjekur dhe të drejtë. Nëpërmjet referendumit popullor të 22 nëntorit 1998 dhe miratimit në Kuvend, Kushtetuta e R.Sh., ishte dokumenti i parë thellësisht demokratik dhe mishërim i akteve dhe konventave ndërkombëtare, që mbrojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Megjithatë Kushtetuta as e lejon, as e ndalon shprehimisht dënimin me vdekje, neni 21 i saj sanksionon se jeta e personit mbrohet me ligj. Në këtë mënyrë, Kushtetuta ia la këtë çështje për zgjidhje, legjislacionit të ardhshëm dhe vendimeve gjyqësore. Kjo gjendje vazhdoi derisa Gjykata Kushtetuese me Vendim Nr.65 datë 10.12.1999 shpalli si antikushtetues dënimin me vdekje në kohë paqe që parashikohej në K.P., dhe K.P.U., me anë të të cilit lehtësoi e shpejtoi pozicionimin e vetë organit legjislativ, Kuvendit të R.Sh., për të bërë rregullimet përkatëse në K.P., dhe K.P.U., si dhe ratifikimin e Protokollit Nr.6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, në nenin 1.

Në fakt, është i njohur nga të gjithë vendimi nr. 65 datë 10.12.1999 i Gjykatës, me të cilin ajo deklaroi si të papajtueshëm me Kushtetutën dënimin me vdekje në kohë paqeje, që parashikohej në dispozitat e Kodit Penal. GJK arsyeton në vendim, se dënimi me vdekje, “... i analizuar sipas frymës së Kushtetutës dhe të KEDNJ, është i papajtueshëm me thelbin e këtyre të drejtave dhe lirive. Ai është mohim i të drejtës për jetën dhe përbën në vetvete një dënim çnjerëzor e mizor, që shteti e realizon me anë të pushtetit gjyqësor të tij. Dënimi kapital nuk ka të bëjë me kufizimin, por me eliminimin përfundimisht të subjektit nga shoqëria.” Mbështetur në nenin 17, pika 2 të Kushtetutës, që nuk lejon për asnjë rast, kufizime të lirive dhe të drejtave të njeriut që mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në KEDNJ, GJK arriti në përfundimin, se dënimi me vdekje përbënte tejkalim të frymës së Kushtetutës dhe KEDNJ. Ka qenë ky, vendimi që i hapi rrugën procedurave të ratifikimit të Protokollit shtesë nr. 6 të KEDNJ, gjë të cilën Shqipëria ishte angazhuar ta realizonte brenda një afati trevjeçar pas nënshkrimit të saj. Deklarimi antikushtetues i dënimit me vdekje ishte, ndër të tjera, një konfirmim i vendosmërisë për të vënë në jetë KEDNJ. Për të

arritur në këtë përfundim, GJK u mbështet edhe në jurisprudencën e gjykatave kushtetuese të vendeve të tjera.

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese, shfuqizoi si antikushtetuese të gjitha dispozitat në Kodin Penal dhe Kodin Penal Ushtarak që përmbanin dënimin me vdekje në kohë paqeje. Ky vendim ishte një arritje në fushën e të drejtave të njeriut dhe riafirmonte frymën demokratike të Kushtetutës dhe të zbatimit të detyrimeve ndërkombëtare, referuar Protokollit 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore. Shfuqizimi i dënimit me vdekje nga dispozitat penale ushtarake, për krime të kryera në gjendje lufte apo gjendje të jashtëzakonshme. Në përmbushje të angazhimeve ndërkombëtare, Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar Ligjin Nr.9639 date 09.11.2006 'Për ratifikimin e Protokollit Nr.13 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore për heqjen e dënimit me vdekje në të gjitha rrethanat', në përmbajtje të së cilës, përcaktohet shprehimisht detyrimi i shteteve palë nënshkruese për të shfuqizuar dënimin me vdekje në të gjitha dispozitat ligjore kombëtare, madje edhe për ato raste që parashikojnë këtë dënim në gjendje lufte apo gjendje të jashtëzakonshme. Me botimin e këtij ligji në Fletoren Zyrtare Nr.127 datë 06.12.2006, heqja e dënimit me vdekje nga dispozitat e Kodit Penal Ushtarak, parashikuar në gjendje lufte apo gjendje të jashtëzakonshme, ishte një detyrim kushtetues.

Në këtë kuadër, institucioni i Avokatit të Popullit në zbatim të detyrimit kushtetues dhe ligjor, në shkurt të vitit 2007, i ka rekomanduar Kuvendit dhe Qeverisë së R.Sh., marrjen e nismës ligjore për të shfuqizuar Nenet 7/1, 8/a, 25, 26, 28, 34, 47 dhe 77 të Ligjit Nr.8003 datë 28.09.1995 ndryshuar me Ligjin Nr.8919 dt.04.07.2002 Kodi Penal Ushtarak. Nga institucionet përkatëse u mor iniciativa ligjore dhe me ligjin Nr.9722, datë 30.4.2007, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ndryshimet përkatëse të ligjit nr.8003, datë 28.9.1995 Kodi Penal Ushtarak i R.Sh., i ndryshuar, me anë të të cilave shfuqizonte dënimin me vdekje nga dispozitat e K.P.U., parashikuar në gjendje lufte apo gjendje të jashtëzakonshme, duke shënuar një progres në legjislacionin penal për heqjen e dënimit me vdekje në Shqipëri, në të gjitha rrethanat.

KAPITULLI IV: E DREJTA E JETËS: ÇËSHTJA E FETUSIT DHE ABORTIT

4.1. Vështrimi i përgjithshëm mbi konceptet e jetës dhe të abortit

Ende sot komuniteti shkencor dhe ai mjekësor nuk kanë arritur të na ofrojnë një përcaktim të saktë në lidhje me momentin e fillimit të jetës. Konsensusi është gjetur vetëm në lidhje me fazat e progresit të shtatëzënisë së gruas. Koncepti i “*të qenurit shtatzënë*” nuk është term shkencor, por është një term informal i cili i referohet procesit të fertilizimit.⁵⁹ Studime të ndryshme me karakter mjekësor kanë vërtetuar se një numër i konsiderueshëm shtatëzanish përfundojnë në aborte të padëshirueshme. (Scott,1997:827) Për rrjedhojë, do të ishte e drejtë që të shtrohet pyetja se kur i lind e drejta fetusit për të jetuar. Cilat janë disa nga problematikat e kësaj çështje në vendin tonë?

Çështjet që lidhen me të drejtat që gëzon fetusit kanë bërë që të ngrihen debate dhe diskutime të shumta me lejimin apo moslejimin e abortit, pra ndërprerjen e shtatëzanisë. Si i është përgjigjur GJEDNJ-ja këtyre problematikave?

Kuptimi që shkenca mjekësore ka për abortin është “*dhënia fund para kohe dhe shkatërrimi i fetusit të shtatëzanisë, i cili nuk është akoma i aftë për të jetuar jashtë trupit të nënës, gjatë 28 javëve të para. Dhënia fund e shtatëzënisë pas 28 javëve quhet lindje e parakohshme*”. (Nosi,1953:33) Kuptimi mjekësor i abortit është ngritur mbi konceptet bazë mjekësore që lidhen me procesin e evoluimit të shtatëzanisë. Koncepti juridik i abortit është: “*ndërprerja e qëllimshme e procesit fiziologjik të shtatëzanisë me pasojë vdekjen e fetusit*”.

⁵⁹Who's Right to Life - Women's Rights and Prenatal Protections under Human Rights and Comparative Law, http://reproductiverights.org/sites/crr.civicactions.net/files/documents/RTL_3%2014%2012.pdf , sipas të cilës thuhet se Fertilizimi ndodh kur një spermë e vetme penetron vezën për të formuar një zigotë. Pas fertilizimit zigota udhëton përmes tubit fallopian të femrës dhe fillon të ndahet për të krijuar qeliza, duke u shndërruar në një blastocist ose paraembrion. Blastocisti ose paraembrioni arrijnë mitrën pak a shumë pesë ditë pas fertilizimit. Përafërsisht tre javë pas fertilizimit, blastocisti apo paraembrioni i vendosur në mitër është zhvilluar mjaftueshëm për t'u konsideruar një embrion. Embrioni zhvillohet në një fetus rreth fundit të javës së tetë deri në fundin e javës së dhjetë.

Shpesh herë termat ndërprerje e shtatëzani së dhe abort përdoren si sinonim të njëra-tjetrës; por diferenca qëndron pikërisht në faktin se koncepti i parë nënkupton vdekjen e fetusit, edhe pse kuptimi gramatikor i tij lejon një interpretim më të gjerë deri në rastin e shkaktimit të lindjes së parakohshme. Aborti në legjisllacione të ndryshme ka pasur rregullime të ndryshme ligjore, duke u nisur nga Kodi i Hamurabit i cili e konsideronte si faj kryerjen e abortit. Në Romë ku fenomeni i abortit ishte përhapur më shumë, fetusi nuk mbrohej nga e drejta romake sepse konsiderohej si pjesë e pandarë e trupit të nënës.

Më vonë jeta e fetusit filloj të merrej në mbrojtje nga legjisllacionet e mëvonshme duke filluar nga Kodi i Justinianit i cili parashikonte dënime për abortin. Problemi i abortit në disa vende është lidhur dhe me pikëpamjen, sipas së cilës, fetusi do të konsiderohej një qenie e gjallë, vetëm kur ai do të kishte shpirt kështu në Greqinë e vjetër, sipas Hipokratit, fetusi bëhej me shpirt në muajin e tretë të shtatëzani së, ndërsa sipas Platonit dhe Aristotelit, vetëm pas lindjes.

Periudha e mesjetës ofroi një nivel më të lartë mbrojtjeje ndaj abortit, sepse në të drejtën kanonike, të drejtën franceze, të drejtën gjermane dhe angleze gjatë kësaj periudhe aborti barazohej me vrasjen dhe për këtë arsye këto të drejta parashikonin dënime të rënda deri në vdekje. Kjo tendencë pësoi një ulje nga fundi i shekullit të XVIII dhe në fillimet e shekullit të XIX, sepse u shoqërua me kundërshtime në radhët e dijetarëve dhe juristëve, duke sjellë një farë zbutje në dënimet.

4.2. Debati bashkëkohor mbi momentin e fillimit të jetës

Kur flasim për të drejtën e jetës lindin pyetje si, a është koncepti i jetës absolut, çka do të thotë se fillon jeta pas një momenti të caktuar, apo është një koncept gradual -ku fetusi konsiderohet gradualisht në jetë me zhvillimin e tij? (Viljoen, 2004:3014) A nënkuptohet edhe fetusi kur flitet për personin? Gjykata e Strasburgut ka vlerësuar se përgjigja e pyetjes se kur fillon jeta duhet të interpretohet dhe të gjejë rregullim në të drejtën e brendshme të shteteve për shkak se së pari, ky problem nuk ka gjetur ende një përgjigje në shumicën e shteteve që kanë ratifikuar Konventën, dhe së dyti, sepse nuk ka

një konsensus në nivel evropian në lidhje me përkufizimin shkencor dhe ligjor të fillimit të jetës.⁶⁰

Konventa nuk e qartëson se çfarë është “jeta”, ose kur dhe ku fillon apo mbaron mbrojtja e Nenit 2 të Konventës. Në fakt, në mungesë të një kompromisi evropian (apo mbarë botëror) ligjor apo shkencor në lidhje me çështjen, Komisioni, gjatë kohës kur ende ekzistonte, dhe madje edhe Gjykata tani, nuk ka vullnetin për të vendosur standarde të sakta në këtë kuadër. Nga ana tjetër Gjykata e Strasburgut u shpreh se nuk ka një interpretim në lidhje me çështjen nëse një fëmije që nuk ka lindur ende mund të konsiderohet një person për qëllimet e nenit 2 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. (Korff, 2006:10)

Siç e përcaktoi edhe Gjykata në çështjen e *Vo kundër Francës*: ... çështja se kur fillon e drejta për jetën i përket hapësirës së vlerësimit që Gjykata zakonisht konsideron se, Shtetet duhet të gëzojnë në këtë sferë, pavarësisht nga interpretimi i Konventës, një “instrument jetik që duhet të interpretohet në dritën e kushteve të ditëve të sotme” (...). Arsyet për këtë përfundim së pari, janë se çështja për një mbrojtje të tillë nuk është zgjidhur brenda shumicës së vetë Shteteve Kontraktuese, veçanërisht në Francë, e cila është bërë subjekt debati dhe së dyti, se nuk ka një kompromis evropian mbi përkufizimin shkencor dhe ligjor të fillimit të jetës. ... Pra, Gjykata është e bindur se asnjë nga këto janë të pranueshme, dhe madje as nuk ka mundësi, përse i përket kësaj çështjeje, që të jepet një përgjigje në mënyrë abstrakte mbi pyetjen nëse fëmija i palindur është person për qëllime të Nenit 2 të Konventës.

Shtrohet pyetja kur një fetus mund të “fitojë” të drejtën e jetës? Kjo pyetje i ndan juristët në dy kampe; ata që janë në favor të abortit shpesh e drejtojnë debatin mbi çështjen se fetus i merr jetë në momentin kur lind. Kundërshtarët e konsiderojnë fetusin njeri që nga ngjizja, dhe e drejta e jetës sipas tyre nis që nga ky moment. Momenti i fillimit të jetës është një pikë kyçe në debat për ata që janë përfshirë në hartimin e ligjeve që rregullojnë abortin. Ende nuk ka ndonjë marrëveshje në lidhje me momentin e fillimit të jetës në asnjë nga shkencat që studiojnë këtë fushë si: mjekësia, filozofia apo teologjia për të përcaktuar pikërisht fazën e zhvillimit të fetusit në të cilën ai do të mbrohet nga e drejta e jetës.

⁶⁰ Çështja *Vo kundër Francës*, aplikim nr.53924/00.

Duke iu referuar fazave të zhvillimit të fetusit për të dhënë një vështrim të konceptimit të jetës dallojmë:

Ngjizjen: disa studjues dhe, në veçanti, Kisha Katolike thekson se embrioni duhet të trajtohet si një person nga konceptimi dhe kështu kundërshton abortin. Momenti i ngjizjes është një pikë krejtësisht logjike për t'u zgjedhur si fillimi i jetës njerëzore. Në këtë pikë embrioni përmban kodin gjenetik të plotë dhe ka filluar të zhvillohet si një qenie njerëzore e veçantë dhe unike. (Barzelatto, 2005:15)

Zënia vend e vezës së fekunduar në mitër: ky është momenti kur veza e fekunduar është futur në mitër. Kjo ndodh rreth një javë pas konceptimit. Kjo pikë është e lehtë për të identifikuar por kjo pikë është po aq arbitrare si çdo pikë tjetër.

"Gjallërimi": kjo është kur fetusit lëviz për herë të parë në barkun e nënës. Kjo ndodh rreth 16-17 javë pas ngjizjes. Kjo ide rrjedh nga një teori e braktisur e krishterë se ky ishte momenti që fetusit merr shpirtin e tij. Për shembull, Shën Augustini bëri një dallim midis embrionit *inanimatus*, i papajisur ende me një shpirt, dhe embrionit *animatus*, i pajisur me një shpirt. Aristoteli nxori teorinë e tij me tre faza të jetës: bimore, shtazore, racionale. Faza e jetës bimore arrihet që në konceptim, kafsha në "*animacion*", dhe qenia racionale pas lindjes gjallë.

Ndarja e indit: kjo është koha kur indet e fetusit janë ndarë në lloje të ndryshme sipas funksionit të organeve dhe mbulon një periudhë të gjatë kohore. Kjo lloj teorie ind-ndarjeje nuk duket të ketë ndonjë status të qartë moral - kështu që zgjedhja e kësaj si datë kyçe është ndoshta për shkak se paraqitja gjithnjë e më njerëzore e fetusit shkakton ndjenjën gjithnjë e më të mbrojtjes të fetusit. (Wesley, 1997:15).

Fillimi i Aktivitetit të trurit: disa besojnë se jeta fillon me shenjë e parë të aktivitetit të trurit. Kjo është një pikë logjike, pasi ajo shënon një nga kushtet e nevojshme për të qenë i gjallë. Por, aktiviteti i trurit në këtë fazë nuk është më shumë se një kusht - kjo nuk tregon se fetusit është në fakt i vetëdijshëm. (Valient, 1996:25)

Qëndrueshmëria e fetusit: disa studiues janë të mendimit se jeta fillon në fazën kur fetusit mund të mbijetojë jashtë mitrës. Ky është kriteri më i zakonshëm i përdorur në hartimin e ligjeve që rregullojnë abortin. Nëse një fetus mund të mbijetojë jashtë mitrës varet nga:

- gjendja e shkencës mjekësore

- objektet mjekësore në dispozicion në një vend të caktuar
- kompetenca apo gadishmëria e nënës.(Bamgbose, 2004:48)

Lindja: kjo në fakt, duket të jetë një datë e qartë dhe e kuptueshme, por edhe këtu ka mosmarrëveshje në pikën kur një fëmijë është i lindur. A është i tillë:

- kur një pjesë e foshnjës është jashtë trupit të nënës?
- kur e tërë fëmija është jashtë trupit të nënës?
- apo kur fetusit duhet të mbështetet në burimet e veta për t'u mbajtur gjallë?

Disa njerëz mendojnë se është absurde se e drejta e një qenie për jetën duhet të varet nga fakti nëse një qenie është e vendosur brenda ose jashtë mitrës. (Almagor, 2009:25) Pra, siç e pamë, ka vështirësi në zgjedhjen e një pikë të saktë kur fetusit merr të drejtën për të jetuar për këtë arsye do të ishte më e drejtë të pranohet se fetusit e zhvillon apo e fiton të drejtën e jetës në mënyrë graduale.

Në lidhje me këtë çështje, në kuadër të rendit juridik në shqyrtim, Komisioni dhe Gjykata në vend që të impononin një standard uniform, kanë vlerësuar dhe po vazhdojnë të vlerësojnë çështjet në lidhje me fillimin e jetës vetëm për ato detyrësore, duke trajtuar çështjet një nga një, ndërsa u lënë liri të konsiderueshme Shteteve për të rregulluar vetë problemet në fjalë, përsa kohë që ata i trajtojnë ato në mënyrën e duhur, në veçanti duke i dhënë peshën e duhur interesave të ndryshme që janë në rrezik dhe duke i dhënë ekuilibrin e duhur atyre interesave. Kjo mund të vihet re nga jurisprudenca e organeve të Konventës në lidhje me ndërprerjen e induktuar të shtatëzanisë. Nga pikëpamja sociale dhe morale sa më shumë i zhvilluar të jetë fetusit, aq më shumë i vështirë është aborti dhe më shumë peshë i jepen të drejtave të fetusit në krahasim me të drejtat e nënës.

4.2.1. E drejta për të mos lindur (veçse i shëndetshëm)

Kohët e fundit lidhur me të drejtën e jetës është konfiguruar në disa shtete të Europës e drejta e fetusit për të lindur veçse i shëndetshëm. Në fakt, jo rrallë herë gjatë shtatëzanisë mjekët kanë konstatuar se embrioni është në pamundësi për të bërë një jetë të shëndetshme pas lindjes, kjo për faktin që mund të jetë i prekur nga sëmundje të

pashërueshme. Këto sëmundje pasi konstatohen duhet t'i komunikohen nënës e cila ka të drejtën për të vendosur në lidhje me vijimësinë apo për ndërprerjen e shtatëzanisë. Mosrespektimi i detyrimit të mjekut për informim në një rast të tillë, pengon ushtrimin e të drejtës së gruas për të zgjedhur nëse do të vazhdojë shtatzëninë apo do ta ndërpresë sipas mënyrës së parashikuar në ligj. (Scott, 1997:827) Në rastin e një fëmije me talasemi, sëmundje kjo e diagnostikuar nga mjeku që ndjek shtatzëninë e gruas, gruaja duhet të informohet për ekzistencën e kësaj sëmundjeje që të mund të vendosë nëse do të vazhdojë shtatëzaninë në këto kushte apo jo.

Gjykata e Lartë Franceze, në vendimin e famshëm *Perruche* të datës. 28.11.2001 vendosi se *“Përsa i përket gabimeve të kryera nga mjeku apo laboratorit mjekësor në ekzekutim të kontratës së kujdesit mjekësor me gruan shtatëzënë, cënimi i të drejtës së saj për të zgjedhur ndërprerjen e shtatëzanisë, me qëllim evitimin e lindjes së një fëmije me keqformime të rënda, e legjitimon për të kërkuar shpërblimin e dëmit të verifikuar në keqformimet e fëmijës.”* Ky vendim i Gjykatës së Lartë franceze së bashku me vendimin e Gjykatës së Lartë Italiane⁶¹, hapi debatin mbi të drejtën për të lindur veçse i shëndetshëm.

Ligjvënësi pas këtij qëndrimi të Gjykatës së Lartë ndërhyri duke parashikuar disa ndryshime esenciale në lidhje me këtë çështje. Kështu nuk mund të kërkohej shpërblimi i dëmit për fëmijën e lindur me keqformime nga mjeku pasi gjendja e tij nuk është provokuar apo rënduar nga gabimet e mjekut, por u legjitimua kërkesa e dëmshpërblimit nëse nëna nuk ishte informuar për shkaqet e keqformimit, me qëllim që të vendoste në lidhje me vijimësinë e shtatëzanisë. Më vonë, praktika gjyqësore italiane bëri disa ndryshime duke mosnjohur të drejtën për të lindur veçse i shëndetshëm dhe mospranimin e kërkesës për dëmshpërblim.⁶² Gjykata e Lartë italiane, vendosi rrëzimin e kërkesës për dëmshpërblim për fetusin e lindur të keqformuar, kjo jo për për shkak të veprimeve të mjekut. Mos informimi nga ana e mjekut nuk ka lidhje shkakësore të drejtpërdrejtë pra nuk

⁶¹ Vendim nr.6735 datë 10.05.2002 i Gjykatës së Lartë italiane, në të cilin njihet edhe e drejta e babait të fëmijës për tu dëmshpërblyer, si rezultat i mosinformimit nga ana e mjekut.

⁶² Vendim nr.14488 datë 29.07.2004 i Gjykatës së Lartë Italiane, seksioni i tretë civil. “I konceptuari mund të gëzojë një të drejtë mbrojtjeje të një interesi të caktuar vetëm pas lindjes dhe të varur nga fakti i lindjes. Nëse nuk verifikohet ky fakt, mohoet edhe mbrojtja e të drejtës së garantuar. Prandaj, t'i njohësh të konceptuarit të drejtën për të mos lindur do të thote t'i njohësh një të drejtë, që në fakt nuk mund ta ushtrojë dhe që është konsumuar”.

është shkak i keqformimeve të fëmijës, pasi ka influencuar në të drejtën e gruas për të zgjedhur nëse do të vazhdonte shtatëzaninë ose jo.⁶³

Ligji nr. 8045, datë 7.12.1995 “Për ndërprerjen e shtatëzanisë” në legjislacionin shqiptar lejon kryerjen e abortit eugjenetik në raste të keqformimeve të rënda të fetusit të papajtueshme me jetën.⁶⁴ Në legjislacionin tonë parashikohet e drejta e fetusit për të lindur i shëndetshëm, por jo “e drejta për të mos lindur veçse i shëndetshëm”.

4.3. E drejta e jetës dhe aborti

Jurisprudenca e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut thekson se e drejta e individit për jetën mbrohet nga neni 2 i KEDNJ-së, por njëkohësisht, edhe nga neni 8 i kësaj Konvente nën i cili mbron dhe garanton dhe të drejtën e individit për “jetë private dhe familjare”. Ky nen ka për qëllim ndalimin e ndërhyrjes së shtetit në jetën private dhe familjare të individëve. Në vitin 1976 Komisioni për të drejtat e njeriut, ka konstatuar se neni 8 i KEDNJ-së është i zbatueshëm për çështjet e abortit pasi legjislacioni përmes të cilit rregullohet ndërprerja e shtatëzanisë prek sferën e jetës private, kjo sepse kur femra është shtatëzënë, jeta e saj ndërlidhet ngushtë me fetusin në zhvillim (Korff, 2006:10).

Më vonë ky aspekt sqarohet edhe më tej pasi neni 8 të KEDNJ-së nuk mund të interpretohet se lejon të drejtën për abort, por vë theksin te e drejta e femrës për respektimin e integritetit të saj fizik dhe psikologjik, qartazi të paraparë në nocionin e “jetës private”. Në këtë aspekt, shtetet kanë detyrimin që të sigurojnë shërbimet e tyre në atë mënyrë që respekti për lirinë e profesionistëve mjekësorë në praktikë, të mos pengojë ushtrimin e të drejtës për ato shërbime për gratë shtatëzëna. Megjithatë, përfundimi i shtatëzanive përfshin jo vetëm të drejtat e nënave të ardhshme, por edhe të baballarëve. Nisur nga ky qëndrim gjyqtarët e Strasburgut arritën në përfundimin se të drejtat e

⁶³ Vendim nr.16123 datë 14.07.2006 i Gjykatës së Lartë Italiane, seksioni i tretë civil: “Dëmi konsiderohet si humbje apo pakësim në lidhje me një gjëndje të mëparshme, që shpërblimi synon të riintegrojë. Në këtë rast, nuk verifikohet dëmi, pasi e vetmja alternativë e lindjes jo i shëndetshëm, është mosardhja në jetë”.

⁶⁴ Ligj Nr.8045, datë 7.12.1995 “Për ndërprerjen e shtatëzanisë”, neni 9: “Kur komisioni gjykon se fetusit ka keqformime të papajtueshme me jetën, apo sëmundje invaliduese me trajtim të pasigurtë, vendos për ndërprerjen e shtatëzanisë në çdo kohë.”

mundshme të babait për respektimin e jetës së tij private dhe familjare nuk mund të interpretoheshin aq gjerë sa për të futur të drejtën e konsultimit apo të ngritjes së padisë në gjykatë lidhur me abortin e kërkuar nga bashkëshortja e tij, pasi respekti për jetën private të gruas shtatëzënë “personi kryesor lidhur me shtatëzaninë” interpretohet nga ana e Gjykatës si mbizotërues ndaj cilësdo të drejte të babait.

Si përfundim, ankesa e babait në rastin *Boso* se vendimi i gruas për kryerjen e abortit nuk ishte diskutuar me të, është refuzuar si i pabazë. Praktika gjyqësore tregon se kur bëhet fjalë për interesat e dy prindërve të ardhshëm, vendimi i gruas për të mos u bërë prind mbizotëron ndaj atij të burrit për t'u bërë prind. Nëse rrezikohet integriteti trupor i nënës, mbizotërimi i të drejtave të saj për autonomi bëhet pothuajse automatik. Ndërkohë që në rastet e abortimit, Gjykata ka konstatuar se të drejtat e babait janë dytësore krahasuar me ato të nënës, pikëpamja ndryshon kur vendimi ka të bëjë me fillimin e shtatëzanisë. Në rastin *Evans*, Gjykatës i'u dha mundësia për të analizuar zbatimin e dispozitave për mbrojtjen e të drejtave të njeriut lidhur me “teknologjitë e reja riprodhuese”, dhe me të drejtat e marrëdhëniet me riprodhimin. Rasti kishte të bënte me nxjerrjen e vezëve nga vezoret e paditëses për trajtimin *in vitro* (IVF). Paditësja është ankuar se ligjet vendore lejonin ish-partnerin e saj për të tërhequr kontratën e tij për ruajtjen dhe përdorimin e vazhdueshëm të embrionit, duke ia hequr mundësinë asaj që të ketë fëmijë, me të cilin ishte e lidhur gjenetikisht. Fillimisht, Gjykata konstatoi se koncepti i “jetës private” përfshin të drejtën e respektimit të vendimit për t'u bërë prind gjithashtu nënvizoi se si mashkulli, ashtu edhe femra, që i hyjnë trajtimit *in vitro* (IVF-së) meritojnë trajtim të barabartë, përkundër përfshirjes së tyre të ndryshme në procedurë dhe rrjedhimisht, ruajta dhe implantimi i vezoreve të fertilizuara kërkon dakordësinë e vazhdueshme të të dyja palëve. Kohëve të fundit kjo dispozitë është interpretuar se gjithashtu përfshin zgjedhjen se si të bëhesh prind.

Gjykata konstatoi se nocioni i autonomisë personale është parim themelor i interpretimit të garancive të parapara në nenin 8 të KEDNJ-së, prandaj, e drejta lidhur me vendimin për t'u bërë prind përfshin të drejtën e zgjedhjes së rrethanave të bërjes prind. Gjykata mendon se rrethanat e lindjes gjithsesi janë pjesë e pakontestueshme e jetës private të personit sipas kësaj dispozite.

4.3.1.Momenti i debatueshëm i fillimit të jetës

Ashtu siç kemi theksuar, vende të ndryshme kanë mendime të ndryshme mbi momentin se kur fillon jeta e njeriut. Në ndryshim nga neni 4 i Konventës Amerikane mbi të Drejtat e Njeriut, e cila shprehet se “*jeta e njeriut duhet të mbrohet në përgjithësi, që nga momenti i mbetjes së gruas shtatëzënë*”, neni 2 i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ) hesht në lidhje me kufizimet kohore të së drejtës së jetës dhe nuk përcakton “çdonjëri” jetën e të cilit KEDNJ mbron.

Konventa nuk parashikon as momentin e fillimit të jetës së njeriut dhe nëse e drejta për jetën shtrin kufijtë e saj dhe mbi fëmijën e palindur.⁶⁵ Ky moment bëhet pre e polemikave në çështjet e abortit. Pyetjet që ngrihen në këto raste janë: A është i ligjshëm dëmtimi i fetusit? A ka të drejtë gruaja të bëjë abort? A do të konsiderohet fetus si qenie e gjallë? Kur mund të konsiderohet si qenie njerëzore? Po në rastet e dëmtimit të tij pa dëshirën e gruas?

Sigurisht që është e nevojshme njohja e natyrës sensitive dhe emocionale të çështjeve të abortit, kundërshtimet e forta lidhur me këtë çështje, madje edhe mes vetë mjekëve. Filozofia e njeriut, eksperiencat e tij, ekspozimi i individit ndaj limiteve të ekzistencës së tij si qenie njerëzore, edukimi fetar, kuptimi individual mbi jetën, familjen dhe vlerat e tjera, standardet morale që njeriu vendos dhe mundohet të ndjekë, që të gjitha këto influencojnë e ngjyrosin mendimet dhe përfundimet e secilit për jetën dhe abortin.

Ashtu si legjislationet e shteteve amerikane, edhe legjislationet e vendeve anëtare të KEDNJ ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme nga njëri tjetri lidhur me përgjigjen e pyetjes se kur fillon jeta dhe përcaktimin e nocionit “njeri”. Në fushën shkencore ka dy qëndrime mbi statusin moral të embrionit e si rrjedhojë dhe të mbrojtjes ligjore që i ofrohet: - embrionet njerëzore nuk konsiderohen qenie njerëzore, e si rrjedhojë mbrojtja që u ofrohet është relative; dhe qëndrimi i dytë, se embrionet njerëzore kanë të njëjtin status moral si qeniet njerëzore e si rrjedhojë mbrojtja që i ofrohet të dyve është e njëjtë. (Kane, 2011:39)

⁶⁵ Shih *Vo v. Francës* e cit.

Shumë vende të Evropës, gjatë diskutimeve dhe nënshkrimit të Konventës së Këshillit të Europës mbi të Drejtat e Njeriut dhe Biomjekësinë, nuk arritën të kenë një konsensus lidhur me përcaktimin e embrionit, e si rrjedhojë, ishin në pamundësi për të përfshirë kërkimet mbi embrionin në Konventë. Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut u lë vendeve anëtare një marzhë/hapësirë vlerësimi lidhur me çështjen e fillimit të jetës. Kjo në varësi të standardeve kombëtare, kulturës, drejtimit fetar të çdo vendi anëtar të saj. Kjo për shkak se edhe vetë Shtetet Anëtare kanë qenë në pamundësi për të zgjidhur konfliktet ndërmjet tyre për çështjen. Në ditët e sotme, statusi i embrionit dhe/ose fetusit ka filluar të ketë njëfarë mbrojtjeje si rrjedhojë e progresit shkencor dhe pasojave potenciale të kërkimeve në inxhinierinë gjenetike, rikrijimin mjekësor të vëzhguar (*in vitro*) ose eksperimente mbi embrionin. (Izumi, 2011:19)

Kështu, në shumë vende embrioni ka fituar të drejta sipas ligjeve civile që lidhen me trashëgiminë, pranimin e dhuratave etj.⁶⁶ Shpesh herë konsiderohet se një qenie njerëzore që zhvillohet konsiderohet “njeri” që në momentin e konceptimit, e si rrjedhojë krijohet ideja se aborti është të jetë i paligjshëm. Kjo për faktin se çdonjëri ka të drejtën e pamohueshme për jetën, e duke qenë se jeta është parakusht për shijimin e të mirave të tjera, krijohet ideja se kjo e drejtë është themelore dhe asnjë e drejtë tjetër s’mund të qëndrojë para saj. Në këtë aspekt duket sikur e drejta as që mund të vihet në balancë me preferencat e një individi tjetër, qofshin këto dhe preferenca mbi atë se çfarë mund të ndodhë brenda trupit të këtij individi.

Si në jurisprudencën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës⁶⁷, ashtu dhe në jurisprudencën e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut⁶⁸ vihet re se e drejta e fetusit për jetën ka qenë gjithmonë e lidhur me të drejtën e gruas për të vendosur vetë për trupin e jetën e saj. Sipas jurisprudencës së SHBA-së, e drejta për privatësi mbrohet nga Amendamenti i 14 i Kushtetutës. E drejta për proces të rregullt, e parashikuar në këtë Amendament, mbron ndër të tjera dhe të drejtën për privatësi⁶⁹ në të cilën hyn dhe e drejta

⁶⁶ Duhet pasur parasysh se jo gjithmonë gruaja shtatzënë është dhe mamaja biologjike e fëmijës së palindur.

⁶⁷ *Roe v. Wade*, 410 U.S. 113 (1973); *Doe v. Bolton*, 410 U.S. 179 (1973); *United States v. Vuitch*, 402 U.S. 62 (1971).

⁶⁸ *X v. the United Kingdom* (ECtHR).

⁶⁹ i.d. 7.

e gruas për të kryer abort. Kështu, në çështjen *Roe v. Wade* Gjykata Supreme e SHBA-së u shpreh se kjo e drejtë duhet të jetë në balancë me dy interesat e shtetit: mbrojtjen e jetës së foshnjës së palindur si dhe mbrojtjen e shëndetit të gruas. Gjykata Supreme e SHBA ka konfirmuar se të drejtat e grave për jetën dhe shëndetin duhet të kenë prioritet mbi interesin e shtetit për të mbrojtur jetën prenatale. Kjo Gjykatë është shprehur, lidhur me shtatëzaninë, se “liria e gruas cenohet në një sens unik e të veçantë për racën njerëzore”⁷⁰ duke pasur parasysh jo vetëm dëmtimin psikologjik dhe stresin e shkaktuar, por njëkohësisht dhe cënimin e shëndetit mendor dhe fizik, që mund të shkaktohet në rastet e vazhdimin të plotë të një shtatëzanie.

Edhe në qoftë se fetusit nuk është një qenie njerëzore, ajo është konsideruar në mënyrë të qartë nga shumica e njerëzve dhe shumica e shoqërive, si një ekzistencë me status të veçantë që nuk duhet të hidhet rastësisht. Sipas interpretimit të bërë nga Komisioni Europian nenit 2 të Konventës, ky nen nuk përmend abortin në listën e veprimeve të parashikuara në paragrafin e dytë, çka do të thotë se ka tre opsione: - neni 2 nuk mbron aspak jetën e një fetusit të palindur, - njeh të drejtën e jetës së fetusit me disa kufizime, - i jep një të drejtë absolute jetës së fetusit.

Interpretimi i tretë u konsiderua i papranueshëm nga Komisioni, pasi ky interpretim nuk merrte parasysh rreziqet që mund t’i kanoseshin jetës së gruas shtatëzënë/mamasë, çka do të thoshte se “jeta e palindur” e fetusit do të kishte përparësi mbi jetën e saj.⁷¹ Ky nuk do të ishte interpretimi i duhur sipas Konventës, pasi jo vetëm që të gjitha Palët Kontraktuese kishin lejuar abortin kur ky kishte qenë i nevojshëm për të shpëtuar jetën e gruas shtatëzënë (madje që në vitet 1950), por njëkohësisht ka pasur dhe tendenca për një liberalizim të plotë të abortit.

Komisioni u shpreh se të gjitha kufizimet e parashikuara në fjalinë e dytë të paragrafit të parë dhe në paragrafin e dytë të nenit 2 të Konventës, për nga natyra, kanë të bëjnë me persona të lindur dhe nuk mund të aplikohen ndaj fetusit. Si përdorimi i termit “*gjithkush*”,⁷² në Konventë, si dhe konteksti në të cilin përdoren këto terma tentojnë të

⁷⁰*Planned Parenthood of Southeastern Pennsylvania v. Casey*, 505 U.S. 833, 852 (1992).

⁷¹ *Shih A.B. and C. v. Ireland* (ECtHR).

⁷² Termit e përdorura në tekset e Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut në anglisht dhe frëngjisht për termin “*çdokush*”.

mbrojnë mendimin se nuk përfshin të palindurin. Megjithatë, sipas Komisionit, në disa rrethana, fetusi mund të gëzojë disa të drejta sipas nenit 2, fjalia e parë, pavarësisht pikëpamjeve të ndryshme të shteteve kontraktuese. Siç shihet, si në jurisprudencën e SHBA, ashtu dhe në atë të GJEDNJ vihet re përdorimi i termit “*fetus*” ose “*i palinduri*”, prandaj lind nevoja e shpjegimit të kuptimit të tij në mënyrë që të kuptohet rëndësia që i kushtohet.

4.3.2. Çështja e ligjshmërisë së abortit

Zhvillimet e fundit në mjekësi dhe në drejtësi sugjerojnë një mbrojtje të mëtijshme për fetusin e shëndetshëm, të aftë për jetë autonome (Bianku, 2010:83). Gjithsesi nuk ka konsensus në vendet europiane për mbrojtjen e fetusit, megjithëse dispozitat e Konventës dhe Bioetika mbrojnë edhe format embrionale të jetës njerëzore.⁷³

Gjykata e Strasburgut ka treguar se, e drejta e fetusit për të jetuar nuk është një e drejtë absolute. Kjo gjykatë nuk bie në kundërshtim me abortin për motive shëndetësore, veçanërisht nëse vazhdimi i shtatëzanisë do të vinte në rrezik jetën e nënës. Shteti mund të vendosë kufizime për të drejtën e abortit por pa çënuar të drejtën për jetë personale që u garantohet grave shtatëzëna nga neni 8 i Konventës. Duke parë qëndrimet e deritanishme të Gjykatës së Strasburgut për mbrojtjen e fetusit kuptohet se Konventa nuk e mbron të drejtën e jetës për fetusin duke lejuar ligjet për lejimin e abortit, gjë që nuk e përjashton mundësinë që në të ardhmen, ky qëndrim i saj të ndryshojë. Ndryshe nga Konventa Europiane e të drejtave të njeriut, Konventa Amerikane e të Drejtave të Njeriut është shprehur shumë qartë në lidhje me të drejtën e fetusit për të jetuar, kur parashikon në nenin 4 të saj se: “*Çdo njeri ka të drejtë të jetojë*”. *Kjo e drejtë duhet të mbrohet me ligj që nga momenti i konceptimit*”.

Edhe Kushtetuta Shqiptare nuk shprehet se në çfarë momenti fillon detyrimi i shtetit për mbrojtjen e të drejtës së jetës, nëse ky detyrim fillon që me konceptimin e fëmijës, me lindjen gjallë të tij apo në ndonjë moment tjetër. Duke iu referuar nenit 1 të

⁷³ Preambula e Konventës së të drejtave të fëmijës e Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

ligjit “Për ndërprerjen e shtatëzanisë” i cili parashikon se: “Ligji garanton respektimin e çdo qenieje njerëzore që në fillim të jetës”, ky parim nuk shkelet, përveç rasteve kur është e domosdoshme dhe në kushtet e përcaktuara në këtë ligj.” Dispozitat e Kodit Penal, nga ana tjetër, nuk nxjerrin jashtë ligjit abortin në vetvete, por mbrojnë shëndetin e gruas nga praktikat e jashtëligjshme të personelit mjekësor. Kjo edhe për arsye se në balancimin midis sakrifikimit të të konceptuarit dhe të drejtës për mbrojtjen e shëndetit të gruas shtatëzënë, përparësi ka kjo e fundit.

Duke iu referuar dispozitave të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, dallojmë disa figura të veprave penale që lidhen me shkeljen e Ligjit Nr. 8045, datë 7.12.1995 “Për ndërprerjen e shtatëzanisë”. Por duke parë se këto figura të veprave penale futen në grupin e veprave penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatëzanisë ose mosdhënia e ndihmës, kuptohet se qëllimi i këtyre parashikimeve është mbrojtja e shëndetit të gruas shtatëzënë dhe jo mbrojtja e së drejtës së fetusit për të jetuar. Për më tepër edhe në praktikën gjyqësore shqiptare, nuk njihet ndonjë rast ku të jetë dënuar ndonjë person, kur ka shkaktuar një abort që vjen në kundërshtim me rastet dhe rregullat e parashikuara nga Ligji Nr.8045, datë 7.12.1995 “Për ndërprerjen e shtatëzanisë”. Gruaja është përjashtuar si subjekt i veprës penale, në ndryshim nga Kodi Penal i mëparshëm. Nuk ka përgjegjësi penale gruaja shtatëzënë kur ndërprerja e shtatëzanisë kryhet prej saj ose nga persona të tjerë, me pëlqimin e saj, jashtë rasteve të përcaktuara në ligj.

Nga sa më lart mendojmë se as legjislacioni shqiptar nuk e mbron të drejtën e jetës që me konceptimin e tij, por kur në Kushtetutë parashikohet se jeta e personit mbrohet me ligj, me person do të kuptohet vetëm çdo njeri i cili ka lindur dhe jo fetusit i konceptuar dhe se Ligji Nr. 8045, datë 7.12.1995 “Për ndërprerjen e shtatëzanisë” u miratua më tepër si një nevojë për të shmangur abortet e pakontrollueshme dhe nga persona të pa specializuar të cilët vinin në rrezik jetën e grave shtatëzëna, në kushtet kur aborti ishte i ndaluar me ligj. Neni 2 i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, përcakton detyrimin pozitiv të çdo shteti në respektimin e kërkesave për ruajtjen e jetës në sferën e shëndetit publik.⁷⁴ Gjykata

⁷⁴ Çështja “Vo kundër Francës”, që kishte të bënte me vdekjen e fëmijës së palindur të kërkueses si pasojë e një neglizhence serioze mjekësore. Sipas Gjykatës së Strasburgut, çështja e të drejtës së jetës së fetusit. i takonte të drejtës së brendshme. Por edhe nëse prezumohej që fetusit i gëzohej mbrojtja, detyrimet pozitive të

e Strasburgut ka theksuar se: “Edhe nëse prezumohet se fetusi gëzon mbrojtje, detyrimet pozitive të shtetit nuk shkojnë deri aty sa të ofrojnë instrumente ligjore me karakter penal në rastet e eliminimit të paqëllimshëm të fetusit”.

Po ashtu lind pyetja nëse mund të kërkohet shpërblimi për dëmtimin e fetusit shkaktuar nga veprimet e mjekut, para lindjes? A do të mbajë përgjegjësi penale mjeku, në këtë rast? Dëmtimet e fetusit, nuk mund të përbëjnë shkak për dëmshpërblim, para lindjes, për arsye se fetusi nuk ka zotësi juridike. Si rrjedhim, shpërblimi i dëmtimit të fetusit nuk mund të kërkohet, në këtë moment, për arsye se fetusi nuk ka zotësi juridike të ndarë nga zotësia juridike e nënës. Të drejtat e fetusit kristalizohen dhe mund të ushtrohen vetëm pas lindjes.⁷⁵ Por, nëse fetusi lind gjallë, mund të kërkohet dëmi i shëndetit të fetusit shkaktuar nga veprimet e mjekut, para se të vinte në jetë. Në një vendim të Gjykatës së Lartë Spanjolle, mjeku u deklarua fajtor për mjekim të pakujdesshëm, pasi dështoi në dhënien e ndihmës mjekësore duke shkaktuar dëmtimin e fetusit gjatë lindjes.⁷⁶ E drejta e gruas për të ndërprerë shtatëzaninë, brenda kushteve të lejuara nga ligji nuk përbën një detyrim për mjekun, i cili nuk e praktikon abortin nëse kjo vjen ndesh me parimet e tij morale, dhe ndërgjegjen.

Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe ligjvënësi ynë, i cili pranon se e drejta e gruas për të ndërprerë shtatëzaninë nuk nënkupton detyrimin e mjekut për të kryer abortin.⁷⁷ Në praktikën e huaj, detyrimi në këtë rast qëndron në referimin e pacientes në një mjek tjetër i cili pranon të kryejë ndërprerjen e shtatëzanisë. (White & Baldwin, 2011:116) Neni 9 i Konventës Europiane së të Drejtave të Njeriut, përmban gjithashtu të drejtën e personit (mjekut) për të refuzuar, në përputhje me ndërgjegjen e tij, të kryejë abortin, ndërprerjen e trajtimit, dhënien e kontraceptivëve, por duke e drejtuar pacientin në një mjek tjetër.

Ligji shqiptar ashtu si ligjet e shumë vendeve të tjera, nuk parashikojnë të drejtën absolute të fetusit për të jetuar. Kjo e drejtë nëse do të njëhej do të pengonte ushtrimin e të drejtës së grave për të vetëvendosur si pjesë e të drejtës për jetë private, dhe pikërisht të së

shtetit nuk shkojnë deri aty sa të ofrojnë instrumente me karakter penal në rastet e eliminimit të paqëllimshëm të fetusit. Ankimi civil ishte teorikisht i mjaftueshëm në këtë rast.

⁷⁵ Vendim i datës 13.10.1992 i Gjykatës së Lartë spanjolle, Seksioni civil.

⁷⁶ Vendim i datës 19.01.1995 i Gjykatës së Lartë spanjolle, Seksioni penal.

⁷⁷ Ligji “Për ndërprerjen e shtatëzanisë”, neni 16: “Asnjë mjek nuk mund të detyrohet të kryejë ndërprerje të shtatëzanisë kundër vullnetit të tij.”

drejtës së tyre për të ndërprerë shtatëzaninë, në përputhje me kriteret e përcaktuara në ligj. Në keto kushte asnjë person, madje as bashkëshorti, nuk mund të kërkojë qoftë nga gjykata kufizimin e kësaj të drejte.⁷⁸ Këtë qëndrim ka mbajtur dhe jurisprudenca e Strasburgut, në një sërë çështjesh, duke përcaktuar se mosnjohja babait, e të drejtës për të kërkuar moskryerjen e ndërprerjes së shtatëzanisë, nuk cënon të drejtën e tij për jetë private dhe familjare, të garantuar edhe nga Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut.⁷⁹

4.3.3. Ndërprerja e shtatëzanisë pa pëlqimin e gruas.

Ndërprerja e shtatëzanisë pa pëlqim të gruas në shumë vende parashikohet si figurë e veprës penale. Edhe në nenin 93⁸⁰ të Kodit tonë penal “*Ndërprerja e shtatëzanisë pa pëlqim të gruas.*” është figurë e veçantë e veprës penale. Objekti i kësaj vepre është mbrojtja e jetës dhe shëndetit të gruas shtatëzanë. Objekti i veprës penale në fjalë është i dyfishtë pasi në aspekte të veçanta mbrohet edhe e drejta e fetusit për të jetuar.

Nga ana objektive, krimi kryhet me veprime që ndërpresin shtatëzaninë në mjedise spitalore publike apo klinika private të lejuara posaçërisht si dhe brenda kohës së lejueshme për ndërprerje, veç rastit kur ndërprerja diktohet nga një shkak shëndetësor i justifikuar.

Vepra penale mund të kryhet me anë të veprimeve aktive, kimike (ilaje apo substanca që kanë efekte abortive), fizike apo mekanike, si dhe nga emocionet apo frika.

Lind pyetja: A përbën vepër penale ndërprerja e shtatëzanisë, dhënia e informacionit për një medikament i cili shkakton abortin, një gruaje shtatëzënë? Në praktikën mjekësore shpesh, mjekët apo farmacistët informojnë pacientët dhe u japin medikamente të cilat shkaktojnë ndërprerjen e shtatëzanisë, duke qenë në dijeni të faktit se pacientja dëshiron të kryejë abortin, jashtë rasteve të përcaktuara në ligj. Legjislacioni ynë parashikon ndalimin e reklamimit të produkteve që shkaktojnë ndërprerjen e shtatëzanisë,

⁷⁸ Ligj Nr.8045, datë 7.12.1995 “Për ndërprerjen e shtatëzanisë”, neni 6, “Kur është e mundur, në këshillimin dhe marrjen e vendimit për ndërprerjen e shtatëzanisë, merr pjesë edhe bashkëshorti ose prindi.”

⁷⁹ Çështja “*Paton kundër Mbretërisë së Bashkuar*”.

⁸⁰ Ndërprerja e shtatëzanisë pa pëlqim të gruas, veç rastit kur ndërprerja diktohet nga një shkak shëndetësor i justifikuar, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet.

ndërkohe që njihet detyrimi i mjekut për të informuar në lidhje me metodat kontraceptive të ofruara.⁸¹ Në asnjë nga këto raste nuk ka filluar ndjekja penale për veprën penale të ndërprerjes së shtatëzanisë.

Praktika gjyqësore e huaj ka mbajtur qëndrimin se mjeku i cili jep informacion për medikamente të cilat shkaktojnë ndërprerjen e shtatëzanisë, jashtë rasteve të parashikuara në ligj, mban përgjegjësi penale. Gjykata e Lartë spanjolle ka lënë në fuqi vendimin e një gjykate më të ulët e cila ka dënuar një mjek që i kishte përshkruar një gruaje shtatëzanë –e cila donte të abortonte- për të marrë një ilaç që provokonte abort. Kërkuesi pretendoi se gjykata nuk duhet të vlerësonte këtë veprim të mjekut si ndërprerje të shtatëzanisë, strictu sensu, jashtë rasteve të parashikuara në ligj, por duhet ta vlerësonte si një informacion të përgjithshëm për efektet e një medikamenti të dhënë nga mjeku.⁸²

Po ashtu shtrohet për diskutim çështja nëse mund të konsumohet kjo vepër penale me anë të mosveprimeve apo do të kemi përgjegjësi penale për mosdhënien ndihmë e cila ka shkaktuar dëmtimin e rëndë të shëndetit duke ndërprerë shtatëzaninë. *A priori* nuk mund të përjashtohet mundësia e shkaktimit të veprës penale me anë të mosveprimeve, edhe pse nga leximi literal i dispozitës, mund të mos nënkuptohet kjo formë e kryerjes së saj. P.sh. në rastin e mamisë, e cila ka detyrimin të asistojë gruan gjatë lindjes, në mënyrë të qëllimshme, kjo nuk i jep ndihmën e nevojshme dhe shkakton ndërprerjen e shtatëzanisë, plotësohen të gjithë elementët e veprës penale të ndërprerjes së shtatëzanisë, e cila duhet të aplikohet në këtë rast si dispozitë specifike.

Për marrjen në përgjegjësi penale, nuk kërkohet ardhja e ndonjë pasoje tjetër, veç ndërprerjes së shtatëzanisë. Por, e rëndësishme është të theksohet se ndërprerja e shtatëzanisë duhet të sjellë si pasojë vdekjen e fetusit, pasi në rast se fetusin nuk vdes, do të kemi të bëjmë me shkaktim të lindjes së parakohshme. Lindja e parakohshme, (përsheptimi i qëllimshëm i lindjes) i shkaktuar si pasojë e dëmtimeve të qëllimshme, nuk

⁸¹Ligj Nr.8045, datë 7.12.1995 “Për ndërprerjen e shtatëzanisë”, neni 14: “Në të gjitha rastet e ndërprerjes së shtatëzanisë, mjeku që i kryen ato është i detyruar të informojë gratë për shërbimet e planifikimit familjar dhe t’i këshillojë për metodat kontraceptive që ofron institucioni ku ai punon dhe/ose institucione të tjera shtetërore e private.”, neni15: “Ndalohej çdo lloj propagande dhe reklamimi, direkt ose indirekt, me fjalë ose figurë, e institucioneve, metodave, medikamenteve e produkteve që shkaktojnë ndërprerje të shtatëzanisë, përveç se në botimet shkencore të destinuara për mjekë dhe farmacistë.”

⁸² Gjykata e Lartë Spanjolle, seksioni penal, vendim datë 03.04.1997.

parashikohet në legjislacionin tonë penal, ndërkohë që ligji penal Italian e parashikon si figurë të posaçme të veprës penale. Në këtë rast nuk bëhet fjalë për vdekjen e fetusit, por vetëm për përshpejtim të kohës që do të duhej normalisht për lindjen duke qenë se dëmtimi shkaktohet në kohën kur fetusit është në gjendje për të jetuar në mënyrë autonome.

Në rast se do të vërtetohej vdekja e fetusit, të maturuar, të aftë për të jetuar në mënyrë autonome, atëherë sipas ligjit Italian do të ketë vrasje me dashje, ndërsa sipas legjislacionit shqiptar, ndërprerje të shtatëzarisë pa pëlqim të gruas. P.sh. në rastin kur nga dëmtimet e shkaktuara gruas, është ndërprerë shtatëzania, si dhe fetusit pasi është shkëputur nga trupi i gruas gjallë, ka jetuar dhe disa orë dhe më pas ka vdekur, si dhe vërtetohet se ka patur mundësi të jetojë në mënyrë autonome por ka vdekur për shkak të dëmtimeve. Edhe në rastin kur fetusit, i shkëputur nga trupi i gruas i gjallë, vdes si pasojë e imaturimit dhe si pasojë e paaftësisë për të jetuar në mënyrë autonome, do të konsumohet vepra penale e ndërprerjes së shtatëzarisë pa pëlqim të gruas.

Nga ana subjektive vepra penale kryhet me dashje, kundër vullnetit të lirë të gruas, pa pëlqimin e saj, me përjashtim të rastit kur ndërprerja diktohet nga një shkak shëndetësor i justifikuar me raport mjekësor dhe mjeku e gjykon të domosdoshme ndërprerjen e shtatëzarisë edhe pa pëlqimin e gruas shtatëzënë. Për efekt të përgjegjësisë penale, nuk ka rëndësi koha e shtatëzarisë, por kërkohet që subjekti ta dijë se gruaja është shtatëzanë dhe i shkaktohet ndërprerja me dashje. (Elezi,2013:84)

Plagosja e rëndë e cila ka sjellë si pasojë ndërprerjen e shtatëzarisë parashikohet si figurë e veçantë e veprës penale në seksionin për veprat penale të kryera kundër shëndetit, dhe jo në seksionin e veprave penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin e gruas nga ndërprerja e shtatëzarisë. Ndërsa, në rast se ndaj gruas përdoret dhunë fizike apo psikike personat do të përgjigjen për plagosje të rëndë kur si pasojë ka ardhur ndërprerja e shtatëzarisë. Ndërprerja e shtatëzarisë pa pëlqimin e gruas kryhet me veprime direkte për ndërprerjen e shtatëzarisë, kundër dëshirës. Dallimi në të dy dispozitat qëndron si në objekt ashtu dhe në anën objektive.

4.4. Vështrim i shkurtër mbi rregullimin ligjor të abortit në vende të ndryshme europiane

Ashtu si dhe kemi trajtuar më sipër GJEDNJ-ja ka lënë çështjen e abortit në juridiksionin e të drejtës së brendshme, për këtë arsye vende të ndryshme kanë korniza të ndryshme ligjore për mbrojtjen e jetës para lindjes. Strategjia e promovimit për njohjen e një të drejte për jetën para lindjes, është zgjeruar dhe ka dalë në kontekstin e proceseve të reformave kushtetuese, iniciativave legislative, dhe sfidat e gjykatave që kërkojnë për të zgjeruar të drejtat kushtetuese në mbrojtjen e të drejtës për jetën prenatale.

Por jo të gjitha shtetet i presin pozitivisht iniciativat për të mbrojtur jetën e individit që nga ngjizja, për t'i bërë pjesë të legjislacioneve të tyre të brendshme. Vendet perëndimore në përgatitjen e projektligjeve marrin në konsideratë normat ligjore të shteteve fqinje dhe më gjerë, që të mund të vënë në jetë një ligj i cili më së miri do të mund të gjente aplikueshmërinë e tij në atë vend. E njëjta strategji e hartimit të projektligjeve ndiqet edhe në vendet e Bashkimit Europian duke realizuar që ligjet e vendeve anëtare të jenë sa më të afërta dhe jo me dallime të skajshme. Më poshtë do të trajtojmë shkurtimisht legjislacionin e abortit në disa vende në nivel krahasimor, duke dhënë një dimension të gjerë njohurive mbi këtë çështje.

Gjermania: Sipas të drejtës së aplikueshme që prej vitit 1995, aborti në Gjermani parimisht është i ndaluar, mirëpo lejohej në raste të përcaktuara. Lejohej aborti brenda 12 javësh pasi gruaja të ketë kryer bisedën e detyrueshme me qendrën këshilluese për gratë shtatëzëna, në të cilën gruaja shtatëzënë vendos se nëse do ta abortojë fëmijën apo jo. Pas konsultës, gruas që ka vendosur të bëjë abortin i jepet një certifikatë dhe vetëm me këtë letër ajo ka mundësi t'i drejtohet mjekut për ta kryer abortin. Aborti klasifikohet i ligjshëm nëse klasifikohet si i patjetërsueshëm, në rast se rrezikohet jeta e gruas, ose kemi të bëjmë me ndonjë implikim kriminal, pra dhunim. Në Gjermani janë afër 1930 qendra për këshillime të cilat lëshojnë certifikata për abort për ato që dëshirojnë ta marrin një hap të tillë.⁸³

⁸³Edhe Shoqata e Caritasit Katolik Gjerman ka njoftuar se vetëm në vitin 1997 pas 20.000 këshillimeve që i ka bërë 1/4 e grave kanë vendosur që të mos abortojnë, por ta mbajnë fëmijën. (Papa këto këshillimore

Franca: Sa i përket kohëzgjatjes se deri kur lejohet aborti, Franca klasifikohet si vend më "progresiv" në këtë fushë. Kjo lidhet ngushtë me luftën e pandërprerë të grave. Në vitin 1975 nxirret një ligj i cili lejon abortin deri në javën e dhjetë. Ndryshimi i këtij ligji bëhet edhe njëherë në vitin 2001 ku kohëzgjatja për të kryer abortin zgjatet edhe për dy javë. Mbas hyrjes në fuqi të këtij ligji të ri, shumë klinika në praktikë edhe më tutje përpiqen që të mos e aplikojnë ligjin e ri. Kjo do të thotë se baza juridike ndryshon nga realiteti. Mirëpo, kjo ka shkaktuar që shumë gra të kalojnë kufijtë e të shkojnë në Holandë apo Spanjë dhe të kryejnë abortin.⁸⁴

Austria: Që nga viti 1975 në Austri aborti mund të bëhet pa rrezikun për t'u akuzuar për vepër penale, nëse gruaja së pari, konsultohet me ndonjë mjek, dhe së dyti, nëse mjeku e shikon si të detyrueshëm dhe së treti, nëse aborti bëhet brenda tre muajsh. Mesatarja e abortimeve legale në Austri vlerësohet diku 20.000 deri 25.000.⁸⁵

Në rastin *S.H. Dhoma* e lartë u konfrontua me kufizimet që hasën prindërit që ishin në pritje të fëmijës gjatë përpjekjeve të tyre për zbatimin e teknologjive për riprodhim artificial. Kërkesa ishte parashtruar nga dy austriakë të cilët dëshironin të zgjidhnin fekondimin *in vitro* (IVF) me vezë dhe spermë nga dhuruesit. Sipas ligjit në fuqi, ky lloj dhurimi është i ndaluar në të gjitha rastet, ndërsa dhurimi i spermës është i lejuar atëherë kur sperma vendoset drejtpërsëdrejti në mitrën e gruas "*inseminim artificial in vitro*" (IVF). Një pjesë e madhe e aktgjykimit merret me përcaktimin e marginës së vlerësimit që shtetet gëzojnë për rregullimin e çështjeve të riprodhimit artificial. Gjykata ishte e mendimit se, duke qenë se në legjislacionin e vendeve anëtare të Këshillit të Evropës ka një përcaktim të qartë drejt lejimit të dhurimit të spermës për qëllime të IVF-së, nuk mund të thuhet se ky konsensus i ri, vlen dhe është i lidhur edhe me riprodhimin artificial. Në të kundërt, kjo pasqyron një fazë të zhvillimit brenda një fushe posaçërisht dinamike të ligjit, që nuk e prek fushëveprimin e marginës së vlerësimit. Kjo është më se e vërtetë duke pasur parasysh se trajtimi IVF mbetet çështje etike dhe ndjeshme në shoqërinë Austriake.

katolike i ka kritikuar dhe e ka ndaluar që këto të lëshojnë certifikata për abortin. Pas përpjekjeve të shumta nga ipeshkvët e ndryshëm gjermanë, më në fund dorëzohen nga përpjekjet e tyre që ta kundërshtojnë vendimin e Papës, pra ndalimin e dhënies të këtyre lloj certifikatave, mirëpo vetëm institucioneve të kishës).

⁸⁴Sipas të dhënave të njohura, nga Progres Raporti, i vitit 2002 mesatarja e aborteve në Francë sillet diku afër 200.000 në vit.

⁸⁵ Shih <http://www.imabe.org/infos/2000/ausgabe%202.htm>

Në mbështetje të interpretimit të saj rreth çështjes, Gjykata gjithashtu ka vërejtur se për sa i përket dhurimit të vezës, të gjitha instrumentet juridike relevante në nivel evropian kanë heshtur ose – në rastin e Direktivës së Bashkimit Evropian mbi standardet e sigurisë për dhurimin e qelizave njerëzore – shprehimisht ia kanë lënë vendimin mbi përdorimin ose jo të qelizave embrionale shtetit përkatës. Duke vlerësuar në njërën anë zgjedhjen e shtetit për të përmbushur dëshirën për vënien në dispozicion të riprodhimit të asistuar nga mjekësia dhe në anën tjetër shqetësimin ekzistues të pjesët e mëdha të shoqërisë lidhur me rolin dhe mundësitë e mjekësisë bashkëkohore riprodhuese, Gjykata ka theksuar se Austria nuk ka vënë ndalesë të përgjithshme mbi riprodhimin artificial (procedurat në fjalë të kryera si të vetme në fakt ishin të lejuara me ligjin e Austrisë), e as nuk ua ndalon çifteve që dëshirojnë t'i përdorin metodat që nuk pranohen në kornizën juridike të saj të shkojnë jashtë vendit për të kërkuar trajtime të ndryshme për infertilitet. Vetë fakti se duke e ndaluar përdorimin e spermës apo vezës së dhuruar për IVF Austria ka zgjedhur që të lejojë dhurimin e spermës për inseminimin artificial *in vitro*, ka treguar se ky shtet i qaset çështjes me kujdes, duke kërkuar pranimin e realiteteve sociale me qasjen ndaj parimit. Gjykata i ka mirëpritur argumentet e interesit publik që Austria ka marrë parasysh për vendimin rreth ndalimit të dhurimit të spermës apo vezëve për IVF me qëllim mbrojtjen e femrave, meqë dhurimi i vezëve mund të shpjerë në zhvillime problematike siç është shfrytëzimi dhe poshtërimi i tyre, në veçanti i atyre që gjenden në situata ekonomike të pafavorshme; ato që kanë të bëjnë me amësinë e ndarë, meqë IVF mund të çojë në krijimin e marrëdhënieve të pazakonta ku rrethanat sociale deviojnë nga ato biologjike, përkatësisht, ndarja e amësisë në një aspekt biologjik(nëna gjenetike) dhe në një aspekt të “mbajtjes së fëmijës”(nëna mbajtëse). Nga ana tjetër edhe në aspektin social shihet mirëqenia e fëmijëve dhe nevoja për parandalimin e riprodhimit selektiv. Si përfundim, Gjykata rithekson se Konventa gjithnjë është interpretuar dhe është aplikuar duke marrë parasysh rrethanat aktuale. Edhe nëse vërteton se nuk ka pasur shkelje të nenit 8 në rastin aktual, Gjykata mendon se kjo fushë, ku ligji duket se evoluon vazhdimisht dhe është subjekt i një zhvillimi dinamik të shkencës dhe ligjit, duhet t'i nënshtrohet shqyrtimit nga shtetet kontraktuese.

Suedia: Ligji suedez iu lejon grave suedeze që të vendosin lirisht për abortin pa u kërcënuar nga dënimi deri në javën e 14-të. Një shtatëzani mund të ndërpritet edhe në javën

e 24-të, mirëpo për këtë nevojitet një leje nga organet mbikëqyrëse. Suedia qëndron para vendeve tjera si: Danimarka, Norvegjia dhe Finlanda sa i përket kohës se kur guxohet të bëhet abortimi, të cilat deri në javën e 12-të gratë mund të vendosin lirisht se a deshirojnë ta mbajnë fëmijën apo jo.⁸⁶

Irlanda është konsideruar si vendi me ligje më të ashpra në çështjen e aborteve. Abortet janë plotësisht të ndaluara, me përjashtim vetëm nëse vihet në rrezik jeta e gruas. Gratë irlandeze, për shkak se nuk mund të abortojnë në vendin e vet, kalojnë nëpër vendet fqinje diku afër 7000 në vit, për të bërë abortin.

4.5. Rregullimi i abortit në Shqipëri. Analizë e Ligjit Nr. 8045, datë 7.12.1995 “Për ndërprerjen e shtatëzanisë”

Ashtu si mbrojtja e jetës si një nga të drejtat absolute të individit që ka ekzistuar në kohët e hershme, ashtu dhe dënimi i abortit i ka rrënjët po aq të hershme. E drejta zakonore e mbron jetën e gruas shtatëzanë. Kështu, në Kanunin e Lek Dukagjinit vrasja e gruas shtatëzanë gjente rregullim juridik në seksionin e krimeve kundër jetës. (Elezi, 1983:14) Në lidhje me vrasjen e gruas shtatëzënë, normat e Kanunit të Lek Dukagjinit parashikojnë se ai që vret gruan shtatëzënë, qoftë edhe nga pakujdesia, është i detyruar të lajë çmimin e gjakut të gruas dhe të fëmijës. Çmimi i cili do të paguhet për jetën e gruas ishte 3 qese me florinj dhe çmimi për fetusin ishte i njëllotë, por nëse fetusin i vranë ishte mashkull atëherë paguhej dyfishi.

Kanuni i Labërisë nuk lejonte të vritej gruaja ose vajza shtatëzënë, nga marrëdhënie jashtëmartesore, pa lindur foshnjën dhe pas lindjes ajo vritej nga prindërit e saj. Në periudhën e Republikës dhe të Monarkisë normat e të drejtës penale përmbanin ndëshkime shumë të rrepta në lidhje me vrasjen e gruas shtatëzënë. (Luarasi,2007: 393) E drejta penale socialiste, siguronte mbrojtjen e plotë juridike penale të jetës së personit nga krimet kundër jetës. Kodi Penal i vitit 1952 u kushtonte kreun e IV krimeve kundër personit duke

⁸⁶Shih <http://www.imabe.org/infos/2000/ausgabe%202.htm>

parashikuar llojet e ndryshme të vrasjeve, midis të cilave edhe vrasjen në rrethana të cilësuar ku hynte edhe vrasja e gruas shtatëzënë.

Ky qëndrim gjeti pasqyrim të plotë edhe në Kodin Penal të vitit 1977 sepse ky sistem ishte ndërtuar mbi bazën e rëndësisë së marrëdhënieve shoqërore që mbroheshin nga legjislacioni penal. Në krimet kundër personit, vendin e parë dhe kryesor e zinin krimet kundër jetës dhe në nenin 84 të këtij Kodi parashikohej figura e veprës penale të vrasjes së gruas duke e ditur që është shtatëzënë.(Elezi, 1983:30)

Në Shqipëri aborti është i rregulluar sipas ligjit dhe urdhërave të Ministrisë së Shëndetësisë për abortin. Ligji nr.8045, datë 07.12.1995 “Për ndërprerjen e shtatëzanisë” dhe Ligji nr.8876, datë 4.4.2002, “Për shëndetin riprodhues”, përfaqësojnë mjete të rëndësishme në kuadrin ligjor shqiptar, në lidhje me të drejtat riprodhuese. Ligji Nr.8045, datë 7.12.1995 “Për ndërprerjen e shtatëzanisë” përkohet nga parimi se “Çdo grua ka të drejtën e informacionit të saktë dhe të këshillimit para ndërprerjes së shtatëzanisë.”⁸⁷ Në këtë kuadër, një rol të rëndësishëm ushtrojnë këshillimet që ndodhen pranë çdo lagjeje. Mjekët dhe personeli i tyre, këshillojnë gratë me të gjithë informacionin e nevojshëm.. Gjithashtu, ligji lejon ndërprerjen e shtatëzanisë vetëm me pëlqimin e gruas. Gjithsesi, parashikohet se, kur është e mundur, në këshillim dhe në marrjen e vendimit për ndërprerjen e shtatëzanisë, merr pjesë edhe bashkëshorti, ose prindi. Ligji “Për shëndetin riprodhues” parashikon se, “Çdo grua, e lirë dhe e përjashtuar nga çdo formë diskriminimi, detyrimi dhe dhune, ka të drejtë për t’u kontrolluar e për të vendosur lirisht për të gjitha çështjet që lidhen me seksualitetin e saj dhe shëndetin seksual e riprodhues⁸⁸”. Gjithashtu, sanksionohet e drejta e çdo individi për të zgjedhur marrëdhënien seksuale dhe për të kontrolluar jetën riprodhuese. Kjo zgjedhje nënkupton se asnjë grua nuk mund të detyrohet të jetë shtatëzënë dhe se, çdo ndërhyrje mjekësore e lidhur me shëndetin riprodhues dhe seksual duhet të kryhet me pëlqimin e saj (Anastasi, 2013: 35). Ligji Nr.8045, datë 7.12.1995 “Për ndërprerjen e shtatëzanisë” parashikon në nenin 3 të tij se “Ndërprerja e vullnetshme e shtatëzanisë bëhet vetëm nga mjeku specialist obstetërgjinekolog në institucione shëndetësore shtetërore e private që plotësojnë kushtet e përcaktuara në

⁸⁷ Ligj nr.8045, datë 07.12.1995, “Për ndërprerjen e shtatëzanisë”, neni 2, pika 2.

⁸⁸ Ligj Nr. 8876, datë 4.4.2002, “Për shëndetin riprodhues”, neni 6, pika 1.

udhëzimin përkatës të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit”. Pra, ligji parashikon se ndërprerja e shtatëzanisë realizohet vetëm nga mjeku duke ndaluar në këtë mënyrë ndërprerjen e shtatëzanisë nga persona të paautorizuar të cilët mund ti shkaktojnë dëme serioze shëndetit të nënës. Rastet kur konsiderohet shkak shëndetësor i justifikuar janë të parashikuara në Ligjin Nr.8045, datë 7.12.1995 “Për ndërprerjen e shtatëzanisë” dhe vlerësohen me raport nga ekspertimi mjekoligjor kur:

- nga vazhdimi i shtatëzanisë dhe/ose lindja e fëmijës rrezikohet jeta ose shëndeti i gruas,⁸⁹
- fetusit ka keqformime të papajtueshme me jetën, apo sëmundje invaliduese me trajtim të pasigurtë,⁹⁰
- shtatëzania i krijon probleme psikosociale gruas,⁹¹
- shtatëzania është rezultat i përdhunimit ose një krimi tjetër seksual,⁹²
- vërtetohen arsye të tjera sociale.

Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit përcakton me udhëzim të veçantë përmbajtjen, mënyrën e hartimit dhe shpërndarjes së materialeve udhëzuese⁹³. Mendojmë se e rëndësishme në këtë aspekt është vlerësimi nga ana e komisionit apo gjykatës, në bazë të kriterit të “cilësisë së jetës”, të vlerësuar edhe nga gjykata e Strasburgut, i cili gjen vend në ligjin tonë në trajtën e kriterit “të papajtueshme me jetën”. Kjo do të thotë që pasojat e keqformimit të jenë të tilla që denigrojnë të ardhmen e fëmijës dhe ulin rëndë dinjitetin e tij, si dhe i shkaktojnë vuajtje të rënda fizike dhe mendore, ankth e shqetësim. Në këtë aspekt, me keqformime të papajtueshme me jetën, apo sëmundje invaliduese me trajtim të pasigurt, të përfshihen keqformime apo sëmundje serioze dhe jo ato që janë vetëm të padëshirueshme për prindërit apo për shoqërinë.

Në vlerësimin e këtij kriteri mendojmë se duhet marrë parasysh si gjendja aktuale e gruas ashtu dhe e ardhmja e parashikueshme, duke mos u fokusuar vetëm në rreziqet në

⁸⁹ Shih nenin 9 paragrafi 1 Ligjit Nr.8045, datë 7.12.1995 “Për ndërprerjen e shtatëzanisë”

⁹⁰ Shih nenin 9 të Ligjit Nr.8045, datë 7.12.1995 “Për ndërprerjen e shtatëzanisë”

⁹¹ Shih nenin 10 i Ligjit Nr.8045, datë 7.12.1995 “Për ndërprerjen e shtatëzanisë”

⁹² Neni 11 Ligjit Nr.8045, datë 7.12.1995 “Për ndërprerjen e shtatëzanisë”

⁹³ Neni 5 i Ligjit Nr.8045, datë 7.12.1995 “Për ndërprerjen e shtatëzanisë”

momentin e marrjes së vendimit. Nuk duhet të përfshihen rastet kur shtatëzania është thjesht e padëshirueshme apo e papërshtatshme për nënën dhe familjen e saj, por duhet të vlerësohet se sa arsye sociale ndikojnë në mirëqenien dhe shëndetin fizik e mendor të gruas. Proçesi fiziologjik ndërpritet për shkak të veprimeve të mjekut, personelit mjekësor, apo personave të tjerë, dhe jo për shkaqe natyrale, si pasojë e një sëmundjeje, apo gjendjes shëndetësore të gruas.

Neni 4 i këtij ligji parashikon se, mjeku specialist prej të cilit kërkohet ndërprerja e vullnetshme e shtatëzanisë, është i detyruar të informojë gruan për të gjitha rreziqet dhe komplikimet që i sjell ndërprerja e shtatëzanisë, të drejtat që i garantohen me ligj për familjen, nënën dhe fëmijën, për institucionet dhe organizmat që mund t'i ofrojnë ndihmë morale dhe financiare dhe për klinikat që i kryejnë ndërprerjet e shtatëzanisë.

Pasi gruaja të marrë të gjitha udhëzimet dhe informacionet përkatëse, mjeku kërkon konformimin me shkrim të kërkesës, 7 ditë pas kërkesës së parë.⁹⁴ Kur kërkesa bëhet nga një vajzë e mitur 16 vjeçare, përveç kërkesës së saj, kërkohet edhe miratimi i një personi i cili ushtron autoritetin prindëror ose të kujdestarit ligjor të saj⁹⁵. Neni 9 i këtij ligji përcakton afatet brenda të cilave mund të lejohet ndërprerja e shtatëzanisë dhe në paragrafin e parë të këtij neni përcaktohet se *“Ndërprerja e shtatëzanisë për arsye mjekësore mund të bëhet deri në javën e 22 të shtatëzanisë, në rast se një komision i përbërë nga 3 mjekë, pas ekzaminimit dhe konsultimit, gjykon se vazhdimi i shtatëzanisë dhe/ose lindja e fëmijës rrezikon jetën ose shëndetin e gruas.”* Pra ky paragraf përcakton afatin 22 javor vetëm nëse rrezikohet shëndeti i gruas sepse në rastet kur *“komisioni gjykon se fetusit ka keqformime të papajtueshme me jetën, apo sëmundje invaliduese me trajtim të pasigurt, vendos për ndërprerjen e shtatëzanisë në çdo kohë”*.⁹⁶ Kurse në rast se gruaja vlerëson se shtatëzania e saj krijon probleme psikosociale, ndërprerjen mund ta bëjë brenda javës së 12, por edhe deri në javën e 22⁹⁷, nëse komisioni i përbërë nga 3 specialistë mjekë,

⁹⁴ Shih nenin 6 të Ligjit Nr.8045, datë 7.12.1995 “Për ndërprerjen e shtatëzanisë” i cili përcakton se “Në rast se gruaja, pas marrjes së informacionit të përmendur në nenin 4, përsërit kërkesën e saj për ndërprerjen e shtatëzanisë, mjeku kërkon konfirmimin me shkrim të kërkesës. Ky konfirmim kërkohet pasi të kenë kaluar të paktën 7 ditë nga kërkesa e parë.”

⁹⁵ Shih nenin 8 të Ligjit Nr.8045, datë 7.12.1995 “Për ndërprerjen e shtatëzanisë”

⁹⁶ Shih nenin 9 paragrafi 2 të Ligjit Nr.8045, datë 7.12.1995 “Për ndërprerjen e shtatëzanisë”

⁹⁷ Shih nenet 10 dhe 11 të Ligjit Nr.8045, datë 7.12.1995 “Për ndërprerjen e shtatëzanisë”

punonjës socialë, juristë, pas ekzaminimit dhe konsultimit, gjykon se shtatëzania është rezultat i përdhunimit ose një krimi tjetër seksual, si dhe arsye të tjera të vërtetuara sociale. Sipas këtij ligji të Ministrisë së Shëndetësisë ndërprerja e shtatëzanisë apo aborti është i ligjshëm deri në javën e 22, por edhe në çdo kohë nëse gjatë kohës së shtatëzanisë janë të evidentuara keqformimet, deformimet, sëmundjet që janë të pashërueshme, si dhe nëse shtatëzania është rezultat i një përdhunimi apo ndonjë akti tjetër krimi seksual.

Ligji në nenin 15 të tij ndalon në mënyrë kategorike propagandën dhe reklamimin, direkt ose indirekt, nga ana e institucioneve të metodave, medikamenteve dhe produkteve që shkaktojnë ndërprerje të shtatëzanisë, përveç se kur këto informacione publikohen në botimet shkencore të destinuara për mjekë dhe farmacistë. Neni 16 i Ligjit Nr. 8045, datë 7.12.1995 “Për ndërprerjen e shtatëzanisë” përcakton se mjeku nuk është i detyruar të kryejë ndërprerje të shtatëzanisë kundër vullnetit të tij. Mund të konstatojmë se sipas të dhënave që i përmendëm ligji mbi abortin është liberal dhe kryerja e abortit bëhet pa frikë se do të jetë gruaja e përndjekur për akt penal.

Përndjekja penale, sipas këtij ligji dhe udhëzimeve, mund të aplikohet vetëm për mjekun specialist, nëse i shkel dispozitat e ligjit të miratuar nga Ministria.⁹⁸Në Shqipëri, Kodi ynë Penal në seksionin V të tij ku parashikohen veprat penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatëzanisë ose mosdhënia e ndihmës e trajton abortin apo ndërprerjen e shtatëzanisë është e paraqitur në nenet 93-95. Periudha brenda të cilës mund të lejohet aborti nuk është objekt i rregullimit të këtij Kodi pasi kjo përcaktohet sipas udhëzimeve dhe vendimeve të marra nga Ministra e Shëndetësisë. Neni 93 i Kodit penal parashikon dënime me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet për ndërprerje të shtatëzanisë pa pëlqim të gruas, veç rastit kur ndërprerja diktohet nga një shkak shëndetësor i justifikuar.

Më sipër trajtuam se gruaja e ka të drejtën e abortit vetëm nëse rrezikohet shëndeti i gruas apo jeta e saj, dhe atë nëse kanë kaluar 10 javë, 20 javë po edhe në çdo kohë të

⁹⁸Këtu po japim vetëm një shifër të aborteve të kryera në Shqipëri, sipas B. Ç. Vetëm në Tiranë ka patur çdo vit rreth 10.000 aborte, kundrejt 7000 - 8000 lindjeve. Të gjitha këto aborte janë të regjistruara, por një numër i madh i aborteve bëhet në mënyrë të fshehur, ilegalisht. Prandaj numri i mesipërm mund të jetë edhe më i madh.

shtatëzani. Para 10 javëve të shtatëzani gruaja e ka të drejtën e abortit pa asnjë procedurë të veçantë, pavarësisht se për çfarë arsye. Nëse kanë kaluar 10 javë pas ngjizjes, gruaja mund të kërkojë ndërprerje të shtatëzani duke bërë kërkesën me shkrim që i dërgohet komisionit të posaçëm për këtë çështje, por paraprakisht duhet të jenë të evidentuara këto dukuri:

- në bazë të indikacioneve medicinale konstatohet se gjatë shtatëzani apo edhe pas lindjes, mund të vijë deri te keqësimi i rëndë i shëndetit të gruas apo edhe deri te vdekja e saj.
- Kur mund të pritët se fëmija do të lindë me mungesa të rënda psikike dhe trupore, bazuar në indikacionet eugjenike.
- Kur ngjizja ka qenë pasojë e dhunimit, marrëdhënieve seksuale me personin e paafte apo me personin e mitur.

4.5.1. Diskutime mbi problematikat aktuale në vendin tonë: aborti në moshë të re dhe aborti selektiv

Në përfundim të këtij kapitulli sjellim në këtë paragraf disa nga problematikat aktuale që po kalon shoqëria jonë lidhur me abortin që vitet e fundit po konsiderohen shqetësuese: aborti në moshë të re dhe aborti selektiv. Gjatë viteve të fundit është vënë re një rritje e tendencave për abortet në moshe të re dhe ato selektive. Ashtu si në shumë vende të Evropës Lindore dhe Shqipëria ka nivel shumë të lartë të abortit. Në Shqipëri përqindja e abortit është 230 aborte për 1.000 lindje të gjalla, ndërkohë që përqindja mesatare e Evropës është 28 për 1.000 lindje të gjalla. Statistikat në vendin tonë duket që janë vërtetë shqetësuese. Gjithsesi shifrat mbeten ende të diskutueshme pasi nuk ka të dhëna të sakta lidhur me këtë fenomen. Arsyeja kryesore lidhur me mungesa të tilla raportimi lidhet me abortet që bëhen në klinika private dhe ato që bëhen privatisht nga vetë femrat nëpërmjet marrjes së pilulave⁹⁹. Grup-moshat më të prekura janë ato nga 13 deri në

⁹⁹ Pilula e abortit RU486 u aprovua nga FOOD & DRUG administration në vitin 2000 në SH.B.A. Ajo përdoret deri në 7 javë (49 ditë) shtatëzani e kombinuar dhe me një tablete tjetër për të shkaktuar kontraksionet uterine dhe më vonë abort të plotë.

18 vjeç¹⁰⁰. Numri i aborteve nga adoleshentet sa vjen e rritet, pavarësisht se bëhet fjalë për një brez jo pak të informuar lidhur me metodat për t'u mbrojtur nga shtatëzanitë. Shqetësuese mbetet sidomos kryeqyteti, ku, referuar të dhënave nga dy maternitetet në Tiranë, paraqiten për abort të paktën tri raste në javë.

Po në të njëjtat nivele mbetet edhe aborti selektiv: shumë prindër, pasi mësojnë se fëmija që do sjellin në jetë nuk është i seksit mashkull, preferojnë ta abortojnë. Ky fakt shqetësues është konfirmuar edhe nga studimi i kryer mbi balancat gjinore të lindjeve në vendin tonë. Studimi vë në dukje se popullsia shqiptare ka qenë e dominuar nga meshkujt për një kohë të gjatë, por vitet e fundit është vënë re një rritje e mëtejshme e këtij dominimi. Kjo pasi në vend po lindin më shumë meshkuj se femra, duke e çuar raportin e lindjeve femra-meshkuj në 100 femra të lindura kundrejt 111 meshkujve. Më i dukshëm ky fenomen i dëshirës për të sjellë në jetë vetëm meshkuj është në Dibër, Durrës, Lezhë dhe Fier, ndërsa më i zbutur në qytetet juglindore. (Gjoncaj: 2010).

Ligji Nr.8045, datë 7.12.1995 “Për ndërprerjen e shtatëzanisë” garanton respektimin e çdo qenie njerëzore që në fillim të jetës së tyre, pra që në fazën e konceptimit. Shtatëzania deri në 22 javë mund të ndërpritet për një sërë arsyes shëndetësore, përfshirë edhe ato psikosociale të përcaktuara, në zbatim të këtij ligji nga Ministria e Shëndetësisë. Në to nuk përfshihet aborti për zgjedhjen e seksit. Një tjetër ligj që ndihmon në frenimin e këtij fenomeni është edhe ai me numër 10 339, datë 28.10.2010 “Për Aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për të Drejtat e Njeriut dhe Biomjeksinë”. Një kapitull i veçantë i ligjit merr në mbrojtje personat që të mos diskriminohen, po ashtu parashikon zhvillimin e testeve gjenetike vetëm për shmangien e sëmundjeve gjenetike të trashëguara. Për herë të parë dy nene të veçanta të ligjit marrin në mbrojtje embrionet. Kështu, ndalohet përdorimi i teknikave që synojnë modifikimin e gjenomit njerëzor, si dhe zgjedhjes së gjinisë fëmijës së ardhshëm. Ky miratim i kësaj Konvente vjen duke vlerësuar se progresi në biologji dhe mjekësi duhet të përdoret për përfitimin e brezave të tanishëm dhe të ardhshëm, të ndërgjegjshëm se keqpërdorimi i biologjisë dhe mjekësisë mund të çojë në akte që rrezikojnë dinjitetin njerëzor dhe duke theksuar nevojën për bashkëpunim ndërkombëtar, në mënyrë që dhe gjithë popullata

¹⁰⁰ Sipas disa mjekeve të tjere *ne spitalet shtetërore dhe klinikat private) grupmoshat janë 15 deri në 19 vjeç.

shqiptare të mund të gëzojë përfitimet e biologjisë dhe mjekësisë, është parë e arsyeshme që edhe vendi jonë të aderojë në këtë Konventë”

Ndërsa neni 14 i ligjit flet pikërisht për mospërzgjedhjen e gjinisë duke cituar se: “Përdorimi i teknikave të riprodhimit me ndihmën e elementeve mjekësore nuk lejohet për qëllim të zgjedhjes së gjinisë së fëmijës së ardhshëm, përveç rasteve kur duhet të shmanget një sëmundje e rëndë e trashëguar e lidhur me gjininë. Për të gjitha sa më sipër, Ministria e Shëndetësisë e konsideron ndërprerjen e shtatëzanisë me qëllim për zgjedhjen e seksit fetal, si një veprim absurd, moralisht dhe ligjërisht të dënueshëm.

KAPITULLI V: E DREJTA E JETËS versus EUTANAZIA

5.1. Vështrim i përgjithshëm historik mbi konceptin e eutanazisë.

Për ligjvënësin dhe për shkencën e mjekësisë vazhdon të përbëjë një çështje delikate aplikimi i eutanazisë. Origjina e fjalës eutanazi vjen nga bashkimi i dy fjalëve greke "eu" që do të thotë e mirë, dhe "thanatos" do të thotë vdekje, pra koncepti embrional e konsideron eutanazinë si një vdekje të mirë, të lehtë, duke i dhënë fund jetës në një mënyrë për të lehtësuar dhimbjet dhe vuajtjet. Koncepti embrional i eutanazisë i jep asaj një dimension human duke e konsideruar si një zgjedhje të privilegjuar.(Otani, 2010:19).

Eutanazia për vetë rrethanat dhe nevojat me të cilat është përballur shoqëria i ka rrënjët të thella. Fillesat e saj në formën më embrionale, i gjejmë që në antikitet. Në Spartën e vjetër, fëmijët e porsalindur me keqformime vriteshin, ndërsa në ishullin Kos të Greqisë së vjetër, për personat e moshuar organizohej një gosti, në përfundim të së cilës ju ofrohej atyre të pinin një substancë helmuese.(Kuhse.2001:147) Platoni theksonte se mjekësia duhet të kujdeset për qytetarët me trup dhe mendje të shëndoshë, dhe duhet të lërë të vdesin ata që janë të dobët (Harris,2001: 70). Ndërsa në Betimin e Hipokratit, rreth vitit 420 (para Krishtit) parashikohej se: *“Nuk do t’i jap askujt, as me kërkesën e tij, një ilaç që shkakton vdekjen, apo t’i jap një këshillë me një qëllim të tillë”*. Me vonë, në periudhën klasike, në kushte të caktuara, ndihma në vetëvrasje pra “eutanazia” trajtohej si etike. Eutanazinë e gjejmë të përfshirë dhe në Kodin e Hamurabit i cili e trajtonte këtë fenomen si çështje etike. Në Testamentin e Vjetër citohet një rast konkret që dëshmon ekzistencën e eutanazisë ai i Saul (II Samuele 1,6-10): një ushtar vret Saulin me kërkesë të këtij të fundit, por Davidi në vazhdim dënon ushtarin me vdekje për kryerjen e vrasjes.(Harris,2001: 367)

Gjermania naziste është konsideruar si shembulli me makabër i përdorimit të eutanazisë, si pjesë e një programi asgjësimi, i cili sipas ideologjinë naziste quhej "higjienë racore". Sipas kësaj ideologjie ishte detyrë madhore e shtetit të përkujdesej për pastrimin e racës njerëzore dhe detyrë e tij të kujdesej vetëm për ata që ishin të shëndetshëm fizikisht dhe mendërisht. Shteti dhe njerëzimi nuk duhej të shteronte energjitë e tij për kujdesin ndaj të sëmurëve dhe racave "jo të pastra", si dhe duhej të parandalonte riprodhimin e tyre.

Programi i eutanazisë naziste "*Aktion T4*" u praktikua deri në vitin 1941, dhe nuk kishte për qëllim respektimin e dëshirës të të sëmurit për të shpëtuar nga vuajtjet, por aplikohet në këndvështrimin racor, me synim uljen e shpenzimeve shëndetësore shtetërore, duke u quajtur "eutanazi sociale". (Borry & Schotsmans & Dierickx, 2006;32) Në korrik të vitit 1933 u miratua "*Ligji për parandalimin e pasardhësve me sëmundje të trashëguara*" i cili parashikonte sterilizimin e detyruar të njerëzve që mendohej se kishin sëmundje të trashëguara të tilla si: skizofrenia, epilepsia, etj. Programi i sterilizimit përfshinte gjithashtu alkoolizimin kronik dhe forma të tjera të devijimit shoqëror. Ligji është administruar nga Ministria e Brendshme nën përgjegjësinë e Wilhelm Frick nëpërmjet gjykatave të shëndetësisë.

Pas miratimit të këtij ligji procesit të sterilizimit iu nënshtruan 360,000 njerëz në vitet 1933 - 1939. Brenda administratës naziste, disa sugjeruan se programi duhet të zgjerohet për njerëzit me aftësi të kufizuara fizike, por një ide e tillë u frenua pak a shumë duke qenë se një nga njerëzit më të fuqishëm të regjimit, Joseph Goebbels, kishte një këmbë të deformuar. Pas 1937 mungesa e krahut të punës në Gjermani, për shkak se djemtë e moshave të reja thirreshin në luftë, u vlerësua se çdokush i aftë për punë konsiderohet "i dobishëm" dhe në këtë mënyrë përjashtohet nga ligji, gjithashtu për këtë shkak shkalla e sterilizimit ra. (Bleuler, 1924: 2014). Më vonë ideja e sterilizimit për personat me pa aftësi të pjesshme fizike qoftë këto dhe të trashëgueshme u konsideruar si sjellje antisociale.

Shtete të tjera si: Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Suedia, Zvicra dhe vende të tjera gjithashtu kanë miratuar ligje që autorizojnë sterilizimin e klasave të caktuara të njerëzve. Për shembull, në mes të vitit 1935 dhe përgjatë vitit 1975 në Suedi janë sterilizuar 63,000 njerëz mbi baza eugjenike. Më vonë, përparimet në fushën e reanimacionit mjekësor, të pasqyruara edhe në media si p.sh rasti i agonive të zgjatura të Titos, Frankos, lindën përsëri diskutimin mbi eutanazinë. Duke iu referuar vdekjes ligji pozitiv shpesh flet për krim, organizatat dhe lëvizjet pro-eutanazinë, flasin për të drejta personale të pamohueshme ndërsa, kisha, në lidhje me jetën, gjithmonë ka folur për vlerë ndaj të cilës nuk mund të hiqet dorë. (Read & Masson, 2004:36).

5.2. Parimet e eutanazisë: universaliteti dhe utilitarizmi

Një nga parimet përgjithësisht të pranura të etikës, të paraqitura nga Kanti është se vetëm ato parime etike që mund të pranohen si rregull universal (pra që aplikohen njëloj për të gjithë) duhet të pranohen. Sipas kësaj teorie “ju duhet ta bëni diçka në qoftë se ju jeni të gatshëm për të bërë pikërisht të njëjtën gjë në rrethana saktësisht të ngjashme, pavarësisht se kush do të ishin ata persona, të afërm, familjarë etj”. Justifikimi për këtë rregull është i vështirë për t’u gjetur sepse kjo është vetëm një e vërtetë e qartë (Michalsen & Reinhart, 2006:32). Variacione të kësaj ideje gjenden në shumë besime fetare duke marrë si referim besimin kristian sipas të cilit duhet të "bëni tek të tjerët atë që do të dëshironit ta bënin të tjerët tek ju".

Një rregull është universal nëse ka vazhdimësi në formën e një ligji të pashkruar. Të vetmet rregulla të cilat janë moralisht të mira, janë ato të cilat mund të jenë të përgjithësuara. Pra, personat në favor të eutanazisë argumentojnë se duke i dhënë të gjithëve të drejtën për të pasur një vdekje të mirë përmes eutanazisë ajo është e pranueshme si një parim universal dhe se eutanazia është pra, moralisht e pranueshme. Por vetëm kjo nuk e justifikon eutanazinë. Parimi i universalitetit nuk jep arsyetim pozitiv për çdo rrethanë. Rregullat e vërteta morale duhet të jenë universale, por universaliteti nuk është i mjaftueshëm për të thënë se kemi të bëjmë me një rregull pozitiv moral. (Smith, 1997:39) Megjithatë eutanazia ndodh gjithsesi dhe përderisa ndodh është më mirë që të ketë një rregullim ligjor të përshtatshëm.

Utilitarizmi është besimi se rregullat morale duhet të jenë të projektuara për të prodhuar lumturinë e një numri sa më të madh të njerëzve. Nëse pranohet kjo si bazë për kodin tonë etik dhe, në fakt, kjo është bazë e etikës së shumë shoqërive, atëherë argumentet e mësipërme janë thelbësore. Nga një këndvështrim utilitar, eutanazia tregon se duke lejuar njerëzit të kenë një vdekje të mirë, në momentin që e vendosin ata vetë do t'i bënte ata më të lumtur sesa të jetonin në dhimbje prej sëmundjes së tyre, humbjes së dinjitetit dhe ankthit duke pritur një vdekje të ngadalshme e të dhimbshme. (Manoj, 2004:11) Por, duke llogaritur lumturinë totale njerëzore kundërshtarët e eutanazisë që pajtohen me utilitarizmin

në parim mund të pretendojnë se efektet negative tek familja, miqtë dhe personeli mjekësor - do të jenë më të mëdha, edhe pse lumturia është e vështirë të matet objektivisht.

5.3. Llojet e eutanazisë dhe cilësimi ligjor i tyre

Aktualisht përkufizimi që i është bërë eutanazisë është: *“Vdekja e përshpejtuar në kohë e personit që vuan nga një sëmundje e pashërueshme, vdekjeprurëse ose që shkakton anomali të rënda fizike të cilat rëndojnë shumë gjendjen psikike, emocionale apo fizike të të sëmurit, vdekje kjo që mund të shkaktohet në mënyra të ndryshme dhe nga subjekte të ndryshëm në bazë të dëshirës së qartë dhe të vazhdueshme të të sëmurit, me interes vetëm për t’u dhënë fund vuajtjeve të tij”* Ndryshe eutanazinë e quajnë 'vrasje për mëshirë', ndoshta duke menduar të sëmurin terminal dhe vuajtjet e zgjatura nga dhimbjet e padurueshme. (Beauchamp.&Davidson, 1979;4)

Proçesit të eutanazisë i nënshtrohen individët të cilët konsiderohen të sëmurë terminalë. Në kategorinë e të sëmurëve futen individët që kanë të dëmtuar rëndë cilësinë e jetës nga kushtet fizike të tilla si: paraliza, vështirësi të qëllitjes etj. Zakonisht një person që i nënshtrohet eutanazisë vuan nga një sëmundje e pashërueshme, por ka edhe kur disa njerëz duan që jeta e tyre të marrë fund. Megjithatë mendohet se dhimbja e padurueshme është arsyeja kryesore që njerëzit kërkojnë eutanazinë, disa anketa në SHBA dhe Holandë tregojnë se kërkesa për eutanazi për shkak të dhimbjeve të forta ishin më pak se një e treta. (Wreen,1988:48) Koncepti i *"së drejtës për të vdekur"*, që në mënyrë të pashmangshme nënkupton dhe përmban konceptin e *"vdekjes me dinjitet"*, *"vetëvrasjes me prokurë"*, *"eutanazisë vullnetare"* çka në thelb do të çonte në njohjen për këdo të *"së drejtës për t'i dhënë fund jetës edhe duke përdorur ndihmën e të tretëve"*. Në një kuptim më të gjerë të eutanazisë përfshihen shumë rryma mendimi, ku ndër më të spikaturat është ajo e liberalizmit të cilët njohin të drejtën për të vdekur. (Otani, 2010:19) Studiuesit të cilët janë kundër eutanazisë e konsiderojnë si një fjalë të zbukuruar e cila përdoret në vend të fjalës vdekje. (Emanuel, 1994:121) Studiues të shumtë kanë individualizuar disa forma të eutanazisë të cilat janë:

1. Eutanazia aktive
2. Eutanazia pasive
3. Eutanazia vullnetare
4. Eutanazia jo-vullnetare
5. Eutanazia indirekte
6. Vetëvrasja e asistuar

Më poshtë do të trajtojmë në mënyrë më të zgjeruar disa nga llojet e eutanazisë të cilat janë aplikuar në vendet ku ajo është e ligjëruar.

5.3.1. *Eutanazia aktive.*

Vepra e kundërligjshme ku nga veprimi ose mosveprim i hiqet jeta një personi tjetër, me dashje ose nga pakujdesia, përkufizohet si "vrasje". Vrasja me dashje cilësohet heqja e qëllimshme e pajustificuar e jetës së një personi tjetër (Elezi,2008:50). Eutanazia aktive e plotëson këtë definicion, në kuptimin që është shkak i vdekjes së personit. T'i shkaktosh vdekjen dikujt që është duke vdekur për shkak të një sëmundjeje, nuk ka ndryshim nga vrasja e tij. Ndërsa, përsa i përket qëllimit, ai që vret për mëshirë nuk mund të pretendojë se qëllimi i tij nuk ishte të vriste, por të lehtësonte personin tjetër nga vuajtjet. Nëse e vetmja mënyrë për të lehtësuar vuajtjet është të vrasësh dhe ai që vret e di këtë, atëherë ekziston qëllimi për të vlarë, pra plotësohet ana subjektive. Por, në praktikë duhet bërë kujdes për konstatimin e qëllimit, në këtë drejtim.

Në praktikën gjyqësore, vdekja e shkaktuar nga efektet anësore të njohura të një medikamenti, trajtohet në mënyrë të ndryshme nga dhënia e një medikamenti çfarëdolloj me qëllim primar shkaktimin e vdekjes së pacientit për motive mëshire, pra bëhet dallimi midis rastit kur mjeku i injekton pacientit *potassium kloride*, me rastin kur i injekton *morfinë* në situata të ngjashme.(Stolberg,2007:20). Në rastin e dhënies së një doze vdekjeprurëse *potassium kloride* pacientit, duhet të vërtetohen së bashku dy elemente që janë: motivi i mëshirës për pacientin dhe respektimi i vullnetit të këtij të fundit, për shkaktimin e vdekjes. Në një rast të praktikës gjyqësore, mjeku është deklaruar fajtor për tentativë vrasje dhe jo për vrasje, pasi nuk u provua nëse shkak i drejtpërdrejtë dhe i

domosdoshëm i vdekjes ishte veprimi i mjekut dhe jo sëmundja. Megjithatë, Gjykata në këtë rast u shpreh se, injektimi i *potassium kloride* tregonte se qëllimi primar i mjekut ishte shkaktimi i vdekjes së pacientit dhe jo lehtësimi i vuajtjes, dhe mjeku kishte kryer veprime të drejtpërdrejta, duke injektuar *potassium chloride*, për shkaktimin e vdekjes së pacientit.

Një mjek që i jep *morfinë* një pacienti që është i sëmurë nga sëmundje e pashërueshme me qëllim lehtësimin e dhimbjeve, parashikon se kjo ndikon edhe në përkeqësimin e frymëmarrjes dhe përshpejtimin e ardhjes së vdekjes së pacientit, megjithëse nuk e ka si qëllim. Në këtë rast mjeku nuk vepron në kundërshtim me ligjin, sepse dhënia e morfinës në disa rrethana është praktikë mjekësore e njohur dhe e lejuar me ligj. Pavarësisht se injektimi i *morfinës* dhe i *potassium klorid* kanë të njëjtin efekt, përdorimi i tyre nga ana e mjekut bën disa dallime. Në rastin e parë qëllimi është lehtësimi i vuajtjeve, ndërsa përshpejtimi i vdekjes nuk është i qëllimshëm por i parashikueshëm. Në rastin e dytë, qëllimi është shkaktimi i vdekjes së pacientit, si i vetmi mjet për lehtësimin e dhimbjeve të pacientit. Kur injektohet *morfinë*, kemi aplikimin e parimit të veprimit me efekt të dyfishtë. Në këto raste lind pyetja: A do të jetë e pranueshme kryerja e një veprimi të tillë? Si për shembull, një grua shtatëzënë, a mund të marrë një medikament që i nevojitet, por që do të rrezikonte jetën e fetusit? Një mjek, a duhet t'i japë pacientit një medikament që i lehtëson dhimbjet por që mund t'i shkaktojë vdekjen? Dhënia e një doze të konsiderueshme *morfine*, shkakton vdekjen e pacientit (frymëmarrjen) apo lejon pacientin të vdesë në paqe? Parimi i veprimit me efekt të dyfishtë përpunon natyrën e qëllimit në veprimet që shkaktojnë vdekjen e personit dhe që sjellin dy pasoja njëkohësisht. (Harris,2001:147). Sipas këtij parimi, një veprim i tillë i mjekut mund të jetë moralisht i pranueshëm, vetëm nëse do të plotësohen kushtet e mëposhtme, në mënyrë kumulative:

1. Veprimi është i mirë në vetvete (lehtësimi i vuajtjeve).
2. Qëllimi i veprimit është vetëm arritja e një efekti të mirë (lehtësimi i vuajtjeve dhe jo shkaktimi i vdekjes), ndërsa rezultati është i padëshirueshëm,
3. Efekti i mirë nuk duhet të jetë pasojë e efektit të keq, (pra vdekja e pacientit nuk është shkak që sjell si pasojë lehtësimin e vuajtjeve) por është pasojë e drejtpërdrejtë e veprimit.
4. Ky është i vetmi veprim nga i cili mund të arrihet ky rezultat.

Në legjislacionin tonë penal eutanazia aktive nuk parashikohet shprehimisht si vepër penale, në ndryshim nga disa legjislacione të huaja. Eutanazia aktive mund të jetë vullnetare ose jovullnetare. Marrja e pëlqimit të pacientit për kryerjen e eutanazisë nuk ka rëndësi për cilësimin ligjor të veprës, por merret parasysh nga gjykata në caktimin e dënimit. Shtrohet pyetja, mjeku i cili nuk ndërmerr trajtim të shpëtimit të jetës, me mosveprim, është po aq i fajshëm ligjërisht dhe moralisht, sa mjeku i cili me veprime aktive i shkakton vdekjen pacientit? Ekziston qëndrimi se dallimi midis tyre është i parëndësishëm përse kohë që: pasojat janë të njëjta (vdekja e pacientit); ekziston qëllimi, si në veprim (vrasja) edhe në mosveprim (zgjedhja e mosndërhyrjes); vepra penale e vrasjes mund të kryhet me veprim dhe me mosveprim. Por, ekziston edhe qëndrimi i kundërt, se qëllimi në rastin e mosveprimit nuk është të vrasësh dikë, pasi ekziston mundësia që pacienti të mos vdesë por të mbetet në jetë. Pra, nuk është ndërprerja e trajtimit të mbajtjes në jetë që vret pacientin, më shumë sesa procesi i sëmundjes nga e cila vuan pacienti.

5.3.2. Eutanazia pasive.

Në rastin e eutanazisë pasive vdekja e personit ka ardhur si pasojë e një mosveprimi. Pra, dikush lejon dikë të vdesë. Kjo mund të ndodhë duke u tërhequr trajtimin ose mbajtjen në trajtim:

1. Tërheqja e trajtimit: për shembull, shkëputja nga një makineri e cila ka qenë e nevojshme për të mbajtur një person të gjallë, në mënyrë që ai të vdesë prej sëmundjes se tij.
2. Trajtim i munguar, si për shembull, mos kryerjen e një operacioni që do të zgjaste jetën edhe pse për një kohë të shkurtër.

Tradicionalisht, eutanazia pasive është menduar si më tepër e pranueshme se eutanazia aktive. Në praktikë, kur pacienti apo familjarët e tij me anë të një pëlqimi me shkrim, nuk duan të shtyjnë apo zgjasin vdekjen për të sëmurin në stadin terminal mjekët lejohen të bashkëpunojnë në eutanazinë pasive (Rachels, 1975:80). Ndërsa nga pikëpamja ligjore, kur mjeku ka lënë një të sëmurë në një stad terminal, pa i dhënë ndihmën mjekësore, me

qëllim që të vdesë sa më shpejt, është e diskutueshme nëse përgjigjet për mosdhënie ndihme me pasojë vdekjen e pacientit apo për vrasje me mosveprim. Shpesh konsiderohet se trajtimi mjekësor nuk zgjat në mënyrë të vlerësueshme jetën dhe ndërprerja e trajtimit nuk është shkak i vdekjes apo i përshpejtimit të saj. Si rrjedhim mohohet vetë fakti i vrasjes, për arsye se vdekja është pasojë e vetme e drejtpërdrejtë e sëmundjes së pashërueshme të pacientit.

Por ekziston edhe mendimi i kundërt, ku mjeku duhet të përgjigjet për vrasje edhe pse vetëm ka përshpejtuar ardhjen e vdekjes, duke mos vepruar. Si rrjedhim, nuk i lejohej mjekut të ndërpresë teknikat e trajtimit reanimues vetëm sepse e gjykon si të pashmangshme, ardhjen e vdekjes. (Mannes,1975:27) Si shembull këtu sjellim praktikën gjyqësore italiane e cila ka pranuar se duhet të ekzistojnë dy kushte themelore për të marrë autorizimin nga gjykata, për ndërprerjen e ushqimit artificial:

1. Gjendja vegetative e shëndetit duhet të jetë e pakthyeshme dhe të mos ekzistojë asnjë bazë shkencore mjekësore, sipas standarteve të njohura në nivel ndërkombëtar, që të ketë ndonjë mundësi rikuperimi të ndërgjegjes;
2. Duhet të provohet në mënyrë të qartë dhe bindëse, që pacienti përpara së të humbte ndërgjegjen, do të ishte kundër vazhdimit të kurave.

Nëse nuk vërtetohet qoftë dhe një nga kushtet, Gjykata e Larte Italiane ka vendosur se gjyqtari duhet të mos japë autorizimin për ndërprerjen e ushqimit artificial. Ndërsa në praktikën Angleze kjo është e lidhur gjithmonë me respektimin e vullnetit të pacientit, nëse është në interesin më të mirë të tij të vazhdojë trajtimin e mbajtjes në jetë. (Emanuel,1994:121) Mund të jetë në interesin më të mirë të pacientit të vdesë sesa t'i nënshtrohet një trajtimi të mbajtjes në jetë, kur cilësia e jetës së tij është shumë e varfër dhe e shoqëruar me vuajtje të rënda.

5.3.3. Eutanazia vullnetare dhe jo vullnetare

Eutanazi vullnetare kemi kur pacienti me kërkesën e tij të vendosur në autonomi të plotë dëshiron të vdesë. Ndërsa eutanazia jo-vullnetare ndodh atëherë kur personi është i pavullnetshëm ose ndryshe i paaftë, si fëmijët e mitur apo personat me inteligjencë

krejtësisht të ulët, të bëjnë një zgjedhje kuptimplotë ndërmjet të jetuarit dhe vdekjes. Në këtë rast, një person i përshtatshëm merr vendimin në vend të tyre.

Gjithashtu, eutanazia jo-vullnetare përfshin edhe rastet kur, personi është një fëmijë i mitur, i cili edhe pse është në kushte mendore dhe fizike të marrë vendime vetë, nuk i lejohet nga ligji pasi nuk është madhor dhe nuk ka zotësi për të vepruar. Edhe në këtë rast, është dikush tjetër që merr vendimet në emër të tyre, dhe kryesisht janë prindërit, të cilët kanë edhe kujdestarinë mbi fëmijët. Në rastin e eutanazisë vullnetare kemi vullnetin e shprehur të personit për ardhjen e vdekjes. Kjo shfaqje e vullnetit mund të shfaqet në mënyra të tilla (Perrett,1996:22) si: duke kërkuar ndihmë të vdesë; duke refuzuar trajtimin e rëndë mjekësor; duke kërkuar trajtimin mjekësor të ndalet, ose makineria e mbajtjes në jetë të fiket; duke refuzuar për të ngrënë, etj.

Në rastet e eutanazisë jo-vullnetare, personi nuk mund të marrë vetë një vendim ose nuk mundet të bëjë të njohura dëshirat e tij. Kjo mund të ndodhë në rastet kur personi është në gjendje kome; personi është në moshë të mitur, pra, fëmijë ose personi është mendërisht i paaftë, etj.

Përgjithësisht në eutanazinë jo-vullnetare, personi dëshiron të jetojë, ose të paktën nuk është i aftë të shprehë të kundërtën, por gjithsesi dikush i cili kujdeset për të mund të marrë një vendim të tillë. Kjo është zakonisht vrasje, por jo gjithmonë.(Rachels,1975:80). Le të sjellim disa shembuj.

Një ushtar ka marrë plagë nga plumbat dhe si pasojë i është hapur një plagë e madhe në stomak. Ai përjeton dhimbje të mëdha dhe ndodhet në agoni. Ai i lutet mjekut të ushtrisë për të shpëtuar jetën e tij. Mjeku e di se ai do të vdesë në dhjetë minutat e ardhshme çfarëdo që të ndodhë. Doktorin nuk ka më ilaçe qetësuese për dhimbjen me vete, ndërkohe ai vendos për të kursyer dhimbjen e mëtejshme të ushtarit dhe i qëllon me armë për të vdekur.

Një person është parë në një dritare të katit të 10-të një ndërtese të djegur. Rrobat e tij janë në zjarr dhe zjarrfikësja nuk ka mbërritur ende. Personi ulërin për ndihmë. Një kalimtar aty afër kupton se brenda disa sekondave personi do të vuajë një vdekje plot agoni nga djegiet. Ai ka një pushkë me vete dhe e qëllon personin në flakë në mënyrë që ai të vdesë. (Emanuel,1994:121) Shumë raste të tilla të ngjashme ndodhen në 11 shtator të vitit

2001 kur u qëlluan 2 kullat binjake. Në këtë ngjarje tragjike të njerëzimit ndërsa ndërtesat digjeshin pa asnjë rrugëdalje shiheshin persona në flakë të cilët hidheshin nga dritaret e ndërtesave për të vrrarë veten. Në këto dy raste jemi në kushtet e përdorimit të eutanazisë vullnetare.

5.3.4. Eutanazia indirekte dhe doktrina e efektit të dyfishtë.

Eutanazia indirekte ka të bëjë me sigurimin e trajtimeve, zakonisht për të reduktuar dhimbjen, të cilat kanë si efekte anësore shpejtimin e vdekjes së pacientit. Në këtë rast, meqë qëllimi kryesor nuk është të vrasësh, kjo shihet nga disa grupime të ndryshme, si një veprim moralisht i pranueshëm. Një justifikim përgjatë këtyre linjave është quajtur zyrtarisht doktrina e efektit të dyfishtë. Kjo doktrinë parashtron se, në qoftë se, duke bërë diçka moralisht të mirë e cila shoqërohet nga një efekt anësor moralisht i keq, është etike të supozohet se efekti anësor i keq nuk ishte menduar. Kjo është e vërtetë edhe në qoftë se parashikohet se efekti i keq ndoshta do të ndodhë. (Dowbiggin,2007:64) Parimi është përdorur për të justifikuar rastin kur një mjek i jep drogë një pacienti për të lehtësuar dhimbjet dhe simptomat e sëmundjes, edhe pse ai e di se duke bërë këtë mund të shkurtojë jetën e pacientit. Kjo për shkak se mjeku nuk është drejtuar direkt në vrasjen e pacientit, rezultati i keq, vdekja e pacientit, është një efekt anësor i rezultatit të mirë për të zvogëluar dhimbjet e pacientit.

Shumë mjekë përdorin këtë doktrinë për të justifikuar përdorimin e dozave të larta të barnave të tilla si morfina, me qëllim lehtësimin e vuajtjeve në pacientët e sëmurë-terminalë, edhe pse ata e dinë se droga ka të ngjarë të shkaktojë vdekjen e pacientit më shpejt.(Ramsay,2011:308) Faktorët e përfshirë në doktrinën e efektit të dyfishtë janë:

1. Rezultati i keq nuk duhet të jetë mjet për të arritur një të mirë. Pra, nëse e vetmja mënyrë për të lehtësuar dhimbjen e pacientit është vrasja e tij, doktrina e efektit të dyfishtë nuk zbatohet.
2. Ky veprim duhet të jetë proporcional me shkakun. Nëse mjeku i jep një pacienti një dozë qetësuesi (droge) të madhe me të cilën është i sigurt se e vret atë, dhe kjo dozë është shumë më e madhe se doza e nevojshme për të kontrolluar dhimbjen e tij,

atëherë ky mjek nuk mund të përdorë për t'u mbrojtur doktrinën e efektit të dyfishtë për të treguar se çfarë bëri ishte e drejtë.

3. Ky veprim duhet gjithashtu të jetë ai i përshtatshmi.

Mjeku duhet t'i japë pacientit ilaçin e duhur. Nëse ai i jep pacientit një dozë fatale droge (qetësuesi), është e padobishme mbrojtja se qëllimi ishte për të lehtësuar simptomat, të vjellat, pasi droga nuk ka ndonjë efekt në të vjella. Mjeku gjithashtu duhet t'i japë pacientit ilaçin e duhur për simptomat e tij. Nëse ai i jep pacientit një dozë fatale qetësuesi për dhimbjet, është e padobishme mbrojtja duke thënë se qëllimi ishte për të lehtësuar dhimbjet në qoftë se pacienti nuk kishte dhimbje por vështirësi në frymëmarrje. (Michalsen & Reinhart, 2006:32). Pacienti duhet të jetë në gjendje terminale ndaj në rast se mjeku i jep pacientit një dozë të lartë qetësuesi për dhimbjet dhe në kushtet e mos marrjes së qetësuesit, ai do të ishte shëruar nga sëmundja e tij apo plaga, është e padobishme që mjeku të mbrohet duke thënë se qëllimi i tij ishte lehtësimi i dhimbjeve. Kjo vlen edhe në qoftë se nuk do të kishte asnjë mënyrë tjetër për të kontrolluar dhimbjen e pacientit.

Disa filozofë mendojnë se ky argument mund të përdoret shumë mirë për të mirën e atij që vendos të shkaktojë vdekjen. Ne jemi përgjegjës për të gjitha pasojat e veprimeve tona dhe në qoftë se ne mund të parashikojmë dy efekte të veprimit tonë, ne duhet të marrim përgjegjësinë morale për të dy efektet, duke mos u përpjekur të shmangemi me pretendimin se kishim për qëllim vetëm efektin që i përshtatet. Synimi është i parëndësishëm nëse disa janë të mendimit se disa akte janë objektivisht të drejtë ose të gabuar, dhe se qëllimi i personit që i bën ato është i parëndësishëm. (Gurney, 1972:237) Por shumica e sistemeve ligjore e konsiderojnë qëllimin e një personi si një element jetësor për të vendosur nëse ata kanë kryer një krim, dhe se sa serioz është ky krim në rastet kur ka shkaktuar vdekjen.

Filozofë të tjerë mendojnë se Doktrina e efektit të dyfishtë supozon se ne mendojmë se vdekja është gjithmonë e keqe. Në qoftë se jeta do të vazhdonte normalisht atëherë ky veprim nuk do të justifikohet në lidhje me pacientin, por gjërat negative si dhimbja dhe vuajtja e bëjnë vdekjen një gjë të mirë, dhe ne nuk kemi nevojë të përdorim doktrinën e efektit të dyfishtë. Efekt të dyfishtë mund të prodhojë edhe një rezultat i papritur moral. Nëse ju mendoni se një vdekje e shpejtë është më mirë se një e ngadalshme, doktrina e

efektit të dyfishtë do të tregonte se një mjek i cili ka për qëllim të vrasë pacientin është moralisht superior ndaj një mjeku i cili thjesht ka për qëllim të lehtësojë dhimbjet.

5.3.5. Vetëvrasja e asistuar

Vetëvrasja e asistuar i referohet rasteve kur personi i cili është duke vdekur, ka nevojë për ndihmën e dikujt tjetër në kryerjen e këtij veprimi. Kjo ndihmë mund të jetë edhe thjeshtë në formën e sigurimit të drogave apo substancave të tilla, nga një doktor, anëtar i familjes apo çdo person tjetër. (Wreen,1988:48) Ndihma që mund të japë një person i tretë për realizimin e vetëvrasjes, përbën një çështje që mund të diskutohet nga pikëpamja etike dhe ligjore. Megjithatë kryerja e vetëvrasjes nuk konsiderohet në asnjë vend si veprim që dënohet penalisht, ndihma që jepet për shkaktimin e vetëvrasjes, në shumë vende përbën vepër penale. Në Angli dhe Kanada, për këtë vepër penale parashikohen dënime me burg deri në 14 vjet. Rastet praktike kanë qenë të pakta, por janë bërë propozime në drejtim të rishikimit të masave të dënimit, dhe madje në disa vende, të depenalizimit të kësaj lloji veprë.

Legjislacioni ynë penal nuk e parashikon dënimin e tentativës së vetëvrasjes. Dhënia ndihmë në vetëvrasje nuk parashikohet si figurë e veçantë e veprës penale, por në nenin 99 të Kodit Penal, parashikohet shkaktimi i vetëvrasjes si vepër penale: *“Shkaktimi i vetëvrasjes ose i tentativës së vetëvrasjes të një personi, si rrjedhojë e trajtimit të keq sistematik ose nga sjellje të tjera sistematike që prekin rëndë dinjitetin, të kryera nga personi që e ka në varësi materiale apo çfarëdolloj varësie tjetër”*.¹⁰¹ Kjo vepër penale nuk mund të aplikohet në rastin konkret, për arsye se në rastin e ndihmës që mund t’i japë një person një tjetri për realizimin e vetëvrasjes, nuk kemi të bëjmë as me trajtim të keq sistematik as me sjellje të tjera sistematike, që prekin rëndë dinjitetin e njeriut. Pra, duke qenë se mungojnë elementet e anës objektive të kësaj veprë dhe personi nuk mund të përgjigjet për veprën penale të vrasjes, për arsye se ai thjesht e ka ndihmuar viktimën me mjete, ilaçe apo këshilla, atëherë arrijmë në konkluzionin se ndihma në vetëvrasje nuk

¹⁰¹ Shih nenin 99 të Kodit Penal i Republikës së Shqipërisë.

parashikohet si vepër penale nga legjislacioni ynë penal. Ndhmës në këtë rast quhen personat që me këshilla, udhëzime, dhënie mjetesh, largim të pengesave, ndihmojnë në kryerjen e vetëvrasjes nga viktimat. Sipas legjislacionit dhe praktikës gjyqësore italiane, personat që ndihmojnë apo asistojnë në vetëvrasje do të përgjigjen penalisht. (Stolberg,2007:27) Kur personi që vetëvritet është i mitur nën moshën 14 vjeç apo i papërgjegjshëm, nuk aplikohet kjo vepër penale por dispozitat e përgjithshme për vrasje.

Nga ana objektive, kjo vepër realizohet me pjesëmarrjen fizike apo psikike, në vetëvrasjen e dikujt tjetër. Me pjesëmarrje fizike kemi të bëjmë kur personi pajis apo ndihmon me mjetet e nevojshme në kryerjen e vetëvrasjes, duke lehtësuar kryerjen e saj. Me pjesëmarrje psikike kemi të bëjmë kur dikush vepron për të bindur dikë të kryejë vetëvrasjen. Duhet që të ekzistojë edhe lidhja shkakësore midis veprimit të personit dhe ardhjes së pasojës. Nëse veprimi i personit nuk ka pasur asnjë ndikim fizik apo psikik mbi ardhjen e pasojës, atëherë ky person nuk do të mbajë përgjegjësi penale. Ndërsa kur si rezultat i dhënies së ndihmës nuk ka ardhur si pasojë vdekja, por, personi ka pësuar dëmtime të rënda ose shumë të rënda, ai që ka dhënë ndihmën do të përgjigjet për dhënie ndihmë për vetëvrasje e mbetur në tentativë. (Jotkovitz,2006:24). Nga ana subjektive, kur ekziston vullneti për të bashkëpunuar, personi parashikon mundësinë e ardhjes së pasojave dhe kontribuon në ardhjen e tyre. Në rast se subjekti e ndihmon duke i dhënë barin vdekjeprurës, por pa pasur vullnet për të bashkëpunuar nuk do mbajë përgjegjësi penale. Në rast kur një person shkon te farmacisti dhe i kërkon *fotoksinë* a ndonjë bar tjetër vdekjeprurës, farmacisti ia jep këtë duke parashikuar mundësinë se ky mund ta përdorë ose jo edhe për qëllime vetëvrasjeje, por nuk e dëshiron këtë.

5.3.6. Urdhërat DNR si një formë eutanzie pasive

DNR-të janë urdhra "*Mos më rigjallëroni*" të pacientit, të cilët janë projektuar për të parandaluar vuajtje të panevojshme. Një urdhër DNR në dosjen e pacientit do të thotë se një mjeku nuk i kërkohet të bëjë tentativa të ringjallë një pacient në qoftë se zemra e tij ndalon. Rrethanat e zakonshme në të cilat është i nevojshëm një urdhër i tillë janë kur nuk ka asnjë përfitim të pacientit dhe kur ngarkesat janë mbizotëruese nga

përfitimet.(Wreen,1988:48). Edhe pse DNR-të mund të konsiderohen si një formë e eutanazisë pasive, nuk janë të diskutueshme nëse me ata në thelb është abuzuar apo jo, pasi janë të destinuar për të parandaluar pacientët që vuajnë në mënyrë të pakuptimtë nga efektet e këqija që reanimimi mund të shkaktojë: për shembull, në rast se kemi të bëjmë me kocka të copëtuara, dëmtim të rëndë të trurit etj. Udhëzimet e lëshuara nga Shoqata Mjekësore Britanike dhe *Royal College of Nursing* parashtrojnë se urdhrat DNR duhet të lëshohen vetëm pas diskutimit me pacientët apo familjen e tyre. Edhe pse diskutimet me pacientët dhe të afërmit e tyre në lidhje me tentativën e ringjalljes apo jo mund të jenë të vështira, mjekët pranojnë se kjo nuk është arsye që diskutimet mos të bëhen. Rastet më të vështira për diskutim janë zakonisht ato që përfshijnë pacientët që e dinë se janë duke vdekur, vuajnë shumë për shkak të dhimbjeve por që mund të jetojnë edhe për disa muaj në rast se përdorin tentativat e rigjallërimit. Në fushën profesionale mjekësore ka mjaft udhëzime për rrethanat në të cilat mund të nxirret një DNR dhe është arritur në përfundimin se urdhrat DNR nxirren vetëm në rastet kur:

1. Gjendja e pacientit është e tillë që reanimimi nuk ka gjasa të ketë sukses.
2. Pacienti mendërisht i aftë, ka deklaruar vazhdimisht ose shënuar faktin se nuk dëshiron të ringjallet.
3. Një ringjallje e suksesshme nuk do të ishte në interesin më të mirë të pacientit, sepse kjo do të çonte në një cilësi të dobët të jetës

Në Mbretërinë e Bashkuar, politikat lidhur me çështjen duhet të sigurojnë:.

- Një politikë që respekton të drejtat e pacientëve në lidhje me ringjalljen apo jo.
- Politika është në dispozicion për pacientët, familjet dhe kujdestarët.
- Politika është vënë nën auditim dhe monitorohet rregullisht. (Emanuel,1994:121)

Keqpërdorimi i DNR-së. Udhëzime më të qarta mbi DNR-të u miratuan sërish në Britaninë e Madhe në vitin 2000, pasi një numër i madh pacientësh në dukje të shëndetshëm, zbuluan se kishin urdhra DNR ose urdhër "Mos më ringjallni" shkruar në shënimet e tyre mjekësore pa u konsultuar me ta apo të afërmit e tyre. Moshat e thyera në Britaninë e Madhe deklaruan se kishin frikë dhe se ndjeheshin në rrezik për të mos qenë ringjallur thjesht për shkak të moshës së tyre dhe se shumë prej tyre mund të mos e merrnin vesh kurrë që kanë patur një urdhër DNR në dosjen e tyre.

5.4. Kuptimi i Eutanazisë në bazë të nenit 2 KEDNJ

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut trajton të drejtën e jetës në nenin 2 të saj. Në bazë të këtij neni të KEDNJ-së është ngritur pyetja nëse, në rrethana të caktuara, individët mund të shkelin ndalimin e heqjes së jetës, në mënyrë të veçantë në rastin e një vetëvrasjeje të ndihmuar, eutanazisë dhe heqjes së trajtimit mjekësor. A mund apo a duhet që Shteti të “mbrojë” të drejtën për jetën edhe të një personi që nuk dëshiron të jetojë më, duke dalë pra në kundërshtim me vullnetin e atij personi? A kanë individët në bazë të Konventës jo vetëm një të drejtë për jetën, dhe për të jetuar – por edhe një të drejtë për të vdekur ashtu siç e vendosin dhe kur e vendosin vetë? Dhe së fundi, a mund të lejojë Shteti dhënien fund të jetës me qëllim që ti jepet fund vuajtjeve, edhe nëse personi në fjalë nuk mund të shprehë vullnetin e tij në këtë rast? Pavarësisht interpretimeve të ndryshme që i janë bërë nenit 2 KEDNJ-së, ky nen nuk e lejon eutanazinë.

Në raste të tjera është shtruar kjo pyetje duke përdorur si bazë ligjore nenin 8 të KEDNJ-së,¹⁰² ku parashikohet e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare? Në praktikë, në Shtetet Anëtare, pyetja tenton të jetë në lidhje me faktin nëse aparatet që mbajnë në jetë pacientët mund të fiken edhe përpara se personi të konsiderohet si “klinikisht i vdekur” (kurdo që mund të ndodhë) me qëllim që të mos shtohet pa arsye procesi i vdekjes. Pyetja që lind në bazë të Konventës në çështje të tilla është nëse ligji në një Shtet Anëtar që lejon fikjen e aparatit që mban në jetë pacientët mbron ende në mënyrën e duhur të drejtën për jetën të personit në fjalë. Megjithatë, edhe në këto kushte, kjo pyetje nuk është hasur në jurisprudencën e Gjykatës. Në dritën e precedentit për kërkesat në lidhje me ndihmën e dhënë për vetëvrasje që diskutohet më poshtë, ka të ngjarë që Gjykata, nëse, dhe kur përballet me këtë çështje, do t’i lërë një hapësirë të gjerë vlerësimi Shteteve. Pyetja ka lidhje të ngushtë dhe në fakt hedh dritë mbi pyetjen e dytë: nëse është e lejueshme që të jepet trajtim analgjezik për një person në gjendje terminale

¹⁰² Shih nenin 8 të KEDNJ-së ku thuhet se “Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve.”

apo që po vdes dhe nëse ky trajtim ka efekte anësore të përshpejtimin të vdekjes së pacientit. Për këtë çështje, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës rekomandon se Shtetet Anëtare duhet: Të sigurojnë që, përveç kur pacienti zgjedh ndryshe, një person me gjendje terminale apo që është duke vdekur, të marrë përkujdes të duhur për qetësimin e dhimbjeve dhe analgjezik, edhe nëse ky trajtim si efekt anësor mund të kontribuojë në shkurtimin e jetës së individit (Rekomandimi 1418 (1999), paragrafi 9, në (a)(vii)).

Në nenin 8 të KEDNJ-së duhet të theksojmë se përjashtohet eutanazia aktive.¹⁰³ Mbi bazën e këtij neni rekomandohet që shtetet anëtare ftohen të krijojnë komisione kombëtare, të cilat do të jenë përgjegjëse për shqyrtimin e ankesave kundër mjekëve dhe të raportojnë përfundimet e tyre tek Këshilli i Evropës. Rekomandimi ngre çështjen e heqjes së ndërhyrjes për zgjatjen e jetës, në rastet e sëmundjeve në gjendje preagonike dhe të sëmundjeve si rezultat i terapive analgjezive "pushtuese".

Në lidhje me faktin nëse eutanazia mund të jetë në përputhje me Konventën edhe në mungesë të një shprehjeje të qartë të vullnetit të personit në fjalë – gjithashtu nuk është përcaktuar nga organet e Konventës. Këtu gjithashtu ka në fakt deri diku një motiv më të qartë në kuptimin që këto “vrasje të mëshirshme” duket qartë se konsiderohen si të pranueshme në Rekomandimin 1418 (1999), dhe në faktin që asnjë Shtet Anëtar i Këshillit të Evropës nuk lejon ndërprerjen aktive të jetës (siç u kundërshtua me heqjen e aparatit që mbante në jetë pacientin si në çështjen e mësipërme të Z. A), përveç me kërkesën e vetë pacientit. Për shkak të këtij kompromisi në dukje, dhe në bazë të theksit që i vë Gjykata “autonomisë personale”, siç u trajtua më sipër, është e mundur (madje edhe me probabilitet) që Gjykata, kur ndeshet më këtë pyetje, të krijojë përshtypjen se Shtetet që do ta lejojnë një gjë të tillë mund të mos arrijnë të përmbushin detyrimin e tyre për të mbrojtur jetën – por shumë do të varet nga rrethanat e çështjes. Mbi eutanazinë dhe problemet e tjera të civilizimit bashkëkohor duhet të realizohen diskutime, studime akademike dhe shkencore me qëllim që të arrihet të ndërtohet një draft i cili do të rregullonte këtë proces

¹⁰³Shih nenin 7 të KEDNJ-së ku thuhet se “Askush nuk mund të dënohet për një veprim ose një mosveprim që, në momentin kur është kryer, nuk përbënte vepër penale sipas të drejtës së brendshme ose ndërkombëtare. Po ashtu, nuk mund të jepet një dënim më i rëndë se ai që ishte i zbatueshëm në momentin kur është kryer vepra penale. Ky nen nuk do të ndikojë mbi gjykimin dhe dënimin e një personi për një veprim ose mosveprim, i cili, në momentin kur është kryer, quhej vepër penale sipas parimeve të përgjithshme të së drejtës, të njohura nga kombet e qytetëruara.

dhe do të minimizonte abuzimet që mund të lindin nga praktikimi i saj. (Emanuel, 1994:121)

5.5. Jurisprudenca e paktë e GJEDNJ-së lidhur me eutanazinë.

Të vetmet çështje në këtë fushë kanë pasur të bëjnë me grupin e pyetjeve: nëse një person që është i sëmurë rëndë fizikisht, por që gëzon shëndet të plotë mendërisht ka të drejtë të zgjedhë që të vdesë duke kryer më mirë vetëvrasje, sesa të vazhdojë të jetojë? Dhe nëse ndodh kështu, nëse ai person mund të kërkojë asistencë nga të tjerët për t'i dhënë fund jetës, apo nëse Shteti ka të drejtë apo detyrim për të ndërhyrë në parandalimin e sa më sipër. Gjykata ka shqyrtuar këto pyetje në periudha të ndryshme, në situata të ndryshme dhe duke iu referuar jo vetëm Nenit 2, por edhe neneve të tjera të Konventës. Në veçanti i ka lidhur analizat e saj në lidhje me Nenet 2, 3 dhe 8 në mënyrë të tillë që të demonstrojë përjashtjen e saj ndaj të drejtave që mbrohen në Konventë.

Çështja e parë në këtë fushë është çështja *X kundër Gjermanisë* e vitit 1984 kishte të bënte me një të burgosur që kishte bërë një grevë urie dhe më pas ishte ushqyer forcërisht nga autoritetet. X u ankua për këtë trajtim duke argumentuar se përbënte trajtim çnjerëzor dhe poshtërues duke qenë në kundërshtim me Nenin 3 të Konventës. Megjithatë ai nuk argumentoi qartë se në bazë të Konventës ai kishte të drejtën e tij për të zgjedhur për të vdekur duke e vrarë veten me anë të grevës së urisë. Komisioni e hodhi poshtë kërkesën e tij. Sipas mendimit të Komisionit ushqimi me zor i një personi përfshin, në fakt, elementë poshtërues që në rrethana të caktuara mund të konsiderohen se ndalohen nga Neni 3 i Konventës. Megjithatë, në bazë të Konventës, Palët e Larta Kontraktuese kanë gjithashtu detyrimin për t'i siguruar çdokujt të drejtën për jetën siç parashtrohet në Nenin 2. Një detyrim i tillë në rrethana të caktuara duhet të nxisë ndërmarrjen e hapave pozitive nga ana e Palëve Kontraktuese, në veçanti masa aktive për të shpëtuar jetë kur autoritetet e kanë të burgosur e nën mbikëqyrjen e tyre personin në fjalë. Kur, si në rastin në fjalë, një person i burgosur bën një grevë urie, kjo pashmangshmërisht çon në konflikt midis së drejtës së personit për integritet fizik dhe detyrimit në bazë të Nenit 2 të Palëve të Larta Kontraktuese – një konflikt, në fakt, që nuk zgjidhet vetëm me anë të Konventës. (Korff, 2006: 19).

Një nga çështjet që mund të merret si referencë në lidhje me pyetjen e përgjithshme rreth së “drejtës për të vdekur”, është ajo e *Sanles Sanles kundër Spanjës*. Kjo çështje kishte lidhje me një burrë, Z. Sampedro, i cili kishte qenë tetraplegjik që nga mosha njëzet e pesë vjeçare, dhe që nga viti 1993, kur ishte rreth pesëdhjetë vjeç, ishte përpjekur të njihej nga gjykatat spanjolle pretendimi i tij për të drejtën për t’i dhënë fund jetës së tij me ndihmën e të tjerëve (duke përfshirë në veçanti doktorin e tij), pa ndërhyrje nga ana e Shtetit. Gjithsesi aplikuesi vdiq përpara se procesi gjyqësor në Spanjë të përfundonte dhe e afërmja që caktoi ai që të ndiqte çështjen e tij, Znj. Sanles Sanles, u konsiderua nga gjykatat spanjolle dhe nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut se nuk kishte të drejtë të përfaqësonte çështjen, d.m.th., në seancën vijuese nuk do të konsiderohej si “viktima” e pretenduar e shkeljes së Konventës.¹⁰⁴

5.5.1. Çështja *Dianne Pretty kundër Mbretërisë së Bashkuar*

Pyetjet e ngritura në *Sanles Sanles* u sollën përpara Gjykatës, në fakt, në çështjen vijuese të *Dianne Pretty kundër Mbretërisë së Bashkuar*. Në vitin 2002 GJEDNJ-ja është ballafaquar me çështjen e vetëvrasjes së asistuar, në legjislacionin e vendit, dhe mori vendim për pranueshmërinë e ankesës që thirrej në nenin 8, duke iu referuar shprehimisht në këtë mënyrë për herë të parë konceptit të autonomisë personale. Paditësja, e cila vuante nga pasojat shkatërruese të një sëmundje degjeneruese që shkaktonte kushte përkeqësuese shëndetësore dhe ishte shkak i vuajtjeve të mëdha fizike dhe mendore, ka kërkuar të drejtën për të përfunduar jetën e saj me ndihmën e bashkëshortit. Nga pikëpamja e paditëses, vendimi i saj për të zgjedhur mënyrën e vdekjes duhej të shihej si pjesë e të jetuarit, e cila pa dyshim mbrohet përmes nenit 8. Duke vendosur për pranueshmërinë e kësaj padie, Gjykata deklaroi se respektimi i dinjitetit dhe lirive njerëzore qëndron në thelbin e Konventës. Duke mos mohuar në asnjë mënyrë parimin se jeta është e shenjtë dhe e mbrojtur me Konventë, Gjykata ka konsideruar se sipas nenit 8 nocioni i cilësisë së jetës fiton rëndësinë e vet.

¹⁰⁴*Sanles Sanles kundër Spanjës*, Vendimi për Pranueshmërinë i 20 tetorit 2000.

Paditësja në këtë rast pavarësisht se ishte në pamundësi të plotë fizike, aftësia intelektuale për të gjykuar situatën e saj dhe çfarë ajo dëshironte të bënte, nuk ishte e cënuar. Gjykata nuk është e përgatitur për të përjashtuar se kjo përbën ndërhyrje në të drejtën e saj për respektim të jetës private, siç garantohet përmes nenit 8 të Konventës dhe se e drejta për të zgjedhur nëse personi donte të jetonte apo jo ishte një e drejtë e karakterit ngushtësisht personal. Për herë të parë GJEDNJ njohu të drejtën e personit të zgjedhë apo jo "për të vdekur".

Në Mbretërinë e Bashkuar, kryerja e vetëvrasjes nuk përbën vepër penale, por ndihma për të kryer dikush vetëvrasje përbën vepër penale në fakt (në bazë të Ligjit për Vetëvrasjen të vitit 1961). Megjithatë ndjekja mund të fillojë vetëm me pëlqimin e Drejtorit të Ndjekjeve Publike, një zyrtar i lartë gjyqësor që mund të ushtrojë lirinë e tij të veprimit në këtë çështje. Znj. Pretty pra kërkoi sigurimin nga ana e këtij Drejtori që nuk do të ndiqte penalisht bashkëshortin e saj nëse ai do ta ndihmonte që ajo të kryente vetëvrasje në përputhje me vullnetin e saj, por Drejtori e refuzoi këtë gjë. Gjykatat e Mbretërisë së Bashkuar mbështetën vendimin e Drejtorit për të mos dhënë pëlqimin në këtë sipërmarrje pasi analizuan në detaj precedentin e Komisionit Evropian dhe Gjykatës për të Drejtat e Njeriut. Znj. Pretty atëherë iu drejtua Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Gjykata e pranoi çështjen dhe, përveç pritjes së pretendimeve nga kërkuesi dhe qeveria e paditur, lejoi edhe ndërhyrje nga palët e treta, nga Voluntary Euthanasia Society – Shoqata Vullnetare e Eutanazisë (një organizatë në Mbretërinë e Bashkuar që është në favor të eutanazisë vullnetare) dhe nga Konferenca e Peshkopëve [Romak] Katolik të Anglisë dhe Uellsit. Gjykata citoi edhe pjesë nga paragrafi 9 i Rekomandimit 1418 (1999) i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës që është përmendur më parë, në të cilin Asambleja rekomandon: ... që Komiteti i Ministrave të nxisë Shtetet anëtare të Këshillit të Evropës që ata të respektojnë e të mbrojnë dinjitetin e personave në gjendje terminale, apo që janë duke vdekur në të gjitha rrethanat: ...c:duke mbështetur ndalimin kundër marrjes së paqëllimshme të jetës së personave në gjendje terminale apo që janë duke vdekur, ndërsa: i. njohja e së drejtës për jetën, veçanërisht në lidhje me personat në gjendje terminale apo që janë duke vdekur, garantohet nga Shtetet anëtare në përputhje me Nenin 2 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut që thotë se “askujt nuk mund t’i privohet qëllimisht

jeta”; ii. pohimin se vullneti për t’i dhënë fund jetës së një personi në gjendje terminale apo që është duke vdekur nuk përbën asnjëherë pretendim ligjor për të vdekur në duart e një personi tjetër; iii. pohimin se vullneti për t’i dhënë fund jetës i një personi në gjendje terminale apo që është duke vdekur në vetvete nuk mund të përbëjë një justifikim ligjor për të kryer akte që kanë si synim të shkaktojnë vdekje.

Në të gjitha çështjet e parashtruara në Gjykatë është vënë vazhdimisht theksi tek detyrimi i Shtetit për të mbrojtur jetën. Neni 2, pa ndryshuar gjuhën e shprehur, nuk mund të interpretohet se jep diametrikisht të drejtën e kundërt, përkatësisht të drejtën për të vdekur; ai as nuk mund të krijojë një të drejtë për vetëvendosje në kuptimin që i japin një individ të drejtën për të zgjedhur vdekjen dhe jo jetën. Gjykata përkatësisht konstaton se nuk mund të rrjedhë nga Neni 2 i Konventës asnjë e drejtë për të vdekur, qoftë në duart e një personi të tretë, apo me ndihmën e një autoriteti publik. Kjo pikëpamje pohohet nga Rekomandimi i fundit 1418 (1999) i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës.

5.5.2. Çështja Lambert

Çështja kishte të bënte me gjykimin e dorëzuar më 24 qershor 2014 nga Këshilli i Shtetit Francez i cili autorizon tërheqjen e të ushqyerit dhe hidratimit artificial të Vincent Lambert. Vincent Lambert ka pësuar dëmtime të rënda në kokë në një aksident rrugor më 29 shtator 2008, e cila e la atë tetraplegjik dhe në një gjendje të varësisë të plotë ndaj aparateve mjekesore. Sipas raportit të ekspertëve mjekësorë urdhëruar nga Këshilli i Shtetit më 14 shkurt 2014, ai është në një gjendje kronike vegjetative. Nga shtatori 2008 deri në mars 2009, ai u shtrua në spital dhe më pas në repartin e neurologjise. Vincent Lambert ushqehet në mënyrë artificiale dhe hidratim e cila administrohet e është tërësisht me anë të një tubi gastrik. Gjykata vërejtë se nuk kishte konsensus në mesin e shteteve anëtare të Këshillit të Europës në favor të lejimit mbi tërheqjen e trajtimit të cilat mbanin në jetë pacientin e përmendur. Në këtë sferë, që kishte lidhje me fundin e jetës, shteteve duhet t’i jepej një liri vlerësimi. Gjykata vlerësoi se dispozitat e Aktit të 22 prill 2005, siç është interpretuar nga Conseil d’Etat, përbënte një kornizë ligjore e cila ishte mjaft e qartë për të rregulluar me saktësi vendimet e marra nga mjekët në situata të tilla si në rastin në

fjalë. Gjykata ishte plotësisht e vetëdijshme për rëndësinë e çështjes së ngritur nga rasti në fjalë, e cila bënte fjalë për një çështje jashtëzakonisht komplekse në aspektin mjekësor, ligjor dhe etike.

Në rrethanat e çështjes, Gjykata përsëriti se kjo ishte kryesisht për autoritetet vendore për të vendosur nëse vendimi për të tërhequr trajtimin ishte në përputhje me legjislacionin e brendshëm dhe atë të Konventës, dhe për të përmbushur dëshirën e pacientit në përputhje me ligjin kombëtar. Roli i Gjykatës konsistonte në shqyrtimin e pajtueshmërisë së shtetit me detyrimet e saj pozitive që rrjedhin nga neni 2 i Konventës.

Gjykata gjeti korniza legislative të parashikuara nga ligji i brendshëm, siç ishte interpretuar nga Këshilli i Shtetit Francez, dhe procesi i vendimmarrjes, i cili ishte kryer në mënyrë të përpiktë, të jetë në përputhje me kërkesat e nenit 2.

Gjykata arriti në përfundimin se rasti në fjalë kishte qenë subjekt i një shqyrtimi të thellë në rrjedhën e të cilave të gjitha pikat e mendimit ishin shprehur dhe se të gjitha aspektet ishte konsideruar me kujdes, në dritën e një raport të hollësishëm të ekspertëve mjekësorë dhe vëzhgimeve të përgjithshme nga autoritetet të rangut të lartë të organeve mjekësore dhe etike.

Gjykata arriti në përfundimin se autoritetet vendase kanë respektuar detyrimet e tyre pozitive që rrjedhin nga neni 2 i Konventës, në funksion të lirisë së vlerësimit lënë atyre në rastin në fjalë, dhe se nuk kishte shkelje të nenit.

5.6. Rregullimi ligjor i Eutanazisë në shtete të ndryshme.

Eutanazia aktive konsiderohet si krim në pjesën më të madhe të vendeve të botës dhe ligjet në lidhje më të, diku janë të qarta, në një shtet tjetër jo, e sidomos në lidhje me vetëvrasjen e asistuar.

Përvoja në Holandë

Në prill të 2001, Holanda u bë shteti i parë europian i cili legalizoi eutanazinë dhe vetëvrasjen e asistuar, në raste dhe në rrethana specifike. Kjo erdhi pas një periudhe të gjatë përpjekjesh duke filluar që nga viti 1973, pas sondazhesh dhe referendumesh të

shumta të cilat treguan se populli holandez ishte gjithmonë e më pro kësaj nisme, duke bërë që përqindja të rritej, nga 40 % në 1966 në 70% në 1990.

Gjykata e Leeuwarden, u shpreh se doktori nuk duhet të mbajë përgjegjësi penale kur janë plotësuar kërkesat materiale e proceduriale. Gjykata e Lartë dha vendimin më të rëndësishëm mbi këtë çështje në 1984 kur ajo pranoi dhënien fund të jetës vetëm kur të përmbushen disa kriteret specifike siç janë:

1. Një kërkesë specifike dhe e vullnetshme nga ana e pacientit,
2. Një dhimbje e papërballueshme dhe një situatë e pashpresë pa perspektivë përmirësimi,
3. Të mos ketë alternativa të tjera më të arsyeshme për të lehtësuar dhimbjen,
4. Eutanazia të kryhet nën administrimin e një doktori dhe që vetë doktori të jetë konsultuar më parë me një doktor tjetër kompetent dhe të pavarur.

Ky vendim i hapi rrugën praktikimit të eutanazisë në një shtet të Europës i cili është më i famshmi për tolerancën e tij dhe progresin social. Ndryshimi erdhi më në fund në prill të 2001, ku parlamenti holandez miratoi edhe ligjin i cili lejonte eutanazinë, duke shtuar një amendament në Nenin 293 të Kodit Penal dhe duke përcaktuar edhe rastet specifike kur lejohej. Ligji lejon komisionin e mjekëve, të ndalojë persekutimin e mjekëve të cilët kanë kryer eutanazi kur është përmbushur secila prej kushteve të mëposhtme:

1. Vuajtja e pacientit është e padurueshme dhe pa perspektivë për përmirësim.
2. Kërkesa e pacientit për të vdekur duhet të jetë e vullnetshme dhe insituese (kërkesa nuk duhet të jetë bërë nën influencën e të tjerëve, sëmundjeve psikologjike dhe drogave).
3. Pacienti duhet të jetë plotësisht i informuar për kushtet e tij, mundësitë dhe perspektivat për shërim ose jo.
4. Duhet të ketë një konsultim me të paktën një doktor të pavarur i cili duhet të aprovojë kushtet e mësipërme.
5. Vdekja duhet të kryhet me një mënyrë mjekësore të duhur nga doktori ose pacienti, dhe në ato raste kur doktori duhet të jetë i pranishëm.
6. Pacienti duhet të jetë të paktën 12 vjeç. Për fëmijët nga 12 deri 16 vjeç, kërkohet dhënia e pëlqimit nga ana e prindërve.

Por eutanazia ende mbetet krim në raste kur nuk plotësohen kushtet e mësipërme si dhe për fëmijët nën moshën 12 vjeç për të cilët është e paligjshme.

Përvoja në Belgjikë

Më 23 shtator 2002 edhe Belgjika ndoqi këtë proces, me një legjislacion të ngjashëm me atë të Hollandës por me karakteristikat e veta. Në këtë ligj me eutanazi kuptohet një veprim i kryer me paramendim nga një person i tretë, për t'i dhënë fund jetës së një personi të sëmurë, të bazuar në kërkesën më shkrim të këtij të fundit. Ajo lejon eutanazinë me kushtin e një kërkesë nga ana e të interesuarit për një rast vuajtjeje fizike e psiqike të padurueshme dhe të vazhdueshme. Kushtet e tjera janë të ngjashme me ligjin Holandez. Por ky ligj, nuk përmend vetëvrasjen e asistuar. Kështu që nuk specifikon mënyrat që do të përdoren nga mjekët, pavarësisht nëse pacienti e përshkruan atë në kërkesën zyrtare që i dërgohet Komisionit Federal të Vlerësimit dhe Kontrollit .

Me 86 vota pro dhe 44 kundër Parlamenti në Belgjikë miratoi ligjin që lejon eutanazinë tek fëmijët. Ligji u lejon fëmijëve të sëmurë termalë që të kërkojnë eutanazinë për t'u dhënë fund dhimbjeve nëse nuk ekzistojnë mjekimet e nevojshme. Firma e mbretit Filip mbi ligjin do ta bënte Belgjikën vendin e parë në botë që do të ligjëronte eutanazinë pa kufizime moshash. Eutanazia aplikohet prej disa vitesh në Zvicër dhe Holandë, por vetëm për personat madhorë. Këshilli i Shtetit në Belgjikë mori në shqyrtim pajtueshmërinë e ligjit për eutanazinë me Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut, dhe konkretisht nenin 2 të saj, duke arritur në përfundimin se ligji ishte në përputhje me Konventën, për arsye se:

1. E drejta pozitive e shteteve për të mbrojtur të drejtën e jetës, është balancuar me të drejtën e çdo personi për të vendosur vetë.
2. Detyrimi i autoriteteve për të mbrojtur jetën e personit, është balancuar me të drejtën e personit për të mos iu nënshtruar asnjë trajtimi çnjerëzor apo poshtërues.
3. Është respektuar e drejta për integritet fizik dhe moral të personit, që rrjedh nga e drejta për jetë private e parashikuar nga neni 8 i Konventës.
4. Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut nuk rregullon konfliktin midis të drejtave të parashikuara prej saj dhe nuk parashikon epërsinë e një të drejte mbi një tjetër.

Duke qënë se debati mbi eutanazinë është më shumë një çështje morali, Këshilli iu referua vendimit të Komisionit Europian të të Drejtave të Njeriut, i cili nuk konstatoi shkelje dhe mbështeste vendimin e Gjykatës së Lartë Norvegjeze në lidhje me ligjin për abortin, duke cituar se: “Nuk është detyrë e gjykatave të vendosin nëse zgjidhja e caktuar e një problemi të vështirë si ai i abortit nga legjislatori është zgjidhja më e mirë. Në këtë këndvështrim, mendime të ndryshme do të ketë midis gjyqtarëve dhe anëtarëve të tjerë të shoqërisë. Zgjidhja e konfliktit midis interesave të ndryshme përsa i përket abortit, është pushtet dhe përgjegjësi e ligjvënësit. Gjykatat duhet të respektojnë rregullimin e zgjedhur nga ligjvënësi.”

Përsa i përket pajtueshmërisë së ligjit norvegjez mbi abortin, duke bërë analogjinë me ligjin për eutanazinë, Komisioni Europian i të Drejtave të Njeriut, u shpreh se: “Në një fushë kaq delikate dhe të lidhur ngushtë me moralin e shoqërisë, shtetet anëtare duhet të kenë hapësirë vlerësimi”. Por hapësira e vlerësimit nuk duhet të jetë e pakufizuar. Detyrimi i shtetit për të mbrojtur jetën e personit, duhet të pasqyrohet në procedurat dhe kushtet e vendosura në ligjin për eutanazinë. Në këto kushte, Këshilli i Shtetit (Gjykata e Lartë Administrative), vlerësoi se ligji për eutanazinë ishte brenda kufijve të hapësirës së vlerësimit të lejuar shteteve anëtare, në mbrojtjen dhe respektimin e nenit 2 të Konventës. Këto parashikime nuk kanë për qëllim të përjetësojnë vuajtje të padurueshme ku nuk ka perspektivë për përmirësim.

Nënshkruesit e Konventës janë të lirë t’i interpretojnë gjerësisht parashikimet e saj brenda sistemit të tyre ligjor. Por, megjithëse konventat nuk mund të interpretohen si detyrim për ndalimin e dhënies fund të jetës, me kërkesë ose dhënie ndihmë në vetëvrasje, shtetet nënshkruese duhet të parashikojnë me patjetër mbrojtje të mjaftueshme për të plotësuar kriterin e “respektimit të të drejtës për të jetuar”. Kjo është baza e legjislacionit hollandez mbi eutanazinë. Shkaktimi i eutanazisë, si rrjedhojë e një kërkesë të vullnetshme të pacientit nuk përbën vrasje me dashje, në kuptimin e neneve të konventës.

Për rrjedhim, ligji i ri nuk është në kundërshtim me konventat ndërkombëtare dhe të drejtat themelore të njeriut të përcaktuara në to.

Përvoja në Norvegji

Në Norvegji për të proçeduar me eutanazinë pasive është e nevojshme kërkesa e të interesuarit ose e një të afërmi, në rast pavetëdije. Ky shtet parashikon dënime për vetëvrasjet e asistuara, duke i ngarkuar ata me akuzën e bashkëpunëtorit në vrasje. Në rastet kur është dhënë pëlqimi dhe arsyet kanë të bëjnë me një veprim dhembshurie, gjykata jep vendime pak më të lehta. Në 2000, një mjek norvegjez, Christian Sandsdalen, u shpall fajtor me akuzën e vrasjes me paramendim. Ai pranoi që i kishte dhënë një mbidozë morfine një gruaje të sëmurë të përhershme, pas 20 viteve, e cila ju lut për ndihmë. Kjo i kushtoi atij licensën e mjekut dhe ushtrimin e profesionit, duke i shmangur burgun.

Përvoja në Vendet Skandinave

Në vendet skandinave, panorama është pak a shumë homogjene: në Suedi, eutanazia aktive është e ndaluar, ndërsa vrasja e asistuar tolerohet dhe nuk ka ndonjë ligj specifik që të dënojë atë; në Finlandë është e ligjshme eutanazia pasive. Në Kodin Penal të saj nuk ka asnjë nen rreth vetëvrasjes së asistuar. Ndonjëherë ndihmësi në vrasjen në fjalë informon autoritetet ligjore, që ka ndihmuar dikë për të vdekur, dhe në këtë mënyrë justifikon veprimin e tij dhe nuk ndodh asgjë më tepër.

Përvoja në Gjermani

Së fundmi edhe Gjermania legalizon eutanazinë. Në një vendim të Gjykatës Federale të Gjermanisë, flitet për eutanazinë aktive pra me dhënien e pëlqimit nga ana e pacientit në mënyrë vullnetare. Kjo gjykatë liroi një jurist z. Wolfagng Putz, i cili kishte këshilluar të bijën e një gruaje në koma znj. Kullmer, t'i hiqte tubat ushqyes, pra tubat që artificialisht e mbanin në jetë.

Shumë më përpara pacientja kishte shprehur dëshirën që mjekët të mos e mbanin në jetë artificialisht. Pacientja rreth të shtatëdhjetave kishte rënë në koma dhe kishte qëndruar në një gjendje të tillë për pesë vjet deri në momentin kur vetë vajza e saj, e këshilluar nga ky jurist, i shkëputi tubat. Në këtë mënyrë kjo gjykatë ka qartësuar rastet në të cilat përfshihen çështje të tilla, me sëmundje të pashërueshme dhe dhimbje të tmerrshme, por gjithmonë me kushtin kryesor të dhënies së pëlqimit nga ana e pacientit.

Përvoja në Britaninë e Madhe

Në Britaninë e Madhe, eutanazia nuk është e ligjshme, madje dënohet edhe nga Kodi Penal, edhe pse shpesh ndodh që ndonjë i afërm i pacientit të sëmurë rëndë, ta ndihmojë atë të vdesë dhe pastaj të kërkojë të ulë dënimin nga vrasje me paramendim në vrasje të thjeshtë.

Kjo sjellje e paepur drejt vetëvrasjes me paramendim, reflekton faktin që tradicionalisht në ligjet e Britanisë së Madhe synohet ruajtja e rregullave sociale. Ligji thotë që një person në moshë madhore, me një mendje të shëndoshë, mund të refuzojë trajtime që i zgjasin jetën. Kjo sepse ligji njeh të drejtën e çdo personi për të qenë i lirë të marrë vendimet e tij në lidhje me trajtimet e tij mjekësore, edhe pse ndoshta ato mund të duken të paarsyeshme. Kjo nuk do të thotë që Britania e Madhe e lejon eutanazinë vullnetare, madje në këtë shtet është mundësia e dënimit deri më 14 vjet burg për çdokënd që ndihmon në kryerjen e vetëvrasjeve të asistuar. Çuditërisht vetëvrasja në vetvete nuk përbën krim, që në 1961, e megjithatë ekzistojnë ligje të cilat ndalojnë publikimet që nxisin vetëvrasjet dhe eutanazinë.

Komiteti i Zgjedhur i Dhomës së Lordëve mbi Etikën Mjekësore shprehu pikëpamjen se vrasja e qëllimshme nga shoqëria duhet ndaluar. Ky komitet nuk beson se rastet e pakta në të cilat eutanazia duhet parë si e lejueshme, është një bazë e mjaftueshme për të hartuar politika të përgjithshme të cilat do të shkaktonin një kthim mbrapa si dhe thekson që eutanazia është një çështje në të cilën interesat e individëve nuk duhen parë të ndara nga interesat e shoqërisë në tërësi.

Përvoja në Zvicër

Një rast ndryshe në Europë paraqet Zvicra, në të cilin nuk ka ligje të veçanta mbi eutanazinë, por Kodi Penal përmban masa të cilat mund të aplikohen edhe për të. Neni 144, deklaron se një person i cili vret një tjetër, për arsye dhembshurie, mund të mos dënohet, dhe neni 115 specifikon se ajo çka e bën këtë akt të dënueshëm është ekzistenca e motiveve egoiste. Sot, neni 115 mund të përdoret fare mirë për çështjet e eutanazisë, i cili duhet të themi që nuk ishte qëllimi thelbësor apo primar i ligjvënësit.

Kështu që, dhënia e ndihmës në vrasjet, nuk dënohet, ndërsa mjekët nuk lejohen të kryejnë eutanazi pasi mund të ketë sanksione nga vetë kolegët. Sipas Akademisë së Mjekëve, e cila shërben si një lloj gjykate për ta, “dhënia e ndihmës në vrasjen e pacientit, nuk bën pjesë në aktivitetin e mjekut”. Kjo ka sjellë debate të shumta, çka ka bërë që situata të jetë pa rrugëdalje, por gjërat mund të ndryshojnë. Një lëvizje e re, ka inkurajuar qeverinë që të ridiskutohet çështja e eutanazisë dhe e mjekimeve lehtësuese të dhimbjeve.

Përvoja në Australi

Në Australi, Asambleja Legjislative e Territorit Verior, në maj 1995, kaloi për miratim ligjin mbi eutanazinë, i quajtur Rights of the Terminally Ill Act, i cili lejonte pacientët me sëmundje të pashërueshme, të kryenin vetëvrasje me ndihmën e doktorit. Ky ligj lejonte një person madhor, i cili kishte një dhimbje të padurueshme, të ekzaminohej nga një mjek i specializuar i cili të vendoste nëse pacienti kishte shërim apo jo. Pas kësaj, ekzaminimi do të bëhej edhe nga dy mjekë të tjerë të pavarur, një mjek i specializuar në sëmundjet e pashërueshme dhe një tjetër psikiatër për të konfirmuar se pacienti kishte një sëmundje të pashërueshme dhe jo një person depresiv, i paafte për të vendosur vetë. Pas shqyrtimit të këtyre këshillave, asistenca mjekësore gjatë vetëvrasjes nuk do të ishte e nevojshme, nëse do të ekzistonin qetësueset që do të kryenin një veprim të tillë.

Përvoja në SHBA

Tre shtete Amerikane kanë ligjin i cili lejon mjekun të japë ilaçe pacientit me sëmundje vdekjeprurëse të cilët dëshirojnë t'i japin fund jetës së tyre këto shtete janë: Oregoni, Washingtoni dhe Vermonti

Në SHBA, vendimet e Gjykatës së Lartë, e quajnë të ligjshme eutanazinë pasive dhe qeveria federale ka autorizuar vetë shtetet në rregullimin ligjor të një çështjeje kaq delikate. Në 1994, shteti i Oregonit aprovoi ligjin e parë amerikan që lejonte doktorët të nxisnin vdekjen për të sëmurët e pashërueshëm. Death With Dignity Act u hartua për të mbrojtur interesat e pacientëve siç mund të ishin:

1. Shmangien e dhimbjeve dhe vuajtjeve të panevojshme;

2. Mbrojtjen dhe forcimin e të drejtës së personave madhorë për të marrë vetë vendime në lidhje me shëndetin e tyre;
3. Shmangien e rasteve tragjike të përpjekjeve ose vetëvrasjeve të suksesshme në një mënyrë jo humane dhe dinjitoze.

Akti legalizon vetëm vetëvrasjen e asistuar nga mjeku, duke u shprehur se “asnjë fjali e këtij akti nuk duhet të interpretohet sikur lejon një mjek ose një person tjetër, t’i japë fund jetës së një pacienti me injeksione vdekjeprurëse apo eutanazi aktive. Ai i lejon një qytetari rezident në Oregon, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, i diagnostifikuar me një sëmundje të pashërueshme, të bëjë një kërkesë më shkrim me qëllimin e përdorimit të substancave të cilat e lejojnë atë t’i japë fund jetës së tij në mënyrë humane dhe dinjitoze. Për këtë janë përcaktuar procedurat që çdo pacient dhe mjek duhet të ndjekë, në mënyrë që këto veprime të mos quhen në kundërshtim me këtë akt dhe të mos ketë vend për abuzime dhe shkelje.

Edhe pse ka patur debate gjyqësore në lidhje me këtë Akt të nxjerrë, gjykata është shprehur se vetë shtetasit e Oregonit, me anë të një procesi demokratik, kanë vendosur të zgjidhin debatin e madh moral, ligjor dhe etik, mbi vetëvrasjen e asistuar duke votuar jo një herë, por dy, në favor të këtij akti, duke e lënë lështu këtë akt të fuqi dhe plotësisht të zbatueshëm në territorin e këtij shteti.

5.7. Debati mbi eutanazinë në Shqipëri.

Çështja e eutanazisë ka qenë në qendër të debateve të nxehta për shumë vite dhe është e rrethuar nga konsiderata fetare, etike dhe praktike duke krijuar në këtë grupe pro dhe kundër ligjërimit të saj. Parimisht eutanazia duhet të kryhet vetëm me kërkesën e personit, por ka raste kur ata mund të jenë shumë të sëmurë dhe vendimi merret nga të afërmit, mjekë ose në disa raste, gjykatat. (Mannes,1975 ;27). Pasi kam bërë studimin kam vërejtur që në Shqipëri, konceptet teorike ekzistojnë por ka një boshllëk ligjor në lidhje me eutanazinë, pasi duke mos dalë me një dispozitë konkrete për Eutanazinë, lë shteg për abuzime lidhur me cilësimin ligjor të veprës duke u shkelur të pandehurve të drejtat e tyre procedurale dhe materiale. Mund të mendohet se mungesa e legjislacionit për këtë të

fundit sjell si pasojë mohimin në mënyrë të heshtur të së drejtës së gjithsekujt për të vdekur në dinjitet. Kohët e fundit është diskutuar disa herë në media çështja e eutanazisë në vendin tonë, duke menduar se do të ishte e udhës që ajo të lejohej edhe në vendin tonë. Eutanazia implikon individin dhe shoqërinë; është çështje përgjegjësie shtetërore dhe vetjake; ndërlikon filozofinë për jetën, teologjinë, etikën, mjekësinë, jurisprudencën që të mos trajtohet me hipokrizi apo mjete dhe praktika ilegale që shkelin dinjitetin njerëzor edhe në fund të jetës, por të mbahet një qëndrim i caktuar kundrejt saj nëpërmjet parashikimit të dispozitave ligjore në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kodin Penal dhe akte tjera ligjore. Eutanazia, eutanazia aktive, eutanazia pasive, ndihma në vetëvrasje, si terma janë të njohur në praktikën tonë mjekësore, sidomos dhjetëvjeçarin e fundit. Në fakt, ato nuk janë praktikuar ende, përveç disa rasteve të ashtuquajtura trajtim mjekësor lehtësues (paliativ) si një lloj i eutanazisë pasive.

Deri më sot nuk ka patur asnjë rast në Shqipëri, të ndjekjes penale apo të dënimit të mjekëve për kryerje të eutanazisë. Megjithatë ajo ka qenë aplikuar dhe aplikohet tek ne si psh: eutanazia pasive e të sëmurëve ose të plagosurve të pakurueshëm, ku ekipi mjekësor, për shkak të gjendjes ende të prapambetur të mjekësisë, mungesës së pajisjeve moderne, ka qenë i detyruar të pranojë eutanazinë pasive. Nga pikëpamja etike, në Kodin Deontologjik të vitit 1998 në nenin 20 të tij parashikohet shprehimisht se: “Lehtësimi i vuajtjeve dhe dhimbjeve është një nga parimet bazë të mjekësisë. Përsheptimi i mbarimit të jetës është në kundërshtim me etikën mjekësore.”

Përsa i përket të drejtës shqiptare, eutanazia nuk është e lejueshme pasi kjo vjen në kundërshtim dhe me normat e moralit të popullit shqiptar, madje vrasja e kryer në kushtet e eutanazisë konsiderohet si vrasje e thjeshtë. Vrasje e thjeshtë, si rregull, cilësohet dhe eutanazia aktive, domethënë kur subjekti shkakton vdekjen me kërkesën dhe pëlqimin e vetë viktimës, ose për t’u dhënë fund sa më shpejt vuajtjeve e dhimbjeve të forta, të shkaktuara nga një sëmundje e rëndë e pashërueshme.

Ekziston një pikëpamje që vrasja e kryer në gjendje të eutanazisë të dënohet si krim, ose në bazë të nenit 76 të Kodit Penal ose si vrasje në rrethana lehtësuese në bazë të nenit 82 të Kodit Penal, kur ka rrethana të tilla. Gjithsesi në Kodin Penal nuk parashikohet

si figurë e veçantë e veprës penale eutanazia, madje në kapitullin e krimeve kundër shëndetit dhe jetës, termi eutanazi nuk ekziston.

Një çështje tepër e diskutueshme është edhe ajo e përgjegjësisë për kryerjen e eutanazisë, në kuadrin e jurisprudencës së Gjykatës së Strasburgut, e cila tashmë përbën pjesë integrale të rendit tonë juridik. Në fakt ekzistojnë një sërë shtetesh si ai i Danimarkës, Hollandës apo Belgjikës, të cilët e pranojnë eutanazinë.

Nëse i referohemi jurisprudencës së Gjykatës së Strasburgut, neni 2 i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut i detyron shtetet, jo vetëm të mos ndërmarrin akte që me paramendim dhe në mënyrë të qëllimshme marrin jetën e dikujt, por edhe të marrin masat e duhura për të ruajtur jetën e personave brenda juridiksionit të tyre. Ky nen nuk mund të interpretohet sikur njeh edhe të drejtën diametralisht të kundërt, konkretisht të drejtën për të vdekur, dhe as nuk mund të krijojë një të drejtë për të vendosur vetë në lidhje me vdekjen. Shteti nuk mund të mjaftohet vetëm me deklarin e sanksioneve në rastin e shkeljes së të drejtës së jetës, por duhet të ndërmarrë masa parandaluese operative, me qëllim mbrojtjen e personit, jeta e të cilit është e rrezikuar. Për më tepër shteti duhet të ndërmarrë masa për zgjatjen e jetës. Gjykata e Strasburgut nuk mjaftohet vetëm me kaq, por arrin deri aty sa të vendosë se edhe thjesht neglizhenca nga ana e autoriteteve publike, është e mjaftueshme për të përbërë shkelje të nenit 2.

Ndalimi i eutanazisë dhe parashikimi në shumë legjislacione të huaja si vepër penale, është vlerësuar nga Gjykata e Strasburgut, si jo në kundërshtim me Konventën. Në çështjen Pretty kundër Mbretërisë së Bashkuar, Gjykata konstatoi se kërkuesja nuk e ka të drejtën për të vdekur, qoftë me ndihmën e një personi të tretë apo të autoritetit publik mjekësor. Neni 2 i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut përfundimisht nuk përfshin edhe të drejtën për të vdekur.

Eutanazia vullnetare është fillimi i një "shpati të rrëshqitshëm" që të çon në vdekje të lehtë të pavullnetshme dhe vrasjen e njerëzve të cilët nuk e dëshirojnë atë. Në qoftë se ne do të lejojmë diçka relativisht të padëmshme sot, me pranimin e saj, mund të fillojë një trend që rezulton në diçka aktualisht të paimagjinueshme. Nëse eutanazia vullnetare do të bëhej ligjore, nuk do të kalonte shumë kohë përpara se eutanazia e pavullnetshme të fillonte të ndodhte. Personalisht mendoj se do të ishte praktikisht e pamundur për të siguruar që të

gjitha aktet e eutanazisë të ishin me të vërtetë vullnetare dhe se çdo liberalizim i ligjit nuk do të çonte në abuzim. Njerëzit e pambrojtur si të moshuarit, të vetmuarit, të sëmurët apo personat në gjendje të vështirë do të ndjeheshin në presion. Mjekët mund të fillonin praktikën e vrasjes së njerëzve pa lejen e tyre. Reduktimi i shpenzimeve të kujdesit shëndetësor do të çonte në vrasjen e pacientëve për të kursyer para.

Sipas përkrahësve të eutanazisë arsyeja kryesore pse përgjithësisht mjekët mbështetin eutanazinë vullnetare është sepse ata besojnë se duhet të respektojnë të drejtën e pacientëve të tyre që të trajtohen si qenie njerëzore autonome. Por mjekët duke qenë më shumë të vetëdijshëm se njerëzit e tjerë në lidhje me kostot që shpesh mund të jenë pa rezultat sipas një studimi kanë më shumë gjasa për të nderuar kërkesat e pacientëve të tyre për vdekje.

Mjekët nazistë u angazhuan në programet masive të eutanazisë pavullnetshme, pikërisht në sajë të këtij parimi, kështu që ne nuk duhet të vendosim besimin tonë në moralin e mirë të mjekëve. Përkrahësit argumentojnë se nazistët nuk janë një shembull i dobishëm moral, sepse veprimet e tyre në përgjithësi ishin kriminale dhe eutanazinë jo-vullnetare e përdoren si një akt të qëllimshëm politik. Shembulli i nazistëve i ka bërë njerëzit më të ndjeshëm ndaj rreziqeve të eutanazisë pavullnetshme. Ekziston gjithashtu teoria se me anë të zyrtarizimit të eutanazisë kemi "zhvlerësuar jetën" se lejimi i saj dërgon mesazhin se është më mirë të jesh i vdekur se sa i sëmurë ose i paaftë. Nënteksti është se disa jetë nuk i japin më vlerë jetesës. Kjo jo vetëm që vë të sëmurin ose të paaftin në rrezik, por gjithashtu ul statusin e tyre si qenie njerëzore ndërsa ata janë ende në jetë. Në përfundim të këtij diskutimi mendoj që në vendin tonë nuk është ende koha për të lejuar eutanazinë pasi në gjykimin tonë kushtet dhe niveli i jetesës, i kombinuar me rrethana të tjera lidhur me mjekësinë e bëjnë të pamundur lejimin e saj.

5.8. Argumentet kundër aplikimit të eutanazisë në vendin tonë.

Studiuesit janë të ndarë në dy kampe: ata të cilët janë pro dhe kundër aplikimit të eutanazisë. Ata të cilët janë *pro* eutanazisë mendojnë se nuk ka arsye pse eutanazia nuk mund të gjejë rregullim ligjor dhe të kontrollohet në mënyrën e duhur. Nga ana tjetër ata gjithashtu pranojnë se mund të lindin disa probleme. Por janë të pakontrollueshme.

Vështirësitë sipas argumenteve të dhëna nga përkrahësit e eutanazisë mund të qëndrojnë në vështirësinë për t'u kuptuar nëse eutanazia po zbatohet për arsye egoiste apo duke i ushtruar presion pacientëve të pambrojtur. (Harris,2001:147)Studiues të ndryshëm të shkencës mjekësore dhe ligjore japin argumente të ndryshme në lidhje me eutanazinë të cilat do i trajtojmë më poshtë.

Unë do të sjell këtu argumentet në mbrojtje të tezës se në Shqipëri eutanazia nuk duhet të aplikohet.

5.8.1. Argumentet fetare

Edhe Shkenca e teologjisë e kundërshton hapur dhe në mënyrë kategorike eutanazinë sepse ata besojnë se e drejta për të vendosur kur një person vdes i përket vetëm Perëndisë, duke e konsideruar individin aset nën vullnetin e Tij. Argumentat që kjo shkencë ka dhënë kundër eutanazisë dhe *pro* jetës janë:

- Eutanazia është kundër fjalës dhe vullnetit të Perëndisë.
- Eutanazia dobëson respektin e shoqërisë për shenjtërinë e jetës.
- Vuajtja mund të ketë vlerë.
- Eutanazia vullnetare është fillimi i një "shpati të rrëshqitshëm" që të çon në vdekje të lehtë të pavullnetshme dhe në vrasjen e njerëzve të cilët nuk e dëshirojnë atë.

Sipas teologëve Perëndia na ka dhënë vullnet të lirë për t'u vetëvararë, ose ti kërkojmë të tjerëve për ta realizuar këtë gjë, por ky akt nuk është në përputhje me vullnetin e Tij. Çdo qenie njerëzore është krijimi i Perëndisë dhe kjo imponon kufizime të caktuara mbi ne. Vetëvrasja dhe kërkimi i vdekjes si një e drejtë sipas teologjisë konsiderohet si mohim ndaj Zotit dhe të drejtave të Perëndisë mbi jetën tonë, të drejtën e tij për të zgjedhur sa dhe si çdokush nga ne do të vdesë. (Brody,1975:94). Studiues të teologjisë janë kundër eutanazisë për arsye se ata shohin vlera pozitive në procesin e vuajtjeve pasi për shekuj dhe breza me radhë vuajtja është konsideruar si një fuqi e veçantë që tërheq një person më afër me Krishtin, një hir i veçantë. Qëndrimi i shumicës së religjioneve në lidhje me vuajtjen është që duhet të lehtësojmë vuajtjet kur mundemi, dhe ti qëndrojmë afër atyre që vuajnë, duke i ndihmuar ata të përballojnë vuajtjet e tyre, por, ne kurrë nuk duhet të mendojmë për të

eliminuar ata që vuajnë. Papa Gjon Pali II shkruante se *"vuajtja, më shumë se çdo gjë tjetër, hap rrugën për hirin që shndërron shpirtat njerëzorë"*. Disa mendojnë se vdekja është vetëm një nga testet që Perëndia bën për qeniet njerëzore, dhe se mënyra si reagojmë tregon llojin e personit që jemi, dhe se sa i thellë është besimi ynë në Zot. (Materstvedt,2003:17) Kur njerëzit janë duke vdekur ata mund të jenë në gjendje, më shumë se në çdo kohë në jetën e tyre, të përqendrohen në gjërat e rëndësishme në jetë, dhe për të (jetën) vendosin mënjanë kulturën e sotme të konsumatorit, egon e tyre dhe dëshirën për të kontrolluar botën.

Kufizimi i procesit të vdekjes do t'i mohonte atyre këtë mundësi. Në disa religjone lindore ekziston besimi se ne jetojmë shumë jetë dhe cilësia e çdo jete është vendosur me mënyrën se si jetojmë jetën tonë të mëparshme. Ata mendojnë se vuajtja është pjesë e forcës morale të universit dhe se duke ndërprerë jetën, një person ndërhyt në përparimin e tij drejt çlirimit përfundimtar. Nga një pikëpamje jo-fetare disa njerëz gjithashtu besojnë se vuajtja ka vlerë dhe se ajo ofron një mundësi për të rritur dijen, karakterin, dhe dhembshurinë. Vuajtja ka aftësinë të tërheqë të gjitha burimet e një qenie njerëzore dhe u mundëson atyre të arrijnë pikët më të larta dhe më fisnike të asaj që ata vërtetë janë. Vuajtja e lejon një person që të jetë një shembull i mirë për të tjerët duke treguar se si të sillen kur gjërat janë të këqija. (LaFollette, 2002:25). Nuk është e lehtë për të përcaktuar vuajtjen dhe natyrën e saj. Shumica prej nesh mund të përcaktojë çfarë mund të quajmë vuajtje, por ajo që është vuajtje për një person mund të mos jetë e tillë për një tjetër. Është veçanërisht e vështirë për të dalë me ndonjë ide objektive të asaj që përbën vuajtje të padurueshme, pasi secili individ reagon në të njëjtat kushte fizike dhe mendore në një mënyrë të ndryshme. Jeta është e shenjtë dhe përfundimi i jetës nga vetë njeriu është akti i cili njollos shenjtërinë e saj. Sipas studiuesve të teologjisë ka katër arsye kryesore pse duhet të vriten qeniet njerëzore:

1. Jeta e qenieve njerëzore ka vlerë, pavarësisht nga mosha, seksi, raca, feja, statusi shoqëror apo potenciali i tyre për arritje.
2. Jeta e njeriut ka vlerë në krahasim me një të mirë instrumentale, është një e mirë në vetvete dhe jo si një mjet.
3. Jeta e njeriut është e shenjtë, sepse kjo është një dhuratë nga Perëndia.

4. Ne jemi të vlefshëm për veten.

Edhe sipas filozofit Kant qëniet njerëzore racionale duhet të trajtohen si një qëllim në vetvete dhe jo si një mjet për diçka tjetër. Fakti që ne jemi njerëz ka vlerë në vetvete. Ne ekzistojmë, kështu që ne kemi vlerë dhe ne duhet të respektojmë vetë vlerën tonë. (Rachels, 1975 :78) Ne nuk duhet të trajtojmë veten si një mjet për vetë qëllimet tona dhe as të tjerët si të tillë. Kjo do të thotë, se ne nuk duhet të përfundojmë jetën tonë vetëm sepse ajo duket mënyra më efektive për t'i dhënë fund vuajtjeve tona. Të bëjmë këtë është të mos respektojmë vlerën tonë të natyrshme.

5.8.2. Argumentet Etike

Kundërshtarët laikë argumentojnë se çfarëdo të drejtash ne kemi ato janë të kufizuara nga detyrimet tona. Vendimi për të vdekur me vdekje të lehtë do të ndikojë në njerëz të tjerë, familjen, miqtë, në profesionistët e kujdesit shëndetësor dhe ne duhet të balancojmë pasojat për ta (fajësia, hidhërimi, zemërimi) çdo pasojë të keqe që mund të ketë për komunitetin në përgjithësi, kundrejt të drejtave tona. (Mannes,1975:27) Ata argumentojnë se:

- Eutanazia dobëson respektin e shoqërisë për shenjtërinë e jetës.
- Pranimi i eutanazisë pranon se disa jetë (ato të paaftëve apo të sëmurëve) janë me më pak vlerë se të tjerët.
- Eutanazia vullnetare është fillimi i një "shpati të rrëshqitshëm" që të çon në vdekje të lehtë të pavullnetshme dhe vrasjen e njerëzve të cilët nuk dëshirojnë të vdesin.
- Eutanazia nuk mund të jetë në interesin më të mirë të një personi.
- Eutanazia ndikon edhe në të drejtat e njerëzve të tjerë, jo vetëm në ato të pacientit.

Ne duhet gjithashtu të marrin në konsideratë detyrimet tona ndaj shoqërisë, për të balancuar të drejtën tonë individuale për të vdekur. Këto pasoja të këqija mund të jenë praktike të tilla si, duke bërë eutanazinë e pavullnetshme të lehtë e kështu duke vënë njerëzit e pambrojtur në rrezik. Ekziston edhe një kundërshtim politik dhe filozofik se e drejta jonë individuale për autonomi kundër shtetit duhet të jetë e balancuar kundrejt nevojës për të bërë shenjtërinë e jetës një vlerë të brendshme të rëndësishme. (Otani,2010:27). Filozofët laikë vënë përpara një numër të argumenteve teknike, kryesisht

në bazë të detyrës për të ruajtur jetën, sepse ajo ka vlerë në vetvete, ose rëndësinë e saj lidhur me të gjitha qeniet njerëzore.

5.8.3 Argumente filozofike

Shkenca e filozofisë shtron pyetjen se a është vdekja një fakt i keq? Sipas shkencës së filozofisë njerëzit gëzojnë të drejtën për të vdekur kur dhe se si ata duan, pasi çdo person ka të drejtën të kontrollojë trupin, jetën e tij dhe të vendosë se në ç'kohë, në ç'mënyre dhe nga dora e cilit do të vdesë. Pas këtij argumenti qëndron ideja se qeniet njerëzore janë entitete të pavarura biologjike, që kanë të drejtën për të marrë vendime për veten e tyre. Liria e vendosjes mbi të drejtën e vdekjes, sipas përkrahësve të argumentit filozofik, përbën një benefit ndaj shoqërisë. Kjo liri duhet të jetë e pakufizuar sepse kufizimet e panevojshme mbi të drejtat e njeriut kanë një impakt negativ dhe konsiderohen diçka e keqe sepse vdekja është fundi.(Draper,1998:2) Ne priremi ta shohim vdekjen si diçka të keqe për një ose më shumë nga këto arsye:

- Sepse jeta e njeriut konsiderohet thelbësisht e vlefshme.
- Sepse konsiderohet që jeta dhe vdekja janë "punë të Perëndisë" dhe ne nuk duhet të ndërhyjmë.
- Sepse shumica e njerëzve nuk duan të vdesin.
- Sepse shkel në mënyrë drastike autonominë tonë etj.

Dy arsyet e para formojnë pikat kyçe në argumentet e kësaj shkence kundër eutanazisë, por vetëm në qoftë se pranohen se ato janë të vërteta, dy arsyet e fundit nuk janë absolute; në qoftë se një person dëshiron të vdesë, atëherë as këto arsye nuk mund të përdoren për të thënë se do të ishte gabim t'i nënshtrohen eutanazisë. Një tjetër arsye pse vdekja është parë si një gjë e keqe është se kjo është shkelja më e keqe e mundshme e autonomisë së personit, dëshirave të personit i cili nuk dëshiron të vdesë.(Kurtz,1975:94). Njerëzit zakonisht janë të etur për të shmangur vdekjen, sepse ata e vlerësojnë qenien të gjallë,

sepse ata kanë shumë gjëra që ata dëshirojnë të bëjnë, dhe përvojat që ata dëshirojnë të kenë.

5.8.4. Argumentet praktikë dhe teoria e shpërndarjes së drejtë të burimeve mjekësore

Teoria e shpërndarjes së burimeve të pakta mjekësore e trajton eutanazinë si një fakt të pashmangshëm dhe si një fenomen i cili do të ndodhë gjithsesi dhe përderisa ekziston mundësia për t'i ofruar një rregullim ligjor atëherë shteti do të kishte frymëmarrje në lidhje me shpërndarjen e burimeve të pakta shëndetësore që disponon në raste të caktuara. (Letellier,2002:15) Eutanazia mund të jetë e nevojshme për shpërndarjen e drejtë të burimeve shëndetësore argument i cili nuk është paraqitur publikisht nga asnjë qeveri apo autoritet shëndetësor. Është konstatuar se në shumicën e vendeve ka disa njerëz që janë të sëmurë dhe nuk mund të shërohen sepse nuk janë në gjendje për të marrë një trajtim mjekësor në kohën e duhur si pasojë e pamjaftueshmërisë së burimeve shëndetësore. Në të njëjtën kohë burimet shëndetësore janë duke u përdorur për njerëzit që nuk mund të shërohen, dhe të cilët, për arsyet e tyre, nuk do të preferonin për të vazhduar jetën.(Kohl:1994:94) Lejimi i njerëzve të tillë për të kryer eutanazinë jo vetëm që do ti lejonte ata të plotësojnë vullnetin e tyre por kjo do të lejonte që burime të vlefshme shëndetësore të përdreshin për të trajtuar njerëzit të cilët duan të jetojnë. Kundërshtarët e kësaj teorie shprehen se ky është një propozim pragmatik, sipas të cilit ne duhet të lejojmë eutanazinë, sepse ajo do të lejojë më shumë njerëz që të jenë të lumtur. Argumentet e tilla nuk do të bindnin askënd që beson se eutanazia është e gabuar në parim.

Ata besojnë se një propozim i tillë është abuzues dhe do të çonte në vdekje të pavullnetshme për shkak të mungesës së burimeve shëndetësore dhe një abuzim i tillë do ishte shumë i vështirë që të kontrollohej pavarësisht rregullave rigoroze. (Harris:2001:70) Argumentet praktike që ata sjellin për të kundërshtuar teorinë e shpërndarjes së drejtë të burimeve shëndetësore janë se:

- Eutanazia është e panevojshme sepse dëmton motivimin për të siguruar kujdes të mirë paliativ dhe lejimi i saj do të çonte në një kujdes jo të mirë për të sëmurët terminalë.
- Nuk ka asnjë mënyrë të duhur dhe efikase që rregullon eutanazisë.
- Lejimi i eutanazisë minon përkushtimin e mjekëve dhe infermierëve për të shpëtuar jetën duke u dhënë shumë pushtet mjekëve të vendosin në raste të caktuara për jetën e individëve.
- Lejimi eutanazisë do të dekurajojë kërkimin për kura të reja dhe trajtime për të sëmurët terminalë.
- Eutanazia ekspozon njerëzit vulnerabël ndaj presionit për t'i dhënë fund jetës së tyre.
- Lejimi i eutanazisë shton mundësinë për presion moral për të afërmit e moshuar nga familjet egoiste.
- Lejimi i eutanazisë shton mundësinë për presion moral për të shpërndarë burimet mjekësore.
- Pacientët të cilët janë braktisur nga familjet e tyre mund të shohin eutanazinë si zgjidhjen e tyre të vetme.

Këto argumente janë tejet bindëse dhe kanë ndikuar në frenimin e nismave pro lejimit të eutanazisë nisur nga teoria e shpërndarjes së drejtë të burimeve mjekësore

5.8.5. Argumentet bazuar në të drejtat e njeriut

Argumentat bazuar në të drejtën shprehen se një e drejtë e veçantë për të vdekur nuk është e nevojshme, për shkak se të drejtat tona të tjera të njeriut nënkuptojnë edhe të drejtën për të vdekur. Vdekja është një çështje private dhe nëse nuk ka dëm për të tjerët, shteti dhe njerëzit e tjerë nuk kanë të drejtë të ndërhyjnë. (Dowbiggin, 2007:51) Pa krijuar një të drejtë të veçantë për të vdekur, është e mundur të argumentojmë se të drejtat e tjera të njeriut duhet të përfshijnë këtë të drejtë bazuar në argumente të tilla si:

- E drejta për jetën nuk është vetëm e drejtë për ekzistencë

- E drejta për jetën është edhe një e drejtë për një cilësi minimale të saj
- Vdekja është e kundërta e jetës, por procesi i vdekjes është pjesë e jetës
- Vdekja është një nga ngjarjet më të rëndësishme në jetën e njeriut
- Vdekja mund të jetë e mirë apo e keqe etj.

Duke lejuar eutanazinë do të rritet rreziku për shkeljen e të drejtës së jetës dhe kjo e drejtë duhet të prevalojë edhe nëse kjo do të thotë se është shkelur e drejta për të vdekur. Njerëzit ndonjëherë gabohen për atë çka është në interesin e tyre më të mirë gjithashtu ata nuk mund të kuptojnë se duke kryer eutanazinë mund të dëmtojnë njerëz të tjerë.(Ramsay,2011:308) Eutanazia nuk është një akt privat - ne nuk mund të injorojmë asnjë efekt të keq që mund të ketë mbi shoqërinë në përgjithësi.

KAPITULLI VI KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME

KONKLUSIONE

E drejta për jetën është një e drejtë e paderogueshme, e pandashme dhe e patjetërsueshme e cila lidhet ngushtësisht me qenien njerëzore. E drejta për të jetuar është një e drejtë themelore me fokus të gjerë, në të cilin përfshihen aspekte që kanë të bëjnë me çështje dhe aspekte të ndryshme. Punimi synoi një analizë të rëndësishme për të kuptuar se sa efektiv është legjislacioni i fushës për të realizuar të drejtën kushtetuese të jetës, si një nga të drejtat me të cilat individit lind dhe si e drejtë e patjetërsueshme. Ai u fokusua në mënyrë të veçantë në disa elementë si: trajtimi i mbrojtjes së të drejtës së jetës sipas nenit 2 KEDNJ-së; studimi i detajuar i jurisprudencës së Gjykatës Europiane e të Drejtave të Njeriut dhe në veçanti vendimet e fundit të saj; evidentimi i kufizimeve të të drejtës së jetës; konstatimi i zbatimit të legjislacionit kombëtar nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut dhe në mënyrë të veçantë në vendin tonë; evidentimi i akteve të tjera ndërkombëtare që mbrojnë të drejtën e jetës dhe shtrirja e fuqisë ligjore zbatuese të tyre; përcaktimi i termave dhe statusit të abortit dhe eutanazisë si kufizim i të drejtës së jetës.

Më konkretisht, problematikat të cilat kanë qenë objekt diskutimi dhe analizë të detajuar në këtë temë doktriture të para në trinomin: e drejta e jetës-Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut; - Legjislacioni i Republikës së Shqipërisë, janë të lidhura me konceptin e jetës, pra fillimin dhe mbarimin e jetës, me risitë e të drejtës ndërkombëtare dhe europiane në këtë drejtim; kanë të bëjnë gjithashtu edhe me çështjet e abortit dhe problematikat rreth tij si dhe me fenomenin e eutanazisë.

Një nga sfidat, me të cilat ndeshet shoqëria dhe shteti shqiptar në dy dekadat e fundit, është edhe rishfaqja e gjakmarrjes, zakon i trashëguar nga e kaluara, i papajtueshëm me parimet e shoqërisë demokratike dhe të shtetit të të drejtës. Ajo shkakton përçarje e

hasmëri, sjell pasoja shoqërore të rënda, me marrjen e jetës së njerëzve, me ngujimin e mjaft familjeve, duke i rrënuar ekonomikisht dhe duke i shkëputur nga jeta politike-shoqërore, si dhe duke lënë fëmijët pa arsim. Pra, është fakt se në vendin tonë shkelen, rrezikohen ose nuk zbatohen disa nga të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, për shkak të fenomenit të gjakmarrjes. Pavarësisht se gjakmarrja nuk është e përhapur në të gjithë Shqipërinë, por është fenomen i lokalizuar në disa zona dhe me përmasa të kufizuara, ajo përbën problem shqetësues dhe prandaj meriton të vlerësohet seriozisht, si nga pikëpamja politike, ashtu dhe ajo shoqërore. Por për arsye të kufizimit të studimit si nga pikëpamja e tematikës ashtu edhe e volumit, pra shtrirjes, do e fokusojmë vëmendjen tonë në dy problematikat e reja të shoqërisë që është: eutanazia dhe çështjet e abortit.

E drejta e jetës sanksionohet në shume akte në nivel ndërkombëtar dhe rajonal. Ajo sanksionohet fillimisht në nenin 3 të DUDNJ-së si dokumenti i parë i cili ndalet dhe e trajton të drejtën e jetës në veçanti duke i dhënë asaj vendin dhe rëndësinë e duhur. E drejta e jetës është sanksionuar gjithashtu edhe në akte të tjera në nivel ndërkombëtar të tilla si: Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike; Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Ekonomike Sociale dhe Kulturore; Konventa Amerikane për të Drejtat e Njeriut, Konventa Afrikane, Konventa e New York për mbrojtjen e fëmijëve e vitit 1989 etj. Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike është akt ligjërish i detyrueshëm që krijon obligime me anë të të cilave shtetet do të zotohen të respektojnë të drejtat e njeriut të përcaktuara në DUDNJ. Po ashtu edhe Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore. Të drejtat e njeriut janë të ndarë në dy kategori kryesore: në të drejtat Civile dhe Politike, dhe Ekonomike Sociale dhe Kulturore. Kategoria e parë ka të bëjë me të drejtat personale themelore si: e drejta për jetën, integritetin fizik, liria fetare, etj të cilat përfshihen në Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike ndërsa ,kategoria e dytë konsiston në njohjen e të drejtave të barabarta për të gjithë individët, për të marrë pjesë në jetën shoqërore, kulturore dhe ekonomike të vendit. Për të siguruar të drejtat e grupit të parë duhet që shtetet vetëm të mos ndërhyjnë në jetën personale dhe të organizojnë mekanizmat e nevojshëm për të ndëshkuar personat që nuk lejojnë gëzimin e këtyre të drejtave. Ndërsa për sa i përket të drejtave të grupit të dytë, këto të drejta janë më të vështira për t'u siguruar sepse duhet që shteti të ndërhyjë në mënyrë aktive përmes

hartimit dhe miratimit të marrëveshjeve midis tyre për sigurimin e tyre. Përveç instrumenteve universale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, gjithashtu janë zhvilluar edhe disa sisteme rajonale të të drejtave të njeriut, të cilat zakonisht ofrojnë standarte më të larta për të drejtat dhe implementimin e tyre. Përparësia e sistemeve rajonale qëndron në mundësinë e tyre për adresim më efektiv të ankesave. Në rastin e gjykatave mund të nxirren vendime të karakterit të detyrueshëm për kompensim dhe, në përgjithësi, rekomandimet e Komisioneve për të Drejtat e Njeriut merren seriozisht nga ana e shteteve. Rajonet më të rëndësishme të botës që kanë miratuar akte ligjore për respektimin e të drejtave dhe lirive themelore e njeriut janë: Amerika, Evropa, Afrika dhe Vendet arabe. Në këtë studim jemi fokusuar në mënyrë të veçantë në analizën e detajuar të të drejtës së jetës në Europë, pra në mënyrë të veçantë në rendin juridik të Bashkimit Europian dhe në atë të Këshillit të Europës. Si Këshilli i Evropës ashtu dhe Bashkimi Evropian kanë arritur të krijojnë një legjislacion i cili siguron njohjen dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Në përgjithësi, të drejtat themelore të garantuara në BE janë ato të sanksionuara shprehimisht në Traktatet themeluese, në Konventën Europiane të të drejtave të njeriut, si dhe në parimet e përgjithshme të së drejtës komunitare. Për sa u përket të drejtave që u rezervohen në mënyrë specifike emigrantëve jo komunitarë, që na intereson në mënyrë të veçantë, ato u janë lënë, kryesisht, shteteve anëtare. Ndërkohë që, edhe pse të gjitha aktet dhe zhvillimi i politikave kohët e fundit në BE projektohen sa më afër nevojave të qytetarëve, të drejtat që gëzojnë emigrantët janë të përcaktuara nga dy rinde juridike të ndërthurura: legjislacioni evropian dhe ai kombëtar, ky i fundit i influencuar edhe nga e drejta ndërkombëtare. Për këto arsye, u konsiderua i nevojshëm krijimi i një katalogu të të drejtave themelore me karakter ekonomik, politik dhe social, që garantohen dhe respektohen në BE. E drejta e jetës është e sanksionuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në Kartën e Drejtave Themelore e Bashkimit Europian. E drejta e jetës është e sanksionuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në Kartën e të drejtave dhe lirive themelore të BE-së në nenin 2 të saj. Paragrafi 1 i këtij neni është i bazuar në fjalinë e parë të nenit 2, paragrafi 1, të KEDNJ-së, i cili thotë: *“E drejta e çdo njeriu për jetën mbrohet me ligj.”* Fjala e dytë e dispozitës, e cila i referohet dënimit me vdekje, u zëvendësua nga hyrja në fuqi e Protokollit nr. 6 i KEDNJ-së, neni 1, i cili parashikon si më poshtë: *Dënimi me vdekje hiqet. Askush nuk*

mund të dënohet me një dënim të tillë, as të ekzekutohet. Kjo dispozitë është frymëzuar nga neni 2, paragrafi 2, i Kartës. dhe Protokollit Shtesë dhe, në përputhje me nenin 52, paragrafi 3 të Kartës, jepet kuptimi dhe qëllimi i këtij paragrafi. Prandaj përkufizimet dhe detyrimet “negative” që janë në KEDNJ duhet të konsiderohen njësoj edhe në Kartë.

Në Bashkimin Europian, pra nga GJED-ja kemi shume pak vendime që lidhen me të drejtën e jetës dhe posaçërisht me nenin 2 të Kartës. Kjo për shkak se, siç u theksua edhe në paragrafët e mëparshëm, Karta vetëm në fund të vitit 2009 ka hyrë në fuqi, pra si akt juridikisht i detyrueshëm për t’u aplikuar nga gjykatat e BE-së, si dhe për arsye të vendit që ka KEDNJ-ja lidhur me të drejtën e jetës dhe të raportit që ekziston ndërmjet të dyjave.

Vendimi i vetëm i drejtpërdrejtë që lidhet me nenin 2 të Kartës është vendimi C-467/10. GJED-ja, pas shqyrtimit të rekursit arrin në përfundimin se dispozitat e kombinuara të neneve 1 (2) dhe 8 (2) dhe (4) të Direktivës së Këshillit 91/439/KEE e 29 korrik 1991 në lidhje me patentat dhe ato të Nenit 2 (1) dhe 11 (4) të Direktivës 2006/126/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 20 dhjetorit 2006 në lidhje me patentat duhet të interpretohet që nuk e pengojnë legjislacionin e një Shteti Anëtar të refuzojnë ose të njohë, brenda territorit të tij, një patentë të lëshuar nga një shtet tjetër anëtar në rastin kur mbajtësi apo përdoruesi i liçensës nuk ka qenë subjekt i liçensuar nga ai Shtet Anëtar. Këto dispozita duhet të interpretohen në kuptimin që të mos ndalojnë legjislacionin e një Shteti Anëtar të vendosë kufizime apo refuzon të njohë, brenda territorit të tij, patentë për drejtim automjeti të lëshuar në një shtet tjetër anëtar në rastin kur ajo është marrë, në bazë të informacioneve të padiskutueshme që burojnë nga Shteti Anëtar që e lëshon.

Në kuadër të Këshillit të Europës me rëndësi paraqitet KEDNJ-ja. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut është një ndër Konventat më të rëndësishme të ratifikuara nga vendi ynë që zë vendin e duhur në hierarkinë e akteve normative e cila është ratifikuar me ligjin nr 8137, datë 31/07/1996 “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore. E drejta e jetës është parashikuar në nenin 2 të KEDNJ-së. Konventa ka karakter detyrues dhe jo deklarativ, sepse u imponon shteteve anëtare detyrime negative dhe pozitive në favor të mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Pjesë e KEDNJ-së janë tashmë dhe protokollet shtesë, ku ne fokusohemi në mënyrë të veçantë në

Protokollin nr:3 dhe ai nr:13, si dhe Protokollet 15 dhe 16 të cilat janë ratifikuar por nuk kanë hyrë ende në fuqi. Shtetet të cilat ratifikojnë protokollin Nr: 15, i cili amendon Konventën europiane për të drejtat e njeriut konfirmojnë se GJEDNJ-ja, mund të vazhdojë të luajë rolin e saj në mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Europë. Protokollin Nr. 16 i lejon gjykatat më të larta një Pale të Lartë Kontraktuese, siç është përcaktuar nga ky i fundit, të kërkojnë nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhënien e mendime (opinioneve) këshillimore për çështje parimore në lidhje me interpretimin ose zbatimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara nga Konventa ose protokollet e saj. Për këtë arsye Gjykata propozoi dhe gjeti të përshtatshëm si mekanizmat e reja të filtrimit për të lehtësuar punën futjen e "opinioneve këshillimore", që mund të kërkonin gjykatat e brendshme nga GJEDNJ-ja. Kjo do të çonte në zhvendosjen e ngarkesës më të madhe të punës në mbrojtjen e të drejtave të njeriut te gjykatat kombëtare dhe marrja e sa shumë legjitimiteti nga ana e GJEDNJ-së. Shqipëria e ka ratifikuar Protokollin nr. 16 nëpërmjet Ligjit Nr. 48/2015 “Për ratifikimin e protokollit të 16-të të Konventës “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore”, miratuar në datën 7.5.2015 dhe botuar në Fletoren Zyrtare datë 26.05.2015 nr.85. Opinioni këshillimor paraqet hapin e parë drejt institucionalizimit të mëtejshëm të lidhjeve dhe kontakteve mes gjykatave kombëtare dhe Gjykatës së Strasburgut. Gjykatat shqiptare janë, deri diku të kufizuara në të drejtën e tyre për të kërkuar opinion këshillimor, pasi munden vetëm të kërkojnë opinion këshillimor në kontekstin e një çështje në pritje të gjykimit të tyre. Kjo do të thotë se pyetja përkatëse ligjore duhet të ketë lindur mbi bazën e një çështjeje të diskutueshme në lidhje me të drejtat individuale dhe se procedura nuk do të lejojë shqyrtime abstrakte të legjislacionit.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka analizuar nenin 2 të Konventës si në planin substancial dhe në atë procedural. Plani substancial përkon me detyrimin e shtetit, veç rastit kur është absolutisht e domosdoshme, për të mos përdorur forcën që mund të çojë në privimin e jetës. GJEDNJ-ja ka marrë në shqyrtim një numër rastesh në të cilat pretendohet se organizimi jo i duhur dhe kontrolli nga ana e policisë ka çuar në vrasje të shumë personave, gjë kjo që bie në kundërshtim me kërkesat e nenit 2 të Konventës.

Duke patur parasysh vështirësitë për të mbikëqyrur shoqëritë moderne, paparashikueshmërinë e sjelljes njerëzore, dhe zgjedhjet operative që duhet të bëhen në

terma të prioriteteve dhe të burimeve, gjykata është e kujdesshme, kur vlerëson një detyrim pozitiv, që të mos e interpretojë nenin 2 në një mënyrë që i imponon shteteve një barrë të pamundur ose joproporcionale. Detyrimi pozitiv i shteteve mbulon edhe rastet që një individ kërkon të “vetëvritet”. Edhe në një situatë të tillë shtetet kanë detyrimin të ndërmarrin të gjitha masat për të shmangur vetëvrasjen e personave të caktuar.

Aspektet proceduriale të nenit 2 të KEDNJ-së kërkojnë që shtetet të kryejnë një hetim efektiv të vdekjeve që kanë ndodhur në kundërshtim me ligjin vendas. Edhe pse një detyrim i tillë nuk shfaqet në pamje të parë të nenit 2 të Konventës, pa atë, ndalimi për marrjen e paligjshme të jetës do të bëhej pothuajse i pakuptimtë. Për këtë arsye kjo detyrë proceduriale është ndërtuar nga ana e Gjykatës së Strasburgut për të siguruar që të drejtat substanciale të parashikuara në nenin 2 të mbrohen në mënyrë efektive në praktikë. Hetimi duhet të kryhet nga një organ i pavarur publik; duhet të jetë i plotë dhe rigoroz; duhet të jetë në gjendje të përcaktojë përgjegjësinë për vdekjen. Në qoftë se agjentët e Shtetit janë përgjegjës, hetimi duhet të jetë në gjendje të përcaktojë nëse vrasja ishte ose jo justifikuar sipas nenit 2 paragrafi 2 të KEDNJ-së. Nëse hetimi ka filluar në bazë të një ankesë penale, parashtruesi i ankesës duhet t'i krijohet mundësia për të marrë pjesë në procedurë, dhe duhet të mundësojë përfshirjen efektive. Në lidhje me objektin e hetimit, neni 2 i Konventës kërkon që agjentët e Shtetit duhet të jenë përgjegjës për përdorimin e forcës vdekjeprurëse që ushtrojnë. Prandaj veprimet e tyre, duhet t'i nënshtrohen një forme shqyrtimi të pavarur dhe publik, të aftë për të përcaktuar nëse forca e përdorur ishte apo nuk ishte e justifikuar në një grup të veçantë të rrethanave. Kriteri i dytë ka të bëjë me detyrimin e shtetit nga pikëpamja proceduriale. Në fakt, këtu bëhet dallimi ndërmjet detyrimit të rezultatit dhe detyrimit të procedurës. Në qoftë se agjentët e Shtetit janë përgjegjës, hetimi duhet të jetë në gjendje të përcaktojë nëse vrasja ishte ose jo e justifikuar sipas nenit 2 paragrafi 2. Kriteri i tretë ka të bëjë me shpejtesinë e autoriteteve në hetimin e përdorimit të forcës vdekjeprurëse. Ai duhet të jetë i plotë dhe rigoroz; duhet të jetë në gjendje të përcaktojë përgjegjësinë për vdekjen. Nëse hetimi ka filluar në bazë të një ankesë penale, parashtruesi i ankesës duhet t'i krijohet mundësia për të marrë pjesë në procedurë, dhe duhet të mundësojë përfshirjen efektive të një të afërmi tjetër. Konventa nuk e përfshin shprehimisht të drejtën për trajtim mjekësor por në shumë raste kërkuessit kanë argumentuar

se vdekjet që kanë rezultuar nga ndërhyrja dhe neglizhenca e dënueshme mjekësore duhet të përfshijnë përgjegjësinë e Shtetit në shumë mënyra. Ata pretendojnë se Shteti ka një detyrim për të siguruar një hetim të plotë të fakteve në lidhje me çështjen dhe problemet që ngrihen dhe në këto çështje të rënda Shteti ka një detyrim për të ndëshkuar personat që janë përgjegjës. Pra, neni 2 të KEDNJ-së mund të angazhojë përgjegjësinë e shtetit kur administrimi i pakujdesshëm i kujdesit shëndetësor ka rezultuar në vdekjen e një pacienti dhe do të kërkojë gjithashtu që të ketë një sistem efektiv të hetimit gjyqësor në rastet e aksidenteve mjekësore. Po ashtu autoritetet shtetërore mund të kenë një detyrim pozitiv për të marrë masa parandaluese konkrete për të mbrojtur një individ jeta e të cilit është në rrezik, për shembull nga veprat penale të një individi. Në veçanti, Shtetet duhet të marrin masa të arsyeshme për të mbrojtur të burgosurit nga kryerja e vetëvrasjes dhe nga vrasja nga një person tjetër në burg. Detyrimi për të marrë masa për të mbrojtur jetën e të burgosurve sipas nenit 2 të KEDNJ-së është veçanërisht i rreptë për shkak të pozitës së tyre të pambrojtur. Kjo përgjegjësi është reflektuar nga fakti se barra e provës në lidhje me çdo dëmtim të pësuar në burg, dhe veçanërisht vdekjen e individit, i takon shtetit. Personat e arrestuar janë në një pozitë të pafuqishme dhe detyrimi i autoriteteve për të dhënë llogari për trajtimin e një individi të paraburgosur është veçanërisht i rreptë, ku ai individ vdes ose zhduket më vonë. GJEDNJ-ja po ashtu ka trajtuar një numër çështjesh në lidhje me problemet mjedisore që pretendoheshin se ndikonin në mënyrë të drejtpërdrejtë në të drejtat individuale që mbrohen nga Konventa, duke përfshirë të drejtën për jetën. Detyrimet pozitive mund të lindin edhe kur autoritetet shtetërore nuk marrin masat e arsyeshme për të mbrojtur jetën nga rreziqet e mjedisit. E drejta për jetën do të zbatohet edhe në rastet e dëbimit apo ekstradimit të një individi, ku si pasojë mund të rezultojë vdekja e tij, megjithëse kjo ka më shumë gjasa të angazhojë nenin 3 për mbrojtje nga trajtimi çnjerëzor dhe degradues.

Në temë trajtohet gjithashtu edhe çështja e dënimit me vdekje, çështje e cila tashmë pothuajse paraqitet një problem i kapërcyer. Dënimi me vdekje si masa më ekstreme është e parashikuar të zbatohet vetëm për vepra penale me rrezikshmëri të lartë shoqërore. Sot ky dënim vazhdon të jetë në fuqi në një pjesë të vendeve në botë. Ky dënim është një dëmtim i dukshëm i të drejtës së jetës dhe në lidhje me mbrojtjen e kësaj të fundit është miratuar

Protokolli nr:6 i KEDNJ-së i cili heq dënimin me vdekje në kohë paqe. Ky Protokoll e lejon këtë dënim në kohë lufte për vepra penale me karakter kryesisht ushtarak dhe vepra me rrezikshmëri të lartë shoqërore. Protokolli nr.13 e heq përfundimisht dënimin me vdekje edhe në kohë lufte. Çështjet kryesore tani kanë lidhje me “*ekstradimin, përjashtimin dhe dëbimin*” kur parashikohet në atë vend dënimi me vdekje. Në këtë temë është analizuar në detaje e vetmja çështje që ka të bëjë me të drejtën e jetës, pra nenin 2 KEDNJ kundër Shqipërisë e cila lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me rastet e dëbimit apo ekstradimit të një individi, shtetas shqiptar, ku si pasojë mund të rezultonte vdekja e tij, edhe pse kjo është trajtuar së bashku me nenin 3 për mbrojtje nga trajtimi çnjerëzor dhe degradues. Bëhet fjalë për çështjen “*Rrapo kundër Shqipërisë*” e datës 25 shtator 2012. Gjykata shprehet teksualisht: *Është për të ardhur keq që gjykatat e ulta ranë dakort që të lejonin ekstradimin e ankuesit pa ekzaminuar mundësinë e rrezikut të pretenduar nga ai. Është shokues fakti se gjykatat e ulta nuk kërkuan kurrë siguri nga Qeveria që bënte kërkesën, se dënimi me vdekje nuk do të jepej nëse ankuesi dënohej.*

Në lidhje me vendin tonë duhet theksuar se Gjykata Kushtetuese me Vendim Nr.65 datë 10.12.1999 shpalli si antikushtetues dënimin me vdekje në kohë paqe që parashikohej në K.P., dhe K.P.U., me anë të të cilit lehtësoi e shpejtoi pozicionimin e vetë organit legjislativ, Kuvendit të R.Sh., për të bërë rregullimet përkatëse në K.P., dhe K.P.U., si dhe ratifikimin e Protokollit Nr.6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, në nenin 1.

Duke iu rikthyer edhe njëherë konceptit të jetës, Konventa në fakt nuk jep një përcaktim të qartë për jetën, gjithashtu ajo nuk përcakton kufijtë e fillimit dhe të përfundimit të mbrojtjes që kjo Konventë i bënë të drejtës së jetës. Për këtë arsye por dhe për shkak të mungesës së kompromisit ligjor në nivel evropian dhe shkencor në lidhje me çështjen, tashmë i përket hapësirës së vlerësimit të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Sipas Gjykatës, shtetet duhet të gëzojnë në këtë sferë, pavarësisht nga interpretimi i Konventës, një “*instrument jetik që duhet të interpretohet në dritën e kushteve të ditëve të sotme*”. Një problem që lidhet me të drejtën e jetës pra ka të bëjë me fillimin dhe me mbarimin e jetës fizike të qenies njerëzore. Pra ndalim tek termi “*çdo njeri*”, i përdorur në nenin 2 të KEDNJ. Në kontekstin e nenit 2 të KEDNJ-së konceptit i “*Jetës*” nënkupton

jetën njerëzore. A do të kuptohet edhe fetusit me këtë term apo jo? Në qoftë se po, kjo do të sillte që aborti, në parim, të ndalohej nga ligjvënësi dhe të kishte ndjekje penale nga organet përkatëse. Së pari, duhet thënë dhe për të gjithë është më se e qartë, se në këtë çështje ndërthuren pikëpamje sociale, morale, fetare, politike, juridike, shëndetësore etj. Së dyti, duhet thënë se si në rrafshin kombëtar, ashtu edhe në atë ndërkombëtar, nuk ka një konsensus. Megjithatë, duke iu referuar Komisionit Europian të të Drejtave të Njeriut, me termin “çdo njeri”, të përdorur në KEDNJ, nuk i është njohur fetusit e drejta absolute për jetë, por edhe në gjykatë, nuk është paraqitur për gjykim ndonjë çështje që të kërkojë një zgjidhje të qartë dhe të prerë lidhur me abortin. Çështja e lejimit të abortit ka qenë objekt diskutimesh kontradiktore që në fillimet e lindjes së konceptit të abortit. Në fakt, në mungesë të një kompromisi evropian (apo mbarë botëror) ligjor apo shkencor në lidhje me çështjen, Komisioni, gjatë kohës kur ende ekzistonte, dhe madje edhe Gjykata tani, nuk ka vullnetin për të vendosur standarde të sakta në këtë kuadër. Nga ana tjetër Gjykata e Strasburgut u shpreh se nuk ka një interpretim në lidhje me çështjen nëse një fëmijë që nuk ka lindur ende mund të konsiderohet një person për qëllimet e nenit 2 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Siç e përcaktoi edhe Gjykata në çështjen e *Vo kundër Francës*: ... çështja se kur fillon e drejta për jetën i përket hapësirës së vlerësimit që Gjykata zakonisht konsideron se, Shtetet duhet të gëzojnë në këtë sferë, pavarësisht nga interpretimi i Konventës, një “instrument jetik që duhet të interpretohet në dritën e kushteve të ditëve të sotme” (...). Ashtu si legjislacionet e shteteve amerikane, edhe legjislacionet e vendeve anëtare të KEDNJ ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme nga njëri tjetri lidhur me përgjigjen e pyetjes se kur fillon jeta dhe përcaktimin e nocionit “njeri”. Në fushën shkencore ka dy qëndrime mbi statusin moral të embrionit e si rrjedhojë dhe të mbrojtjes ligjore që i ofrohet: - embrionet njerëzore nuk konsiderohen qenie njerëzore, e si rrjedhojë mbrojtja që u ofrohet është relative; dhe qëndrimi i dytë, se embrionet njerëzore kanë të njëjtin status moral si qeniet njerëzore e si rrjedhojë mbrojtja që i ofrohet të dyve është e njëjtë. Shumë vende të Evropës, gjatë diskutimeve dhe nënshkrimit të Konventës së Këshillit të Europës mbi të Drejtat e Njeriut dhe Biomjekësinë, nuk arritën të kenë një konsensus lidhur me përcaktimin e embrionit, e si rrjedhojë, ishin në pamundësi për të përfshirë kërkimet mbi embrionin në Konventë.

Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut u lë vendeve anëtare një marzh/hapësirë vlerësimi lidhur me çështjen e fillimit të jetës. Kjo në varësi të standardeve kombëtare, kulturës, drejtimit fetar të çdo vendi anëtar të saj. Kjo për shkak se edhe vetë Shtetet Anëtare kanë qenë në pamundësi për të zgjidhur konfliktet ndërmjet tyre për çështjen. Në ditët e sotme, statusi i embrionit dhe/ose fetusit ka filluar të ketë njëfarë mbrojtjeje si rrjedhojë e progresit shkencor dhe pasojave potenciale të kërkimeve në inxhinierinë gjenetike, rikrijimin mjekësor të vëzhguar (*in vitro*) ose eksperimente mbi embrionin. Ligji shqiptar po ashtu si ligjet e shumë vendeve të tjera, nuk parashikojnë të drejtën absolute të fetusit për të jetuar. Kjo e drejtë nëse do të njihej do të pengonte ushtrimin e të drejtës së grave për të vetëvendosur si pjesë e të drejtës për jetë private, dhe pikërisht të së drejtës së tyre për të ndërprerë shtatzëninë, në përputhje me kriteret e përcaktuara në ligj. Në këto kushte asnjë person, madje as bashkëshorti, nuk mund të kërkojë qoftë nga gjykata kufizimin e kësaj të drejte. Praktika gjyqësore e huaj ka mbajtur qëndrimin se mjeku i cili jep informacion për medikamente të cilat shkaktojnë ndërprerjen e shtatzënisë, jashtë rasteve të parashikuara në ligj, mban përgjegjësi penale. Mbrojtja dhe respektimi i të drejtës së jetës së individit, e konceptuar dhe e sanksionuar si një nga të drejtat më themelore të njeriut, qëndron në themel të legjislacionit tonë kushtetues dhe të atij penal e procedural penal. Jeta e personit mbrohet me ligj. Në këtë mënyrë është sanksionuar koncepti juridik i mbrojtjes së jetës njerëzore në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Ky formulim shpreh qartë dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë mbrojtjen e jetës së njeriut, e cila përbën një vlerë kushtetuese. Duke ardhur në legjislacionin shqiptar, kemi parasysh legjislacionin përkatës në këtë fushë, ku Ligji nr. 8045, datë 07.12.1995 Për ndërprerjen e shtatzënisë”, njeh të drejtën e ndërprerjes së vullnetshme të shtatzënisë, vetëm në disa kushte të caktuara.

Një specifikë lidhur me abortin në shoqërinë shqiptare e cila vitet e fundit po konsiderohet shqetësuese ka të bëjë me abortin selektiv. Gjatë viteve të fundit është vënë re një rritje e tendencave për abortet selektive, ku shumë prindër, pasi mësojnë se fëmija që do sjellin në jetë nuk është i seksit mashkull, preferojnë ta abortojnë. Ky fakt shqetësues është konfirmuar edhe nga studimi i kryer mbi balancat gjinore të lindjeve në vendin tonë. Studimi vë në dukje se popullsia shqiptare ka qenë e dominuar nga meshkujt për një kohë

të gjatë, por vitet e fundit është vënë re një rritje e mëtejshme e këtij dominimi. Për të gjitha sa më sipër, Ministria e Shëndetësisë e konsideron ndërprerjen e shtatzënisë me qëllim përzgjedhjen e seksit fetal, si një veprim absurd, moralisht dhe ligjërisht të dënueshëm.

Interesant paraqitet gjithashtu momenti i mbarimit të jetës. Këtu ngrihet problemi i eutanazisë. Disa e shohin këtë si një raport midis mbrojtjes të së drejtës për të jetuar dhe moslejimit të torturës dhe të vuajtjes. Edhe në këtë çështje nuk ka një qëndrim të njëjtë nga shtetet, që ndodhen nën juridiksionin e KEDNJ. Kohët e fundit, në Hollandë, apo edhe në ndonjë vend tjetër, është lejuar eutanazia. Ndoshta këtu duhet të kemi parasysh që Holanda është një shtet disi liberal në mjaft drejtime. Të vetmet çështje të GJEDNJ-se në këtë fushë kanë pasur të bëjnë me grupin e pyetjeve: nëse një person që është i sëmurë rëndë fizikisht, por që gëzon shëndet të plotë mendërisht ka të drejtë të zgjedhë që të vdesë duke kryer më mirë vetëvrasje, sesa të vazhdojë të jetojë dhe nëse ndodh kështu, nëse ai person mund të kërkojë asistencë nga të tjerët për t'i dhënë fund jetës, apo nëse Shteti ka të drejtë apo detyrim për të ndërhyrë në parandalimin e sa më sipër. Gjykata ka shqyrtuar këto pyetje në periudha të ndryshme, në situata të ndryshme dhe duke iu referuar jo vetëm Neni 2, por edhe neneve të tjera të Konventës. Në veçanti i ka lidhur analizat e saj në lidhje me Nenet 2, 3 dhe 8 në mënyrë të tillë që të demonstrojë përjasjen e saj ndaj të drejtave që mbrohen në Konventë. Disa nga çështjet më të fundit mund të merren si referencë në lidhje me pyetjen e përgjithshme rreth së “drejtës për të vdekur”, ato të *Sanles Sanles kundër Spanjës*, *Pretty kundër Mbretërisë së Bashkuar dhe Lambert*, vendimi i fundit i GEJDNJ-se. Në të gjitha çështjet e parashtruara në Gjykatë është vënë vazhdimisht theksi tek detyrimi i Shtetit për të mbrojtur jetën. Neni 2, pa ndryshuar gjuhën e shprehur, nuk mund të interpretohet se jep diametrikisht të drejtën e kundërt, përkatësisht të drejtën për të vdekur; ai as nuk mund të krijojë një të drejtë për vetëvendosje në kuptimin që i japin një individ të drejtën për të zgjedhur vdekjen dhe jo jetën. Gjykata përkatësisht konstaton se nuk mund të rrjedhë nga Neni 2 i Konventës asnjë e drejtë për të vdekur, qoftë në duart e një personi të tretë, apo me ndihmën e një autoriteti publik. Kjo pikëpamje pohohet nga Rekomandimi i fundit 1418 i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës. Eutanazia aktive konsiderohet si krim në pjesën më të madhe të vendeve të botës dhe ligjet në lidhje

më të, diku janë të qarta, në një shtet tjetër jo, e sidomos në lidhje me vetëvrasjen e asistuar. Ne kemi sjellë eksperiencën e disa vendeve të Europës dhe më gjërë lidhur me eutanazinë. Sa i takon Shqipërisë, kohët e fundit është diskutuar disa herë në media çështja e eutanazisë në vendin tonë, duke menduar se do te ishte e udhës që ajo të lejohej edhe në vendin tonë. Eutanazia implikon individin dhe shoqërinë; është çështje përgjegjësie shtetërore dhe vetjake; ndërlikon filozofinë për jetën, teologjinë, etikën, mjekësinë, jurisprudencën që të mos trajtohet me hipokrizi apo mjete dhe praktika ilegale që shkelin dinjitetin njerëzor edhe në fund të jetës, por të mbahet një qëndrim i caktuar kundrejt saj nëpërmjet parashikimit të dispozitave ligjore në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kodin Penal dhe akte të tjera ligjore. Eutanazia, eutanazia aktive, eutanazia pasive, ndihma në vetëvrasje, si terma janë të njohur në praktikën tonë mjekësore, sidomos dhjetëvjeçarin e fundit. Në fakt, ato nuk janë praktikuar ende, përveç disa rasteve të ashtuquajtura trajtim mjekësor lehtësues si një lloj i eutanazisë pasive. Deri më sot nuk ka patur asnjë rast në Shqipëri, të ndjekjes penale apo të dënimit të mjekëve për kryerje të eutanazisë. Megjithatë ajo ka qenë aplikuar dhe aplikohet tek ne si psh: eutanazia pasive e të sëmurëve ose të plagosurve të pakurueshëm, ku ekipi mjekësor, për shkak të gjendjes ende të prapambetur të mjekësisë, mungesës së pajisjeve moderne, ka qenë i detyruar të pranojë eutanazinë pasive. Në përfundim të këtij diskutimi mendoj që në vendin tonë nuk është ende koha për të lejuar eutanazinë pasi në gjykimin tonë kushtet dhe niveli i jetesës, i kombinuar me rrethana të tjera lidhur me mjekësinë e bëjnë të pamundur dhe të përsheptuar lejimin e saj.

REKOMANDIME

Nga studimi në fjalë me shumë modesti po sjellim këtu disa rekomandime. E drejta e çdo njeriu për jetën mbrohet me ligj dhe ajo nuk i adresohet në mënyrë ekskluzive vetëm ligjvënësit, por i referohet një detyrimi të përgjithshëm të autoriteteve, për të marrë masa të përshtatshme për mbrojtjen e jetës së njerëzve.

1. Autoritetet shtetërore duhet të marrin masa të përshtatshme, konkrete dhe efektive për mbrojtjen e jetës së shtetasve. Rekomandohet në këtë drejtim rritja

e vazhdueshme e autoritetit të shtetit të të drejtës për sigurimin e rendit e të qetësisë, për mbrojtjen e jetës së njeriut, është kërkesa kryesore që dikton situata e tanishme dhe në të ardhmen.

2. Për respektimin e të drejtës së jetës nevojiten si reforma ligjore ashtu edhe mekanizma zbatues efektiv.
3. Vendi ynë duhet të sigurojë të drejtën e jetës shtetasve të vet me të gjitha mënyrat përfshirë këtu edhe nga gjykatat, të cilat janë tepër të rëndësishme për zbatimin e kësaj të drejte themelore.
4. Të gjithë organizmat shtetërorë duhet të orientohen dhe t'i referohen gjithmonë e më shume rekomandimeve të Këshillit të Europës për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtës së jetës.
5. Po ashtu gjykatat në mënyrë të veçantë duhet medoemos të mbajnë parasysht jurisprudencën e GJEDNJ-së lidhur me çështjet që implikon garantimi i të drejtës së jetës. Një vlerë të veçantë në këtë drejtim pati vendimi “*Rrapo kunder Shqipërisë*” ku GJEDNJ-ja tërhoqi vëmendjen gjykatave dhe në përgjithësi shtetit shqiptar.
6. Gjyqtarët duhet të trajtohen në vazhdimësi mbi këtë jurisprudencë dhe praktikë gjyqësore.
7. Po ashtu duhet patur parasysht që çështjet e ekstradimit të shtetasve shqiptarë, kur përfshihet dënimi me vdekje në një shtet tjetër ku individi ka kryer krime, duhet të trajtohen më me kujdes nga gjyqtarët shqiptarë dhe nga Ministria e Jashtme. Në këtë drejtim gjyqtarët dhe gjithë autoritetet shtetërore që përfshihen në respektimin e mbrojtjes së jetës, edhe me qëllim integrimin e vendit në BE duhet të orientohen dhe të njohin mirë edhe jurisprudencën e Strasburgut dhe të ndjekin nga afër zhvillimet e fundit në shoqëritë demokratike.
8. Sa i takon nenit 2 KEDNJ dhe nenit 2 të Kartës, duhen ndjekur nga afër zhvillimet e fundit dhe të kemi një përjasje të plotë me këto rende juridike mbikombëtare.
9. Sa i takon çështjeve të abortit, në vendin tonë duhen marrë masa urgjente për reduktimin në maksimum të abortit në moshë të vogël dhe abortit selektiv.

Masat konkrete për eliminimin e fenomenit të abortit selektiv dhe atij në moshë të vogël, që prek në mënyrë të drejtëpërdrejtë vendin tonë, duhet të trajtohen jo nga pikëpamja modifikimeve ligjore por ato sociale. Një vlerë të vecantë këtu merr çështja e parandalimit dhe planifikimit familjar.

10. Edukimi i vajzave në moshë të re mbetet gjithsesi një çështje tepër e rëndësishme dhe prioritare.
11. Sa i takon fenomenit të eutanazisë mendoj se nuk është ende koha për përfshirjen e saj në legjislacionin tonë. Shqipëria duhet të marrë parasysh në respektimin e kësaj të drejte rekomandimet e Këshillit të Europës si dhe në mënyrë të veçantë jurisprudencën e GJEDNJ-së. Vetëm nëse do të arrihet edhe në Shtete të tjera të Europës përfshirja e eutanazisë, vendi ynë do të mund të lejojë eutanazinë.
12. Vendi ynë duhet të garantojë respektimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, mbi të drejtën për të jetuar, të drejtën për të vdekur dhe të drejtën e abortit në bazë të zhvillimeve të fundit dhe bashkëkohore lidhur me këto koncepte.

BIBLIOGRAFI

Burime Parësore

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
2. Kodi Penal i Shqipërisë i vitit 1995.
3. Kodit Penal Austriak.
4. Kodit Penal Gjerman
5. Kodit Penal Norvegjez.
6. Ligji Danez i vitit 1998 mbi Eutanazinë Pasive
7. Rezoluta 613 e vitit 1976 e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës
“Për të drejtat e pacientit në fazën e fundit të sëmundjes dhe që është duke vdekur”.
8. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut
9. Konventa Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut
10. Konventa për “mbrojtjen e grave shtatëzana” Nr. 103 në vitin 1952
11. Pakti Ndërkombëtar mbi të drejtat Civile dhe Shoqërore
12. Pakti Ndërkombëtar mbi të drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore
13. Konventa kundër torturës dhe dhunës, trajtimit apo ndëshkimit çnjerëzor dhe poshtërues.
14. Konventa mbi të drejtat e fëmijëve
15. Marrëveshja e stabilizim Asociimit
16. Karta e Lirive dhe e të Drejtave Themelore
17. Karta Sociale Europiane

18. Protokolli Nr.4 i Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut
19. Protokolli Nr.6 i Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut
20. Protokolli Nr.7 i Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut
21. Protokolli Nr.12 i Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut
22. Protokolli Nr.13 i Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut
23. Protokolli Nr.14 i Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut
24. Protokolli Nr.15 i Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut
25. Protokolli Nr.16 i Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut
26. Karta Afrikane për të Drejtat e Njeriut dhe Popujve
27. Ligji nr. 8045 datë 07.12.1995 “Për ndërprerjen e shtatëzanisë”
28. Ligji nr. 10107 datë 30.03.2009 “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”
29. Ligj nr. 10 339, datë 28.10.2010 “Për Aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën për të drejtat e njeriut dhe Biomjeksinë”.

Burime dytësore

1. Akandji-Kombe Jean-Francois, (2005), *Detyrimet pozitive sipas Konventës Europiane të Drejtave Të Njeriut. Udhërrefyes për përdorimin e Konventës Evropiane të Drejtave të Njeriut*, Këshilli i Europës, Manual i të drejtave të njeriut, fq. 20-35.

2. Aleksandras Dobryninas. (1999). Përvoja e Lituanise lidhur me heqjen e dënimit me vdekje, në heqjen e dënimit me vdekje në Shqipëri, materialet nga konferenca ndërkombëtare e organizuar në bashkëpunim nga Kuvendi i Shqipërisë, Këshilli i Evropës.
3. Alfredson, Gundumur et. Al. 1999. *The Universal Declaration of Human Rights*. Oslo: Scandinavian University Press.
4. Alston, Philip (ed.). 1999. *The EU and Human Rights*. Oxford: Oxford University Press.
5. Alston, Philip and James Craëford (eds.). 2000. *The Future of UN Human Rights Treaty Monitoring*. Cambridge: Cambridge University Press.
6. American Civil Liberties Union. (2000). Briefing Paper The Death Penalty.
7. Anastasi A., (2010) *Të drejtat e gruas në legjislacionin shqiptar*, Tiranë.
8. Anastasi.A,Omari.L, 2010. E drejta Kushtetuese ABC,Tirane.
9. Aristotele. (2000). *Etica Nicomachea*, BOMPIANI.
10. Bacon F.(1623) *De Digitate et eugmentis scientiarum*.
11. Baefsky, Anne F. 2002. *Hoë to Complain to the UN Human Rights Treaty System*. Transnational Publishers.
12. Baxi, U., (2002). *The Future of Human Rights*. Oxford University Press.
13. Beauchamp, Tom L.; Davidson, Arnold I. (1979). "The Definition of Euthanasia". *Journal of Medicine and Philosophy*
14. Beauchamp, Tom L.; Davidson, Arnold I. (1979). "The Definition of Euthanasia". *Journal of Medicine and Philosophy*
15. Blaser.(2000) 'Eutanazia dhe të Drejtat e Njeriut Ligj:? përputhshme ose kontradiktor ' Studimeve Ndërkombëtare Shoqata, në dispozicion në <http://ëëë.ciaonet.org/isa/bla01/>
16. Borchardt, K.D. (2011). *ABC-ja e së drejtës së Bashkimit European*. Tiranë: Ministria e Integritit.
17. Bosshard, Georg et al. (2002). Rregullorja dhe praktika për vdekjen e asistuar në: *Revisten Javore Mjekësore*, 2002, nr. 132: 527-534.

18. Harper Collins. Edëards, Steven D. (2003): Tre konceptet e vuajtjes. Në: *Mjekësia, Shëndetësia dhe Filozofi*, 2003, nr. 6: 59-66.
19. Brody, Baruch (1975). "Voluntary Euthanasia and the Laë". In Kohl, Marvin. *Beneficient Euthanasia*. Buffalo, Neë York: Prometheus Books.
20. Buonnano, L., & Nugent, N., (2013). *Politikat dhe proçeset e politikave te Bashkimit European*, Kosovë: Universum Press,
21. C. Catanzaro, "Eutanasia: aspekti një confronto", në dispozicion në: <http://www.sophia.unical.it/tesi/eutanasia/default.htm>
22. Callahan, Danieli (1992). Vetëvendosje (Ed.) (1999): *Bioetika. Një antologji*. Oxford, Blackëell Publishers.
23. Canaj E., & Bana S., (2014). *E drejta e Bashkimit European*. Tiranë: Arbëria 07.
24. Cassell, Eric J. (1991): *Natyra e vuajtjeve*. Oxford University Press.
25. Cassese, A. (2001), *International Criminal Laë. A Commentary on the Rome Statute for an Internaitonal Criminal Court*. Oxford: Oxford University Press.
26. Ceco, M., (2002) *Pajtimi i gjajeve në kontekstin e trajtimit të konflikteve në Shqipëri* kumtesë në Konferencën Kombëtare "Shteti dhe shoqëria civile në mbrojtje të të drejtës së jetës",
27. Council of Europe (ed.) (2000) *Human Rights in International Laë*, Basic texts. Strasburg: Council of Europe Publishing.
28. Counsil of Europe(2003) Euthanasia, ethical and human aspects.
29. Craig, P. Burca, D. (2013). *E drejta e Bashkimit European*. Teksti. Vendimet dhe materialet. Tiranë: AIIS (perkth.) Vol I.
30. *Cross - perspektiva kulturore në etikën mjekësore. Londër: Jones dhe Bartlett*
31. D'Aquino T., *Summa Theologiae*, II-II. Qu. 64, art. 5.
32. D'Arcy, (2003). *Politikat e Bashkimit European*. Tiranë: Papirus.
33. Daci, J. (2011). *Të drejtat e njeriut*. botimi i III, Tiranë: Julvin 2.
34. Danja Sinani. (2011). Perkufizimi juridik i vdekjes "eutanzasia".
35. De Haan, Jurriaan (2002): Ligji i ri holandez mbi eutanazisë. Në: *Rishikim Mjekësor Ligji*, 2002, nr.10: 57-75.
36. Dhoma e Lordëve (1994): Raporti i komisionit të zgjedhur për etikën mjekësore.

37. Dobjani E., (2002) Fjala e hapjes në Konferencën Kombëtare “Shteti dhe shoqëria civile në mbrojtje të të drejtës së jetës”, mbajtur në Konferencën Kombëtare, “Shteti dhe shoqëria civile në mbrojtje të të drejtës së jetës”, Tiranë, Luarasi,
38. Doutriaux, Y & Lequesne, Ch.,(2007). *Institucionet e Bashkimit Europian*. Tiranë: Papirus.
39. Draper, Heather (1998). "Euthanasia". In Chadwick, Ruth. *Encyclopedia of Applied Ethics 2*. Academic Press.
40. ELEZI - S. Kaçupi - M. HAXHIA. (2001). "Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë", Tiranë.
41. Elezi I., (2002) *Mbrojtja e të drejtës për të jetuar- si e drejta më themelore e njeriut*, kumtesë në Konferencën Kombëtare “Shteti dhe shoqëria civile në mbrojtje të të drejtës së jetës”,
42. Elezi, I. 2009, E Drejta Penale, pjesa e posacme, ERIK.Tiranë.
43. Emanuel, Ezekiel (1994). "The history of euthanasia debates in the United States and Britain". *Annals of Internal Medicine*
44. Fjalorth per integrimin europian, institucionet dhe politikat e Bashkimit Europian (2010), Tiranë; Ministria e Integritetit, (në varësi të konceptit).
45. Freeman, M., (2002) *Human Rights*, Oxford: Polity
46. Gesundheit, Benjamin; Steinberg, Avraham; Glick, Shimon; Or, Reuven; Jotkovitz, Alan (2006). "Euthanasia: An Overvieë and the Jeëish Perspective". *Cancer Investigation*
47. Gjoncaj A. (2010) “Raport i paekuilibruar midis sekseve në lindje në Shqipëri”.
48. Gomien, D. (2005). *Udhëzues i shkurtër për Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut*. Universiteti i Oslos.
49. Graves, FA (1989): Përgjegjësia e mjekut ndaj pacientëve të sëmurë të pashpresë. Në: *Neë England Journal e Mjekësisë*, 1989, nr. 321:976-7. Griffiths, John et al. (1998): *Eutanazia dhe ligji në Holandë*. Amsterdam University Press.
50. Gruda, Z. (2000). *Mbrojtja ndërkombëtare e të drejtave të njeriut*. (Volumi 1&2), Prishtinë: TIMEGATE.

51. Gurney, Edëard (1972). "Is There a Right to Die – A Study of the Law of Euthanasia". Cumberland-Samford Law Review
52. Harris, John (2003): Pëlqimi dhe fundi i vendimeve të jetës. Në: *Gazetën e Etikës Mjekësore*, 2003, nr.29: 10-15.
53. Harris, NM. (2001). "The euthanasia debate". J R Army Med Corps, October
54. Helge Dvorak (2000) Biographisches Lexikon der Deutschen Burschenschaft. Vol. I. Heidelberg,
55. Heqja e dënimit me vdekje në Shqipëri, Toena, Tirane 2001.
56. Hodginson P dhe Rutherford A, 1996, Capital Punishment Global Issues and Prospects, Eaterside Press, Volume II.
57. Ian Doëbiggin (March 2007). A Concise History of Euthanasia: Life, Death, God, and Medicine. Roëman & Littlefield.
58. Ilir Panda, (2002) *E drejta e jetës sipas Konventës europiane për të drejtat e njeriut*, kumtese e mbajtur në Konferencën Kombëtare, *Shteti dhe shoqëria civile në mbrojtje të të drejtës së jetës*, Tirane, Luarasi.
59. Jacque, J. (2010) *E drejta institucionale e Bashkimit Europian*. Tiranë: Papirus.
60. Janis, M. (2000). *E drejta europiane e të drejtave të njeriut*. Prishtine.
61. Keoën, J (2001): Eutanazia, Etika dhe Politikat Publike. Një argument kundër Legalizimit. Cambridge University Press.
62. Kohl, Marvin (1974). "The Morality of Killing]" New York: Humanities Press.
63. Kohl, Marvin; Kurtz, Paul (1975). "A Plea for Beneficent Euthanasia". Beneficent Euthanasia. Buffalo, New York
64. Kongregacioni i shenjtë për Doktrinën e Besimit (1980): Deklarata për eutanazisë.
65. Kristo, V., (2007) *Kontrolli kushtetues i pajtueshmërisë së legjislacionit shqiptar me standardet e KEDNJ*, kumtesë në Konferencën Kombëtare, *Përmirësimi i cilësisë së zbatimit të KEDNJ nëpërmjet zgjerimit të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve vendase*, Tirane, 1.
66. LaFollette, Hugh (2002). Ethics in practice: an anthology. Oxford: Blackwell.
67. Lazoëski, A., & Bushati, A. (2014). *Bazat e së drejtës europiane*, Tiranë: Dudaj.

68. Luarasi A., (2002) Raportet aktuale ndërmjet të drejtës shtetërore dhe të drejtës zakonore shqiptare, kumtesë në Konferencën Kombëtare “Shteti dhe shoqëria civile në mbrojtje të të drejtës së jetës”.
69. Magro M.B. (2001). *Eutanasia e diritto penale*, Torino.
70. Mannes, Marya (1975). "Euthanasia vs. the Right to Life". *Baylor Law Review* 27
71. Manoj Kumar Mohanty (2004). "Variants of homicide: a review". *Journal of Clinical Forensic Medicine* 11
72. Markert Michler (1990), "Marx, Karl, Mediziner", *Neue Deutsche Biographie (NDB) German*
73. Materstvedt, Lars Johan; Clark, David; Ellershae, John; Førde, Reidun; Boeck Gravgaard, Anne-Marie; Müller-Busch, Christof; Porta i Sales, Josep; Rapin, Charles-Henri (2003). "Euthanasia and physician-assisted suicide: a view from an EAPC Ethics Task Force". *Palliative Medicine*
74. Michalsen A, Reinhart K (2006). "'Euthanasia': A confusing term, abused under the Nazi regime and misused in present end-of-life debate". *Intensive Care Med*, 22
75. Milo, P. (2002). *Bashkimi Evropian, Ideja, Integrimi, Identiteti, E ardhmja*, Tiranë: Albpaper.
76. Morselli E. (1923). *L'uccisione pietosa (Eutanasia)*, Torino.
77. Naço, N. (2002) *Roli i prokurorisë në parandalimin dhe luftën kundër krimeve të jetës*, kumtesë në Konferencën Kombëtare “Shteti dhe shoqëria civile në mbrojtje të të drejtës së jetës”,
78. *Në mbrojtje të lirive themelore. Jurisprudencë dhe interpretime të rregullimit të jetës dhe aktivitetit të autoriteteve shtetërore në Evropë*, (2010), Qendra Shqiptare e Rehabilitimit të Traumës dhe Torturës, Tiranë.
79. Nick Kemp (7 September 2002). *Merciful Release*. Manchester University Press.
80. Nourissat, C., (2010) *E drejta e biznesit e Bashkimit Evropian*. Tiranë: Papirus,
81. Nuni F., (2002) *Shteti dhe shoqëria civile në mbrojtje të të drejtës së jetës*, kumtesë në Konferencën Kombëtare “Shteti dhe shoqëria civile në mbrojtje të të drejtës së jetës”,

82. Oluyemisi Bamgbose (2004). "Euthanasia: Another Face of Murder". International Journal of Offender Therapy and Comparative Criminology
83. Otani, Izumi (2010). ""Good Manner of Dying" as a Normative Concept: "Autocide", "Granny Dumping" and Discussions on Euthanasia/Death with Dignity in Japan". International Journal of Japanese Society
84. Oxford Dictionaries. Oxford University Press. April 2010. Retrieved 26 April 2011.
85. Pappas, Demetra (1996). "Recent historical perspectives regarding medical euthanasia and physician assisted suicide". British Medical Bulletin
86. Perrett R.E. (October 1996). "Buddhism, euthanasia and the sanctity of life". J Med Ethics
87. Philippe Letellier, (2001) "History and Definition of a Word, in Euthanasia" Ethical and Human Aspects By Council of Europe
88. Porcarelli A., Eutansia nella storia.
89. R Cohen-Almagor (2009). "Belgian euthanasia law: a critical analysis". J. Med. Ethics
90. Rachels J (January 1975). "Active and passive euthanasia". N. Engl. J. Med.
91. Ramsay, J H R (28 May 2011). "A king, a doctor, and a convenient death". British Medical Journal
92. Roger Hood. (2001). The Death Penalty: A World-wide Perspective, Oxford, Clarendon Press.
93. Schotsmans, P. (1993): Pacienti në një gjendje të vazhdueshme vegjetative. Një etike ri-vlerësim. në: Tijdschrift voor filosofie en theologie, nr. 54.
94. Singer, Peter (1993): Çfarë është e gabuar me vrasjen? Në: Singer, Peter: Etika praktike. Cambridge University Press.
95. Smith, R., (2003) *Textbook on International Human Rights*, Oxford: Oxford University Press.
96. Stolberg, Michael (2007). "Active Euthanasia in Pre-Modern Society, 1500–1800: Learned Debates and Popular Practices". Social History of Medicine
97. Toska Dobjani E., (2011) *Gjykata kushtetuese shqiptare si një mjet ankimi efektiv në kuadër të Konventës Europiane të të drejtave të njeriut në lidhje me*

mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, Revista Shqiptare Ligjore, vol. 1, fq. 25-35.

98. Van der Heide, Agnes et al. (2003): Fundi-i-jetës vendim-marrje në gjashtë vende evropiane: studim përshkrues. Në:, *Lancet* vol. 361: 345 350.
99. Vdekja nuk është drejtësi, Toena, Tetor 2001.
100. Eesley J. Smith (1997). *Forced Exit* . Në York: Times Books.
101. Weston, Burt H. - Stephen P. M., (1999) *The Future of International Human Rights*. Në York: Transnational
102. Wreen, Michael (1988). "The Definition of Euthanasia". *Philosophy and Phenomenological Research*
103. Zaganjori Xh, ., (2007) *Efektiviteti i mjeteve të brendshme të sistemit shqiptar në kuptimin e nenit 13 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut*, kumtesë e mbajtur në Konferencën Kombëtare me temë” Përmirësimi i cilësisë së zbatimit të KEDNJ nëpërmjet zgjerimit të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve vendase”, Tirane, fq.1-10)
104. Zaganjori, Xh., & Vorpsi, A., & Biba, D. (2012). *Parime kushtetuese dhe të drejta themelore në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese*, Tiranë: Adelprint.
105. Zyberi, G. (2011). *E drejta ndërkombëtare e të drejtave të njeriut*. Tiranë: BOTART.

Vendime Gjyqësore të GJEDNJ-së

Ahmed kundër Austrisë, (1996) (GJENDNJ)

Anguelova kundër Bullgarisë (2002) (GJENDNJ)

Bazorkina kundër Rusia,(2006) (GJENDNJ)

Branko TOMAŠIĆ etj.kundër Kroacisë, (2009) (GJENDNJ)

Cavit Tinarlioglu kundër Turqisë, (2016)

Dülek kundër Turqisë,(2011) (GJENDNJ)

Elena Apostol and others kundër Rumanisë (2016)

Ergi kundër Turqisë, Luluyev v Ruisë Luluyev, (2006) (GJENDNJ)
Erikson kundër Italisë, (1999) (GJENDNJ)
Gulec kundër Turqisë, (1998) (GJENDNJ)
Isenc kundër Francës (2016)
Jordan kundër Mbretërisë së Bashkuar
Keenan kundër Mbretërisë së Bashkuar, (2001) (GJENDNJ)
Kiliç kundër Turqisë, (2000) (GJENDNJ)
Kurt kundër Turqisë,(1998) (GJENDNJ)
Lopes de Sousa Fernandes kundër Portugalisë (2015)
Luluyev dhe të tjerët kundër Ruisë, (GJENDNJ)
Mahkraiyeve kundër Ruisë, (2011) (GJENDNJ)
Maiorano kundër Italisë, (2009) (GJENDNJ)
McCann kundër Mbretërisë së Bashkuar, (GJENDNJ)
McGlinchey kundër Mbretërisë së Bashkuar, (2003) (GJENDNJ)
Mihu kundër Rumanisë, (2016)
Ogura kundër Turqisë (GJENDNJ)
Oneryildiz kundër Turqisë, (2002). (GJENDNJ)
Oneryildiz kundër Turqisë, (2005) (GJENDNJ)
Osman kundër Britania e Madhe, (1998) (GJENDNJ)
Oztunc kundër Turqise (2016)
Paul dhe Audrey Edëards kundër Mbretërisë së Bashkuar, (2002) (GJENDNJ)
Salman kundër Turqisë (2000) (GJENDNJ)
Tais kundër Francës (2006,) (GJENDNJ)
Tarariyeva kundër Russia, (GJENDNJ)
Vo kundër Francës(2000) (GJENDNJ)
Yasa kundër Turqi (1998) (GJENDNJ)

Website

- i. www.bundesgerichtshof.de/cln_134/EN/Judges.
- ii. www.euthanasia/USA/History/html
- iii. www.medicalethics.com
- iv. www.religioustolerance.org/euthanas.htm
- v. <http://www.thefreedictionary.com>
- vi. http://www.schreeuwomleven.nl/abortus/text_of_dutch_euthanasia_law.doc.
- vii. <http://www.legal-dictionary.thefreedictionary.com/homicide>
- viii. <http://www.dictionary.reference.com/browse/homicide>
- ix. <http://www.depts.washington.edu/bioethx/topics/pas.html>
- x. http://www.leg.state.or.us/comm/commsrvs/background_briefs2004/Health%20Care/FG_Physician_Assisted_Suicide2004.pdf